


HALIL RAMA



Kritika letrare



Tedor Laço
Eshref Ymeri
Bujar Kapexhiu
Fatos Daci
Sakip Cami
Irfan Dashi
Avni Ndreu

Naim Berisha
Emmy Krosi
Barie Çupi
Demir Rusi
Rexhep Polisi
Shpëtim Cami
+++++



40 VEPRA LETRARE TË 40 AUTORËVE, NË "SKANER"

Me parathënie të Prof. dr. Eshref Ymeri

HALIL RAMA

40 VEPRA LETRARE
TË 40 AUTORËVE, NË “SKANER”

- Profile krijuesish dhe kritika letrare -

Tiranë 2024

Titulli:
40 VEPRA LETRARE
TË 40 AUTORËVE, NË “SKANER”
- Profile krijuesish dhe kritika letrare -

Autor:
HALIL RAMA

Redaktor:
Dr. Hajri Mandri

Recensent:
Prof. dr. Eshref Ymeri

Art grafik:
DASHAMIR VRANIÇI

ISBN:
9789928355935

Shtëpia botuese



PASQYRA E LËNDËS

PARATHËNIE nga Prof. dr. Eshref Ymeri: Arti i analizave kritike të Halil Ramës, Mjeshtër i Madh	5
---	---

- I-

PROFILE KRIJUESISH

• Presidenti Reagan ose ëndërra amerikane e jetësuar	12
• Adn-ja e pandryshuar e Shefki Karadakut.....	19
• Teodor Laço, njeriu i letrave, politikës dhe diplomacisë.....	26
• Dr.Sali Kurti, “Nderi” i Klubit Letrar “Pjetër Budi”	33

-II-

PROZA

• Çfarë kënaqësie të lexosh Zija Çelën!	40
• Një vështrim ndryshe për novelën e Preç Zogajt “Bija e vjetër e nënës së re”	44
• Një palë opinga për Hrushovin?!	49
• “Magjia” e “shitjes së nderit” në romanin e Namik Dokles.....	55
• Kriza e leximit në romanin “Dimri i librave” të Bashkim Hoxhës	62
• Romani “Polakja” i Xhevat Mustafës, radiografi e diktaturës, prognozë e së ardhmes	66
• “Brenga e prokurorit”, sfida e Ahmet Prençit për t’u renditur me elitën krijuese të kombit	73
• Zhgënjimet dramatike të tranzicionit në novelën “Viza amerikane” të Shefqet Mekos.....	78
• Astrit Gjunkshi flet me “Hirushja pellazge”	84
• Ekzaminimi i diktaturës në romanin “Doktoresha” të autorit Flamur Buçpapaj	90

-II-

POEZIA

• Hysni Bruçi, si model i poetit kombëtar	98
• Poezia e Alban Balës, magjia e fjalës së magjishme	104

- Jetëzimi i ndjenjës në poezinë e Rexhep Polisit..... 109
- Për poezinë e Avni Ndreut foli elita krijuese dibrane..... 114
- Letërsia ndryshe në poezinë e Emmy Krosit 120
- Barie Çupi-Boba, zë i veçantë në poezinë e sotme shqipe 124
- Poezia e dhimbjes njerëzore në pesë libra të Demir Rusit 127
- Poeti Hamdi Skeja, në enciklopedinë “Personalitete shqiptare të Francës” 130

-II-

LETËRSI DOKUMENTARE

- Vepër shkencore me vlera të jashtëzakonshme etnokulturore 136
- Berishët e Muhurrit, si rast unikal në historinë Skënderbegiane..... 143
- Skënderbeu ka lindur në Sinë të Dibrës 148
- Nga Çabej e Kadare, tek Ylli Asllani–kush janë 58 dijetarët e Gjirokastrës 157
- Hazis Ndreu, ikonë e artit dhe kulturës kombëtare 164
- Prof.dr.Eshref Ymeri, shtigjeve të fjalës artistike 169
- Për poetin e këngës, Naim Plaku..... 173
- Fakte dhe ngjarje historike të shkruara me dashuri njerëzore nga Sakip Cami..... 177
- Petro Zheji: “Shqipja është mëma e të gjitha gjuhëve” 180
- “Toponimia e Çidhnës”, një botim me vlera të rralla shkencore..... 187
- “Na ka çue Shkodra ni fjalë”, mbrojtja e qytetit nga serbo - malazezët 189
- Thesare arkeologjike dhe etnokulturore në tre libra të Dilaver Kurtit 196
- Vepra krijuese e Dr.Hajri Mandrit në tri dimensione 203
- Pedagogjika e Peshkopisë, tempull i dijes 207
- Publiçistika impresionuese e Irfan Dashit 211
- Prof.Shpëtim Cami “koherent me ato çka thotë e bën” 216
- Lura dhe personalitet e Lurës në një vepër enciklopedike..... 220
- Mirënjohje çamërie për Dibrën e dibranët 227

PARATHËNIE

ARTI I ANALIZAVE KRITIKE TË HALIL RAMËS, MJESHTËR I MADH



Prof. dr. Eshref Ymeri

*“Kritika kërkon shumë më tepër
formim kulturor, sesa krijimtaria”*

Oskar Uaild

Mjeshtri i penës, Halil Rama, njihet si një analist veprash të gjinive të ndryshme. Kjo vepër është një kaleidoskop idesh, përsiatjesh, faktesh. Janë 40 vepra të gjinive të ndryshme, të 40 autorëve, duke filluar nga vepra biografike e një autoreje amerikane, kushtuar jetës politike dhe artistike të ish-presidentit amerikan *Ronald Reagan (Ronald Reagan -1911-2004)*, dhe duke vazhduar me krijimtarinë e autorëve tanë, të pasqyruar në prozë artistike, në poezi, në letërsi dokumentare, në diplomaci dhe në monografi.

Duke pasur parasysh këndvështrimet mjeshtrërore të Halil Ramës, i cili ka një përvojë mjaft të pasur në fushën e kritikës letrare, lexuesi vëren se aparati i artit të këtij kritiku të talentuar shoqërohet nga tri të dhëna për autorët e veprave që ai analizon:

Së pari, autorët përthithin përshtypjet që kanë nga mjediset që i rrethojnë. Ato përshtypje, si në një fokus, grumbullohen në vetëdijen e tyre. Nga mijëra copëza vëzhgimesh, të shpërndara në hapësirat jetësore, vjen e krijohet diçka e tërësishme. Nga mijëra tiparesh të veçanta, të zbuluara në figurën e njerëzve që hasin në përditshmërinë e tyre dhe që ata

i regjistrojnë në kujtesën e vet, vjen e krijohet një tip-pesonazh me vlera përgjithësuese. Nga mijëra pikësnyimesh që ata perceptojnë gjatë endjes së tyre në vorbullat e kohës, vjen e lind një pikësnyim tipik.

Së dyti, emocionet, faktet dhe mendimet e perceptuara, autorët i shndërrojnë në materie të artit.

Së treti, produkti i krijimtarisë së autorëve kthehet mbrapsht po në atë mjedis, prej nga qe vjelë, domethënë te lexuesi.

Ta perceptosh artin e kritikës, është po aq e vështirë, sa edhe ta krijosh atë. Çfarë bën kritika e Halil Ramës dhe çfarë duhet të vazhdojë të bëjë ajo në këtë proces?

Me këtë pyetje, lexuesi i kësaj vepre zbërthen detyrën e rëndësishme dhe të domosdoshme që ai i ka shtruar vetes:

Kritika e tij shërben si shkollë për lexuesit dhe për autorët, ajo shërben si një universitet, si një enciklopedi, me pikësnyimin që ta ngrejë nivelin kulturor të të dyja palëve.

Qëllimi kryesor i analizave të Halil Ramës është vlerësimi i argumentuar i veprave letrare dhe përqendrimi i vëmendjes së lexuesit në kuptimin dhe vlerën e tyre.

Analiza e strukturës dhe e përmbajtjes së veprave është njëri nga parimet themelore të punës së tij hulumtuese, të konkretizuar në trajtimin e hollësishëm të përmbajtjes dhe të ideve të tyre. Ai e përqendron vëmendjen te elementet e kompozicionit, te zhvillimi i subjektit, te karakteri i heronjve, te stili i rrëfimitarisë dhe te aspekte të tjera, të cilat ushtrojnë ndikim mbi mbresat e përgjithshme të veprave.

Duke u ndalur në tipartet artistike të veprave, autori i ka shtruar vetes detyrën për të nxjerrë në pah dhe për të vlerësuar rolin e tyre edukativ në masën e lexuesve. Ai analizon gjuhën dhe stilin e veprave, aftësinë e autorëve të tyre për të krijuar figura të goditura artistike dhe për të shprehur mendime tejet të qëlluara.

Në këtë punim me vlera enciklopedike, autori Halil Rama u tërheq vëmendjen lexuesve te analiza kontekstuale. Gjatë vlerësimit të veprave të autorëve të ndryshëm, ai ka parasysh kontekstin e zhvillimit të ngjarjeve. Ai studion rrethanat, në të cilat veprat qenë krijuar, veprat e mëparshme të disa prej autorëve, rëndësinë e tyre historike dhe sociale për vlerësimin sidomos të periudhës së diktaturës komuniste dhe të ca dukurive të rënda

të periudhës neokomuniste, që pati nisur me vendosjen e demoshëmtisë dhjetoriste. Me analizat kontekstuale, Halil Rama i ndihmon lexuesit të kuptojnë edhe më mirë se çfarë roli luajnë veprat artistike në letërsi dhe në shoqëri.

Diçka tjetër që bie në sy në penën e Halil Ramës, është objektiviteti, një parim ky shumë i rëndësishëm në punën e kritikut letrar. Këtu ai ka parasysh një orientim të përgjithshëm: kritiku duhet ta vlerësojë një vepër artistike, pavarësisht nga parapëlqimet e veta subjektive dhe duhet të marrë parasysh këndvështrimin e lexuesve të ndryshëm; me këtë rast, ai ka të drejtë të shprehë këndvështrimin e vet subjektiv, por ai duhet ta argumentojë bindshëm pozicionin e vet, duke marrë parasysh edhe normat shoqërore dhe kulturore. Pra, në këtë libër, puna e kritikut Halil Rama, mbështetet në analizën, vlerësimin dhe interpretimin e veprave të 40 autorëve, me qëllim që t’u vijë në ndihmë lexuesve të zbërthejnë thelbin e përmbajtjes së tyre.

Në analizat e autorit bie në sy studimi sistematik i veprave të të gjitha gjinive letrare, me pikësynimin për të evidentuar tiparet e tyre artistike, estetike dhe ideologjike. Gjatë analizave, ai u është përmbajtur disa metodave të ndryshme origjinale, të cilat po i rendisim në vijim:

Së pari, metoda historike. Me këtë metodë nënkuptohet studimi i veprave në kontekstin e kohës dhe të rrethanave kur janë krijuar. Aty analizohen faktorë historikë dhe kulturorë, të cilët kanë ndikuar mbi autorët në krijimin e veprave në fjalë.

Së dyti, metoda strukturore. Analiza strukturore bazohet në studimin e organizimit dhe të kompozimit të veprave, analizohen elementet strukturore, të tilla, si subjekti, personazhet, gjuha dhe stili, në mënyrë që lexuesi të kuptojë se si bashkëveprojnë dhe formojnë një të tërë.

Së treti, metoda tematike. Gjatë përdorimit të metodës tematike, autori këtu analizon temat dhe idetë themelore të krejt korpusit të veprave të 40 krijuesve. Përmes kësaj metode, ai ka hulumtuar se si krijuesit në fjalë i kanë trajtuar probleme, çështje dhe koncepte të caktuara dhe se si i kanë lidhur me idenë e përgjithshme të secilës vepër.

Së katërti, metoda psikologjike. Me analizën psikologjike të veprave në fjalë, Halil Rama hedh dritë mbi botën e brendshme të personazheve dhe ecurinë e zhvillimit të tyre psikologjik. Ai ka analizuar motivet dhe

komponentët emocionalë të veprave, në mënyrë që lexuesi të kuptojë se si krijuesit i kanë përcjellë ato përmes personazheve të tyre.

Së pesti, metoda sociologjike. Me këtë metodë nënkuptohet përfshirja e aspekteve sociale, ekonomike dhe politike, të cilat janë pasqyruar në veprat e të gjithë krijuesve. Autori e ka vënë theksin te pasqyrimi nga ana e tyre i problemeve, normave dhe vlerave shoqërore.

Së gjashti, metoda krahasuese. Me analizat krahasuese në penën e Halil Ramës nënkuptohet ballafaqimi i veprës së një autori me veprat e tjera ose krahasimi i aspekteve të ndryshme të së njëjtës vepër. Kjo e ndihmon atë të hulumtojë edhe më thellë karakteristikat e veprave të analizuara dhe të zbulojë ngjashmëritë dhe dallimet me tyre.

Së shtati, metoda filozofike. Analizën filozofike autori e orienton drejt studimit të ideve filozofike që janë të pranishme në veprat e hulumtuara. Në analizat e tij ai ndalet në çështje fundamentale të të kuptuarit e jetës, të moralit dhe të aspekteve të tjera me rëndësi parësore.

Kjo vepër studimore në fushën e kritikës së veprave në disa gjini letrare, mund të vlerësohet pa asnjë mëdyshje si një dialog mes autorëve dhe lexuesve, ku kritikë Halil Rama shfaqet në rolin e ndërmjetësit që jep një ndihmë tejet të çmuar për të kuptuar dhe interpretuar veprat e kaq shumë autorëve.

Në këtë vepër përvijohet si ide kryesore tema “shkrimtari-kritiku-lexuesi”, ku detyra e kritikut është sa e mprehtë, aq edhe e rëndësishme. Kjo detyrë ka vetëm një zgjidhje: kritikë e ngre lart edhe kulturën e shkrimtarit, edhe kulturën e lexuesit.

Kur e mbaron së lexuari këtë vepër voluminoze, lexuesit i lind një pyetje e vetvetishme:

Si ka qenë e mundur që autori ka përballuar një punë kaq të madhe për përgatitjen e kësaj vepre të vëllimshme? Çfarë e ka ndihmuar? Shkalla e lartë e arsimimit, horizonti i gjerë kulturor, dëshira, fisnikëria e shpirtit, dashamirësia ndaj krijuesve të talentuar? Sigurisht që këto të gjitha kanë luajtur rolin e tyre të pazëvendësueshëm. Por ka edhe diçka tjetër, shumë të rëndësishme, që zbulohet në përgjigjen e pyetjes së mësipërme. Përgjigjen e ka pasë dhënë Presidenti i 30 (1923-1929) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës *Xhon Kalvin Kulixh (John Calvin Coolidge Jr.-1872-1933)*, i cili ka thënë:

“Në këtë botë, asgjë nuk mund ta zëvendësojë vullnetin e fortë, këmbënguljen. As gjeniu, gjeniu pa famë dhe i pashpërblyer s’është asgjë. As talenti, asgjë nuk haset më shpesh sesa talenti i dështuar. As arsimimi, bota është plotë me njerëz të arsimuar që janë të braktisur. Vullneti i fortë në arritjen e qëllimit–ja kjo është mrekullia vetë”.

Eshref Ymeri
Kaliforni, 21 korrik 2024

.com/post/fatmir-terziu-fjalë-për-halil-ramën



HALIL RAMA

**Kjo është revista "Albanian Post"
Londër dhe www.fjalaelire.com**



ALBANIAN POST Nr. 69
Maj 2024

FJALË PËR HALIL RAMËN

... dhe për të tjerët. Në këtë numër të revistës "Albanian Post" do të gjeni një analizë të detajuar të politikës së jashtme të qeverisë Rama, si dhe të rolit të kësaj qeverie në procesin e reformave të shtetit dhe të bashkëpunimit me bashkësitë ndërkombëtare. Në këtë numër do të gjeni edhe një intervistë me Halil Ramën, kryeministër të Kosovës, në të cilën do të diskutohet për marrëdhëniet tregëtare dhe politike midis Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe për rolin e Kosovës në procesin e reformave të shtetit dhe të bashkëpunimit me bashkësitë ndërkombëtare.



WWW.FJALAEELIRE.COM

I.

PROFILE KRIJUESISH

PRESIDENTI REAGAN OSE ËNDËRRA AMERIKANE E JETËSUAR

- Në përzgjedhjen e këtij libri për përkthim, dr. Arian Starova, ish-ministër i Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, aktualisht president i Këshillit Atlantik të Shqipërisë dhe kryetar i Bashkimit Liberal Demokrat, duket se është frymëzuar fort nga mesazhet që ai përcjell. Kjo për faktin se, nga përpjekjet për të mos lejuar ndikimin komunist edhe në qytetin e mirënjohur të filmit, në Hollywood, në qytetin e tij të artit, deri në shembjen e sistemit komunist në Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera satelite përreth tij në fundin e viteve 1980 e fillimin e viteve 1990 dhe ende sot, Presidenti Reagan u shndërrua në njeriun-simbol të nevojës ndërkombëtare të luftës kundër “perandorisë të së keqes” siç e quante ai sistemin politik komunist. Rrugëtimi i jetës së Reagan-it, i pasqyruar me mjeshtëri të veçantë nga autorja e librit, Peggy Noonan, përbën njëheresh edhe një kujtesë e thirrje kundër regjimeve autoritare të ditëve të sotme dhe politikave të tyre luftënxitëse



Në shkurt të vitit 2001, një sondazh i opinionit publik, i kryer nga CNN, “USA Today” dhe “Gallup”, i pyeste amerikanët për emrin e njeriut, të cilin ata e mendonin si Presidentin më të madh të SHBA-së. Dhe në krye të tij u rendit Ronald Reagan-i me 18 për qind. (Më pas, vinte Xhon F.Kenedi me 16 për qind dhe pas tij Abraham Linkoln me 14 për qind). Katërmbëdhjetë vjet pas atij sondazhi (2015), profili i Ronald Reagan-it vjen i plotë në shqip nëpërmjet monografisë së Peggy Noonan (“Kur mbretëron karakteri – Renald Reagan” ndër librat botërorë më të shitur e më të kërkuar të viteve të fundit), të përkthyer nga dr. Arian Starova, ish-Ministër i Jashtëm i Qeverinë së Pajtitimit Kombëtar të vitit 1997.

Siç shprehet vetë zoti Starova, nxitja për këtë përkthim ka qenë vetëm rrugëtimi krejt i veçantë i jetës së Ronald Reaganit, ku vështirësitë, mungesat dhe sukseset kanë qenë ndërthurur me shumë sesa ato të çdo presidenti tjetër të 100 viteve të kaluara. Presidenti Reagan lindi më 6 shkurt të vitit 1911, në Illinois, në një qytet të quajtur Tampiko, në një shtëpi me qira me një dhomë që ndodhej mbi ndërtesën e një banke.

Qoftë dhe vetëm nga kapitulli i dytë i librit “Të gjithë presidentët kanë prejardhjen e tyre”, sështë e vështirë të kuptojmë se “Regan është i papërsëritshëm, në kuptimin se familja e tij nuk kishte asnjë përkatësi shoqërore të caktuar ose arritje, nuk kishte as prejardhje prej fisnikërisë vendore ose shtresës së mesme, nuk kishte asnjë profesion të trashëguar, të tillë, si mjek ose doktor dhe nuk kishte asnjë pronë, asnjë fermë, ose dyqan të vogël”.

Nga ky libër, ndër të tjera, marrim mesazhin se Reagan-i ishte dhe mbeti një politikan romantic, i magjepsur nga lëvizja e historisë, nga besimi i thellë te Zoti dhe nga rëndësia e të qenit të njeriut gjithnjë i drejtë dhe i ndershëm, nga ideja se është diçka e mirë që të bëhesh pjesë e një gjëje të madhe që bëhet për mirë. Ai i shfaqti këto veti gjatë gjithë kohës së tij si drejtues, nga Sindikata e artistëve të Hollivudit deri te Presidenca e tij.

Mesazhi tjetër i qartë që përcillet nga ky libër është ai i dashurisë së pamatë të ish-gubernatorit të Kalifornisë dhe Presidentit të 40-të të SHBA-së për Zotin, Amerikën dhe vlerat morale të njeriut. “Ai e donte Amerikën, jo vetëm sepse ai ishte mësuar për këtë nga familja e tij dhe nga kultura e asaj kohe për ta dashur Amerikën, jo vetëm sepse besonte tërësisht në vërtetësinë mahnitëse dhe vlerën e pohimeve të etërve të saj themelues.

Ishte edhe fakti konkret dhe vetjak se ai e donte Amerikën meqenëse liria që ajo ofronte (kushdo mund të hapte një radiostacion, edhe ndonjë mjek me ide të çmendura) i jepte atij mundësinë (kushdo mund të fliste në radio, edhe një dikush që nuk dinte asgjë), jo vetëm për të hyrë në moshën e rritur mbi një themel të mirë, por edhe për të shpëtuar familjen e tij gjatë krizës së madhe.

Ai ishte provë e gjallë e ëndrrës amerikane. Nuk mendonte se ajo ishte një ëndërr e përsosur, nuk mendonte se çdo njeri kishte marrë të njejtin përfitim, sepse ai mendonte se jeta ishte e vështirë dhe fati plot me padrejtësi. Megjithatë, ai mendonte se, ndërsa sistemet njerëzore përparojnë, ai i Amerikës ishte i mrekullueshëm dhe i përshtatshëm për një premtim të arritshëm.

Gjithsesi, rëndësia e këtij libri për Presidentin Reagan mund të lidhet me faktin se para lexuesit shqiptar vjen trashëgimia politike, letrare e artistike e Ronald Reagan-it, e cila vazhdon të jetë e fuqishme, veçanërisht për republikanët që shqyrtojnë mundësinë e kandidimit dhe të fitores në zgjedhjet presidenciale të vitit 2023.

Ata që kanë qenë të pranishëm në ditën e vrenjtur kur ai u betua si guvernator i Kalifornisë, betohen se ndërkohë që ai po bënte betimin, dielli doli pak prej reve dhe ndriçoi mbi të. Edhe ata që kanë qenë atje në ditën me re, kur ai po përurohej si President në vitin 1980, thonë se dielli doli prej reve, ndërkohë që ai vuri dorën për të bërë betimin ... Kjo nuk duket si e vërtetë, por e tillë është.

REAGAN ISHTE EDHE SHKRIMTAR I MIRË

Për lexuesin është interesant kapitulli i tretë “Ylli i kinemasë”, nga ku del qartë se si Regani kënaqej me aktrimin, dashuronte pikturën dhe donte të bëhej aktor, një yll kinemaje, por e kishte të vështirë ta shprehte këtë gjë. Ai arriti që ta shndërronte talentin e tij për të shkruar në talent për komunikim. Reagan-i e ktheu artin e tij në shërbim të ideve, tek të cilat ai besonte. Proza e tij nuk përmban kurrë zhvillime të papritura, nuk bën ndalime të paparashikuara, nuk befason. Ajo ka butësinë e një rrjedhe të thjeshtë.

Duke u përpjekur të japë të plotë arsenalin krijues të ish- Presidentit

Reagan, autorja e librit, Peggy Noonan, dëshmon vlerat e tij si prozator i talentuar. Sipas saj, ajo çka shquhet në tregimet e Ronald Reaganit është rrjedhshmëria shumë e madhe. Ai ka një fjalor të gjerë..., korigjon rrallë ato që duket se janë kopje të para. Si adoleshent dhe i ri 20- vjeçar, ai shkroi për burrat në frontin e luftës. Reagan-i shkruante ndonjëherë edhe për teatrin, për shfaqjet e teatrit vendordhe për futbollin amerikan. Megjithatë, në shkrimet e tij gjeje kurdoherë njerëz shumë të zemëruar, që ktheheshin prej luftës në shtëpi, të rënë shpirtërisht, të hidhëruar prej asaj që kishin parë. Heronjtë e tij të rinj janë të mavijosur, të rënduar nga kujtimet e llogoreve.

Reagan-i shkruante ku të mundej, në tryezën e tij të punës në shtëpi, në zyrë, ndonjëherë në avion, kur shkonte nga një fjalim në tjetrin, gjatë viteve ndërmjet fundit të mandatit të tij si guvernator dhe fillimit të presidencës. Ai nuk u sundua kurrë nga shkrimet e tij, merrte përsipër të përkufizonte lirinë, të përcaktonte synimet e etërve themelues, të përforconte kuptimin e pjesës përkatëse të Kushtetutës.

Ai qe një shkrimtar i mirë dhe karrierën e tij politike e kishte bërë, në të vërtetë duke u mbështetur te fjalimet që kishte shkruar dhe rishkruar vetë – mbi skeda, të cilave, siç dihet mirë, ua ndryshonte vendin që t'i mbante gjërat të freskëta.

Reagan-i ishte shumë ambicioz, por ai nuk i ndante gjithnjë me njerëzit ambiciet e tij të veçanta. Kudo që ai shkonte, nga shkolla në kolegji dhe në radio, ai ia arrinte që të konkurronte, të fitonte dhe të ngrihej gjithnjë më lart.

VEPRIMTARINË E REAGAN-IT E SUNDOI PËRBALLJA ME SFIDAT

Nuk ishin vetëm ekzistenca e komunizmit dhe synimi keqdashës i komunistëve ato që e shtynë Reagan-in të pranonte të kandidonte për President. Ishte edhe fakti se komunistët po luftonin për të marrë nën kontroll Hollivudin, qytetin e tij të profesionit, prodhuesin e madh të historive që shpjegojnë Amerikën e amerikanëve... Duke rrezikuar emrin dhe jetën e tij në periudhën e një kohe të errët dhe të ngarkuar të historisë së Hollivudit dhe të amerikanëve, ai u shndërrua në njeriun e

ndershmërisë heroike, që nuk e lejoi komunizmin të pushtonte Hollivudin.

Autorja Noonan shkruan: “Reagan-i filloi si ‘i pari’ dhe përfundoi si ‘i fundit’. Ai qe i pari guvernatori i Kalifornisë, i pari aktor, i pari i divorcuar, i pari konservator modern me ide serioze për t’u bërë president ... Por dhe ‘i fundit’ prej më të mëdhenjve, i fundit që e ka pasur praninë e tij më të madhe, si atë të një anijeje ... Ai udhëhoqi në një mënyrë të tillë që pjesa më e madhe e njerëzve të zakonshëm dhe e të mëdhenjve të Amerikës – heronjtë e përpjekjeve të palodhura të ‘fluturimeve luftarake’ – e besuan instinktivisht sepse ata e dinin se ai do të përpiqej të bënte atë që ishte e drejtë ...”

Mendimi filozofik dhe jeta e tij ishte mbizotëruar nga sfida e bashkuar me përpjekje, të cilat shpërbleheshin: “Kërko diçka dhe do të të jepet. Kërko dhe do të gjesh”. Ai kishte kërkuar dhe kishte pyetur, kishte punuar fort, kishte ëndërruar gjëra të mëdha dhe përfundonte te puna që dashuronte, e cila i jepte pasuri, kënaqësi dhe respekt.

Nëse i referohemi jetës dhe veprës së tij, nga ky libër del qartë se Ronald Reagan-i nuk krijoi asnjëherë mendim të mirë për pesimistët dhe për humbjet që dukej, sikur i kërkonin vetë. Përkundrazi, ai nxiti dhe mbështeti “ata që luftojnë për liri dhe kundër komunizmit kudo që ata të jenë”, siç bëri me fjalimin që mbajti në 8 qershor të vitit 1982 në Parlamentin e Britanisë. Po ashtu, siç është shprehur Natan Sharanski, hapi më i rëndësishëm në Luftën e Ftohtë dhe shkatërrimi i perandorisë sovjetike kanë qenë fjalët dhe veprimet e Reganit në fillim të detyrës si president.

Do të mbeten përherë profetike dhe si thirrje për shndërrim fjalët e Reganit drejtuar Presidentit Gorbaçov: “Rrëzoheni këtë mur, zoti President”, duke pasur parasysh murin ndarës midis Gjermanisë Perëndimore dhe Gjermanisë Lindore. Pas atyre fjalëve filloi shpërbërja e Bashkimit Sovjetik komunist”.

VLERAT QË SOLLI REAGANI NË SJELLJEN E AMERIKËS NË BOTË

Ajo që e formoi Reagan-in, ishte diçka më shumë sesa të qenit spiker në radio, diçka më shumë sesa të qenët aktor, diçka më shumë sesa të arriturit e suksesit. Të gjitha këto janë thënë nga personalitete të politikës

amerikane edhe ditën e përrimit të aeroplanmbajtëses RONALD REAGAN, CVN 76, në 3 marsin e vitit 2001.

Admirali Vern Klark është shprehur se Shtetet e Bashkuara kanë emërtuar një numër aeroplanmbajtësesh me emrat e ish-presidentëve – Xhorxh Uashington, Abraham Linkoln, Tedor Rusvlet, Harri S.Truman, Duajt Ajzenauer, Xhon F.Kenedi. Por, sipas tij, emri i Ronald Reaganit nënkupton lirinë. Klark ka thënë se ashtu siç ndodhi me emrin e tij, ashtu do të ndodhë dhe me këtë anije ... Ndërsa senatori Xhon Verner i Virxhinias e ka quajtur anijen “një ishull të demokracisë që lundron nëpër dete”.

Ish-Presidenti Bush, krenar që ndodhej i pranishëm në pagëzimin e anijes më të re të forcave detare më të mëdha të botës, ka shprehur bindjen se “Anija Reagan do të lundrojë gjigante dhe e fortë, ashtu si burri që ne kemi njohur ... Ne jetojmë në një botë, e cila në aq shumë mënyra është formësuar nga vullneti dhe zemra e tij. “Ajo që ne deshëm, ajo për të cilën ne luftuam, qe një komb më i fortë në një botë më paqësore ... Vlerat që solli Ronald Reagan-i në sjelljen e Amerikës në botë nuk do të ndryshojnë...”.

Si President, Ronald Reagani besonte pa mëdyshje se tirania është e përkohshme dhe se shpresa e lirisë është e përgjithshme dhe e përhershme, se kombi amerikan ka mirësi të papërsëritshme dhe duhet të mbetet në mënyrë të papërsëritshme i fortë, se Zoti mban anën e drejtësisë, sepse të gjitha të drejtat tona janë dhurata të vetë Atij. Disa arritje zbehen me kalimin e kohës. Arritjet e Ronald Reagan-it zmadhohen bashkë me kalimin e kohës.

Kur Reagani u zgjodh President në vitin 1980, konservatorët iu referuan kësaj fitoreje si “Revolucioni Reagan”, që nënkuptonte një qeveri më të vogël, ulje taksash dhe rikthim të krenarisë së Amerikës në botë.

Kur u largua nga detyra në janar të vitit 1989, Presidenti Reagan e përmendi këtë në fjalimin e lamtumirës, që mbajti nga Zyra Ovale. “Fitorja ime u quajt ‘Revolucioni Reagan’ dhe unë e pranoj këtë. Por për mua ka qenë gjithnjë si një zbulim i madh, një rizbulim i vlerave dhe I logjikës sonë”.

Por nuk janë vetëm republikanët që duan ta përmendin emrin e Presidentit të -40të amerikan. Presidenti Obama i referohet herë-herë Ronald Reagan-it dhe trashëgimisë së tij, madje ka bërë këto komente

gjatë fushatës së vitit 2008: “Unë mendoj se Ronald Reagani ndryshoi trajektoren e Amerikës në një mënyrë, që nuk e bënë as Richard Niksoni dhe as Bill Clintoni. Ai inkurajoi atë që njerëzit ndienin dhe që kërkonin: qartësi dhe optimizëm”.

Ronald Reagan-i është popullor jo vetëm për konservatorët, por për shumë amerikanë të të gjitha bindjeve politike.


Shumë prej mbështetësve të tij të paepur thonë se ai do të mbahet mend më shumë për ringjalljen e frymës kombëtare dhe të optimizmit, në një kohë të vështirë për ekonominë, kur amerikanët vinin në pikëpyetje vendin e tyre në botë. Pikërisht këtu konsiston edhe rëndësia e këtij libri të autores Peggy Noonan, e cila ka qenë ndihmëtare e posaçme e Presidentit Ronald Reagan prej vitit 1984 deri në vitin 1986.

Ky libër i shqipëruar nga dr. Arian Starova, botim i “Tirana Times”, na jep një profil të plotë të Presidentit Reagan, i cili mbetet një ikonë për shumë republikanë në arenën kombëtare, përfshirë edhe ata që mund të kandidojnë në zgjedhjet e ardhshme presidenciale.

<http://www.panorama.com.al/111-vjetori-i-lindjes-presidenti-reagan-ose-endrra-amerikane-e-jetesuar/>

ADN-ja E PANDRYSHUAR E SHEFKI KARADAKUT

- Dr. Lutfi Turkeshi, gazetar dhe studiues nga Republika e Maqedonisë së Veriut, e vlerëson Shefki Karadaku si “Khajamin e ditëve tona”. Në këtë konkluzion ai arrin pasi ka lexuar romanet “Puthja e ngrirë”, “Një mijë vjet dashuri”, “Vila e magjepsur”, “Salamandrat”, “Filantropi”, “Panagjerikus” e të tjerë, dhe vëllimet poetike “Kënga e karrove të drithit”, “Melodi të Shkumbinit”, “Ylberi”, “Lumi me njëqind zemra” e “Feniks” të poetit e shkrimtarit Shefki Karadaku, i cili asnjëherë nuk do t’i nënshtrohej jetës edhe pse e vuante atë...
- Romani i Shefki Karadaku “PUTHJA E NGRIRE” u botua në anglisht. Pasi iu dhurua selive të huaja diplomatike në Tiranë, nga një kopje e tij, erdhi menjëherë vlerësimi i ambasadorit gjerman Peter ZINGRAF për këtë roman tejet të arrirë, që me të drejtë është mirëpritur e vlerësuar nga personalitete të botës letrare të kryeqytetit....



Në një shtëpi karakteristike të lagjes Spahikorre të qytetit të Elbasanit, më 9 qershor 1941 lindi, mori shkollimin bazë dhe nisi rrugëtimin e jetës Shefki Karadaku, i cili ndër vite do të bënte emër si një nga poetët

e prozatorët më të mirë në shkallë kombëtare. Këtë lagje, si dhe gjithë Elbasanin ai e konsideronte ADN-në e tij të pandryshuar. Në kujtesën e tij, sa qe gjallë, ruhej Spahikorrrja e fëmijërisë, e me të drejtë pikëllohej kur e shihte se si është dëmtuar..., ruheshin banesat e traditës, të mbetura ende tashmë, si një dëshmi që dënon dhe akuzon!

I zhytur në nostalgjinë e kohës, ish-mësuesi dhe shkrimtari i talentuar rrëfente mjeshtërisht: “Ne, në Spahikorre i adhuronim pemët, veçanërisht ullinjtë; unë si poet, ca më shumë dhe, si të isha një druid i vërtetë, i kam kushtuar edhe një vjershë të veçantë njërit prej ullinjve të Spahikorres. Pale pastaj, shelgjeve dhe karakaftëve hijerënda, apo shtegtimit magjepsës të shpendëve!”. Mjafton qoftë dhe ky rrëfim i çiltër për të konkluduar se Shefki Karadaku, megjithëse një familjar i rregullt dhe përgjithmonë i obliguar, shpirtin e kishte prej bohemi të çliruar dhe të papërmbajtur.

Siç shkruan bashkëkohësi i tij, Enver Kushi, brenda korpusit letrar, Shefki Karadaku ka sendërtuar shtëpinë e shpirtit të tij buzë Shkumbinit, atje ku “ylberi ka rënë mbi brigjet e trishtuara”.

Dhe kjo shtëpi e shpirtit të poetit ka mbledhur brenda stinët dhe qiejt e Elbasanit, shirat zemërakë, çeljen e karakaftëve, zërat njerëzorë, jehonat e largëta të fëmijërisë, këngët e Isuf Myzyrit, kuajt e hazdisur, kopshtijet e vendlindjes, nënën dhe babain, Nadiren dhe mallin për Çamërinë, Dorianin dhe Albanën, fëmijët e tij.

SHTËPIA E SHPIRTIT TË TIJ...

Në këtë shtëpi të shpirtit të tij vijnë erërat e vjeshtës “të m’i krehin flokët kaçurrelë” apo ulen dhe ngrihen lejlekët. Dhe kur heq çatinë e kësaj shtëpie shpirti, poeti sheh “qiellin plot me re përçark...” Dhe, kur hap dritaret e kësaj shtëpie, shpirti, bashkë me valët e Shkumbinit që “përplas jehonën e planetit”, vjen Nadirja që i “sjell erën çame si bukuroshe e magjishme” dhe “gëzimet misterioze të një atdheu të braktisur”.

Në laboratorin krijues të Shefki Karadakut gjen një arsenal veprash krijuese. Nga “Kënga e karrove të drithit” te “TORAKS”, krijuesi prodhon emocione të freskëta, me originalitet të këndshëm e të besueshëm që gjelbërojnë humanizëm, me mesazhe befasuese, të ndjeshme e me ndjenjë dashurie njerëzore.

Karrierës së tij krijuese prej pesë dekadash, i shtohen edhe disa muaj të paharrueshëm që i kaloi në një fshat të humbur të rrethit të Elbasanit, kur jepte mësim në një shkollë fillore. Studiuesi dhe analisti i zellshëm i veprës së tij letrare, Bardhyl Ajazi, në monografinë “Elbasan, i bukur Elbasan” (me syrin e poetit Shefki Karadaku), ndër të tjera shkruan: “...Shefki Karadaku i perkiste një familjeje të mirëfilltë intelektuale. Babai i Shefkiut, Xhaferr Karadaku ishte një arsimtar, që pasi mbaroi atë të bekuar Normale, gjithë jetën ia kushtoi mësuesisë. Nëna e Shefkiut, Adileja ishte një grua e kulturuar dhe arsime dashëse. Ajo bëri shumë sakrificë për shkollimin e fëmijëve të saj. Vëllai i Shefkiut, Astriti mbaroi studimet për gazetari dhe punoi për shumë vjet në organet kryesore të shtypit. Motra e Shefkiut, Natasha mbaroi studimet për mësuesi dhe punoi për shumë vjet në arsim. Pra, Shefkiu, në detyrën e arsimtarit ishte në fushën e vet, ishte në botën e librave. Janë ato vite kur ndjeu shijet e para të kënaqësisë së heshtur krijuese, nga skicat, tregimet, reportazhet, monografitë historiko-letrare, për të vijuar pastaj për 20 vjet në revistën prestigjioze “Ylli”, si një nga zërat më të spikatur dhe si mbështetësi real e kurajoz i letrarëve të rinj nga i gjithë vendi.

TË MËDHENJTË E LETRAVE PËR KARADAKUN...

Shefki Karadaku, me korpusin e tij letrar ka hyrë denjësisht në historinë e letërsisë shqipe. Një bilanc më konkret e gjejmë te libri “Absurdi mbretëror” – (Shënime kritike, ese, këndvështrime për krijimtarinë e Shefki Karadakut), në të cilin autori i 35 veprave letrare në prozë e në poezi portretizohet si një nga shkrimtarët e dalluar të kohës së tij. Gjejmë në këtë libër kolosët e letrave shqipe: Dritëro Agolli, Lllazar Siliqi, Petro Marko, Adriatik Kallulli, por dhe personalitete të njohura të letrave shqipe, si, Moikom Zeqo, Roland Gjoza, Riza Lahi, Petraq Risto, Agim Cerga, Milianov Kallupi, dr.Lutfi Turkeshi, Faruk Myrtaj, Sazan Goliku, Halil Rama e Sakip Cami, të cilët vlerësojnë maksimalisht veprën letrare të Shefki Karadakut ndër vite. Në librin “ABSURDI MBRETËROR”, botuar në 75-vjetorin e lindjes së shkrimtarit, Bardhyl Ajazi ka përmbledhur artikuj kritikë dhe esse. (Këndvështrime për krijimtarinë e Shefki Karadakut).

Dhe nëse patriarku i letrave shqipe, **Dritëro Agolli** vlerëson koncepti-

min popullor të realitetit në përmbledhjen “Meloditë e Shkumbinit” të Shefki Karadakut, ku evidenton gjuhën e pasur të vargjeve të tij, të ngjashme me motivet popullore, si “Vajza e mullixhiut”, “Nata e fundit e aksionit” e të tjera, Kallulli shprehet për pleksjen bukur e me forcë të ngjyrave, të heroikes me tragjiken, të fëlligështisë e dobësisë morale të armiqve të egër.

Për një nga poezitë më të njohura **Adriatik Kallulli** shkruan: “Poezia e Shefki Karadakut është në shumë raste një poezi pikurë. Ai e ndien që lexuesit i duhet shprehur në një mënyrë të tillë që të parafytyrojë me kthjelltësi atë që ka parë njëherë poeti”. Shembull tipik për këtë është poezia “Kënga e karrove të drithit”, ku gëzimi për korrjen, për bollëkun e grurit shprehet me një kuadër plot lëvizje:

*“Kur të fillojë të bredhë nesër dielli,/Në largësinë e fushës si lejlek,/Atëherë,
pas karrove të drithit,/Udhën e kaltër të arave do ndjek....”*

Kurse **Llazar Siliqi** do të shprehej: “Kur më 1967 Shefki Karadaku doli me vëllimin e tij të parë, ‘Kënga e karrove të drithit’, ne u gëzuem që radhët e poetëve shqiptarë u shtuan me një poet të ri, me një lirik të qetë e të ambël, me ndjenja të holla, me dorë piktori të akuarelit”.

Shkrimtari **Petro Marko**, pasi ka lexuar novelën e Shefki Karadakut, “Rrugët e para”, shprehet: “Sikur ta kishte këtë botim në vargje dhe ta kishte pagëzuar po me këtë emër, ne përnjëherësh do të thoshim: poeti, pasi njuh rrugët e para të jetës, ka zbuluar në to fenomene dhe tinguj, ose ngjyra të reja dhe tani po na i dhuron me dashuri...”

Doktor Lutfi Turkeshi, gazetar dhe studiues nga Republika e Maqedonisë së Veriut, e vlerëson Shefki Karadaku si “Khajamin e ditëve tona”. Në këtë konkluzion ai arrin pasi ka lexuar romanet “Puthja e ngrirë”, “Një mijë vjet dashuri”, “Vila e magjepsur”, “Salamandrat”, “Filantropi”, “Panagjericus” e të tjerë dhe vëllimet poetike “Kënga e korrave të drithit”, “Melodi të Shkumbinit”, “Ylberi”. “Lumi me njëqind zemra” e “Feniks” të poetit e shkrimtarit Shefki Karadaku, i cili asnjëherë nuk do t’i nënshtrohej jetës, edhe pse e vuante atë...

“Si feniks, shkëlqen me ide kuarci duke ndërtuar “udhë betoni”... I tillë është poeti Shefki Karadaku. Tërë vargjet e poemës ‘Feniks’, shkruan ai, janë të harmonizuara estetikisht në të gjitha nivelet e të shprehurit emocional, individual, stilit origjinal dhe figuracionit. Këto poezi janë shprehje e një personaliteti poetik jo të zakonshëm... Poeti ka edhe idilin

e vet të vendlindjes që është “... me çuka, rrape-qiparisa dhe subtropiku mund t'i flasë qershisë, por jo ajsbergë...”. Poeti ka edhe dashurinë e shprehur, si Naimi e Çajupi: ‘Të këndoj ty bukuroshe si alku, unë s’jam poet i vjetër melik, po zemra po aq e lashtë sa dheu, përpara teje rreh si det antik...’, që pastaj të vijojë: ‘Po zemra e kërkon nudon e bukur, le të jetë ajo si mbretëreshë, që nëpër gjoksin e saj malli i shkurtër si tajfun floride të përqeshë...’ Si të përfundojmë?! Shkurt, poezi e veçantë, e jashtëzakonshme, e bukur... Është e tillë poezia e poetit Shefki Karadaku... Është shumë refleksive, sa herë ta lexosh dhe rilexosh, gjithnjë do të nxjerrësh ndonjë ndriçim nga qielli me plot yje lirike të poetit të madh. Pra, kjo lirikë është identiteti poetik si katarzë”, -shkruan dr. Lutfi Turkeshi-Gazetar, studiues (“IDENTITETI SI KATARZË” –Gazeta “Fakti”, 8 mars 2001, Shkup).

Petraq Risto, redaktor i romanit “Puthja e ngrirë”, vlerëson ndërthurjen plot dritë dhe hije, si një afresk bardh e zi nga autori të lirizmit, heshtjes, frikës, rebelimit, ankthit, jetës, dashurisë....

Edhe **Moikom Zeqo** thotë se Shefki Karadaku është poet nga të spikaturit në lirikën shqiptare. Shefki Karadaku portretizohet si një nga shkrimtarët e dalluar të kohës. Karadaku është një nga përfaqësuesit më të spikatur për gjininë e lirikës ku absorbohen përvojat e poetikave tradicionale me ato moderne e avangardiste evropiane dhe realizohet kundërvënia ndaj traditës letrare. Tipare të futurizmit, ekspresionizmit, surrelizmit, madje dhe krepuskolarizmit janë përthithur dhe pasqyruar në poetikat e këtij autori.

KOORPUSI LETRAR I SHEFKI KARADAKUT ËSHTË NJË THESAR I ÇMUAR...

Teksa lexon veprën e Shefki Karadakut, vetëtimthi të kujtohet krijimtaria letrare mjaft cilësore e këtij poeti dhe prozatori që shkruan prej pesë dekadash, si romanet: “Puthja e ngrirë”, “Njëmijë vjet dashuri”, “Argonautët”, “Vila e magjepsur”, “Salamandrat”, “Gjergj Elez Alia”, si dhe disa novela e vëllime me poezi.

Koorpusi letrar i Sh.Karadakut është një thesar i çmuar që rrezaton dritën e artë. Gjetjet metaforike, forca krijuese, gjuha e pasur e shpesh poetike, përdorimi mjeshtëror i fakteve, kronikat, përshkrimi i heronjve,

legendat dhe episodet e bëjnë të këndshme prozën e këtij shkrimtari.

Rrallë gjen në historinë e letërsisë shqipe një autor si Shefki Karadaku, të vlerësuar nga pena të spikatura si, Agim Cerga, Perikli Jorgoni, Milianov Kallupi, Riza Lahi, Jusuf Shahini, Leonard Veizi, Faruk Myrtaj, Mujë Buçpapaj, Ramazan Vozga, Namik Selmani, Sazan Goliku, Sakip Cami, Neritan Dragoti, Ahmet Banushi, Ermir Hoxha, Tomor Jolldashi, Mihal Disho etj.

Krijimtaria e Shefki Karadakut është botuar edhe në gjuhë të tjera europiane. Revista letrare gjermane “Literatura” Nr. 11, ndërmjet 20 autorëve nga Gjermania dhe vendet e tjera të Europës dhe të Ballkanit boton edhe fragmente nga krijimtaria e shkrimtarit shqiptar Shefki Karadaku. Revista është botuar nga shoqëria letrare “Marburg” e Universitetit të Marburgut. Kopjet e saj ruhen në bibliotekën gjermane sipas ISSN.

Disa vjet më parë, me kontributin e familjes u botua në anglisht romani i Shefki Karadakut “PUTHJA E NGRIRE”. Nga një kopje iu dhurua selive të huaja diplomatike në Tiranë. Dhe menjëherë erdhi vlerësimi i ambasadorit gjerman, Peter ZINGRAF për romanin, që me të drejtë është mirëpritur e vlerësuar në botën letrare të kryeqytetit.

Nuk është rastësi që poeti e prozatori Shefki Karadaku mirërpritej e botohej kudo në trevat shqipfolëse, si në Prishtinë, Dibër të Madhe, Ulqin, Strugë etj. Madje, në vitet 1973-1974 gazeta prestigjioze “RILINDJA” e Prishtinës botoi në 6 muaj radhazi novelën e tij “Kur kërcasin boçet e pishave”.

Trashëgimia letare që na la Shefki Karadaku me 13 vëllime me poezi dhe 12 romane e 10 libra me tregime e novela, nuk është pak. Ato janë një kontribut i çmuar për të sotmen dhe për të nesërmen, që të mos ketë “Puthje të ngrirë”, që fjala e lirë të rrjedhë si “Ujëvarë”, që “Gjergj Elez Alia” t’u transmetohet brezave si njeri trim dhe i besës, si njeri i zgjuar dhe i ditur, që respekton njerëzit e tij e vizitorët e huaj të rajonit e të botës, që “Shkumbini” të mos shkatërrojë tokat, por të përmirësojë ekologjinë tonë, që “Elbasani i bukur” të çlirohet nga ndotja dhe të shndërrohet në turizmin tradicional shekullor. Ky është mesazhi që përcjell vepra e Shefki Karadakut. Ndaj, shkrimtarë të tillë si Ai, që kanë sjellë risi në letërsinë tonë, meritojnë vëmendje nga kritika letrare dhe, në mungesë të Lidhjes së Shkrimtarëve, nga Ministria e Kulturës e nga Presidenti i Republikës.

Personalitete si ai, meritojnë vëmendje, sepse janë truri i kombit. Në asnjë libër poetik të tij dhe sidomos, tek më i fundit me titullin sinjifikativ “TORAKS”, nuk mungon Elbasani. Karadaku është ajo kumria që s’ë tradhtoi kurrë...Siç shkruan Kostandin Dhamo: Ky libër, këtë herë, përveç teksit poetik kamidis faqesh edhe disa fotografi dhe vizatime, të hedhura gjithë fantazi fine nga vetë Shefki Karadaku. Këto vizatime së bashku me fotografitë, shpërfaqin jetën e tij midis shtëpisë së lindjes e brigjeve të Shkumbinit, tek kundron kumrien n’ajër, Bezistanin gumëzhitës, Kalanë, Sahatin, shelgun e pikëlluar që shkrehet mbi ujëra, dritaret pas pemëve të redaksisë së revistës “Ylli, Rrugën e Elbasani e ç’nuk tjetër... ”

Shefki Karadaku, nga Elbasani i kumries, kësaj embleme n’ajër, nga Elbasani i Kalasë me çezmat te porta, që rrjedhin e rrjedhin si mikpritja dhe shtëpitë përbrenda me lule dhe vajza të bukura, nga Elbasani i Ditës së Verës, i ballokumeve të ëmbla, i Shkumbinit shkumëzues, përgjatë brigjeve të të cilit stinët ndërrohen si dekore nga Elbasani i Kristoforidhit, Isuf Myzyrit, Dhaskal Todrit, vëllezërve Shpataraku, Bezistanit, Rrapit të Vojvodës, me poezinë dhe prozën e tij me vlera kombëtare, i dhuroi këtij qyteti një identitet të ri, Elbasani i Shefki Karadakut.

Bashkëshortja e tij, Nadirja thotë: “Shefkiu nuk e programonte kohën kur shkruante. Shkruante në shtëpi, në parqe e lulishte, kudo ku gjelbëronte muza e tij.....Kishte ditë që ulej para tavolinës dhe shkruante për 10 orë rresht. Shpesh çohet edhe nga gjumi dhe shkruante për disa orë edhe natën... Nuk kishte regjim të caktuar por pas viteve ‘90 ai shkroi me shumë temp dhe botoi shumë libra, ndërkohë që la në dorëshkrim disa vepra te tjera letrare”.

Më 16 mars 2021 familja Karadaku humbi njeriun e saj të dashur dhe që e bënte të ndjehej krenare. Ndërsa letërsia dhe kultura kombëtare humbën një nga autorët e saj më të shquar, kur mund t’i jepte edhe vepra të tjera, edhe më cilësore artistikisht dhe më të pasura emocionalisht. Shefkiu u shua vetëm fizikisht. Emri e veprat e tij të shumta i kanë dhënë me kohë të drejtën e denjë të pavdekësisë dhe të prehjes në Parajsë.

<https://fjala.al/2022/03/12/adn-ja-e-pandryshuar-eshefki-karadakut/>

TEODOR LAÇO, NJERIU I LETRAVE, POLITIKËS DHE DIPLOMACISË

Vepra shumëpërmasore e shkrimtarit, politikanit dhe diplomatit të
urtë e vizionar

Gazeta “Panorama”, tetor 16, 2021

Njeriu i letrave, i politikës dhe i diplomacies, Teodor Laço zë vend nderi në historinë e letrave shqipe, si një prej shkrimtarëve më të shquar dhe përfaqësues i letërsisë bashkëkohore shqiptare, i cili përveçse përvijoi një profil modern në krijimtarinë letrare, nuk u tregua indiferent edhe ndaj zhvillimeve demokratike, duke u bërë në një nga zërat kryesore në jetën parlamentare shqiptare.



Prej vitesh, botës së mendimit i kishte munguar ky intelektual i shquar, vizionar dhe kurajoz, i cili së bashku me kolegët e tij do ta shndërronin Kinostudion në verën e vitit ‘90 në djepin e mendimit liberal për kohën. Ka vjet që politikës i mungon ministri i kulturës, njëri ndër themeluesit e Partisë Socialdemokrate, ish-themeluesi dhe kryetari i Partisë Bashkimi Social Demokrat (sot Bashkimi Liberal Demokrat).

Laço ishte dhe mbetet simbol i politikanit të arsyës, besnik ndaj vlerave dhe parimeve që besonte... Ai ka lënë pas një trashëgimi të vyer në të gjitha fushat ku kontribuoi. Kontributet e tij kanë qenë të spikatura që kur hyri në kulturën dhe letërsinë tonë, por edhe në proceset demokratike.

JETA

Teodor Laço lindi më 29 shtator 1936, në Dardhë të Korçës. Për të, si Dardha nuk kishte të dytë. Aty netëve të verës qielli është një magji, që mund të mrekullojë edhe shpirtrat e thatë; me yjet e mëdhenj që vezullojnë dritë shkëlqyese, me yjet e vegjël që regëtojnë në të venitur, me yjet që bien e digjen, duke ndjellë trishtim për jetët që shuhen”.

Djali i një mërgimtari, si një nga të shumtët emigrantë dardharë të Amerikës, të atin, Pandi Laço, do ta takonte për herë të parë dhe të fundit kur qe vetëm 20 vjeç, duke e jetuar rininë e tij të hershme larg dashurisë së babait, duke pritur letrat e përmallshme që vinin përtej Atlantikut. U diplomua për agronomi, por talenti i tij spikati sidomos në fushën e letrave. Jetoj me nënën pranë, e cila do të bëhej shëmbëlltyra e shkrimtarit të ardhshëm; e ëmbël, fjalëpakë, e dashur dhe e papërtuar si një nënë. Shtëpia e tij në Dardhë ka qenë deri në ditët e pelegrinazhi më i dashur i Teodor Laços. Babai i dy djemve të talentuar në fushën e kulturës dhe të spektaklit televiziv–Pandit dhe Bledit e bashkëshort i aktores Mirjana, ai u ndie ngrohtë brenda shtëpisë së tij të letërsisë dhe të kulturës deri në ditët e fundit të jetës si pakkush tjetër. Ai nuk e tradhtoi asnjë çast vendlindjen, Dardhën.

Shkoi dhe u kthye si Anteu. Ajo strëhëz u bë frymëzimi i sa e sa veprave letrare të Teodor Laços. “Shtëpi e vjetër e fëmijërisë/ Hapet porta e vjetruar/ Porta që për mua është ankuar/ Kur vija rrallë i ftohtë e i vonuar? Wshtë porta nga e cila Ai u përçoll për në botën e përtejme më 16 tetor 2016. (Vdiq më 15 tetor dhe iu dha lamtumira e fundit nga personalitete të shumta të politikës, letërsisë, artit e kulturës më 16 tetor 2016).

VEPRA LETRARE SHUMËPËRMASORE E TEODOR LAÇOS

Si rrallëkush në fushën e letrave, Teodor Laço krijoi një trashëgimi letrare shumëpërmasore. Krijimtaria e tij është shumë e gjerë. Janë rreth 55 vepra të botuara në letërsi dhe në publicistikë. Me korpusin e tij letrar – romane, tregime, drama, komedi e kujtime. Teodor Laço zë vend të veçantë në historinë e letërsisë shqipe. Ai ka filluar të botojë që prej viteve ‘60. Është autor i disa skenarëve të filmave artistikë dhe dokumentarë.

Disa prej librave të tij janë vlerësuar me çmimet më të larta që jepen në

Shqipëri. Si romancier, tregimtar, dramaturg, komedian, eseist, skenarist, komentator, opinionist e politolog, ai, padyshim njihet nga lexuesi shqiptar, por dhe ai i huaj. Ai njihet si një nga kolosët e letrave shqipe. Janë të njohur për lexuesin romanet e Teodor Laços: “Tokë e ashpër” (1971), “Përballimi” (1975), “Lëndina e lotëve” (1980), “Të gjithë lumenjtë rrjedhin” (1985), “Pushimet e kolonelit” (1990), “Një vit i hidhur” (1995), “Mjegull” (2009), “Vrasja e buzëqeshjes” (2013), “Gropas 67” (2014) etj. Njihet po ashtu proza e tij e shkurtër, si: “Rruga e bardhë”, “Një natë shiu”, “Ajri i ftohtë i mesnatës”, “Portat e dashurisë”, “Pylli në vjeshtë”, “Vdekja e nëpunësit X” etj. Tregimet e tij mbeten modele krahasuese e referuese në tregimin e shkurtër shqiptar.

Pjesë integrale e krijimtarisë letrare të tij janë dramat dhe komeditë, po aq të suksesshme: “Shtëpia në rrugicë”, “Një nuse për Stasin”, “Gjëmimi i atij dimri”, “Qyteti i akuzuar”, “Shi në plazh” etj. Ato kanë lënë gjurmët e tyre në repertorin klasik të spektakleve dramaturgjike shqiptare. Në lëmin e kinematografisë, Teodor Laço cilësohet si një prurës autoritar i skenarëve artistikë, mbi të cilët u realizuan një varg filmash me prirje të reja regjisoriale e artistike. Dorën e tij mbajnë filmat “Përballimi”, “Dhe vjen një ditë”, “Flutura në kabinën time”, “Vitet e pritjes”. Suksesi i tyre në publik u garantua së pari nga skenarët e tyre me vlera.

Nuk mund ta konsiderosh të shteruar fjalën për veprimtarinë krijuese të Teodor Laços pa përmendur edhe publicistikën e tij kulturore, politike e sociale.

Përveç dhjetëra e dhjetëra artikujve Teodor Laço ka shkruar dhe botuar dy librat “Kohë për të kujtuar, kohë për të harruar” dhe “Bashkëjetesë me kohën”. Janë libra vëllimorë me publicistikë social-politike e diplomatike që e cilësojnë atë si një vëzhgues, përjetues dhe analizues të mprehtë të realiteteve historike kombëtare e ndërkombëtare. Edhe libri “Një dritare në Kremlin” është pa dyshim pasqyrë e angazhimit të tij krijues.

Ky libër është një shartim i historisë me krijimin, një kuturisje karakteristike prej shkrimtari, që vjen në ndihmë për të hapur një dritare në kështjellën që rusët e quajnë Kremlin, me një brendësi plot mistere. Kësisoj, Teodor Laço ishte dhe mbetet si model i shkrimtarit të prozës së shkurtër, romanit, dramës e komedisë, skenarit të filmit e publicistikës.

TEODOR LAÇO SI POLITIKAN

Si një prej intelektualëve antikonformistë, që paraprinë me krijimtarinë e tyre vizionin për nevojën e ndryshimeve politike e shoqërore kah demokratizimi i vendit. Teodor Laço u përfshi në proceset e krijimit të pluripartizmit në krahun liberal demokrat, fillimisht si një prej themeluesve e drejtuesve të Partisë Social-Demokrate, duke qenë edhe nënkryetar i saj deri në vitin 1994 dhe më pas, si krijues e drejtues për 10 vjet i Partisë Bashkimi Social Demokrat (që më vonë e ndryshoi emrin në Bashkimi Liberal Demokrat). Gjatë kësaj kohe (1992-1996 dhe 1997-2005), ai zgjidhet deputet i Parlamentit shqiptar. Teodor Laço u bë pjesë e legjislativit nga zgjedhjet e lira pluraliste më 1992. Vijoi si deputet edhe për dy legjislatura me radhë (12 vjet deputet i Kuvendit të Shqipërisë). Si deputet, Teodor Laço do të kujtohet për fjalën e urtë e të mençur, duke ndikuar kështu në shtensionimin e situatave konfliktuale mes shumicës dhe opozitës. Ai që ndoshta nga të rrallët, që në kompromis me PD-në e aleatët e tjerë të qendrës së djathtë, ndonëse me dy deputetë të partisë së tij (Laço dhe Starova) arriti krijimin dhe drejtimin e grupit parlamentar liberaldemokrat.

Në ligjërimin e tij politik, për më shumë se një dekadë në legjislativin shqiptar, spikati mençuria dhe vizioni bashkëkohor. Teodor Laço e drejtoi BSD-në me moton “Për një moral të ri politik” dhe nën këtë moto gjatë dhjetë viteve (1996-2006) kjo parti që përfaqësuese, jo vetëm në legjislativin shqiptar, por edhe në pushtetin vendor (bashki e komuna) me një numër të konsiderueshëm: 200-230 këshilltarë bashkiakë e komunalë. Për të sjellë një moral të ri politik, moral besimi dhe përgjegjësie, Laço e Starova, si dhe bashkëpunëtorët e tyre në kryesinë e kësaj partie (Shaqir Rexhvelaj, Petrit Karabina, Adem Jakllari, Behar Gjoka, Halil Rama, Kozeta Mesiti, Kujtim Leka, Myslim Islami, Tonin Deda, Andon Andoni, Gentian Zoto etj.), përballuan me stoicizëm edhe sulmet e paprincipita në vitet 2004-2005 ndaj tyre e partisë që drejtonin, (kur u sulmuan egërsisht nga lidershpiu demokrat, vetëm e vetëm pse votuan kundër verdiktit të tyre, kandidaturën e Robert Çekut për kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit).

Pas Sabri Godos, do të ishte Teodor Laço që do të njihte dhe do të zbatonte institucionin e dorëheqjes, duke ia lënë drejtimin e partisë diplomatit Arian Starova, që nga kuvendi VI kombëtar i BLD (2006). Në harkun kohor të dy viteve (1994- 1997), Teodor Laço qe ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Qenë pikërisht këta dy vjet kur ky dikaster, ndoshta për herë të parë, njohu standardet e përparuara europiane. Bashkëkohësit e kujtojnë Laçon ministër, veç të tjerash për sjelljen në Tiranë të disa trupave teatrore e muzikore nga vende të ndryshme perëndimore, si dhe të artistëve me famë botërore, duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në integrimin e kulturës shqiptare në botë.

Qe koha kur nën drejtimin e tij Shqipëria rinisi organizimin e festivaleve kombëtare. (Festivali Folklorik, jo më në Gjirokastrë, por në Berat), kur rinisi funksionimi normal i trupave teatrore (Teatri Kombëtar dhe ai i Operës e Baletit, si dhe trupat teatrore rajonale të qyteteve kryesore) dhe kur iu kushtua vëmendja e duhur shtetërore monumenteve të kulturës, arkeologjisë etj.

Pikërisht në vitet kur Ministria e Kulturës drejtohej nga Teodor Laço, u përgatitën dosjet për pranimin e Beratit e Gjirokastrës në UNESCO, ndërkohë që Kruja, Butrinti, Apolonia, Kalaja e Rozafës, Voskopoja etj., njohën bum turistësh.

Teodor Laço ministër mbahet mend edhe për kalimin e pallateve të kulturës të qyteteve kryesore në varësi të bashkive, kur shumë institucione të tjera, si atëherë edhe sot, janë të centralizuara nën administrimin e dikastereve qendrore. Kur ai ushtronte detyrën e ministrit të Kulturës, në vitin 1995, një nga ngjarjet më mbresëlënëse ka qenë sjellja e eshtrave të Faik Konicës në Shqipëri. Fjalët që ka mbajtur për veprimtarinë e Konicës në Nju Jork, në prani të pothuaj të gjithë anëtarëve të “Vatrës, si dhe në Katedralen e Shën Gjergjit, në Boston, edhe sot na japin emocione po aq të thella.

NË DIPLOMACI, SI AMBASADOR NË FEDERATË”N RUSE

Teodor Laço e mbylli karrierën e tij si ambasador i Shqipërisë në Federatën Ruse (2006-2008). Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me të

ashtuquajturit “diplomatë të karrierës”, përrurimi i të cilëve ndjek rrugën e zakonshme të ngritjes nga një gradë diplomatike në tjetrën. Por Teodor Laço e fitoi me meritë edhe këtë titull. Dhe e përfaqësoi denjësisht shtetin shqiptar në Federatën Ruse. Në këtë shtet të madh ai u angazhua dhe ia arriti të promovonte një nivel të lakmueshëm kulturor.

Ashtu si nobelistët Miguel Anhel Asturias, Octavia Paz etj., që njihen edhe si ish-ambasadorë të Amerikës Latine në Francë, edhe Teodor Laço ynë përfaqësoi në Moskë modelin shqiptar të diplomatit. Teodor Laço që, ndoshta nga të rrallët ambasadorë që diti të ndërtojë një raport të drejtë midis pasionit kryesor të tij, që ishte krijimtaria dhe detyrës shtetërore.

Për të, një nga rastet kur i është dashur gjithë gjakftohtësia dhe vendosmëria për ta kaluar, ka qenë koha që u shpall Pavarësia e Kosovës, kur në selinë e ambasadës shqiptare në Moskë erdhi një kërcënim për vendosje bombe, i cili u shoqërua me protesta pas bllokut të ambasadës. Këtë moment tejet të vështirë, ish-ambasadori Teodor Laço e menaxhoi me përpikërinë maksimale. Gjithsesi, si sukses të tij gjatë atyre dy viteve mund të përmendim diplomacinë kulturore.

Ato dy vite, pa iu shmangur fushës së letrave, i shërbyen shkrimtarit dhe diplomatit Teodor Laço për të skeduar librin “Një dritare në Kremlin – Nga Hrushovi te Putin”, që do ta botonte disa vjet pasi kishte dalë në pension, duke i ardhur kështu në ndihmë lexuesit për të hapur një dritare në kështjellën që rusët e quajnë Kremlin, me një mjedis plot mistere. Kështu, dy vitet si ambasador në Moskë Teodor Laço iu përkushtua historisë, arkivave, shtypit, librave të botuara, që kanë zbuluar shumëçka nga ngjarjet që kanë ndodhur brenda mureve të Kremlinit në 50 vitet e fundshekullit të kaluar.

Nëse do të jetonte sot Teodor Laço, një prej figurave të shquara intelektuale e krijuese shqiptare, historia e letërsisë shqipe do të pasurohej më tej me veprat e tij, por vdekja më 15 tetor 2016 ia ndërpreu jetën e veprimtarinë e tij të shumëfishtë.

Sidoqoftë, ne e përjetojmë atë sikur të ishte ende gjallë si një imazh e pasqyrim të aktivitetit të tij të gjatë, të angazhimit të tij të gjerë e poliedrik në disa role e arena të rëndësishme të jetës kulturore, artistike, shoqërore, politike, në kontekst me shoqërinë dhe me kohën kur ai ka jetuar, por edhe me një rreze largpamësie, vizioni e reflektimi që e bën atë një vegimtar e

protagonist të pararojës së shndërrimeve e progresit të jetës e shoqërisë shqiptare. Kontributi dhe trashëgimia e vyer që ai la pas do të jetojnë përgjithmonë.



Panorama.al–<http://www.panorama.com.al/teodor-lacodiplomat-ne-rusi-si-e-kercenuan-me-bombe-ambasadenshqiptare>

<https://gazeta-nacional.com/teodor-laco-ne-85-vjetorin-e.../>

<http://dritare.info/laco-njeriu-i-letrave-politikes-dhe.../>

Libri i tij "Një jetë në shërbim të njerëzve", modeli i shkrimit të një monografie letrare

DR.SALI KURTI, "NDERI" I KLUBIT LETRAR "PJETËR BUDI"



Ai ka të drejtë të ndjehet më krenar se kurrë si përfaqësues dinjitoz i elitës matjane, si një nga bijtë e Matit me histori të lashtë, djep i kulturës dhe artit kombëtar. Të Matit, ku që nga Pjetër Budi e brez pas brezi, fjala poetike matjane nuk ka shterrur kurrë...

Pjesëmarrja në Festivalin e 8-të Kombëtar të Poezisë "Muza Budiane" që u mbajt në qytetin e Burrëlit para pak ditësh dhe vlerësimi me titullin "Anëtar Nderi" i Klubit Letrar "Pjetër Budi", janë një tjetër ngjarje e shënuar në jetën e Dr. Sali Kurtit.

Pasi ka marrë titullin e lartë "Mjeshtër i Madh" nga ish Presidenti i Republikës Bujar Nishani, me dekret Nr.10320, datë 18.05.2017, si dhe titujt "Qyetar Nderi" i Bashkisë Mat; "Mirënjohja" e Këshillit të Qarkut Dibër; "Ambasador i Paqes" nga Federata e Paqes Universale dhe "Njeriu i vitit 2024" i kësaj Federate, titulli "Anëtar Nderi" i Klubit Letrar "Pjetër

Budi", është një tjetër vlerësim i merituar që i shtohet gjerdanit të artë të këtij personaliteti me rrezatim mbarëkombëtar. Dhe kjo, jo rastësisht, por në vlerësim të librit të tij "*Një jetë në shërbim të njerëzve*", si modeli i shkrimit të një monografie letrare.

PËRMBAJTJE E PASUR LËNDORE ME TEMATIKË MJAFTË TË LARMISHME

Njëzetëtre artikujt e këtij libri me 294 faqe, janë vërtetë një përmbajtje e pasur lëndore me një tematike mjaftë të larmishme. Duke dëshmuar për jetën, autori i këtij libri nxjerr nga pluhuri i harresës, momente, histori jetësore, detaje, njerëz, ngjarje, vende e hapësira, të cilat sëbashku shpalosin botën tonë të brendshme dhe të jashtme. Mjafton për këtë qoftë dhe ky perifrazim nga fragmenti "*Nën hijen e lisit me qiellin plot ëndrra mbi krye*": "*Gjatë verës flinim në oborrin e shtëpisë, poshtë një peme lisi shumëvjeçar. Atje shtronim një dyshek prej byku dhe kalonim natën me biseda e shaka me njëri-tjetrin. Harmonia e madhe që kishim, na bënte t'i harronim rrethanat në të cilat jetonim...*" (fq.105). Është ky, një rrëfim i çiltër i fëmijërisë së një personazhi që përmes vështirësish të shumta do të ecte i sigurtë në jetë, nga bankat e shkollës, në auditorët e universitetit e deri në drejtimin e institucioneve të rëndësishme të Matit. Brenda këtyre pak radhëve dallojmë stilin e një shkrimtari me frazë të zgjedhur e gjuhë të pasur, duke e bërë kështu mjaftë tërheqës librin e tij. Në "fronin e shkrimit", Dr.Sali Kurti ka arritur kështu ta skalitë fjalën e shkruar dhe ta vendosë atë në piedestalin e afirmimit të vlerave ideoartistike, si shkruar, ndër më të mirët të një monografie letrare. E ndeshim këtë sidomos në artikujt me titujt: "*Nga fshati në fshat në kërkim të dijes*", "*Ëndrrat filluan të jetësohen*", "*Jetëgjati nuk bëhet jetëshkurtër*", "*Krijimi i strehëzës familjare*", "*Pasioni për tatarin dhe të bukurën në përgjithësi*" etj.

Brendia e këtyre artikujve përshkohet me pasqyrimin e mendimit e të vlerave krijuese, për çfarë dëshmon edhe thënia latine "Fjala ikën, e shkrimi mbetet". Këtë domosdoshmëri autori e ka spikatur në fillim të librit, si moto filozofike dhe këshillë për ata që pretendojnë krijimtari të kësaj lëmie, duke na lënë si testmament fjale se: "*Harresa, për këdo është shpërblimi më vrapar për mundin e kaq shumë viteve dhe sakrificat e sfidat*

e përditshme, të cilat ikin e vijnë në valët e jetës sonë".

Këtë mesazh thelbësor dhe intelektual, Dr.Sali Kurti e përcjell tek lexuesi si dritërrëfim për të afirmuar të bukurën, punën dhe vlerat krijuese në përgjithësi. Madje, duket se pikërisht në këtë optikë, e ka vlerësuar atë edhe ish-Presidenti Nishani në fjalën e tij me rastin e dekorimit me titullin "Mjeshtër i Madh", kur ndër të tjera është shprehur se: *"Për fatin e mirë, kemi shumë personalitete si Dr.Sali Kurti, që me pasion, dëshirë, bindje, parime, dinjitet dhe integritet kanë ndërtuar jo vetëm rrugëtimin e udhën e tyre, jo vetëm emrin e tyre, por edhe arritjet e kontribitet e gjithë Shqipërisë dhe të gjithë shqiptarëve".* Këtë dimension e dallojmë fare qartë në këtë vepër të dr. Sali Kurtit, ku shpalosen ngjarje e fakte historike dhe personalitete krijuese të rrethit të Matit.

Parë nga ky këndvështrim, edhe Drejtuesit e Klubit Letrar "Pjetër Budi", duke e bërë "Anëtar Nderi" të këtij klubi letrar ndër më të njohurit në rang kombëtar, (ashtu si Presidenti Nishani) kanë vlerësuar, jo vetëm pasionin dhe profesionin, jo vetëm dimensionin e qytetarit e të akademikut, por në tërësi veprën krijuese të doktor Sali Kurtit, idetë dhe kontributet tij. Në librin e tij *"Një jetë në shërbim të njerëzve"* është evidente fuqia e mendjes, imagjinata, por edhe fuqia e ndjenjave, si dashuria e gëzimi (te *"Krijimi i strehëzës familjare"* e *"Bekimi si 'prind' dhe magjia si 'gjysh'"*), por edhe dhembja e pikëllimi (tek artikulli *"Humbja e babait dhe të qënët shtylla e një familjeje të madhe"*), si faktorë të krijimit të vlerave.

LIBRI I JETËS....

"Një jetë në shërbim të njerëzve" është libri që Sali Kurti ua dedikon familjes, paraardhësve të tij dhe brezave që do vijnë. Libri i botuar para pesë vitesh nga "Luis Print", me redaktore prof. as. Jolanda Lila, është modeli i shkrimit të një monografie jetësore. Kjo për faktin se në 294 faqet e tij gjejmë detaje për vitet e vështira të fëmijërisë, pemën gjenealogjike, jetën konviktore dhe studentore në Politeknikumin Mjekësor e Universitetin e Mjekësisë të Tiranës, krijimin e strehëzës familjare, punën si drejtor i Shërbimit Stomatologjik të rrethit të Matit, pasionin për teatrin dhe të bukurën në përgjithësi, bekimin si "prind" dhe magjinë si "gjysh", etj., Prof. dr. Sali Kurti nuk nguron të shkruaj në këtë libër se si nga një ish-

bari dhish, kur sapo kishte mbaruar filloren dhe e kishte të pamundur të vazhdonte shtatëvjeçaren, do të ngjiste shkallët e dijes duke rendur nga fshati në fshat e deri në qytetin e Burrelit, dhe se kur pikërisht, kur priste emërimin si ndihmësmjek për të ndihmuar familjen e shumëvujtur, do t'i vinte fletëthirra për ushtar.

Por, asnjëherë nuk u dekurajua. Nga leximi i këtij libri, lexuesi krijon bindjen se arritjet në jetë, në çfarëdolloj fushe, janë kombinim i rrethanave të jashtme të mjegullta me dhunti njerëzore të mbinatyrshe. Më së miri këtë e dëshmon sukcesi i tij që është shumatore e një kalvari të gjatë, e një rruge të vështirë e të mundimshme, të përcaktuar nga natyra dhe përkushtimi i tij... Është pikërisht ky përkushtim, që bariu dhe më pas nxënësi i dikurshëm, që darkat e gjenin të lodhur fizikisht, por gjithnjë të përkulur mbi fletore nën dritën e zbehtë të kandilit, duke bërë detyrat e shkollës për të qenë gati për të nesërmen, ka arritur sot deri krijues dhe administrator mjaft i suksesshëm i klinikës “Mat Dental”, ndër më të preferuarat për pacientët e kryeqytetit.

“Profesioni i stomatologut është një profesion delikat dhe kërkon kohën e vetë për t’u bërë i besuar. Ardhja në Tiranë, për mua ishte si të nisja ditën e parë të punës, pasi po vija në një mjedis ku nuk më njihte askush, së paku ashtu mendoja në atë kohë (15 maj 1998). Por shumë shpejt, me mirësjellje dhe me punë cilësore profesionale, pacientët u vendosën në radhë. Në radhët e tyre fillova të shoh shumë matjanë, të cilët i kisha njohur më parë.

Shumica prej tyre vinin enkas nga Burreli në Tiranë për të marrë shërbimin stomatologjik. Unë mendova se i kisha braktisur me largimin tim në Tiranë, por në fakt jeta më tregoi se ata nuk mund të më braktisnin mua, edhe pse klinikat stomatologjike nuk mungonin në Burrel... Shumica e tyre kur vinin më shprehnin mirënjohjen e thellë për cilësinë e shërbimit të kryer 30 apo 40 vjet më parë, për mbushje dhëmballe që i kishin rezistuar dekadave, e për shumë procese të tjera, të cilat i bënin ata që të udhëtonin e sakrifikonin për të marrë shërbimin përmes duarve të mia”, shkruan ndër të tjera prof. Sali Kurti në librin e tij “Një jetë në shërbim të njerëzve”(fq.239-240). Dhe vërtetë, nuk mund të ketë kënaqësi e sadisfaksion më të madh se ky, pasi besnikëria e këtyre pacientëve e ka bërë prof. dr. Sali Kurtin ta shohë qenien njerëzore, gjithnjë si të delirë dhe pozitive. dhe ta përjetësojë atë në procesin e tij krijues, mjaftë produktiv dhe cilësor.

Ndaj dhe ish-Presidenti i Republikës SH.T.Z. Bujar Nishani, në fjalën e tij me rastin e dekorimit me titullin "Mjeshtër i Madh", ndër të tjera është shprehur se: *"Doktor Sali Kurti ia ka kushtuar jetën profesionit të mjekut, një profesion ky i nderuar, por edhe i vështirë. Me një karrierë të gjatë, gati prej 5 dekadash, ai është kthyer në shembullin e njeriut të punës, duke dalluar për përkushtimin, mirësinë, humanizmin dhe shpirtin e tij krijues"*.

Është pikërisht ky vlerësimi i Kreut të Shtetit Shqiptar, në mjediset e Presidencës, në prani të shumë personaliteteve shtetërore, politike e shoqërore, me rastin e akordimit të titullit të lartë "Mjeshtër i Madh", prof. dr. Sali Kurtit, me motivacionin: *"Për kontributin shumëvjeçar në fushën e stomatologjisë, dhënë me ndërgjegje, përkushtim e profesionalizëm të lartë në ndihmë të popullsisë së rrethit të Matit, si dhe në vlerësim të punës së tij në drejtim të përsosjes së shërbimit mjekësor dentar"*.

Pikërisht për këto merita dhe veçanërisht për shpirtin human, vlerat njerëzore dhe intelektuale e krijuese që mishëron dhe përçon tek publiku i gjerë edhe nëpërmjet librit të tij *"Një jetë në shërbim të njerëzve"*, Ai e meriton plotësisht edhe titullin *"Anëtar Nderi"* i Klubit Letrar *"Pjetër Budi"*. Ndaj dhe ndjehet më krenar se kurrë si përfaqësues dinjitoz i elitës matjane, si një nga bijtë e Matit me histori të lashtë, djep i kulturës dhe artit kombëtar. Të Matit, ku që nga Pjetër Budi e brez pas brezi, fjala poetike matjane nuk ka shterrur kurrë.

Dr.Sali Kurti ka të drejtë të krenohet. tashmë edhe si "Anëtar Nderi" i Klubit Letrar që mban emrin e të Madhit të letrave shqipe, Pjetër Budi, nga Guri i Bardhë i Klosit të rrethit të Matit, në faqen zyrtare të cilit, me të drejtë vlerësohet si poeti dhe prozatori i parë i letërsisë sonë, autor i katër veprave fetare në gjuhën shqipe, organizator dhe udhëheqës i masave popullore në luftën për çlirim nga zgjedha osmane, përkthyes dhe krijues origjinal në fushën e letrave shqipe, për të mbrojtur identitetin etnik e kulturor të popullit tonë.

HALIL RAMA


II.

PROZA

ÇFARË KËNAQËSIE TË LEXOSH ZIJA ÇELËN!

Triptiku “Gjaku i dallëndyshes” – Tre romane në një libër –

Vitin e kaluar Onufri botoi tri romane të Zija Çelës në një vëllim të përbashkët. Kur një vepër letrare botohet për herë të katërt, siç ka ndodhur me romanin “Gjaku i dallëndyshes” të Çelës (botimi i parë – Naim Frashëri, Tiranë 1990; botimi i dytë – Dukagjini, Pejë 1992; botimi i tretë – Koha ditore, Prishtinë 2005 dhe botimi i katërt – Onufri, Tiranë 2021), s’ka dyshim që ai është ndër më të kërkuarit e më të preferuarit nga lexuesi. Dhe kur kjo ndodh edhe me dy romanet e tjera, “Gjysma e Xhokondës” dhe “Banketi i hijeve”, pjesë e këtij triptiku (I pari i ribotuar nga Onufri në 2021, pas botimit të parë më 1992 nga ShBL, Tiranë, dhe botimit të dytë nga Flaka e Vëllazërimit, Shkup, më 1998; ndërsa i dyti ribotim nga Onufri më 2021, pas botimit të parë nga Dukagjini, Pejë, më 1997), kureshtja e lexuesit për ta është e shkallës më sipërore.



1

Kështu ndodhi edhe me mua gjatë shtatë ditëve të kësaj vere të nxehtë, duke lexuar tri romanet e triptikut “Gjaku i dallëndyshes”. Dhe singlerisht u befasova me lëndën e larmishme, bukurinë e narrativës, karakteret e shumta, përshkrimet e portretizimet brilante, gjuhën e pasur e gjithë forcë shprehëse. Vetëm një gjeni si Zija Çela di të sjellë aq atistikisht në një roman virgjërinë si tabu (“Gjaku...”); shpirtin rebel të banorëve të Bardhgolemit e figurat groteske të tre gjeneralëve të Barabisë, njëri prej të cilëve “vret” kuçedrën, që të rridhte uji për bashkëfshatarët, por bëhet vetë kuçedër (“Gjysma...”); si dhe historinë e një konflikti absurd, lindur që në gjenezë,

se cila nga popullatat e krahinës, ku zhvillohen ngjarjet, ka tru në kokë e cila është vetëm brumë kungulli. (*Banketi i hijeve*). Tri romane në një, ku pasi i ke lexuar, të mbeten në mendje shumë shprehje plot domethënie, si këto: “Në Bardhgolem burrat, që janë burra, nuk pranojnë të mbajnë ndërresa të pista dhe gra të përdorura.”; “Ata të Bardhgolemit kërkuan gjakun e çarçafit dhe gjetën gjakun e arkivoleve”; “Në shtëpinë ku mungon një dorë gruaje, besohet se ndryshimet vijnë vetëm nga zvetërimi”; “Kungulli po pushton botën dhe Mamaci nuk ka si të mbetet jashtë këtij ekspansioni”, etj. Për këto tri vepra kanë shkruar me vlerësime të larta pena të shquara. Pjesë nga shkrimet e tyre botohen në libër si Psthënie. Janë aty Mehmet Kraja, Eqrem Basha, Lazër Stani, Ramadan Musliu, Ali Aliu, Remzi Lani, Linda Abazi, Arbër Ahmetaj, Tefik Çausi, Halil Matoshi, Ismail Syla e Xhemail Mustafa. Ata i analizojnë romanet e Çelës jo vetëm në raport me krijimtarinë e autorit dhe të letërsisë shqipe, por edhe me vepra e autorë të mëdhenj të letërsisë së huaj. Dhe përfundimet e tyre janë sa orientuese, po aq të gëzueshme.

2

Pa pretenduar të bëj kritikën e mirëfilltë letrare, dëshiroj të theksoj disa nga mesazhet filozofike që përcjell Zija Çela në këto tri romane. Tek i pari, “*Gjaku i dallëndyshes*”, mesazhe të tilla përcillen gjatë gjithë zhvillimit të ngjarjeve. Madje të bëjnë përshtypje jo vetëm emërtimi i Bardhgolemit, vendbanimit ku janë skenat e ngjarjes, por edhe vetë emrat mbresëlënës të personazheve: Baltazari, doktor Zhavello, Çonda, Kondo, Ana, Shushulla, Lola, Vogël Heta, Kubat Kubati, Kovaç Kovaçi, Xhemë Kurti, etj. Të gjithë ndërveprojnë në funksion të realizimit të një dasme, nga e cila të nesërmen synohet të provohet virgjëria (ose zhvirgjërimi) e nuses, duke e “publikuar” çarçafin e përgjakur. Mesazhi është i qartë: virgjëria vajzërore si tabu deri ditën e martësës! Për të provuar këtë, përzgjidhen edhe shoqëruesit e dhëndërit e të nuses si dëshmitarë. Siç organizohet edhe përgjimi i fshehtë okular për aktin e natës së parë. Si njohës perfekt i së drejtës zakonore, pasi ka vëzhguar, perceptuar e përzgjedhur produktin në një zonë si Bardhgolemi, mjeshtri Zija Çela na mahnit me bukurinë e fjalës, teksa vë në gojën e personazheve shprehje të tilla: “e shkuara është si një varrezë, ku njerëzit tërë jetën ecin në majë të gishtërinjve, nga frika se mos shkelin diçka që përbën mekat.” (fq.75). Dhe më tej: “Ka gjasa që bash në shpirtin e burrit të

gjendet varri i vërtetë i gruas!” (fq. 80) Fantazia e autorit të vë në mendime, kur sjell në vëmendjen e lexuesit zakonin, sipas të cilit: *“dhëndri gjithmonë ka pasur shoqërues burrë të martuar, nusja doemos grua të martuar. Dhe dihet përse: veç të tjerave, shoqëruesit i mësojnë ata të dy si të flenë me njëri-tjetrin natën e parë. Për të mësuar kaq gjë, vajzës i duhen njëzet ose njëzet e pesë vjet...”* (fq.79-80). Teksa ngjarjet vërtiten rreth çarçafit të dëshmisë, autori na magjeps me personifikimin e burrave të Bardhgolemit, atyre që nuk pranojnë të mbajnë ndërresa të pista dhe gra të përdorura. Kësisoj, Z. Çela e vendos botën shqiptare në kthetrat e së djeshmes dhe të sotmes. Një dasmë e cila fillon në oborr, vazhdon me vrasje, por edhe me ngritjen e të vdekurit nga karroca, ku e kishin vënë trupin e tij, për t’u rivrarë përsëri. Sepse asgjë nuk ndodh rastësisht. Edhe sikur njëmijë herë të përsëriteshin ngjarjet, thuhet në faqet e para të romanit, njëmijë herë do të ndodhte vrasja. Dhe sikur kjo të mos mjaftonte, autori rrëfen mjeshtërisht edhe një vetëvrasje misterioze, larg syve të dasmorëve dhe pa dëshmitar. Këtu intriga bëhet thellësisht befasuese, duke e vendosur vetëvrasjen e Çondës në dhomën e dhëndërit. Ndaj dhe Eqerem Basha do ta konsideronte romanin *“një kronikë shqiptare me një lojë të jashtëzakonshme të krimit dhe misterit, të krenarisë, sedrës, psikologjisë së shqiptarit, e thurur me mjeshtërinë e prozatorit të racës, i cili di të krijojë pamje dhe të ndërtojë personazhe, çfarë pak e ndeshim në prozën shqiptare në përgjithësi. Dasma dhe krimi, aq të afërta me njëra-tjetrën dhe aq të fisit me legjendat shqiptare, përsëri më gjerë se kaq, me përshkrime të jashtëzakonshme të personazheve, tipa të veçantë dhe krejtësisht joshabllonikë.”*

3

Ndonëse përsëri me një kolorit të pasur e plot ngjyra, në një linjë tjetër i vendos ngjarjet e personazhet Zija Çela te romani *“Gjysma e Xhokondës”*. Mika (Mimika Gjoka), e fejuara e Albertit dhe mike e ngushtë e Aldos, do t’u deklarojë atyre që në fillim se është *“nga ai vend, ku të vdekurit gjithmonë i shtrijnë me fytyrën nga perëndon dielli dhe të gjallët s’flenë kurrë me kokën nga varrezat”*. Por gjithashtu edhe fare çiltazi: *“Kaq të mirë jeni të dy, sa nganjëherë çuditem që jam fejuar vetëm me njërin.”* Pas zhdukjes misterioze të kësaj zonjusheje, që *“në shpirtin e saj të aventurës kishte gjithnjë një ndjenjë drejtpeshimi”*, do të vihen në kërkim të saj jo vetëm ata, por edhe autoritetet lokale. Me këtë intrigë tërheqëse nis romani. Dhe me peshën se kishte


humbur personazhja, për të cilën “*e shkuara mbetet shpesh po aq interesante dhe po aq e panjohur sa e ardhmja, megjithëse njëra është dimension i jetës dhe tjetra i vdekjes.*” Është pikërisht ndërveprimi i këtyre personazheve, së bashku me tre gjeneralët e me figura të tjera, që përbëjnë pothuajse tërë zhvillimin e ngjarjeve. Madje nga dështimi i kërkimeve, fantazia e autorit shkon përtej ndjenjës së mëshirës kur, si t’i jetë dridhur dora, shkruan: “*O Zot, mëshirë për banorët e Barabisë: këdo që kanë në krye, gjithmonë do t’ua dhjesë punët!*” Dhe s’kishte si të ndodhte ndryshe, përderisa situata zotërohej nga tre gjeneralë të vetëshpallur: gjeneral Çonda, gjeneral Bitoku dhe gjeneral Harito, me këtë titull prej graduatësh falso, të cilët natën “*e bënin çifin si kalamajtë në uturak*”. Duke përligjur botën psikologjike dhe linjën e vijimësisë me romanin “*Gjaku i dallëndyshe*”, autori i vendos herë pas here personazhet e Barabisë përballë atyre të Bardhgolemit, si në rastin e kundërvënies ndaj doktor Zhavellos. Jo pa qëllim, në Barabi gjejmë edhe Fabrikën e Letrës. Sa here fryn era, në vendbanimin Barabi, që gabimisht i thoshin edhe Barbari, fluturojnë andej-këtej copa letrash, ku lexohen gjithëfarë shënimesh. E këtë gjetje Çela e shfrytëzon gjithë elegancë jo vetëm për t’i ndezur ngjarjet, por edhe për t’i veshur me mister e mendim universal. Si për shembull: “*Tri gjëra janë të vështira për t’u njohur dhe një gjë e katërt është e pamundur të njihet. Ato janë: gjurma e gjarpërit mbi gur, e zogut në ajër, e anijes në ujë dhe e burrit në gruan.*” Risi në këtë roman janë edhe “*Ditët e recitimit*”, ku në njërin prej tyre spikat një variant tjetër i baladës së Gjergj Elez Alisë. Sipas këtij varianti, “*Gjergji nuk vdes pas dyluftimit të kobshëm me Balozin e Zi, përkundrazi, ai vazhdon të jetojë për shumë kohë, madje një ditë arrin të ngrihet më këmbë. Veçse ajo që e ngre nuk është motra, siç thuhet në variantin e vjetër, e cila i rrinte mbi kokë dhe i ndërronte nëntë plagët, Gjergj Elez Alinë e ngre më këmbë gruaja.*” Një trill interesant ky, përkundër gjeneral Bitokut, që e kërkon lavdinë përmes lakmisë e pushtetit të dhunshëm, apo gjeneral Haritos që, me egoizmin e shfrenuar, as i verbër s’e lëshon pushtetin. E në këtë kuadër, në kuadrin e një metafore të madhe, banorët e Barabisë ndihen si përgjysmë. Ata pyesin nëse e kanë pasur dikur gjysmën tjetër të vetvetes, e kanë pasur dhe e kanë humbur, apo s’e kanë pasur asnjëherë. Prandaj nuk e njohin as Xhokondën, duke parë vetëm gjysmën e riprodhimit të saj në anë të pasqyrës te berberi Ruc Bërdaku. Sa therëse, por edhe sa e përjetshme kjo metaforë.

4

Pas Bardhgolemit dhe Barabisë, te *“Banketi i hijeve”* (fitues i çmimit “Velija”, 1999), Zija Çela na çon në Mamac, një vendbanim në skajin tjetër të së njëjtës fushë, ku ndodhen edhe dy të parët. Nga dritaret e shtëpive të mamacianëve dallohen *“sokaku i deshëve”, “sokaku i gjelave” dhe “sokaku i cjepëve”*. Autori nuk vonon që të bllofojë me të famshmin kungull i madh, që mbin dhe pushton gjithë qendrën e Mamacit. *“Për Mamacin çështja e kungullit është moral mbi të gjitha moralet.”* (Fq.489). Sepse, duke e ngrënë me shumë qejf, ata duan të thonë se nuk janë kryekungujt e gjenezës, njerëz pa tru janë kundërshtarët e tyre, bardhgolemasit dhe barabiasit. Madje, për armiqësinë mes tyre, autori përcjell edhe këtë kundërvënie të skajshme: *“Sa herë të ndërrojë jetë ndonjëri prej jush, bashkë me atë që ka vdekur, ne do të varrosim edhe një të gjallë.”* Me art përshkruhet ringjallja e Redonit dhe përpjekjet e tij për të rigjetur të ëmën, Dardanën... Po mjeshtërisht, referuar incestit, Z. Çela e mban pezull lexuesin me shprehjen proverbiale: *“Mitra e vërtetë nuk është ajo që shpallet, mitra e njeriut është truri.”* Kësisoj, siç e ka vlerësuar Arbër Ahmetaj: *“Mamaci i Çelës është plot e përplot me jetë, me kurvëri e me hasmëri, me tregti e me festa, me idiotësi e me burg, me të marrë e me të mençur, me emigrantë të ikur e të rikthyer, me të vdekur e të gjallë, që enden herë me krye e herë pa krye, me armiq përballë, me armiqësi të vjetër sa jeta. Autori mban nën kontroll jo vetëm linjat, personazhet, por edhe detaje e gdhendje nga më të imtat, të cilat i sjell e risjell në mënyrë të befasishme për kënaqësinë më të madhe të lexuesit. Ajo që e shndërron leximin e këtij libri në një kënaqësi të vërtetë është aftësia e shkrimtarit që të përziejë në të njëjtën materie letrare hiperbolizime fantastike me mite e rrëfenja të vjetra, që i japin shkrimin një natyrë eterike e mistike, njëherësh e këndshme për t’u lexuar dhe marramendëse si përfytyrim. Nëse vërtet nuk arrijmë “të dëgjojmë zhurmën që bën rruzulli i tokës duke u sjellë në boshtin e vet”, siç i ndodh një personazhi të Çelës, e sigurt që ndiejmë gurgullimën e pastër gjuhësore dhe mjeshtërinë e një shkrimtari të madh bashkëkohor”.*

<https://fjala.al> › 2022/07/30 › cfare-kenaqesie – te- lexosh-zija-celen...

NJË VËSHTRIM NDRYSHË PËR NOVELËN E PREÇ ZOGAJT “BIJA E VJETËR E NËNËS SË RE”



Nëse ndodh ta pyesin se ç’libër do të veçonte mes veprave të tij, në poezi e në prozë, Preç Zogaj rrëfen se do të qe novela “Bija e vjetër e nënës së re”, me të cilën lajmëron se do të gjendet për lexuesin në ditët e Panairit të Librit 2022. Është ndoshta ai krijim që e përmbush idenë e shkrimtarit, se letërsia duhet të arrijë të të prekë, të të emocionojë...të të mallëngjëjë.

A nuk janë fundja artet dhe letërsia mjeti për të arritur çlirimin përmes katharsisit?! “Një grua rreth të tetëdhjetave, Marija, futet një mëngjes me vrap, si në amok, si kurrë ndonjëherë, në dhomën e gjumit të djalit të saj të madh, Franit. “Sikur po e ndinin për ta vvarë”, mendon ky për një çast. Në fakt, Marijes i është shfaqur si ndër ëndërr nëna e saj që ka vdekur e re para gjashtëdhjetë vjetësh. Nga ai moment, shtëpia e Franit në Tiranë shtohet me një “fantazmë”, me atë të Marës, gjyshes, të cilën ai nuk e ka njohur. Me këtë episod fillon kjo novelë me titullin tejet intrigues “Bija e vjetër e nënës së re”, që u promovua të premtën nga UET PRESS.

Nga largësia e gjashtë dekadave, “bija e vjetër”, tashmë tetëdhjetëvjeçare, kujton nënën e saj që ka vdekur e re në moshën dyzet vjeçe. Marijen “nuk e ka lënë kjo jetë”, siç thotë autori, të ndalet e të thellohet te një moment kyç, që është vdekja e nënës së saj. Ky është një moment kyç që ngërthen intrigën e novelës dhe “misterin” e saj. Marija ka qenë nuse e re kur i vjen lajmi për vdekjen e nënës.

Lajmësi ka ardhur nga Mirdita në Lezhë për ta marrë. Pra, jo të thërrasë në mort njerëzit e familjes ku është martuar, por për të marrë bijën. Novela në thelbin e vet është një rikthim i Marijes në rrugën e Malit të Gjatë drejt mortit të së ëmës. Pse nuk e shoqërojnë njerëzit e burrit? Pse nuk janë thirrur ata në mort? Shpjegimi i këtyre pyetjeve ka mbetur në mjegull për shumë vite, jo se nuk është ditur, por njerëzit e dy familjeve nuk kanë dashur ta nxjerrin prej andej, sepse duke qenë një shpjegim që lidhet me ndarjen dhe luftën klasore që futi në jetën e shqiptarëve regjimi i porsavendosur komunist, është në fakt një shpjegim që nuk i përket konstitucionit të tyre shpirtëror dhe zakonor.

Në këtë vazhdë, edhe episodi i shtrëngesës të bijës së re nga njerëzit e familjes prindërore për të mos e lënë të kthehet më në derën e burrit të dhënë me shkuesi, me arsyetimin se këta të fundit e sollën atë të vetme, pa shoqëruar në mortjen e së ëmës. Trilli artistik i Preç Zogajt këtu kalon çdo limit. Penda e Zogaj do ta argumentonte artistikisht këtë akt të paprecedent për atë kohë, kur iu vesh Koldinajve të dekluar atributin e ruajtjes së familjes së Marijes, (kjo pa cen në biografi) nga ndëshkimi i veglave të diktaturës.

Por, “Ajo që kishte hequr keq të mësohej me rënien në shtrat me atë djalë, të cilin para se të martohej e kishte parë vetëm në fotografinë, që ia kishte sjellë shkesi Jak Shquti nga Patalana”, kurrsesi nuk do të shkelte mbi besnikërinë ndaj të shoqit, me të cilin ishte ngjizur trashëgimtari i tyre. “Bija e vjetër” që sheh herë pas here dhe bisedon në ëndrra pa fund me nënën e saj të re, është risi në këtë prozë krejt të veçantë të Preç Zogajt, risi kjo që konsiston qoftë edhe në dialogun e mëposhtëm: “Nëna dyzet e një vjeçe: Pa, ti Marije je! Bija tetëdhjetëvjeçe: Pooo. Nëna e re: Për Zotin, nuk të njofta. Bija e vjetër: Unë ty po.

Nuk ke ndryshu. Nëna e re: Sa vjeç je? Bija e vjetër: (Duke prekur me gishtat e njëres dorë gishtat e tjetrës) tetëdhjetë baj një javë pas ditës së

Shën Mëhillit”... Një dualos si ky vjen nëpërmjet një stilistike të rrallë, që konsiston qoftë edhe kur përshkruan Franin, sikur “aty për aty ndërmendi se nuk mund ta linte vetëm (nënë Marien) si ditët e tjera. Nuk mund ta linte vetëm me fantazmën e nënës së saj që kishte vdekur para 59 vitesh”. Duke na dhënë në portretin e nënë Maries personazhin kryesor që beson në botën e përtejme, autori po me mjeshtëri të rrallë artistike e ndërlidh atë me të birin, Franin, që mëton të krijojë me mendjen e tij një si identikit të gjyshes, Marës: “Konturet e para të portretit të saj dolën si një re puplore nga buzëqeshja e paharrueshme, të thuash hyjnore, që ishte krijuar rreth buzëve të Marijes, në çastin që kishte thanë për të “gja më të bukur !!!.....

Kjo ishte gjyshja e tij nga nëna, një vegim prej fotonesh...”. Prirjen e Preç Zogajt për të sendërtuar një model letrar krejt të ndryshëm në prozën e sotme shqipe, një lexues i vëmendshëm do ta dallonte edhe në përshkrimin brilant të “arës së madhe si përparëse, oborrit të lartë me qemer guri, kullës, një qilari në luginëzën djathtas, hangarit të drithërave, vozgave dhe veglave të punës, ograjës me lisa në shpatin e malit sipër hangarit...”, si dhe portretit të Gjetë Morfanës që dinte të bënte vetëm lajmësit e të vdekurve... që pasi kishte shoqëruar pa bërë zë Marien për disa orë në rrugëtimin e gjatë mes pllajave, lëndinave e maleve të sertë: “E dinte, se në njërën prej kthesave të luginës, nga një si ballkon mes dafinave, shihej ndërtesa dykatëshe e mbuluar me rrasa bojëhiri, shtëpia e saj e vajzërisë.....”.

Në këtë novelë, Preç Zogaj prezantohet edhe si njohës gjer në perfeksion i traditës, zakoneve, riteve e dokeve të krahinës së Malësisë së Lezhës, të sintetizuara këto në përshkrimin e ceremonive mortore, sjelljen e përjetimitin e vdekjes nga njerëzit e familjes etj.

Më evidente kjo në rastin kur: “Hyrja e saj në hangarin e mbushur me gra, disa në këmbë e shumica ulur në stola të gjatë, u prit me pëshpërimat që kërkonin të binte heshtja e plotë dhe të spikaste kuja e Marijes” dhe kur: “Ajo (Maria) përparoi me kryet ulur në korridorin që të çonte te shtrati ku kishin vendosur xhenazen, pa thekët e verdhë të një mbulese, pastaj një trup të bëshëm gruaje me duart e kryqëzuara në gjoks, me veshjet e krahinës, që i rrinin shumë ngushtë dhe dukeshin sikur po shqepeshin po t’ia prekje...”. Tronditëse në novelë janë sprovat e Marijës për të “gjetur” format e nënës së saj te kufoma e ënjtur nga sëmundja. Pasurinë ligjërimore

dhe etnografinë e të folurit të veçantë të P. Zogajt e dallojmë më së miri edhe kur “Vajtimorja më e mirë e Bardhajt e kishte qarë për herë të fundit të ndjerën. Fjalët e saj e kishin shëtitur edhe njëherë Marën e Gjok Lekajt, të bukur si kurrkush, shpirtmirë si Zoja e Bekueme, nëpër kopshtijet dhe korijet e jetës me të cilën ishte ndarë...”.

Mund të perifrazonin edhe dhjetëra episode tjera për të konkluduar se Preç Zogaj vjen në këtë novelë me talentin dhe artin e të shkruarit të një lloje proze të veçantë, me mënyrat dhe mjetet shprehëse si në rrafshin stilistikor ashtu edhe në atë gjuhësor, duke përvijuar pamjen moderne të prozës së sotme shqipe.. Për vetë autorin Zogaj. “Bija e vjetër e nënës së re” është ndër veprat që ka më përzemër. Shkrimtari Rudolf Marku e cilëson si ndër më të mirat e letërsisë shqipe. Si mik i vjetër i autorit ai zbulon se i pat sugjeruar që ta botonte më vete këtë novelë, që sipas tij mund të klasifikohej fare mirë si roman. “E kam konsideruar si veprën më të mirë në prozë të Preç Zogajt dhe ndër romanet më të mirë të letërsisë sonë”, vijoi Marku. Është vepra që autori e vlerëson si më të mirën, ngase temë qendrore- ashtu si edhe në poezitë e tij – është figura e nënës.

Zogaj thotë se nuk ka tendenciozitet në këtë vepër të tij, pasi ky i fundit e vret letërsinë. Nuk ka as mendjemadhësinë t'i rrëfejë një brezi lexuesish atë që ndoshta nuk e kanë jetuar e as e dine. Gjithkush që lexon prozën e tij (këtu kam parasysh edhe romanin “Anjeza nuk u zgjua”), do të ndjente kënaqësi të veçantë. Edhe kjo novelë për absurdin e regjimit komunist, lë mbresa te lexuesit falë mjeteve artistike në shmangie të atij lloj tendencioziteti që e vret letërsinë.

<https://www.fjalaelire.com/post/nje-veshtrim-ndryshe+per+novelen+e+Preç+Zogajt+“Bija+e+vjetër+e+nënës+së+re”>

NJË PALË OPINGA PËR HRUSHOVIN?!


Për romanin fitues të Çmimit të madh të Panairit të Librit 2019, me të cilin Besnik Mustafaj u shpall “Autori më i mirë i vitit”

Ditën e fundit të Panairit të Librit 2019, të dielën e 17 Nëntorit, m'u desh të shkoja tri herë në Pallatin e Kongreseve. Dy herët e paradites, mungonte, pasi ishte shitur tri ditët e para, ndërsa në mesditë erdhi i ribotuar romani fitues i këtij panairi “Dëmtuar gjatë rrugës”. U ndjeva me fat që e mora me autografin e autorit Besnik Mustafaj. Por më me fat u ndjeva pasi e lexova këtë roman, vërtetë me fund të lumtur.

Personazhi, me fund të lumtur është Nëna e autorit. Një fund i lumtur pas një makthi që e kishte pushtuar atë prej tri dekadash se mos një ditë do t'i hapeshin petët e lakrorit....

Ajo kishte shkelur për herë të parë kur ishte 24-vjeçe në një zyrë të vërtetë të pushtetit “atje ku ndihet si frikë deri në kockë hija e rëndë e shtetit”. Siç pohon autori që në krye të herës “është një histori, të cilën ajo e ka mbajtur brenda kokës së vet si një tumor (fjalët e saj) për tridhjetë vjet”.

Dhe ky “tumor” s'ishte gjë tjetër veçse brenga që i çelën një palë opinga, që ajo u detyrua atë pranverë të largët të vitit 1959 nga më i madhi i partisë së krahinës, t'i qëndiste si dhuratë për Nikita Hrushovin, në vizitën e tij të parë në Shqipëri. Që nga marrja e porosisë prej ish-Sekretarit të parë të PPSH të rrethit për të krijuar një palë opinga artistike, që do të përbënin “sekret shtetëror”, personazhi kryesor i romanit “do të mendonte me bindje të rrënjosur një herë e përgjithmonë se sidomos zyrat e politikanëve të lartë janë të mbushura me mistere djallëzore, ku njeriu i pamësuar zbulon



pafuqinë e vet, duke pësuar në shpirt gjymtime të papërfytyrueshme”.

Në thelb, subjekti ka dy pamje: Pamjen gazmore kur pasi iu pëlqyen “opingat” artistike që kasta e atëherëshme ia dhuroi Hrushovit, të cilësuar si “babai i popujve”, nëna u bë “Shoqja S” dhe përzgjidhej si politikane e re “yll në ngjitje” në tribunat e mitingjeve ku brohoritej “Rroftë Hrushovi”, dhe pamjen e zyrtë gjatë gjithë viteve të mëpastajme, kur ajo dyshonte se mos shpallej armike, pikërisht pse kishte krijuar “opingat artistike” për Hrushovin që ishte shpallur armik i revolucionit bolshevik nga mbrojtësi i flaktë dhe i vetëm i tij, Enver Hoxha.

PËRSHKRIM BRILANT I LËMSHIT TORTURUES TË LOTËVE TË NJË NËNE

Autori, si rrallëkush tjetër ka ndërtuar profilin e nënës së tij, nëpërmjet dialogjesh me të vjerrrin dhe monologjeve me vetveten, gjatë procesit të thurjes së opingave “sekret shtetëror” dhe në vijim për frikën se mos pas “tradhtisë” së Hrushovit edhe ajo mund të shpallej armike dhe ta pësonin i biri, vëllezërit dhe gjithë farefisi i saj.

Të krijosh një roman kaq të arrirë artistikisht vetëm mbi këtë subjekt është vërtetë një meritë e veçantë e këtij autori, që si askush tjetër përshkruan lëmshin torturues të lotëve që ia kishin zënë lëfytin e hollë të grykës, kësaj nëne fisnike që s’mendote për asgjë tjetër (nëse do ta arrestonin) veçse për të ardhmen e djalit foshnjarak (në djep). Dhe kur u bind se nuk kishte më asnjë rrugë shpëtimi “një zë, që ishte zëri i saj, edhe pse nuk dilte nga goja e saj, zuri të këndonte vajtueshëm: *“Nji amanet po jua la:/Kur në mur-o t’më murosni,/Syn’ e djathtë t’ma leni jashtë,/Kambn’ e djathtë t’ma leni jashtë,/Gjin’ e djathtë t’ma leni jashtë:/Se kam lanë djalin e vogël/E kur t’nisi djali gjamën,/Me njan’ sy ta shikoj,/Me njan’ dorë ta limoj,/Me njan’ kambë ta lurtoj,/Me njan’ gji ta nergoj.”* Amaneti i një nane që “opinga artistike” mendonte se duheshin thurur veç për burrin e saj dhe për asnjë burrë tjetër në botë.

“Mrekullia, që duhej të nxirrte Nëna ime nga duart e veta ‘vetëm me një grep e pe të bardhë’ishin një palë opinga burrash”. Por për të “Fqinjëria e fjalëve SEKRET dhe SHTETËROR krijonte një bashkim tingullor tepër të frikshëm”. Madje sipas saj “vetëm zyrat mund të bënëin sajime të tilla gjuhësore, që t’i përshkonin veshët dhe trurin si turjela”. Përisht mbi

rrëfime të tilla brilante autori ndërton intrigën për “pyetjet e përsëritura edhe pse të mbetura pa përgjigje si dhe dyshimet e njëpasnjëshme dhe gjithnjë të pasqaruara” që ngadalësojnë tej mase rrjedhën e kohës. Dhe gjithshka “për shkak të atij të mallkuarit, sekretit shtetëror!”. Ishte ajo kohë e mistershme dhe e kobshme kur mund ta haje po të nxirrje sekretin e thurjes së një palë opinga artistike, pasi përbënte “rrezik të madh të gënjehet Partia”.

Pikërisht në këtë kontekst e paraqet auroi edhe marrëdhënien e nënës së tij me Dritën, kushëriren e burrit të saj që vetevetiu “do ta fusnin shoqja shoqen në skurat më të fshehta të shpirtit”. Drita, “e fejuara e damkosur e një armiku të klasës” dhe Selmani, më i arsimuari i zonës që s’pajtohej me qëndrimet staliniste të PPSH janë dy personazhet, marrëdhënia me të cilët, jo vetëm që nuk e zbehin, por përkundrazi e fisnikërojnë profilin e Nënës së B.Mustafajt.

SKANERI I NJË PARTIE QË NDËRHYNTE EDHE NË TRILLET E FSHEHTA DASHURORE

Me mjeshtri të rrallë artistike, me një guhë të pasur e mjete shprehëse interesante autori ekzaminon atë Parti që “kishte për detyrë të ndërhynte edhe në trillet e fshehta dashurore të anëtarëve të saj”, qoftë dhe duke përshkruar atë hallakatje të pavullnetshme ndër përhitje të nënës së tij që ruajti në shpirt një gjurmë të re malli për të shoqin komunist që Partia e kishte dërguar për studime në Tiranë. Ndaj dhe modeli i opingave artistike që i pari i Partisë së krahinës ia kishte porositur si “sekret shtetëror” do të ishte modeli që i përkiste vetëm një burri, që në këtë roman paraqitet si babai i autorit. Ato do të ishin opinga “më të bukurat e të bukurave”. Ndonëse sipas porositësit, masa e këmbës që do t’i vishte nuk kishte asnjë rëndësi, Nëna ishte zhytur në një makth nga i cili s’po dilte dot. E mundonte pyetja e tmerrshme për këmbën e burrit të mistershëm, këmba e të cilit futet në çdo këpucë... “I tillë është vetëm djalli e i biri i djallit. Unë s’kam punë me të. Zot i madh m’i ruaj mendtë në kokë!”. Ndaj dhe s’u besoi veshëve kur mësoi se opingat që kishte thurur ishin për Hrushovin që kishte zënë vendin e Stalinit në Moskë...Ndaj dhe i shpërtheu një e qeshur e vrullshme, e papërmbajshme kur mësoi nga i Vjehri se Hrushovi do

të vishej me opinga si barinj të Tropojës! Në fillim ajo “nuk pati ndonjë lëndim në sedër si krijuesja e shpërfillur e dhuratës simbolike për “babanë e popujve”, kur nuk e përfshinë në delegacionin që do të shkonte nga Tropoja në Tiranë për ta takuar atë. Por më pas kuptoju se “brenda saj rridhte pavarësisht një përrua zemërimi, pse krerët e Partisë në rreth nuk e kishin marrë me vete në Tiranë”. Por gjithsesi, ato ditë kur pjesëmarrja në mitingje ishte e detyrueshme, prodhuesja e opingave artistike për Hrushovin do të shihte vehten dhe do të detyrohej të fliste në tribunën e mitingut të organizuar në qendrën e qytetit Bajram Curri. Dhe për sa kohë, tanët e patën mirë me “babanë e popujve” Nëna, ndonëse e njëjta fare pak politikën do të ishte më e preferuara e drejtuesve të saj në rreth. Por rrjedha ndryshoi në të kundërtën, kur pas “tradhtisë” së Hrushovit, shoqja Rushe, si ziliqare që ishte do ta kërcënonte se tani do t’i hapeshin petët lakorit, ç’ka nënkuptonte se Nëna (ose shoqja S e romanit) do të ndëshkohej si hrushoviste (ajo do të burgosej ndërsa do ta pësonte i shoqi komunist dhe tre djemtë e saj). Por autori, edhe në këtë rast ka meritën e përshkrimit të një Nëne që “krenohej me bukurinë e saj të jashtme, gjë që ishte e papajtueshme me vijën e partisë, sipas së cilës nuk ishte dukja, por thelbi, domethënë bota e brendëshme, shpirti revolucionar që përbënte pasurinë dhe bukurinë e njeriut të ri”.

KOHERENCA ME REALITETIN OBJEKTIV

Nëse ngjarjet i përkasin kohës mënyrë kur partia porosiste që lufta e klasave të zhvillohej edhe brenda familjes, autori i sjell ato në koherencë me realitetin objektiv, qoftë edhe kur pohon “Udhëheqësit kishin një gjuhë të caktuar për të folur me njëri-tjetrin e një tjetër gjuhë për të folur me popullin”. (A nuk ndodh edhe sot kësajsoj me klasën tonë politike të dalë boje?!). Apo edhe kur pohon se ka gërmuar gjatë nëpër arkivat e Agjencisë Telegrafike Shqiptare për të gjetur fotografinë e nënës së tij në tribunën e mitingut të organizuar në Tropojë gjatë vizitës së Hrushovit në vendin tonë. Nga ai miting Nëna ishte dekoruar me “Urdhrin e Yllit me Pesë Cepa” nga Kryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor, dekoratë kjo që do ta stresonte e mbante nën ankth gjatë gjithë viteve të mëvonshme pas “tradhtisë” së Hrushovit, kur mendonte se do t’i hapeshin një ditë petët lakrorit! “Në të vërtetë – shkruan autori – ky arsytim në kokën e

Nënës sime do të sqarohet më vonë, ngadalë, gjatë përplasjeve të vështira që do të kishte ajo me veten për të ndarë sa më mirë nëse ishte viktimë, apo fajtorë në këtë histori”. Është një histori e rrallë mbi të cilën autori ndërthur mjeshtërisht ngjarje e personazhe që na bëjmë të kuptojmë më së miri sistemin e kalbur të diktaturës komuniste. Ndonëse e përshkruan si hamendje të Nënës së tij, në të vërtetë është koha kur pas ngjarjesh e arrestimesh të bujshme për tradhti imagjinare e kalime të paligjshme kufiri, qyteti Bajram Curri jetonte dita-ditës me një bombë me sahat në gji.

Shturjen dhe dekadencën e atij sistemi autori na e paraqet mjaftë bukur qoftë dhe me profilizimin e personazhit të Vasilikës, që ndonëse e kishte sjellë Partia të përhapte të renë e civilizimin në qytetin verior në zemër të maleve, qytetarët thonin: “Na qelbi vendin ajo bishtpërdredhura e dreqit!”. Dhe kur për këtë “bishtpërdredhurën” shkon fjala deri tek shoku Enver (nëpërmjet një letre anonime) se ajo “shkonte në shtrat jo vetëm me djemtë më të pashëm të qytetit, qofshin ata beqarë apo të martuar, por edhe me kuadrot e Partisë e të pushtetit, pa parë moshën e tyre, si dhe me oficerët e Sigurimit në rreth”, Udhëheqësi do t’i kërcënonte ato se “puna e madhe dhe delikate e Partisë duhet përqëndruar kësaj here tërësisht tek burrat, për kalitjen e forcës së karakterit të tyre”. Autori që pohon se letrën anonime, bashkë me shënimin e Enver Hoxhës që e ka gjetur në Arkivën Qëndrore të Shtetit gjatë përgatitjeve për shkrimin e këtij romani, argumenton më së miri për këtë “qëndrim krejt të përligjur të Enver Hoxhës që e kishte kuptuar më në fund se nuk kishte mënyrë tjetër veç anonimatit, për t’ua varë njerëzve të thjeshtë lepurin e frikës, i cili me ata dhëmbët e tij prerës, po ia hante shpirtin popullit, siç hante lakrat natën në vjeshtë, në kopshtet e fshatarëve. Babai i atij lepurit të tmerrëshëm ishte hija e Stalinit”. Këtë tezë e mbron edhe me pohimin e Nënës së tij që i kishte pohuar se “hapi që bëri për t’u përfshirë në politikë, në të vërtetë e kishte hedhur në një greminë ku do të gjente një vetmi të ngulur si tumor i fshehtë, i ngulitur në trurin e saj”.

ENIGMA PËR “KËPUCËN” ME TË CILËN HRUSHOVI GODITI TRIBUNËN E OKB-SË

Dhe si për ta përligjur këtë ngulitje, autori përshkruan më pas me realizëm ngulmimin e Nënës që ai të gërmonte në Arkivin e OKB-së për



këpucën më të cilën Hroshovi paskësh goditur tribunën e intistitucionit më të rëndësishëm botëror me pretekstin se nuk i kishin dhënë fjalën për një replikë rastësore. Autori nuk arrinte ta merrte dot me mend se çfarë lidhje shihte Nëna e tij midis opingave, që kishte bërë dikur për Hrushovin, dhe këpucës, me të cilën kishte goditur ai tribunën e sallës plenare të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, siç ishte bërë e njohur botërisht dyzetepesë vjet më parë (12 tetor 1960)...,kur flitej për sherret e Hrushovit me kryetarin e asaj Asambleje, Frederick Boland-in, si dhe me kryetarin e delegacionit të Filipineve, një farë Lorenzo Sumulong, i cili kishte thënë se popujt e Europës Lindore, të përpirë nga Bashkimi Sovjetik, nuk gëzonin të drejta civile e as politike.

Pikërisht kjo mungesë lirish të drejtash civile e politike si të drejtat bazë të lirisë njerëzore përshkojnë si fill gjithë romanin “Dëmtuar gjatë rrugës” të Besnik Mustafajt. Ai e ka treguar mjaftë bukur në roman se çfarë e bëri Nënë të ketë aq frikë nga zyrat e pushtetit. “Nëna” në romanin tim nuk është një personazh që e bën politikën. Ajo vetëm e pëson politikën. Rrjedhimisht, përjetimet e saj janë ato të një personazhi të pafuqishëm përballë politikës. Vetëdija e pafuqisë është dërrmuese për njeriun. Në këtë roman unë kam synuar ta tregoj ekzistencën e shqiptarit të thjeshtë nën diktaturë jo duke e kërkuar dramën në vatrën e dukshme të dhunës e që ishin burgjet apo internimet, por në atë pjesë të skenës që paraqitej si sukcesi i regjimit e ku jetonte shumica absolute e popullsisë”,-shprehet Mustafaj.

Pikërisht pse ai arrin ta qartësojë Nënë për këtë realitet të trishtë, apo edhe për pakon e ardhur pas shumë vitesh nga Munihu me shënimin e postës së Tiranës “Dëmtuar rrugës”, ky, mund të konsiderohet vërtetë një roman me fund të lumtur. Pas arritjes me këtë roman të llojit dhe stilit të veçantë, Besnik Mustafaj është në të drejtën e tij ta lëjë mënjane politikën dhe t’i përkushtohet totalisht me gjithë potencialin e talentit të tij prozës. Pasi është vërtetë befasues prezantimi i tij i fundit me këtë roman fitues të Çmimit të madh të Panairit të Librit 2019 dhe me të cilin ai u shpall “Autori më i mirë i vitit”.

“MAGJIA” E “SHITJES SË NDERIT” NË ROMANIN E NAMIK DOKLES

Një roman ku përcillen artistikisht mesazhi i domosdoshmërisë së rishkruarjes me realizëm të historisë dhe i luftës pa kompromis ndaj krimit e korrupsionit



Trilli artistik i Namik Dokles në romanin e tij të fundit “Dhjetë gramë nder” – botim i Shtëpisë Botuese prestigjioze “TOENA”, i kalon kufijtë e imaginatës. Një trill artistik befasues që në titull, për të vijuar në episodin e parë të romanit, ku në të famshmin “*takim me historinë*”, një ministër e manipulon atë, në ditën e inaugurimit të Muzeut të Luftës, duke përvetësuar rolin e komandantit të batalionit, e për të vijuar kësajsoj thajse në të 25 episodet e 222 faqeve të romanit. Ideja e “*tregtisë së nderit*” iu ngulit kështu personazhit kryesor,

Nderimit, që ditën kur babai i tij, ish komandanti i vërtetë i batalionit gjatë LANÇ, pasi ia çorri maskën ministrit dyfytërësh, i kërkoi të birin të shkonte të blinte “Dhjetë gramë nder” në ndonjë dyqan të qytetit (!).....

Që këtu, autori përcjell me mjeshtri të rrallë artistike mesazhin e domosdoshmërisë së rishkruarjes së historisë me realizëm. Dhe ndërsa babai e pagoi me ndëshkime tejet të rënda mbrojtjen me stoicizëm të së

vërtetës për kontributin e tij në LANÇ, vite më vonë pas ndryshimit të sistemit, i biri Nderimi, mori kredi për të zgjeruar tregun e nderit (fq.25). Klubi që ai kishte rregulluar me atë kredinë e majme, kishte qenë dikur *klubi i gazetarëve të qytetit, edhe ata shitës të dikurshëm të ndërgjegjes*. Kështu, në shitoren me tabelën “*Këtu shitet nder*”, vijuan të vijnë, jo vetëm prostituta të çnderuara nga “*burra me çorape shtatë javë të palara, me kutërbim shurre dhe sperme..*” (fq.28), por edhe të dërguar nga politikanë të rangut të lartë, nga deputetë e ministra, prokurorë e gjykatës të korrumpuar e të inkriminuar.

Vinte të blinte 1 gramë, dhjetë apo një kilogram nder, edhe ndonjë që mendonte se me të mund të pastrohej e të bëhej i ndershëm, ndonëse “*..kishte vjedhur pensionin e nënës, një tjetër që kishte nxjerrë gruan e tij në semafor, një i tretë që kishte bërë grabitje shumash të mëdha, por pa prekur asnjë qindarkë me dorë, pa çarë mure e pa thyer kasaforta, por vetëm duke hakëruar disa llogari bankare, një i katërt që kishte hall të merrte vesh se si i bëhet me atë që, duke qenë shofer i një ministri, kishte marrë përsipër aksidentin e kryer nga shefi i tij, dikush që pyeste nëse ishte humbje nderi ta tradhtosh gruan me dashnoren apo edhe me vajzën e bosit të kompanisë, sekretare e të cilit është gruaja jote..*”(fq.194).. Një sarkazëm therëse kjo, e autorit Dokle, që buron nga njohja gjër në perfeksion prej tij e realitetit të trishtë që përjeton shoqëria shqiptare e këtij tranzicioni të tejzgjatur. Por edhe denoncimi nëpërmjet fjalës artistike i fenomeneve e dukurive gërryese e shfarosëse të krijuara e manifestuara nga kriminelë të veshur me pushtet. Dhe kur dikush vinte e i kërkonte “*nder për të vdekurit*”, i sigurt se do të rrokullisej me vërtik në greminën e falimentit, Nderimit i vjen ndërmend thënja proverbiale e babait “*Ironia është më e fortë se pushka, të vret e s’ të jep dekorata*”. Kjo do t’i kujtohej më së miri kur ndonëse pluhuri në “*qeskat e nderit*” ishte një kombinim interesant, *fruta tropikale me hudhra shqiptare* (simbol i integritetit tonë eurobotëror), provoi për 72 orë qelitë e burgut, pas denoncimit që kishte bërë vjehrrin e tij (Tosun Brinja, një ish polic famëkeq i diktaturës që kishte përdhunuar deri edhe vajzën e tij) dhe dëshmisë së një djali që deklaronte se kishte blerë në klubin e tij qeska me drogë...(dhe që për të shpëtuar nga ndëshkimi i pamerituar ju desh të paguante qimet e kokës). (fq.191).

DENONCIMI PËRMES FJALËS ARTISTIKE I PABARAZISË ULËRITËSE

Kureshtja e lexuesit sa vjen e shtohet kur Dokle, si askush tjetër përshkruan mjeshtërisht e me gjuhë mjaftë të pasur, madje gjer në detaje, njohjen me *“vrasës me pagesë dhe pa pagesë, vrasës të grave dhe ndonjë vrasëse të burrit; përdhunues kafshërorë, zyrtarë të korrumpuar, hajdutë pronash dhe bankash, drogaxhinj të droguar dhe të tjerë esëll, shpërdorues fondesh dhe tenderash, fshihës të armëve pa lejë, bankierë hajdutë dhe avokatë mashtrues...”*. Dhe pasi sjell në referencë filozofinë se *“burgu është për burrat”* nuk nguron të denoncojë gënjeshtren e madhe se *“në burg janë të gjithë të barabartë”*. Po aq e madhe sa gënjeshttra e Bill Gejtsit që pat thënë se, përballë sëmundjeve, të gjithë njerëzit janë të barabartë. *“Pabarazia ulërinte, njëlloj si jashtë, por në ngushtësinë e birucave e të koridoreve dëgjohej më shumë, më fort dhe jehona e saj nuk pushonte asnjë grimë, natën dhe ditën, në çdo imtë frymëmarrje, në çdo vështrim gardiani, në çdo skërmitje të oficerit të policisë gjyësore, në çdo llogari avokatësh, prokurorësh dhe gjyqtarësh, nuk pushonte dhe të gërryente përbrenda e të tertë përjashta. Të dukej vetja si skelet i tharë në diell...”* (fq. 193).

Do të mjaftonte qoftë dhe vetëm ky perifrazim për të kuptuar se sa thellë e me detaje e njeh e përshkruan Dokle realitetin e trishtë të burgjeve e të drejtësisë së sotme shqiptare. Pjesë e këtij realiteti është edhe sistemi inormativ sipas të cilit *“posta e burgjeve është më e shpejta në botë”*.

IRONIA THERËSE NË GJUHËN E PERSONAZHEVE

Në romanin *“Dhjetë gramë nder”* të Namik Dokles lexuesi befasohet edhe nga ironia therëse që ai vë në gojën e personazheve. Më e dukshme kjo në perifrazime të tilla si : *“..pas martesës, pas dashurisë së parë pa çarçafë të skuqur, të gjithë djajtë dhe djallëzitë u zgjuan, më pëshpëritnin, më pickonin, më kruanin pas veshit dhe, dhjetra herë , isha bërë gati ta bëja pyetjen fatale: kush ta mori virgjërinë? Por tmerrin më të madh e ndjeva atë ditë, kur ai, Tosuni i poshtër, babai i ndyrë, qelbaniku i shtatë gjirizeve, në përpjekjet për të më detyruar t’i jepja gjysmën e biznesit më tha: Kush ia mori virgjërinë gruas sate. A e gjetë të virgjër nusen tënde?!”* (fq.184).

Apo dhe rrëfimi për *shurrarin e monumenteve*, si histori dykohëshe e

diktaturës dhe e demokracisë, e atij që pasi kishte lënë rrogën e 15-ditëshit në birrarinë me qofte e qepë filloi të shante: “*Të pshurrsha mu në rrogë...të pshurrsha...të pshurrsha...*”, dhe dy policë, sikur të kishin mbirë nga dheu, e mbërthyen për krahu...e torturuan aq shumë për të treguar se kush e kishte urdhnuar me e pshurr udhëheqësin e botës (bustin e Stalinit)...dhe kur filluan ta paguejnë si ish-të përndjekur politik: “...*e çoi dreqi në Tiranë dhe atje e kapën duke pshurr monumentin ish-mbretit...*”.

Ishte ky një rrëfim sa prekës aq edhe interesant i atyre blerësve të “*një gramëshit të nderit*”. Më të vërtetë, nga vetë titulli i romanit “*Dhjetë gram nder*”, gjithkush do të mahnitej me gjuhën e pasur të Dokles në dhjetra e qindra raste të përdhosjes së nderit, nga deputetë e ministra, nga prokurorë e gjykatës, nga....dhe në përshkrimin brilant të skenave e veprimeve të Nderimit, personazhit kryesor të romanit, që *u ka dhënë nder nderprishurve dhe nderprishësve*...Kësisoj, ndërsa e profilizon si tregtarin që kishte zgjedhur mallin e duhur për këtë kohë, kur gjithshka, gjithë ekzistenca njerëzore kishte dalë në shitje, Dokle përçon po aq bukur edhe mesazhin se do të ishte më mirë, që në vend të nderit, të shiste pluhurin e harresës.

Përdorimin mjeshteror të sarkazmës nga Dokle e ndeshim edhe në episodin e thyerjes së xhamave të klubit të Nderimit, nga turma të nxitura prej kryehoxhës dhe kryeprietit të qytetit. “*..ajo revoltë nuk kishte të bënte me partitë, ajo rrëmore zemërimi nuk vinte nga përrenjtë e politikës. ‘O i pafe dhe trushkukur!’ apo ‘Të digjen heretikët’, nuk ishin parulla mitingjesh për çfarëdolloj zgjedhësh*”, por inskenime të klerikëve me pretekstin se *shitësi i nderit po çnderon qytetin!*

Sa kënaqësi të lexosh Namik Doklen, qoftë edhe në përfytyrimin prej tij të Kapiten Tosun Brinjës, që kur ishte i plotfuqishëm për mbledhjen e detyrimeve ndaj shtetit...vriste e priste, kërcënonte dhe bërtiste: “*Akoma nuk keni parë gjë. Akoma! Unë s’jam vetëm Tosuni i detyrimeve, por jam kapiteni i tatimeve, i hetimeve, i internimeve, e morët vesh?*”. Një fantazi e shfrenuar kjo e autorit Dokle, duke hequr paralele midis të pandreqshmëve të dy kohëve.

DISA HISTORI TË TRISHTA TEK “DHJETË GRAM NDER”

Sa shumë bëma e gjëma, sa histori të pathëna e të padëgjura! Përveçse trishtimit njerëzor nga përdhosja e nderit, në romanin e ri të Namik Dokles ka plot ngjarje, në të cilat gëlojnë histori të trishta. Përcillen ato mjeshhtërisht në gojën e Xha Veros, por dhe tek historitë e ustait Bajro Jella që muroste shishet me tituj gazetash e letra referuese brenda të cilave përshkruante me pak fjalë histori rastësore me mesazhe të qarta për kohën. Qasje vërtetë interesante e autorit, letra në të cilën shkruhej: *“Kjo godinë deri sot ka qenë xhami, që nuk i gjendej shoqja në nëntë fshatrat e krahinës. Tani ky shtet e ka kthyer në magazinë drithi,. Shteti është komunist, udhëheqës është Enver Hoxha; ky shtet ka shkatërruar xhamitë dhe kishat dhe na ka rrjepur shtatë lëkurë..”*. Befasi për lexuesin është përshkrimi i rrjepjes nëpërmjet shtatë lëkurëve nga pushteti i kohës së diktaturës, që nisin me triskat e ushqimit dhe detyrimet për shtetin; me punën angari duke i detyruar fshatarët të punonin argatë në pronat e tyre; me vendosjen e regjimit të kufirit; me futjen në kooperativë kur u mori tokë e bagëti, nder e dinjitet; kur i detyroi gratë të ndërrojnë rrobat tradicionale me tuta dhe funde që të bëheshin të gjitha njëlloj, si ushtarët kinezë... Dhe kështu e pësoi Bajro Jella, të cilin gruaja e ngushëllonte me fjalët se *“nuk do të jetojë sa orlët as Enver Hoxha”, ndërsa ai u përpoq t’i japë zë murit dhe gjak gurit!*

E vënë në gojën e Bajro Jellës, është vërtetë histori e trishtë ajo kur ndërsa priste të dëgjonte të qarën e parë të një fëmije që takohet me këtë botë, nga dhoma tjetër, nga dhoma e nuses erdhi një ulërimë e një ejkamë që e drodhi në ‘flokë e n’thua...ulërima e nuses që burrave që e bartën 5 orë në krah për në maternitetin e qytetit, në *grahmat e fundit u tha “amanet vajzën”!*. Dhe më trishtuesja në këtë histori, urdhëresa e kryetarit që *“për atë vdekje duhet të bëheshin të pazëshëm, si vetë vdekja”.., që të mos trazohej ai imazhi i shtetit.* (fq.79).

Pjesë e ligjërimin artistik të autorit të këtij romani është edhe ajo e çobanit të dhenve në Bjeshkët e Sharrit, që ndërsa po ndante bukën me udhëtarin e rrugës, kur ky i fundit nxorri thikën e ju turr t’ia rrëmbente orën që e kishte kujtim nga i ati kurbetçi, çobani më i shpejtë, mori një gur e i ra në kokë duke e lënë të vdekur.

Në strukturën kompozicionale krejt të veçantë të këtij romani bën pjesë edhe historia e strehimit të doktor Zhakos me të bijën (nga hebrejtë

e Prizrenit) në mullirin e fshatit, kur Bajro, besnik i shprehjes proverbiale “*shtëpia është e mikut dhe e Zotit*”, tek sa ndodhej pranë vajzës bukuroshe me emrin biblik Hannah, ndjente se si “*magma e shpirtit të tij ngrohej dhe ftohej, shpërthente dhe përzihej me pluhurin dhe merimangat e qosheve të mullirit e aty kapej si mizat*”. Këtu lexuesi befasohet nga bukuria e rrëfimit, natyrshmëria, ritmi, muzikaliteti dhe ngjyrimet e fjalës, trilli dhe lakonizmi, si veçori të pranishme në përshkrimin si askush tjetër të bukurisë femërore nga autori: “*kur (Bajro) pa të hynin në mulli burrin e motrës bashkë me një tjetër të veshur me rroba qyteti dhe një vajzë të re, një lule bore në mes të dimrit...me gjoksin e kërcyer si dy ftonj të sapozverdhur*”. Kështu, aq bukur dhe natyrshëm përcillen në këtë roman *bregat njerëzore, bukuria e rrëfimit dhe larmia e subjekteve*.

Autori N.Dokle ka qasje tejet origjinale edhe në përzgjedhjen e emrave të personazheve si: Bajro, Hanza, Selba, Vaje, Jasmir, Hashmet, Tosun etj; në përdorimin e shprehjeve të shumta popullore dhe përafrimin me to të vargjeve të këngëve, si dhe në përshkrimin e grafitëve.

Në tërësinë e këtij romani ndeshim koleksion rrëfimesh sa shqiptare po aq universale, ngjizur me fantazi të pashtershme kreative dhe të harmonizuara në një libër të strukturuar gjithë origjinalitet ku spikat niveli i lartë artistik i një mjeshtri të rrallë të prozës së sotme bashkohore.

PERIFRAZIME SI SHPREHJE FILOZOFIKE

Nëse gjatë leximit të romanit “*Dhjetë gramë nder*” ndeshim fjalë e fjali të rralla që na nguliten në memorie, si:

“*Humbi si kova në pus*”; “*Kali nuk lidhet te guri i varrit*”; “*Dashni me helm të ambël*”; “*Më dogji si eshkë pa tym*”; “*Prushi nën hi e mban zjarrin pa fikë*”; “*Kur bluan pa drithë, prish gurin e mullirit*”; “*Kur sulet miza prishet gjiza*”; “*Hesht dhe duro, lekat arrno*”; “*E di kangën, por zani nuk po mëdel*”; “*Ishte strall e çallashnik që nuk zbutej*”; “*Pasha, a ke punë me mue, apo me kaçupin tim?!*”; “*Paskam kafshuar më shumë nga sa mund të përtypë*” e “*Gjithshka këputet për së holli, zollumi për së trashi*”; gjejmë gjithashtu në këtë roman rrëfimitarin filozof me thënie të atilla proverbiale, që mund të shërbejnë si postulate. Ja disa prej tyre:

“*Plaku është si zogu pa krahë, është si rrobja e hollë që nuk mban të*

qepur”;


- “Atë që shkel për së gjalli, mos e përcill te varri”;
- “Sëmundja më e keqe në botë është shëndeti pa para”;
- “Çfarëdo që të ngel në fyt, shtyhet me ujë, por kur të ngec uji si t’ia bësh?”
- “Njeriu sa më pranë njerëzores – Në fund të fundit ose je, ose nuk je njeri”;
- “Është mençuri e madhe të rrjepësh budallenj”;
- “Ironia është më e fortë se pushka, të vret e s’të jep dekorata”;
- “Shtëpia nuk është vetëm banesë, por edhe duk e krenari”;
- “Nuk ka rëndësi çfarë bëra, por çdo të ndodhë me atë që bëra”;
- “Hekurin e ha ndryshku, miqësistë politike myku”.

Dhe

- “Sa më shumë hollësira të rrasësh në një gënjeshtër, aq më shpejt thartohet ajo- Është si tallashi në suxhuk”.

Lexon Namik Doklen e të vjen të thuash: “Faleminderit, Mjeshtër, letërsia juaj është e mrekullueshme.” Kështu ndodh edhe kur lexon romanet e tij: “Kolerë në kohë të dashurisë”, “Vallëzim me hënën, “Covid-1984”, “Vajzat e Mjegullës” – botuar edhe në Spanjë e në Londër; “Mjegulla e dimrit të largët”; “Ditët e lakuriqëve të natës”; “Lulet e skajbotës”; dramat “Shën Mëria e Beratit” dhe “Dënimi i dytë i Homerit”, dhe së fundmi romanin “Dhjetë gram nder”, –një gërshetim i jetës së përditshme me elementë **të** distopisë, një radioskopi e shoqërisë në kohët moderne.

KRIZA E LEXIMIT NË ROMANIN “DIMRI I LIBRAVE” TË BASHKIM HOXHËS



Prozatori dhe dramaturgu i mirënjohur Bashkim Hoxha, autor i romaneve më të kërkuar nga lexuesi: “Kronikat e mjegullës”, “Një ditë si Skënderbeu”, “Duartrokitësit”, “Një shaka e vogël me vdekjen” dhe “Asnjëherë të martën”, në panairin e librit 2023 vjen me një titull të ri, sa sinjifikativ aq edhe me një trill të veçantë artistik: “Dimri i librave”, roman ky që do të promovohet po në mjediset e këtij panairi të premtën me 17 nëntor, ora 11 tek stenda “ONUFRI”..

Ky roman që vë në qendër shkrimtarin dhe krizën e leximit e kaloi testin e të qënurit ndër më të mirët e këtij viti gjatë prezantimit para dy muajsh në hapësirat e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, ku autorë, studiues, botues dhe më gjerë që ishin të pranishëm e vlerësuan si një vepër që përshfaq realitete bashkëkohore, nën perceptimin e njerëzve që jetojnë me librin, si një metaforë mbi rëndësinë që ka arti kultura në ridimensionimin shpirtëror e social të kohës që jetojmë. Këtë ridimensionim atutori B.Hoxha e përshfaq që në pjesën e parë “Koha”, ku ndër të tjera shkruan se: “Ka qenë njëherë e një kohë kur letërsia krijonte kombe, si dikur në Rilindje. Tani

ndjenja është zhdukur në drejtim të paditur, fjala është struktur diku në një cep e trembur dhe kapakët e librave janë bërë si sëndukët e gjysheve, që nuk i hap njeri prej kohësh...”(fq.21).

Risi e këtij romani është struktura kompozicionale krejt e veçantë, ku në katër pjesët e titulluara : “Koha”, “Atdheu”, “Jeta” “Pranverë, verë, vjeshtë” dhe në epilogun “Dimri” autori të befason me lëndën e larmishme, bukurinë e narrativës, karakteret e shumta, përshkrimet e portretizimet brilante, gjuhën e pasur e gjithë forcë shprehëse. Në epiqendër është Adnani, një ish poet ushtarak që pas ’90-tës u përshtat me ekonominë e tregut duke krijuar lokalim me emrin “Muza”, ku në një tavolinë të veçantë të saj mblidhen për çdo javë shokët e tij shkrimtarë e poetë: Sokrati, Fatmiri, Simoni, Bela, Sokrati, Mirela..., që diskutojnë për tema të ndryshme e madje recitojnë edhe pjesë nga krijimtaria e tyre dhe shpallin edhe konkursin e më të mirëve. Kësisoj mjeshtri Bashkim Hoxha të mahnit me bukurinë e fjalës teksa vë në gojën e këtyre personazheve ligjërime për tema si atdhedashuria, vdekjen si një monolog, jetën – një pritje e bukur, etj. Për Bashkim Hoxhën “Vdekja është monolog. Jeta është dialog me të paktën dy zëra, nuk mund ta shprehë dot një zë i vetëm”(fq.102). Dhe po në këtë linjë, duke filozofuar mjeshtërisht mbi konceptet për jetën autori shkruan se “...njerëzit vdesin atëherë kur harrohen.” Po në këtë linjë B.Hoxha i trajton në këtë roman edhe marrëdhëniet njerëzore, kur shkruan se: “Marrëdhënia e njeriut me botën është bërë shumë materiale dhe ndjesia ka dalë diçka e tepërt, siç doli i tepërt edhe bishti, në fillim si një atavizëm, pastaj iu zhduk fare njeriut”.

KONCEPTET PËR DASHURINË DHE....

“Dimri i librave”, është romani ku përveçse shqetësimit për humbjen e interesit për të lexuar trajton në mënyrë filozofike edhe konceptet për dashurinë njerëzore. Këtu spikat *bukuria e rrëfimit dhe larmia e subjekteve. Kështu, për djalim e vetëm, Adnani “do të donte që Sidriti të kishte liundur në një datë tjetër, sepse 11 prilli i vdekjes së Enver Hoxhës, zakonisht shpallej çdo vit zi kombëtare, nuk kishte shans ta festojë me gëzim”*. Dhe nëse këtë perifraksim e marrim nga personazhi kryesor, Adnani, për personazhin tjetër me emrin Sokrat “zemra është një balonë me ajër që e fryn dashuria, e bën

aq të lehtë sa të rrëshqet nëpër duar dhe ngjitet lart në hapësirë..”. Duke vijuar po në këtë linjë më tej autori shkruan se “Dashuria për Sokratin ishte pjesa e vetme argëtonjëse e jetës, me ngjyra të ndezura, diçka e lehtë, si e Don Zhuanit në historinë fillestare pa këto këndvështrime të çuditshme regjisorësh mizorë që nuk e njohin fare realitetin”. Konceptet e tij për dashurinë njerëzore, Bashkim Hoxha i shfaq aq bukur duke i vendosur në gojën e personazheve shkrimtarë të romanit të tij. Në këtë përplasje konceptesh ai shprehet në koherencë me realitetin e sotëm; më e dukshme kjo tek personazhi me emrin Bela, për të cilën “dashuritë e ikura janë si plehu që ushqen lulet e reja që i shijojnë të tjerët”. Krejt ndryshe ndodh me Fatmirin, poetin i cili, “që kur Bardha (bashkëshortja) ishte larguar, jetonte me vdekjen e gruas së tij përditë”...dhe gjithsesi pasi e vuajti për vite dashurinë e humbur më në fund e rigjeti kur puthi Belën nën bardhësinë e borës. Këtu autori si mjeshtër i fjalës shkruan se “Dashuria nuk do fjalë. Do vetëm rrahje zemre...”.

....ATDHEDASHURIA DHE SHPËRDORIMI I LIBRAVE

Sado improvizues e spontan që është Bashkim Hoxha, gjatë shkrimit, tipar ky që zbulon poetin brenda tij, ai e ka megjithatë të qartë Itakën ku do të mbërrijë dhe nuk hutohet gjatë rrugës, gjë që i jep rrëfimit të tij një qartësi, një dinamikë dhe një ritëm të lartë. Këtë e bën edhe kur në këtë roman përplas konceptet për atdheun. Kështu, nëse Adnani, poeti që krijoi lokalitetin me emrin “Muza” për frymëzime të mira “Të rëndësishme ai quante atë kohë kur për atdheun ndodhnin ngjarje të mëdha, si ta zëmë luftërat dhe revolucionet, përmbysjet e sistemeve” (fq.22) dhe që “Atdheu i jepte rëndesë ndjesisë së tij për kohën”, (fq.25) krejt ndryshe e koncepton sot kur “Atdheu mezi po merr frymë, i kanë zënë fytyrën...” (fq.61). Këtë ide e shtjellon qartazi kur me lakonizmin e spikatur profilizon personazhin Triumfi, trafikantin që pasi u pasurua në rrugë kriminale arrin të kandidojë për deputet. Me mjeshtri të rrallë artistike autori e fut Triumfin në grupin e atyre që “E kanë vjedhur atdheun, sa nuk i kanë lënë as kockat”. Dhe nëse Simoni që “në krijimet e tij kishte vetëm një qëllim: përpiquej të ushqente dashuri, Politika e sotme bën të kundërtën, mbjell urrejtjen” (fq.197), pasi ka përshkruar rrugëtimin rrugaçëror e kriminal të Trumfit që i dehur nuk ngruron të ngacmojë seksualisht Norën, kamerieren simpatike të lokalit

“Muza”, autori shkruan se “nuk do të çuditej, nëse gazetat do të dilnin me titullin e madh: ‘Një deputet ia lyp kamerieres së klubit të shkrimtarëve’”.


Duke vijuar në këtë linjë deri në fund të romanit, autori Hoxha, mjaftë produktiv e cilësorë në veprat e tij, i jep lexuesit edhe profilin e Sidritit që e vazhdon veprën e babait, Adnanit edhe pas vdekjes së tij, duke vënë te lokali “Muza” një tavolinë në dispozicion të shkrimtarëve dhe poetëve. Por pikërisht Sidriti që ndryshe nga babai shkruante tekste këngësh për këngëtarët e rrymave moderne, do t’i habiste shokët krijues të babait në ditën e kthimit të librave të tyre nga libraritë, kur nga librat e Fatmirit solli mbrapsht 905 nga 1000 që kishte tirazhin, pra ishin shitur vetëm 5. Dhe kur Fatmiri trishtohet para këtij fakti, Sidriti thotë se ka edhe më keq si në rastin e një shokut të tij që i shpërfytyruar e kishte blerë vetë një kopje të librit të tij (ndërsa gjithë tirazhi ishte stok). Dhe si për të përligjur këtë dimër të librave, me sarkazëm therëse autori shkruan edhe rastin kur Triumfi (kandidati për deputet që në jetën e tij s’kishte lexuar asnjë libër), u premtonte poetëve se do t’ua blente gjithë librat e kthyer nga libraritë që t’ua shpërndante falas zgjedhësve të tij. Kësisoj autori Bashkim Hoxha me kthjelltësinë e mendimit, pasi rrëfëhet bindshëm artistikisht, përcjell mesazhin e trishtë se “Fundi i botës do të vijë atëherë kur njerëzit nuk do të lexojnë më libra. Ose jo, ‘Fundi i botës do të vijë kur të mos lexojmë dot sytë dhe fshehtësinë e tyre’”.

Ndërkohë, në tërësinë e këtij romani ndeshim edhe shpirtin poetik të Bashkim Hoxhës, teksa mjaftë episode i shoqëron me poezi që dallojnë për natyrshmërinë, ritmin, muzikalitetin dhe ngjyrimet e fjalës, trillin dhe lakonizmin, si veçori të pranishme në secilën prej tyre. Mendimin e thellë filozofik të këtij gjeniu krijues e dallon qoftë dhe në vargjet: Atdheu im është poezia,/territoret e shpirtit i kam gjithmonë me vete,/po për t’u mbledhur mblidheni te “Muza”,/atdheu i harruar i poetëve...”(Fq.63).Apo kur shpalos në vargje konceptet për jetën si: “Jetoj jetën time/të ngjashme/ me jetën e të tjerëve,/bashkë me të tjerët,/me të njejtin ritëm,/uniform,/ jetojmë jetën e atdheut...”, vargje këto ku Bashkim Hoxha shpalos edhe profilin poetik të një poeti me ndjeshmëri të lartë, me teknika vjershërimi midis tradicionales dhe modernes e postmodernes, me një pasuri të begatë mjetesh dhe teknikash poetike, me struktura vargjesh që e kthejnë formën në një procedim të mesazhit estetik.

ROMANI “POLAKJA” I XHEVAT MUSTAFËS, RADIOGRAFI E DIKTATURËS, PROGNOZË E SË ARDHMES

Xhevat Mustafa gërsheton mjaft mirë përvojën e tij diplomatike me formimin e gjithanshëm letrar e gazetaresk

Pas romaneve “Zë i prerë” (1993) dhe “Mëkatet e vetmisë” (2008) si dhe librit “Duke kërkuar Europën” (2012) (me analiza, komente dhe opinione), publicisti, prozatori dhe diplomati i njohur Xhevat Mustafa sjell për lexuesin romanin e tij të tretë “Polakja”. Kjo vepër letrare e këtij autori është e gjitha një performancë moderne, që të imponohet që në faqet e para dhe në vijim, deri në faqen 314, me subjektin dhe përmbajtjen e veçantë si dhe me formën e bukur artistike të rrëfimit, të ndërtimit, të gërshetimit të linjave e të kapërcimeve kohore.



Ngjarjet zënë fill në qytetin e Gdnaskut, në veriperëndim të Polonisë, vend ku më 1987, në Katovicë, një qytet jugor, ishte zhvilluar një mbledhje e shefave të partive komuniste të vendeve të kampit socialist, e cila ishte drejtuar nga lideri sovjetik Mikhail Gorbaçov. Është shkruar e thënë se pjesëmarrësve u ishte shpërndarë një platformë veprimi në rast revoltash popullore politike e në periudhën e tranzicioneve politike, një kopje e së cilës i kishte rënë në dorë edhe Sekretarit të Parë të PPSH, Ramiz Alia.

Autori ka ekspozuar në këtë roman këndvështrimin e tij ndaj zhvillimeve të vrullshme në qytetin bregdetar të Gdnaskut, ku u diplomuan shumë studentë shqitarë në Akademinë e Flotës Detare të këtij qyteti, gjatë viteve 1950- të deri në vitin 1961. Si publicist, si krijues e diplomat karriere, Xhevat Mustafa gërsheton mjaft mirë përvojën e tij diplomatike me formimin e gjithanshëm letrar e gazetaresk.

Kjo duket që në përshkrimin e ngjarjeve të vullshme në kohën kur “Enver Hoxha po vraponte apo rrëshqiste pa u vetëpërmbajtur drejt plot-pushtetshmërisë së një diktatori, njëherazi klasik dhe unikal, në dukje partizan i një dogme dhe, thellë-thellë ideator dhe zbatues i një modeli sui-generis apo e një çorbe të shpikur prej tij”. Ishte koha, kur disa prej studentëve, në vetvete apo në biseda “sekrete” me njëritjetrin, nanurisheshin nga ideja dhe dëshira e qëndrimit në vendet ku po diplomoheshin, për të krijuar familje me vajzat që dashuronin, dhe njëkohësisht stepeshin, kur mendonin se moskthimi i tyre në Shqipëri mund të interpretohej si tradhti ndaj Atdheut e Partisë. Kjo akuzë nënkuptonte ndëshkime të rënda me burgosje, internime dhe ndëshkime të tjera politike për prindërit dhe pjestarët e tjerë të familjeve, praktikë që kishte vite që zbatoheshin”.

Për dy nga personazhet gjallues të romanit, studentët shqiptarë në Akademinë e Flotës Detare të Gdnaskut, Andon Jaze dhe Jani Kruja, në këtë vorbull ishte e qartë se dilema do t’ia linte vendin përgatitjes së plaçkave dhe të valixheve për kthimin në atdhe.

Dhe ndërsa diktatori Hoxha prishej me Hrushovin e Bashkimit Sovjetik dhe aleatët e tij të bindur dhe po miqësohej me Kinën, Andoni, “edhe pse nuk ishte racist, personalisht mendonte se ndërrimi i “vëllezërve dhe motrave” nuk do të ishte njësoj si ndërrimi i kostumeve, fustaneve dhe ngjyrës së fytyrës apo të flokëve”.

E gjitha kjo përbën siparin e këtij romani, për të vazhduar më tej në retrospektivë, kulëvrijnë marrëdhëniet dashurore të dystudentëve shqiptarë të Akademisë Detare të Gdnaskut me dy buroroshet polake. Mjaftojnë goftë dhe trillet e përdorura në përshkrimin e këtyre marrëdhënieve për të kuptuar se Xhevat Mustafa e ka shkruajtur këtë roman më së pari me vizionin dhe ndjesitë e një artisti.

Krahas portretizimit artistik të dy polakeve, Anna dhe Jadëiga, si personazhet kryesore që përshkojnë romanin nga fillimi deri në mbarim të tij, autori përshkruan mjaft bukur qytetin e tyre të Gdnaskut në gjithë peisazhin socio-kulturor të tij. Ky qytet-port, me bukuritë natyrore, me historinë e pasur si mollë shërri dhe me luftra për të mes Polonisë dhe Gjermanisë, me inteligjencën e tij artikstike e shkollore, si edhe e gjithë Polonia, hyjnë natyrshëm në gjeografinë e përshkrimit. Kuptohet se përshkrimi i Durrësit është bërë edhe më me shumë detaje shprehëse dhe

dashuri.

Të njohurit e miqtë e Janit dhe të Andonit, së toku me plot bashkëkohës, herë në Gdansk e herë në Durrës, popullojnë po natyrshëm lagjet e kujtesës dhe të fantazisë së autorit. Përditshmëria e aktivitetit brenda e jashtë qytetit të Durrësit, vështirsitë e një pune gjithsesi të pavlerësuar, vetë jeta e Andon Jazes dhe Jani Krujës, të kuadratuara në ecejaket rutinë, po edhe me fundin e tyre tragjik, lënë gjurmë emocionuese në kujtesën e lexuesit.

Ishte koha kur, si në gjithë kampin socialist të Lindjes edhe në Poloni, pas vrasjeve dhe zhdukjeve masive të burrave, mes tyre edhe të shumë hebrenjve, kishte superioritet të ndjeshëm të pjesës femërore të shoqërisë. Në këtë realitet studentët shqiptarë të Gdnaskut kishin shansin për të qenë të pëlqyer dhe të kërkuar nga plot vajza polake dhe për aventura kalimtare apo për lidhje serioze me ndonjërin prej tyre, por që, fatkeqësisht, fundin do ta kishin tragjik. Portretizimet e thjeshta dhe të ngrohta të Annës e Jadëigës, të shkurtëra dhe të qëlluara, me pamje nga larg apo në ambiente intime, fokusohen tërësisht në angazhimin njerzor për të mbajtur gjallë familjet e tyre. Po kështu edhe partnerët shqiptarë të tyre; Andoni që “bënte kujdes të fliste një polonishte korrekte gjuhësisht, përpiqet që me lakuriqësinë e shprehjes, të mendimit dhe të ndjenjës së tij, ta bindte Annën se jo të gjitha dashuritë janë të vërteta, dhe prandaj jo të gjitha martesat janë të forta dhe jetëgjata”. Kësisoj, përballë insistimit të Andonit, “Annës së martuar me dashuri me kitaristin polak, Marekun, po i shteroheshin me shpejtësi forcat për të mos u gremisur në krahët e studentit shqiptar nga Durrësi”, nga marrëdhënia jashtëmartesore me të cilin ngjizet dhe fëmija i tyre i vetëm, Feliksi.

Por pas izolimit total të Shqipërisë nga bota, pas viteve ‘60, kjo dashuri dhe ky fëmijë do të mbeteshin pengu i jetës së Andon Jazes, i cili gjatë jetës studentore “kishte mësuar shumë shpejt gjuhën e syve të vajzave polake” dhe kishte arritur ta bindte polaken Anna se “ .pendesa është fare e papërfillshme përballë mëkatit”.

Linja tjetër e romanit janë marrëdhëniet dashurore dhe fundi tragjik nëpër burgjet e diktaturës i polakes Jadëiga, me trup e bukuri marramendëse, dhe bashkëshortit të saj, Janit, që e pësoi vetëm e vetëm pse “pranoi urdhërin e nomenklaturës për t’u divorcuar me polaken, mësuese muzike. Përballë kalvarit e genocidit të pashembullt, “ndoshta ajo

vetë mund të kishte dëshirë për të mos mbetur mollë përjetësisht e ndaluar për meshkujt e tjerë që e dëshironin”, por kurrësesi të mos binte viktimë e përdhunimit çnjerëzor të hetuesit famëkeq, Qemal Hanxhari. “E gjithë qënia e tij mbarte dhe shprehte egërsi, ligësi, pabesi. Ai nuk dinte të qeshte dhe se zgërdhihej, vetëm kur i shihte viktimat e torturave të tij të mbuluara nga gjaku dhe të ulërinin deri në kupë të qiellit. Për të thonin se gjatë luftës partizane ishte përzgjedhur në skuadrën e pushkatimit të Brigadës për ekzekutimin e robërve të luftës Ngashërehej kur ua këpuste fare pa mëshirë kryet pëllumbave, lepujve të vegjël, këlyshëve të porsalindur apo pak ditësh të maceve e qenve Qemal Hanxhari i shërbente verbërisht dhe kafshërisht karrikeve që i dhuroheshin “.

NJOHËS I MIRË I LETËRSISË, MUZIKËS DHE KINEMATOGRAFISË BOTËRORE

Nëpërmjet përshkrimit të ngjarjeve dhe portretizimit të personazheve, Xhevat Mustafa evidentohet në këtë roman si njohës i letërsisë, kinematografisë dhe artit e muzikës botërore. Kështu, nuk është rastësi që ai perifrazon romanin “Ana Karenina” të Tolstoit “me një kurbë në ngjitje zhvillimi dhe tensioni dhe një fund befasues, pa hapje and-in e zakonshëm në shumicën e romaneve të tjerë” .Dhe kështu ai shprehet për lidhjen jashtëmartesore të Andonit me Annën se “Ema Bovaritë dhe Anna Kareninat jetojnë edhe në këto kohë dhe se ia vlen të rrezikohet të dashurohesh me to”. Më tej, Viki, shoqja e saj e ngushtë që këmbëngulte që “Anna të ndjente keqardhje për Romeon e saj shqiptar të përtej gjysmës së shekullit të 20-të” Apo çasti kur panë në kinema filmin francez “E kuqja dhe e zeza”.. dhe kur “truri i punonte me tension të paprovuar, dhe zemra po i rrihte sikur donte t’i çante kraharorin “. Ndërkohë, bashkëshorti i saj Mareku, një natë, pas një seksi të nxehtë, më shumë me shaka e kishte kërcënuar se mund të bëhej edhe Otello, po të dyshonte se ajo shkonte me një tjetër Gjithsesi, Mareku mund t’ia falte Annës, duke justifikuar vetveten se tradhtia bashkëshortore mund të kishte lindur bashkë me Evën dhe Adamin dhe se ai nuk ishte as i pari, as i vetmi dhe as i fundmi viktimë, jo në mbarë botën, por as në pallatin ku jetonin”.

Në këtë roman gjejmë edhe mjaftë referenca të tjera të autorit për letërsinë, muzikën, kinematografinë botërore, si “Frekuentimi i mbrëmjeve

shturëse ku kërcenin lirisht dhe me ritëm të shpejtuar valset dhe mazurkat si dhe meloditë e vallëzimeve të reja amerikane, të zhanrit “rock and roll”, apo “Kërkesa e mësueses së muzikës, Jadëiga për drejtorin e shkollës që t’i sillnin një piano, që informacionet për Bethovenin, Mozartin, Shopenin, Listin, Shtrausin, mund t’i ilustronte edhe me pjesë muzikore nga këto kolosë të muzikës botërore” ..(Por drejtori, që përballë kësaj zonje me trup e bukuri marramendëse ishte shprehur se “Për ty do të zbrisja edhe hënën në tokë!” .nuk nguron ta porosisë : “nxënësve tanë folu më pak për atë Shopenin tënd dhe mësoju më shumë këngë për Partinë tonë dhe për shokun Enver Hoxha!!! .E dyta, mos vish funde me gjatësi mbi gjunjë e fustane me dekolte shumë të hapur!!! .”

Ndërsa si gazetar, autori i këtij romani, jo pa qëllim ka skalitur dhe portretin e ish kolegut të burgosur politik, Petritit, që kishte punuar në Radio Tirana dhe që një ditë ishte shprehur para bashkëvuajtësve në burg se “ndej tmerr kur mendoj se paturpësisht dhe pashpirtmërisht na ka detyruar Enver Hoxha të gënjenim në reportazhet dhe emisionet tona për jetën e lumtur që bëjmë ne shqiptarët dhe për ferrin, ku jetojnë popujt në vendet kapitaliste”. Është koha kur regjimi po eliminonte pareshtur intelektualët më të shquar dhe po i mbushte zyrat me askushë apo me njerëz me formim të varfër .kur intelektualët burgoseshin se “ëndërronin për më shumë orë pa zhurmues të stacioneve televizive italiane, për më shumë liri për puthje dashurie në rrugë, trotuare, barrestorante, në drama e filma dhe jo vetëm në stolat e parqeve e lulishteve, mes errësirës së natës dhe nën vështrimet masturbuese të disa pleqve maniakë , apo, jo rrallë, edhe nga ndonjë sy e vesh i spiunëve vullnetarë dhe me pagesë të Sigurimit të Shtetit, që gjendeshin edhe ku nuk i mendoje dhe prisje, në disa raste edhe në një krevat bashkëshortor, ku njëri nga partnerët tradhëtonte tjetrin në emër të besnikërisë dhe devotshmërisë ndaj Partisë dhe Pushtetit Popullor” Shembulli më sinjifikativ janë polakja Jadëiga dhe intelektual i shqiptar Jani Kruja.

KATOVICA NË ROMANIN E XHEVAT MUSTAFËS

Duke e marrë në tërësinë e tij, mund të konkludojmë se ky roman është radiografi e së shkuarës komuniste të Shqipërisë, por edhe prognozë

e zhvillimeve të këtij çerekshekulli. Këtë e shpreh më së miri rrëfimi i polakes Jadëiga, e cila pas liritimit nga burgu dhe dëbimit në Poloni, u tregonte shoqëve se: “Atje në Shqipëri, në kushtet e ferrshme të burgut pësova një krizë nervore, por mendërisht isha krejt normale .Atje m’i kanë shkukur si me pinca të gjitha ndjenjat dhe instinktët e femrës . Ndërsa, im shoq, Jani Kruja, kishte marrë një tuberkuloz, që siç thoshte edhe vetë, nuk e luftojnë dot as antibiotikët më të fortë.”

Pas ‘90-tës, Jani Kruja do të shprehej se: “deformimi i demokracisë kishte nisur qysh në hapat e saj të parë. Edhe pse nuk gjendej një tekst original, nga qytetarët bëhej çdo ditë e më e lexueshme apo e lakuriqsueshme se gjithshka në Shqipërinë e pas viteve 90, pak a shumë si në Rusi, Poloni, Rumani, Bullgari, Hungari, Çeki . “Katovica” zbatohet sipas një skenari largpamës për transferimin apo trashëgimin e pushteteve dhe të pasurive, nga baballarët tek bijtë e bijat, nuset e dhëndurët, nipërit e mbesat “. Autori e paraqet këtë skenar qoftë dhe nëpërmjet portretizimit të personazhit negativ, hetuesit famëkeq Qemal Hanxhari, i cili në këto vite arrin të pasurohet marramendshëm, ndërsa djali i tij bëhet deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Është vërtetë rrënjëthës takimi i Jadëigës pas shumë vitesh, kur vinte t’i bënte homazh tek varri bashkëshortit shqiptar Jani Kruja, me hetuesin Qemal Hanxhari ..që sipas saj “nuk ishte ndëshkuar as nga shteti mbi tokë dhe as nga Zoti në qiell”. Dhe pikërisht ky përdhunuesi i saj i dikurshëm në qelitë e burgut, tashmë pas 30 vitesh i pohon asaj krenarisht: “Ky është hoteli i tim biri, një nga biznesmenët e mëdhenj, deputet i partisë më të madhe opozitare, që së shpejti vjen në pushtet!”. Gjejmë kështu në romanin “Polakja” të Xhevat Mustafës rrëfime befasuese, që të prekin në shpirt dhe që të ngjallin ndjenja e mendime të thella.

Pa hyrë në detaje të subjektit, me qëllim që të mos zbehim kureshtjen e lexuesit, do të thojë se romani “Polakja” është një provë e forcës emotive të shprehjes, e një bukurie tërheqëse shkrimi, si dhe e një stili të krehur mirë, konçiz e kontemporan.

Romani në fjalë, më ka pëlqyer jo vetëm për gjuhën e zgjedhur, larg estetizimeve dhe përshkrimeve të zgjatura dhe pa vlerë, për stilin e bukur të rrëfimit, sintaksën poetike të përdorur me vend, metaforat e shumta dhe funksionale, për frazeologjinë e pasur e të larmishme, por edhe për mënyrën si është ndërtuar struktura dhe kompozicioni, për format si janë


harmonizuar linjat kryesore me detajet dhe hollësitë dhe për digresionet e përdorura me mjeshtëri.

Mjeshtria e autorit shprehet dukshëm sidomos në portretizimin plot ndjenja, lirizëm e poetizim të polakeve Anna e Jadëiga, duke të shtyrë të mendosh se i ka “dashuruar” nga larg, edhe pa i njohur dhe se synon që të mos i mbajë për vete, por me ato të dashurohen edhe lexuesit.

Esenca e romanit “Polakja” është e lidhur me ambicjet e autorit Xh.Mustafa për të shprehur artistikisht realitetin dhe natyrën në kuptimin më të gjërë si dhe vetë njeriun si pjesë e tyre. Mbi të gjitha ky roman mbart vlera për koherencën dhe mesazhet aktuale, që përçon artistikisht tek lexuesi.

“Milosao 1 prill 2018”, “Gazeta Shqiptare” by gazetashqiptare.al

“BRENGA E PROKURORIT”, SFIDA E AHMET PRENÇIT PËR T’U RENDITUR ME ELITËN KRIJUESE TË KOMBIT



Qoftë dhe nga jehona në tregun mediatik shqiptar, intervistat televizive apo dhe opinionet e komentet e shumta në rrjetet sociale, edhe ata që s’ë patën mundësinë e pjesëmarrjes në prezantimin e bujshëm në një nga sallat më të mëdha të Hotel Tirana “International” (19 tetor 2023), me praninë e qindra personaliteteteve, jo vetëm të letrave, por edhe jurisprudencës (*siç qe pothuajse e gjithë trupa e SPAK dhe nga strukturat e larta të Policisë së Shtetit*) do të vlerësonin se me romanin “*Brenga e Prokurorit*”, Ahmet Prençi po befason botën letrare të kryeqytetit.

Si një nga miqtë e tij të shumtë, para fatin ta kisha dhe lexoja që në dorëshkrim këtë roman (kur ende autori nuk e kishte shtuar edhe një kapitull të tij) dhe sinqerisht jam befashuar me subjektin interesant, me ndërtimin kompozicional ku lëvrijnë aq bukur artistikisht ngjarje e personzhe që të mbeten në mendje.

Ashtu si me romanin “*Anja*”, botuar dhe ribotuar tre vite më pare (përkthyer dhe botuar edhe në turqisht), me të cilin u shpall fitues i çmimit “At Gjergj Fishta”, ndërkohë që qe finalist i çmimit kombëtar të letërsisë për

vitin 2020, edhe me romanin “Brenga e prokurorit”, Ahmet Prençi përçon mjeshtërisht konceptet filozofike për vazhdimësinë e jetës, për familjen dhe shtetin e së drejtës, të shprehura aq qartësisht e që e bëjnë këtë një vepër letrare që sjell risi në prozën e sotme shqipe.

Nëse në eventin kushtuar 150 – vjetorit të lindjes së poetit të madh dhe korifeut të Rilindjes sonë Kombëtare, At Gjergj Fishta, organizuar nga Bashkia dhe Biblioteka e Lezhës (tetor 2021), poeti dhe prozatori Ahmet Prençi u vlerësua me Çmimin e Karrierës “Gjergj Fishta” për romanin “Anja”, me romanin e tij të dytë “Brenga e prokurorit”, ai vjen me portretizime e përshkrime brilante të personazheve, të ngjarjeve e rrethanave, veçanërisht të përjetimeve të personazhit kryesor nga çaste të përballjes me eksponentë kryesorë të krimit.

BRENGA E PROKURORIT TË VRARË SI BRENGË E AUTORIT

Të skeduar e përshkruara si rrëfime ngjarjesh e episode personazhesh që veprojnë në tempullin e drejtësisë, autori si njohës perfekt i fushës, i jep lexuesit jo vetëm profilin e Martin Gurit, simbol i prokurorit që përçon sinjale të qarta se edhe në këtë vend drejtësia mund e do të bëhet, por njëherësh edhe brengat e tij.

Në këtë roman mbresëlënës është brenga e shokut të tij, prokurorit Artur Rrasa të vrarë pabesisht nga dora kriminale...është dhimbja për atë me të cilin, ndonëse në të njejtin profil, netëve të vona inskenonin skena teatrale, kur Arturi luante kriminelin e Ai prokurorin. Ndaj dhe ishte betuar t'i shkonte gjer në fund dosjes së madhe të kriminelit me damkë Marjan Broja.

Por edhe në këtë betejë spikat profili i tij njerëzor, siç është shprehur A.Prençi në disa intervista televizive, sepse edhe prokurori është njeri parasëgjithash. Gjithsesi ai sjell episode nga çaste kulmore të shoqërisë me shokun e rinisë qoftë dhe nga fotoja me të e atë të fëmijëve që mbante në zyrën e tij të punës. *“...në foton me Arturin ishin në këmbë, pranë e pranë, me një buzagaz pak të sforcuar, të nxitur kryesisht nga fotografi... Por, sado i sforcuar si moment, ajo buzëqeshje tashmë e mbante të gjallë Arturin në zemrën e tij. Fotoja që shkrepur një javë para se ta ekzekutonin në pabesi. Këto dy fotografi shërbenin shpesh si dy kolona të forta, ku mbahej gjatë ditës*

së tij prokurori Martin Guri. Aty merrte forcën, frymëzimin dhe motivimin për të ecur përpara me urtësi dhe drejtësi, me mençuri e profesionalizëm, me guxim dhe respekt për gjithçka që e rrethonte, brenda e jashtë asaj zyre. Ndaj edhe i mbante ndër sy, gjithë kohën e gjatë që qëndronte në zyrë. Ato foto e nxisnin gjithmonë të reflektonte, të ishte i kthjellët, i fortë, por dhe njerëzor në vendimet që merrte....”,-shkruan autori Prençi.

Në lëndën tejet jetësore e të pasur është këndvështrimi objektiv i autorit për luftën pa kompromis ndaj krimit, edhe kur ndodhet përballë kërkësive ultimative si ajo e Arjanës.

“Ai e kishte varrosur bashkë me ëndrrat e rinisë së hershme, ngjarjen me Arjanën. Nuk gjente asnjë shpjegim për veten. Kishin kaluar rreth 30 vjet. Martini e kishte të fshirë takimin e parë dhe të fundit me Arjanën. Për dreq, ajo iu shfaq për t’i tronditur të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Ajo bisedë ia kishte nxirë e përmbysur gjithçka kishte para e rrotull vetes. Të gjitha ç’kishte ndërtuar në jetë, ishin tronditur si në një përplasje pllakash tektonike që rrëmbejnë e përpijnë njerëz dhe godina, prej një energjie të jashtëzakonshme, pas një kohe të gjatë gjumi. Po, kështu thuhej në shkencë, tërmetet dhe vullkanet kishin kohën e tyre të gjumit dhe kohën e tyre të zgjimit”.

AHMET PRENÇI, ARKITEKT LIGJËRIMESH TË KËNDSHME

Si një arkitekt i vërtetë ligjërimesh të këndshme, Ahmet Prençi përcjell nëpërmjet këtij romani edhe mesazhin e shenjtërisë së familjes dhe ruajtjes së traditës. Kësisoj ai dëshmon për vlerat e rralla ideoartistike që ai përçon tek lexuesi. Dhe këtë e bën edhe nëpërmjet portretizimit të bashkëshortes së tij, Eliza kur shkruan se “Sytë e Elizës ishin sy të vërtetë, për atë dhe fëmijët e tyre”. Dhe më tej, pasi përshkruan bukurinë e saj fizike e shpirtërore dhe vlerat e spikatura intelektuale e njerëzore, shkruan se: “...pavarësisht të gjithave, fundjavat dhe ditët e pushimeve Martini ia kushtonte familjes së tij, me ndonjë përjashtim të rrallë. U dedikoj tërësisht atyre, sepse kishte nevojë të zhvishte lëkurën e prokurorit për të gjalluar si njeri i thjeshtë dhe familjar i përplotur”. Qoftë edhe nga ky perifrazim konstatohet se si Ahmet Prençi, me romanin e tij e afron lexuesin shumë pranë me personazhet. Ai i përgatit ato për një ngjarje të madhe dhe, sa më pranë saj janë ato, aq më i rreptë është provimi i tyre dhe më dramatik përcaktimi.

Ndërsa evidenton kaq kaq bukur rolin e prokurorit të ditëve të sotme, po aq bukur ai përshkruan edhe terrin e drejtësisë së para tri dekadave, kur viktima të pafajshme dënoheshin në emer të Partisë dhe të popullit. *“Në të ri Martin Guri pyeste veten: Pse nuk thuhet thjesht ‘Armik i popullit’. A nuk ishte edhe partia pjesë e popullit? Po populli, a nuk e përfshinte brenda partinë? Pse duhej ai togfjalësh dallues dhe kundërvënës ndonjëherë?”*(fq.61).

Kësaj enigme autori Prençi i jep shpjegim me arrestimin nga përbindëshi Piro të karrocierit Rushan me një mal me halle,, vetëm e vetëm pse zhvaste për bukën e fëmijëve misër nga ai i kooperativës dhe se kur pinte ndonjëherë, nga gjendja mjerane dhe i pashpresë i jepte ndonjëherë gojës.

Qasje interesante të autorit në këtë roman janë edhe përshkrimet e lutjes së gjyshës, në ato kohë kur nuk lejohej as lutja, as falja tek Zoti, por vetëm besimi tek Partia. *“Gjyshja e mençur vazhdonte në të vetën ‘Te Zoti duhet të falemi përditë, jo vetëm kur troket moti i keq’.*(fq.55-56). Dhe në këtë linjë, me gjuhë mjaftë të pasur e mjete shprehëse interesante A.Prençi përshkruan më pas ngjarjen makabër të një të mbyturit në lum, Hajri Kacani, për të cilin u mbloddhën gjithë burrat e fshatit t’ia nxirrnin kufomën nga lumi...dhe më vonë për të u kënduan këngë, por “Hero i Punës Socialiste” nuk u bë, se na doli me problem në biografi...

Teksa sjell në memorie dhe skalit me mjeshtri të rrallë ngjarje e episode të tilla dëshpëruese, autori Prençi, padyshim qasje kryesore ka brengën e Prokurorit...

“Tani ishte vetë Martini në rrjedhë të frikshme, jo e dukshme si uji, por këmbët dridheshin pa gjetur dot taban. A do të bëhej ai viktima e një lumi që fryhet papritur? Sepse, ashtu krejt papritur erdhi Arjana në zyrën e tij dhe, si një rrebesh vere u lëshua mbi të pa mëshirë. A do të binte ‘dëshmor’ prokurori me një ‘cen’ në biografi, ashtu si djaloshi Hajri Kacani që e kishte dajën armik të Partisë?”(fq.61)

PRETENCA PARA DREJTËSISË DHE PRETENCA PARA ZOTIT

Pikërisht mbi këtë shtrat romancierit tashmë i sprovuar Ahmet Prençi, i përvijon ngjarjet deri tek zgjidhja e enigmës, kur ai vendos sipas ligjit, pavarësisht nga ngjizja e një fëmije nga një flirt dashurie me Arjanën në

rininë e tyre, të cilën ia tregon ajo pikërisht kur ky fëmijë tashmë i rriur me emrin Marjan Boja ishte bërë nga kriminelët më të rrezikshëm. Përballë kësaj dileme, triumfon ligji, vënja në jetë e drejtësisë. Pra prokurori Martin Guri nuk zbrapset nga ndëshkimi i krimit, përpara cilitdo që ta ketë kryer atë. Dhe idenë e kësaj sprove e përçon me mjeshtri të rrallë qoftë edhe nga ana kompozicionale, duke i vendosur kapitujt njëri pas tjetrit me titujt sinjifikativë (sipas imagjinatës dhe trillit artistik): *“Një klithmë nga errësira”*, *“Triptik kujtimesh...”*; *“Një kafe në teher të briskut”*; *“Në kirurgjinë e drejtësisë”*; *“Plumbi i tradhëtisë në shtëpinë e drejtësisë”*; *“Një kopil në derë”*, *“Shfletime nga një sagë kriminale”*; *“Me bombë në prehër”*; *“Pretenca para ligjit”* e *“Pretenca para Zotit”...*

Po. Ashtu siç shkruan botuesi–*Shtëpia Botuese: “Mediaprint”*, me rrëfimin e protagonistit Martin Guri autori Prençi “zbulon gradualisht një sistem drejtësie të kontaminuar nga krimi dhe korrupsioni e bashkë me të “Bregën e Prokurorit”, në rezistencën për të ruajtur idealet edhe kur presionet janë të mëdha. Si një njeri i drejtësisë autori Ahmet Prençi, shkruan i inspiruar nga një realitet i afërt, ku siç thotë, ka ende njerëz të ligjit e rendit që punën e tyre e shikojnë si mision”.

Dhe jo vetëm kaq. Siç vlerëson poeti laureat Rudolf Marku, në romanin “Bregën e prokurorit”, ashtu si dhe te romani “Anja”, duket se pika më e fortë e autorit është krijimi i karaktereve, metaformizimi i tyre nga të qënurit real në të vërtetë fiktivë...”. Si të tillë profilizohen, jo vetëm prokurori Martin Guri, por edhe bashkëshortja e tij Eliza, kur autori vë në gojën e saj fjalët: *“Mos me pas fatin e Rozafës, Martin!”* (Kjo në kontekstin e shenjtërisë së familjes).

Dhe përderisa ky roman merr vlerësime maksimale edhe nga personalitete të letrave, si **Rudolf Marku**, – Poet laureat, shkrimtar i cili është dhe një nga recensuesit e librit “Bregën e Prokurorit”, Behar Gjoka, një nga zërat më të spikatur të kritikës së sotme letrare, publicisti dhe diplomati **Arben Çejku**, gazetari e shkrimtari i mirënjohur **Shefqet Meko** si dhe profesori, eksperti i kriminalistikës **Ervin Karamuço**, nga shkrimtaret e mirënjohura Flutura Aça, Entela Kasi e dhjetra të tjerë, jam i bindur në vlerësimin tim se Ahmet Prençi po e kalon dinjitetshëm sfidën e renditjes me elitën krijuese të kombit.

ZHËNJIMET DRAMATIKE TË TRANZICIONIT NË NOVELËN “VIZA AMERIKANE” TË SHEFQET MEKOS

Viza Amerikane” – Një novelë rrëqethëse... Shefqet Meko vjen kështu me një botim të ri, duke rrëfyer në stilin e tij zhgënjimin dramatik të tranzicionit shqiptar. Artan Pojani, personazhi kryesor i kësaj novele, prezantohet nga autori si shqiptari i vetëm që ishte futur pa vizë në Amerikë, për të denoncuar një vjedhje monstruoze shqiptare. Ish-mësuesi i matematikës që tërë jetën kishte pasur të njëjtën adresë: Kopole, Podgorie, “një tip fshati a lagjeje që shtrihej mes Korçës dhe Pogradecit, me sytë nga liqeni”, këtu kishte ndërtuar biznesin e tij të bletërritjes. Me një gjuhë tejet të pasur e mjete shprehëse interesante, autori e personifikon atë si intelektualin provincial, i cili shijen e parë amerikane e kishte provuar duke lexuar librat e Xhek Londonit.



Dhe si i tillë, ndonëse kishte arritur majat e suksesit me biznesin e tij “Ai gjithmonë ua kishte përshkruar Amerikën bashkëshortes Shpresa dhe fëmijëve, si vendi më i madh në botë, që u jep njerëzve atë që meritojnë, atë që duan, atë që ëndërrojnë, ani pse nuk të fal asgjë”. Si një vend që të jep, jo vend që të fal... Kësisoj, Sh. Meko që edhe në romanin “Saga përtej Atlantikut” e në rrëfimet e mëhershme tek “I tillë jam” përshkruan gjer në detaje e gjallëri artistike realitetin amerikan, edhe në këtë novelë e paraqet personazhin kryesor Artan Pojani, si njohës të Tregut të hapur dhe Shoqërisë së lirë, që sipas tij ishin dhuratë nga Amerika, e cila “nuk ta sillte peshkun në tigan”, por të frymëzonte me ide dhe liri, për t’u bërë peshkatar i profesionit...

“Ndërkohë që shumica e shqiptarëve i shikonin lumturinë dhe rimëkëmbjen përtej kufijve të vendit, ai (Artan Pojani) ishte mbase i vetmi

që veproi krejt ndryshe. Nuk iku askund. Qëndroi te vendlindja, si amanet dhe dëshmi, se vendi bëhet nga ata që e duan dhe nuk e braktisin, jo nga ata që e shajnë, ikin arratisen, fluturojnë larg dhe pastaj flasin për mall, për patriotizëm e dhédashuri, në karta dhe vargje rapsodike”, shkruan në fillim të novelës Meko, për ta paraqitur më pas sa më bindës atë në “betejën” kundër trafikantëve të vizave amerikane.

PAK NGA SUBJEKTI I NOVELËS

Artan Pojanit, që e kishte ngritur sipërmarrjen e tij me punë, sakrificë, ndershmëri e devotshmëri, iu refuzua viza amerikane, pasi dikush tjetër i kishte vjedhur identitetin dhe me dokumente të falsifikuara do të mund të bëhej shtetas i Amerikës. Zhgënjim dhe dëshpërim i thellë ky për atë që ishte diplomuar për mësuesi, por që bletët për të ishin gumëzhima simfonike brenda valles së numrave në pafundësi... “Për Artanin ata ishin atdhetaret më të mëdha, sepse kurrë nuk e kapërcenin kufirin, kurrë nuk shkonin në lindje, por fluturonin vetëm në perëndim të Malit të Thatë. Shpesh i dukej vetja si komandant i një ushtrie magjike.

Jo si ‘Ushtria e vdekur’ e Kadaresë, por ushtri aktive, e shëndetshme dhe energjike... Bletët janë më atdhedashëse se shqiptarët dhe më dashamirëse se amerikanët...”, shkruan Meko. Dhe për ta bërë sa më bindës zhgënjimin e personazhit kryesor të veprës, ai i përmbahet sentencës së rastësisë kur shkruan se: “Ishte rastësia e tij e hidhur që nuk e pati kurrë fat Amerikën. Kush nuk shkoi në atë vend! Gati të gjithë shokët dhe miqtë e tij të rinisë, gati të gjithë ish-nxënësit e tij, gati gjysma e fshatit të tij. Atje kishin shkuar sa e sa familje dhe fise komuniste, ish-zyrtarë të kohës së shkuar dhe po aq ish-spiunë e oficerë ushtrie. Amerika është punë fati. Me fatin nuk zihesh dot”.

Gjithsesi, fati e solli që ai të takonte rastësisht shqiptaro-amerikanin Pandi Pllaha, nga i cili mësoi gjithë skemën e mashtrimit dhe u ndihmua për të shkuar ilegalisht në Amerikë, nga ku do të denonconte trafikantët e vizave.

Pandi Pllaha që kthehej në Shqipëri pas disa vitesh, i braktisur nga ish-miku i tij, Gogo Përculla, rastësisht do të takojë Artan Pojanin në një bar-kafe të Tiranës:

“-A jeni ju Artan Pojani. A jeni ju miku i Gogo Përcullës?

-Gogo Përcullën e njeh tërë Shqipëria si zëvendësministri i përjetshëm, por unë nuk jam miku i tij dhe as që njihemi fare.

-Gogo Përculla më ka kërkuar garanci financiare për ju dhe unë kam nisur garanci për ju, gruan dhe dy fëmijët. Ju kishte dalë lotaria dhe jeni në listën e atyre që kam sponsorizuar. I kam të gjitha të dhënat tuaja në Amerikë. Po të doni, kur të kthehem ua dërgoj kopjet që ruaj në kasafortë... Ua bëra të gjitha dokumentet mbështetëse, por në fund më thanë se ju vendosët të shkonit në Australi...”

Po zbulohet kështu megaskandali i një ish-zyrtari të lartë (zëvendësministrit të përjetshëm Gogo Përculla), i cili kishte ndihmuar Arshim Gatranin të kapte Amerikën, duke i dhënë letrën fituese të lotarisë amerikane dhe garancinë e sjellë nga Pandi Pllaha në emër të Artan Pojanit.

“Arshim Gatrani kishte ditur të ndryshonte jetën e familjes së tij në mënyrën më të habitshme, si askush tjetër. Thjesht kishte mundur të blinte një Lotari të Kartës së Gjelbër, që nuk ishte adresuar tek ai, por te dikush tjetër... I dukej vetja i lindur për në Amerikë... Kishte sajuar disa letra të falsifikuara: një certifikatë lindje, një familjare, atë të martesës, ku vetëm emri dhe mbiemri i tij kishin ndryshuar nga Arshim në Artan, nga Gatrani në Pojani... Por bashkëshortja e tij, Silva, nuk ishte aq entuziaste sa ai... Jeta amerikane u kishte mësuar shumë trille, shumë të panjohura më parë, aq sa dalldisej kur përfytyronte të tilla gjëra...”

Në këtë rast kemi të bëjmë me realitetin letrar artistik dhe vlerën morale të kësaj novele, sintetizuar kjo qoftë edhe në fatin e parathënë të personazhit kryesor të saj. Për këtë mjafton të perifrzojmë: “Por fati i tij kishte qenë i parathënë: ia kishin vjedhur trafikantët mu në mes të Tiranës... Ishte një vjedhje barbare, tipike shqiptare, si ato ‘bëmat’ e pashoqe që kishin ndodhur kudo, në çdo sferë të jetës, pas rënies së shtetit diktaturë”. Kësisoj, në këtë novelë dalin në pah prurjet e reja me vlera dhe veçori, mbi gjuhën, tërësinë ideoartistike dhe mënyrën e shprehjes; vlera këto që konsistojnë qoftë dhe në përshkrimin e miqësisë midis Artan Pojanit e Pandi Pllahës. Kjo edhe në rastin kur: “Niko Kitara nuk donte ta besonte atë që kishte lexuar në disa raporte publike të OJQ-ve shqiptare, ku dilte edhe emri i Pandi Pllahës si menaxher në disa projekte mjedisi dhe zhvillimi urbanistik rural. Shkurt, nën emrin e tij ishin marrë disa qindra

mijëra euro...Këtu është bërë çdo gjë plaçkë tregu. Çdo gjë shitet e blihet, çdo gjë falsifikohet. Prona shitet disa herë brenda ditës...”

Dhe përkundër këtij realiteti të trishtë, autori vë miqësinë e sinqertë midis dy personazheve kryesorë pozitivë.

“Artan Pojani dhe Pandi Pllaha u bënë bashkë kundër kësaj flame mashtrimi. Pandit i vajti mendja menjëherë të Gogo Përculla. Ai kishte marrë në dorëzim të gjitha dokumentet e shoqatës dhe me siguri ai do të ishte fshehur pas emrit të tij. Duke vepruar nën një emër që ishte larg radarit të Brukselit, ishin nënshkruar disa kontrata me firmën e falsifikuar të Pandi Pllahës, që vazhdonte ende të figuronte si drejtor ekzekutiv i shoqatës që kishin krijuar bashkë shumë vite më parë”.

Do të mjaftonin këto skandale për të përshkruar me gjetje artistike sipërmarrjen e shkuarjes ilegalisht të Artan Pojanit në Amerikë, për ta denoncuar vjedhjen e identitetit të tij, pikërisht në praninë e përfaqësuesve të Zyrës Lokale të Emigrimit në shtetin e Dakotës së Jugut. Një solemnitet i vërtetë kur këtu do të fliste qytetari më i ri amerikan nga Shqipëria e Skënderbeut dhe Nënë Terezës. Jo ai me emër të ndryshuar, por Artan Pojani i vërtetë.

Kësisoj, pas romanit “Saga përtej Atlantikut”, me novelën ”Viza Amerikane” (Botim i ”M&B”, me redaktor Sefulla Kata dhe recensentë prozatorët dhe poetët e mirënjohur Ahmet Prençi dhe Arben Çejku), Shefqet Meko vjen si befasi në botën letrare të metropolit shqiptar. Kjo, për vetë rrëfimin mjeshëtor si askush tjetër të përjetimeve, asosacioneve, ngjarjeve dhe karaktereve të personazheve mjaft interesantë, që e bëjnë këtë novelë shumë tërheqëse për lexuesin. Po ashtu, qoftë dhe nga leximi i parë, konstaton shprehje filozofike brilante të këtij autori në skalitjen e personazheve, duke depërtuar thellë në botën e tyre shpirtërore.

KOHERENCA ME REALITETIN SHQIPTAR NË NOVELËN “VIZA AMERIKANE”

Novela “Viza Amerikane”, përveç vlerave artistike, ka edhe vlera aktuale: rrëfen për kohë e ngjarje të jashtëzakonshme dhe për njerëz të jashtëzakonshëm. Të tilla janë jo vetëm dasma shqiptare në Minetonka të Amerikës, ku Pandi Pllaha takon dhe njihet me Stefan Lundrën nga

Saranda që kishte ardhur në Amerikë si i birësuar dhe që e përfytyronte mossuksesin e kombit të vet, ngaqë pushteti i ndërtuar mbi bazë njohjesh i ngjante një rrjete të hollë merimange, që ishte shumë e vështirë të zhbëhej..., por edhe rrëfimet e Artanit për babain që i kishte vdekur i ri nga një aksident në minierë si minator, ndërsa nënën e kishin detyruar të martohej me xhaxhanë që kishte mbetur beqar, duke hapur kështu varrin shpirtëror që ai nuk e mbuloi dot kurrë...

Apo dhe rasti i vizitës së delegacionit amerikan në zyrën e Gogo Përcullës, tashmë zëvendëskryeministër, që u gjet prej tyre i vetëvarur!!! “Nuk kishte ndodhur kurrë më parë një ardhje aq e befte e ekspertëve amerikanë. Ndalesën e parë ata do ta bënë te Gogo Perculla, i cili përpiquej të kuptonte rolin e ri në qeverisjen demokratike shqiptare. Sapo ishte bërë numri dy i qeverisë. Nuk e kishte ëndërruar kurrë një pozicion të tillë” (fq.204).

Autori ka meritën e personifikimit të këtij zyrtari të lartë si “egërsirë të parasë nën tavolinë”, si një bishë të vërtetë që i kishte fillesat e veta te Këmbimi Valutor pranë Bankës Kombëtare për të mbërritur deri zëvendësministër e numri dy i qeverisë, nga që kishte aplikuar mjeshtërisht “bakshishin e palënë gjurmë”, të paverifikueshëm e të pakontrollueshëm... te ky njeri që i dinte të gjitha gjynahet e veta, por nuk ndiente keqardhje. Dhe në koherencë me realitetin e sotëm të trishtë shqiptar, duke aluduar për kreun e megaskandaleve qeveritare, Sh. Meko shkruan se: “Ai kishte bërë gjithçka për përfitim...”


E dinte se biznesi i parë për të gjithë kryetarët, deputetët dhe ministrat ishin vizat. Atë kishte bërë dhe ai. Por tani që biznesi ishte zhvendosur në fusha të tjera, si në ndërtim, në menaxhim plehrash, në hidrocentrale, në ribërjen e bregdetit shqiptar, në rrugët e kombit, koha e vizave i dukej si gjueti lepujsh. Ai ishte bërë mjeshtër i kontratave, i pazareve dhe kasap i vërtetë në ndarjen e ryshfeteve. Dinte të manovronte aq bukur në ndarjen e parave për çdo pazar të pistë që bëhej, sa të linte me gojë hapur”.

Ky realitet i trishtë vjen artistikisht nëpërmjet kësaj novele (që me 17 kapituj në 223 faqe, për nga struktura mund të konsiderohet roman) qoftë edhe duke aluduar me megaskandalin e inceneratorëve. Brendia e mënyrës së trajtës ideore dhe ndërtimore të vetë strukturës së kësaj vepre letrare ngërthen qenien e gjallë të botës së brendshme të personazheve pozitivë

dhe atyre që personifikojnë zyrtarët e korruptuar dhe nuancat e veçorive të botës së tyre shpirtërore të katranizuar.

Edhe në këtë novelë vërehet se proza e Shefqet Mekos ka një raport të pandashëm me kohën. Madje, siç shkruan recensenti Arben Çejku: “Leximi i kësaj novele do të rikthejë në kujtesën e shumë njerëzve histori të ngjashme, me pak apo më shumë dramaticitet. Fundi tragjik i disa prej personazheve vjen si fshikullim nga autori për të gjithë shoqërinë tonë, e cila duhet të dalë nga bataku egocentrist i tranzicionit dhe të mos pajtohet kurrë me krizën e vlerave morale, pavarësisht se ku shfaqen ato”.

Astrit Gjunkshi flet me “HIRUSHJA PELLAZGE” Pse nuk zbehet shkëlqimi i kultures greke?! Origjina 600-vjeçare e gjuhës shqipe dhe kyçi i enigmës..



Ky roman merr një rëndësi të veçantë edhe për faktin se subjekti i tij dhe zhvillimi i ngjarjeve në të, janë në unison me zhvillimet e fundit të shkencës ndërkombëtare, e cila njohu zyrtarisht origjinën 6000-vjeçare të gjuhës shqipe, si një ndër tri gjuhët më të vjetra indo-evropiane.

Autori ka meritën se në ligjërimin e tij estetikoshkencor arrin në përfundimin se sqarimi i enigmës pellazge nuk ka të bëjë me zbehjen e shkëlqimit të kulturës greke.

“Gjuha shqipe është fosile e gjallë e gjuhës pellazge”. Ky përcaktim i gjuhëtarit të shquar Mathieu Aref, si dhe referencat nga libra kushtuar studimeve iliro-pellazge të autorëve të njohur si: Aristidh Kola, Petro Zheji, Zahari Majani, Giuseppe Catapano, Nermin bej Vlora Falaski, Sulejman Mato, Elena Kocaqi, Louis Benloeë, Patrick Colquhoun & Pashko Vasa etj, shërbyen si indicje për poetin, prozatorin dhe studiuesin Astrit Gjunkshi, për të shkruar dhe botuar romanin “Hirushja pellazge”. Është ky një roman, subjekti i të cilit nis me aktin genocidial të pushkatimit nga

nazistët gjermanë me 1944 të prindërve të një prej personazheve kryesorë, Lidias kur ajo dhe vëllai i saj binjak Lision ishin vetëm katër vjeç, ndërsa motra më e vogël e tyre Ulisa tri vjeçe. Në shpirtin e Lidias,- shkruan autori në fillim të romanit (fq.13), përziheshin gëzimi i familjes që kishte krijuar me të shoqin (Panajotis Zingas) dhe vajzën e tyre Melisa, që tashmë ishte në klasën e pestë, me kujtimet e hidhura dhe enigmat e fëmijërisë dhe të familjes ku ajo kishte lindur. Por, do të ishte pikërisht Melisa, ajo që do të zbardhte këto enigma, falë zgjurasisë, bukurisë fizike e shpirtërore (që autori i përshkruan aq bukur me një gjuhë të pasur e mjete shprehëse interesante) dhe këmbëngulja e saj për ta bashkuar domosdoshmërisht atë familje të shpërbërë që para gjashtë dekadash. Asaj i ishin ngulitur në memorie kujtimet e hidhura të së jëmës kur gjermanët ua pushkatuan para syve prindërit, vetëm e vetëm se ata kishin strehuar një familje hebreje. Nga këtu nis dhe fati i hidhur i tre fëmijëve të mbetur jetimë, të cilët në këto kushte do të birësoheshin nga të tjerë për t’u ritakuar pas 64 vitesh. Ribashkimin e Lidias me vëlla Lisionin e motrën Ulisa autori e sjell aq këndshëm e bindshëm në roman, duke përshkruar angazhimin e Melisë në organizimin e Konferencës Shkencore për trashëgiminë e qytetërimit pellazg dhe për sensibilizimin e njerëzve me mendje të hapur, që të njohin e pranojnë të vërtetat që po fshihen qëllimisht prej kohësh, konferencë kjo që do të mbahej në Athinë.

SUBJEKT I NDËRTUAR MBI RASTËSITË

Autori ka meritën që nëpërmjet fantazisë dhe ndërtimit të trillit artistik sjell raste të rastësisë për zbulimin e enigmave, ribashkimin e familjes Lisi pas 64 vitesh dhe angazhimin për të arritur suksesin në organizimin e Konferencës Shkencore, ku do të evidentohet gjuha shqipe si kyçi i zgjidhjes së enigmës pellazge. Fillimisht do të ishte Besiani, i cili pas studimeve të doktoraturës në Universitetin e Harvardit, duke njohur nga afër padrejtësinë që i është bërë qytetërimit dhe gjuhës pellazge, nga ata që i quajnë të zhdukura, kishte përcaktuar si temë studimore: “Përfitime të Zgjidhjes së Enigmës Pellazgjeke për Çështje të Sigurisë”. Këtu, është sërish meritë e autorit që sjell si rastësi Profesor Ethanin si udhëheqës të temës së Besianit. Është po rastësia që e bën romanin tërheqës dhe interesant kur

në të zbulohet fakti që pikërisht profesor Ethani – biri i familjes hebreje të strehuar nga Bardi, siç e thërrisnin babanë e tyre, paskësh qenë miku i Lidias, Lisionit e Ulisës, kur para 64 vitesh, kishin mbetur para portës së shtëpisë të braktisur, të nxirë nga tymi e bloza që përzihej me lotët e tyre.... Ata qenë të vegjël 3-4 vjeçarë kur u ndanë si zogjtë nga foleja e tyre dhe s’kishin si të mbanin mend as vendndodhjen e shtëpisë së prindërve dhe as emrin e mbiemrin e saktë të tyre. Por sërish autori përdor rastësinë për të zbuluar edhe këtë enigmë. Është Besiani, i takuar rastësisht me Melisën, që pas një vizite në shtëpinë e saj, nga një jelek me copë të kuqe dhe disa gjethe pemësh, që nëna e saj ja kishte qëndisur që kur ishte fëmijë, do të zbulonte se ato ishin gjethe lisi, gjethet që fëshfërinin te Dodona pellazge, në malin e Tomorrit në Shqipëri. “Besiani filloj të zbulojë aq sa mundej ato që i dukeshin si pjesë shkronjash të gjelbra dhe filloi t’i lexojë me vështirësi, një nga një: ‘Z...e...l...d...a Li...s...i – Zelda Lisi, ky duhet të jetë emri i nënës suaj. Dhe mbiemri i familjes është Lisi, nënë Lidia, ashtu si emri që kanë edhe këto gjethe...’ (fq.88). U zbulua kështu një nga enigmat që i brente prej kohësh dy nga personazhet më ndërveprues të këtij romani, Lidias dhe vajzës së saj Melisa, që pas studimesh do të ishte një nga arkitektet më famoze të Athinës. Më pas vjen rastësia tjetër, dy fëmijët e Besianit dhe Melisës, Dritori dhe Andra, miq të ngushtë, në të njëjtën klasë të së njëjtës shkollë..., vrojtimi i milingonave (një gjetje interesante kjo e autorit, me të cilat Lidia, Lisioni, Ulisa e Ethani kishin lozuar që kur ishin fëmijë të shtëpia që pasi ishin rritur s’ e gjenin dot), që gjatë vizitës te Akropoli i famshëm i Athinës, do t’i kushtonin frakturë Andrës...

GJUHA GREKE MUND TË ZBULOJË FJALË TË SHQIPES NË ETIMOLOGJINË E SAJ

Gjithsesi, pjesa dërmuese e subjektit të këtij romani është ndërveprimi i personazheve për organizimin e Konferencës Shkencore për gjetjen e të vërtetës për gjithë familjen pellazge. Kjo sipas autorit Dr.Gjunkshi edhe për faktin se “...në shekujt 5-të deri 3-të të lulëzimit të kulturës helene, nuk munguan edhe ndërhyrjet politike për të tejkaluar çdo pengesë dhe kontradiktë që dilte, midis asaj që ishte trashëguar në Greqi dhe asaj që pretendohet se ishte parahelene”. Këto kontradikta, – shkruan

autori (fq.105) shfaqen, duke filluar me “Iliadën” e Homerit në të cilën, përshkrimi i Luftës së Trojës së shekullit të 12-të para erës sonë paraqet, në fakt, ngjarje që lidhen me pushtimet fenikase për të përzënë pellazgët nga këto troje.... Në këtë kontekst, autori vë në gojën e Dr.Besianit argumente të tezës së tij se: “...duke qenë me rrënjë pellazge, gjuha greke mund të zbulojë shpejt fjalë të shqipes në etimologjinë e saj, të cilat konservojnë shumë besnikërisht pellazgishten, sepse janë fosilja më e qëndrueshme e saj”.

Po në këtë kontekst jepet në këtë roman edhe angazhimi i Melisës në projektin e Besianit për nxjerrjen në dritë të thesarit të gjuhës pellazge si dhe trashëgimtares se saj më të drejtpërdrejtë, gjuhës shqipe. Madje, kundërshtitë e bashkëshortit Janis për angazhimin e saj në këtë projekt (për të cilin Melisa shprehet se “nuk do të isha lidhur kurrë me të po ta dija se ishte kaq narcizist”), autori i shpreh mjaftë bukur artistikisht, deri në divorcin e tyre. Këtu autori shtjellon mjaftë bukur edhe konceptin për familjen, duke e vënë atë në gojën e Melisës që e konsideronte shumë të shenjtë. Dhe duke vijuar në këtë linjë (fq.128) romancieri Gjunksi shpjegon nëpërmjet fjalës artistike edhe filozofinë e dashurisë. “Në veçanti, tani që e kishte ndjerë dashurinë për Besianin, ajo e kuptoi se çdo të thotë dashuri. Kishte kuptuar se ajo nuk kishte ndjerë ndonjëherë dashuri për Janis. Ajo që kishte kujtuar se kishte qenë dashuri, në fakt kishte qenë një amalgamë e vlerësimit nga ajo e shenjtërisë së familjes dhe e respektit që kishte për babain e vajzës së saj – ardhur në jetë nga dashuria e tyre fizike në shtrat”, -shkruan autori, i cili më vonë zbulon edhe veprimet mafioze të ish-bashkëshortit të Melisës, Janis, i cili në themel të urrejtjes ndaj shqiptarëve kishte veprimet mafioze që Melisa të mos merrte dot pronësinë e shtëpisë së babait dhe gllabërimin po me metoda korruptive të pronës së xhaxhait të saj në Janinë. Nga këtu autori përcjell edhe mesazhin se “nuk mund të ndërtohet një jetë mbi mashtrime dhe gënjeshtër”.

Në këtë roman, A.Gjunksi sjell rastësi të tjera, si ardhjen e Lisionit nga Gjermania për të referuar në konferencën për zbulimin e të vërtetave për pellazgishten, apo edhe të Ulisës, mjeke në një spital të Athinës, nga bashkimi i të cilëve me Lidian pas 64 vitesh do të mundësohej marrja e pronësisë së shtëpisë së prindërve (të cilën do ta kthenin në qendër të pellazgishtes) dhe të pronave të xhaxhait në Janinë (ku edhe atje u ngrit

qendra për studimin e pellazgjishtes). Në këto përpjekje të mundimshme autori evidenton mbështetjen e Besianit ndaj familjes së Melisës, i cili do të sqaronte se “Çështja e pronave çame të përzënë (si në rastin e xhaxhait të Lidias) është edhe shkaku kryesor se përse mbahet ende në fuqi, nga pala greke, ligji i luftës me Shqipërinë”.

SQARIMI I ENIGMËS PELLAZGE NUK KA TË BËJË ME ZBEHJEN E SHKËLQIMIT TË KULTURËS GREKE

Me gjuhë të pasur prozaike autori na sjell afër fundit të romanit, kur nga Konferenca shkencore me pjesëmarrjen e 150 studiuesve gjermanë, lituanëzë, polakë, turq, italianë, kroatë, shqiptarë, maqedonas, serbë, rumunë, francezë, austriakë, zviceranë, bullgarë, britanikë, spanjollë, irlandezë, belgë e holandezë, madje dhe nga vendet nordike, Izraeli e vendet e Kaukazit (ndërsa grekët ishin përfaqësuar nga dhjetë pjesëmarrës), pas rrahjes së mendimeve e debateve të shumta, fiton konkluzioni i përfaqësuesve shqiptarë se: “ndarjet e sotme i kanë rrënjët në ato ndarje që ka krijuar koha, si rezultat i vështrimit tepër të ngushtë të problemeve, sikur jemi të ardhur nga planete të ndryshme. Zbulimi i qartë i rrënjëve të përbashkëta pellazge do të na qartësojë se shumë nga popujt tanë kanë dalë nga e njëjta vatër, nga i njëjti popull, i cili pësoi katastrofë që filloi nga pushtimet, nga shkatërrimi i shtëpive dhe i pronave dhe u pasua me përzierje të mëdha, me tjetërsimin e paskrupullt të kulturës dhe të gjuhës, për të përfunduar në katastrofën gjuhësore”.

Me këtë roman që është një kontribut i vyer në shërbim të studiuesve vendas e botërorë që kanë arritur në konkluzion se shqipja është gjuha më e lashtë në botë, autori A.Gjunkshi, referuar Homerit, babait të letërsisë moderne që i quante pellazgët “hyjnorë”, si dhe D’angelit që thekson se gjuha e lashtë greke filloj të formohej nga rrënjë pellazge, argumenton bindshëm se “gjuha pellazge nuk është zhdukur, pasi shumë fjalë të saj janë përshtatur, janë ripërtërirë, apo përkthyer në gjuhë të tjera, duke ruajtur sidomos morfemat fjalëformuese”. Parë nga ky këndvështrim autori ka meritën se në ligjërimin e tij estetiko-shkencor arrin në përfundimin se sqarimi i enigmës pellazge nuk ka të bëjë me zbehjen e shkëlqimit të kulturës greke. Dhe pikërisht për kontributin në këtë konferencë ai e quan

Melisën “Hirushja pellazge” (nga ka marrë edhe titullin romani) sepse nga martesë e dytë me Besianin ajo krijon një familje të denjë shqiptare në mes të Athinës. Në kuadrin e projektit për zbulimin e kulturës pellazge autori e konsideron historinë e kësaj familje një ilustrim autentik. Kjo sipas tij për faktin se: “Ashtu si familja pellazge, që pësoi katastrofë por mbijetoi me gjuhën shqipe si dhe në rrënjët e gjuhëve të tjera, edhe familja Lisi, pësoi katastrofë, por u trashëgua dhe po lulëzon”. Dhe pikërisht këtë lulëzim e ringjallje autori shprehet se do të donte edhe për kulturën e gjuhën pellazge.

Ky roman merr një rëndësi të veçantë edhe për faktin se subjekti i tij dhe zhvillimi i ngjarjeve në të, janë në unison me zhvillimet e fundit të shkencës ndërkombëtare e cila njohu zyrtarisht origjinën 6000 vjeçare të gjuhës shqipe, si një ndër tri gjuhët më të vjetra indo-evropiane.

Si përfundim mund të themi se vlerat e këtij romani konsistojnë në kontributin e Dr.Astrit Gjunkshit, një autor mjaft produktiv e cilësor në fushën e letrave, për mbrojtjen e pellazgjishtes shkencërisht dhe artistikisht.

<http://www.panorama.com.al/pse-nuk-zbehet-shkelqimi-i.../>

EKZAMINIMI I DIKTATURËS NË ROMANIN “DOKTORESHA” TË AUTORIT FLAMUR BUÇPAPAJ

Shkodra, metropoli i Shqipërisë së Veriut, e cilësuar nga personalitete kombëtare e ndërkombëtare si “djepi i kulturës shqiptare”, pasi këtu arti dhe kultura kanë shtëpinë e vet, do të ishte frymëzimi i shkrimtarit Flamur Buçpapaj për romanin e tij të ri, “Doktoresha”. Pikërisht nga ky qytet, i njohur për qëndresën antikomuniste, ku kaloi një pjesë të konsiderueshme të rinisë së tij, autori F. Buçpapaj, si një nga drejtuesit e Lëvizjes Studentore ‘90, do të skedonte ngjarjet dhe personazhet. I fokusuar te gjenocidi i pashembullt që sistemi komunist ushtroi ndaj elitës shkodrane, autori ka skalitur mjeshtërisht profilet e personazheve kryesorë, dy profesorë të diplomuar në Austri dhe vajzën e njërit prej tyre “doktoreshë Zanën”, duke i bërë si askush tjetër autopsinë sistemit të kaluar diktatorial në Shqipëri e duke i dhënë kështu lexuesit një roman mjaft tërheqës.



ELIMINIMI, DENIGRIMI DHE SHPËRFILLJA E ELITËS

Në Shkodër, ku elita intelektuale gjatë regjimit komunist është burgosur dhe pushkatuar, dy profesorët e nderuar Martini dhe Leka, vuajnë brengën e eliminimit e denigrimit të shokëve e miqve të mbetur si dhe shpërfilljen e tyre nga të pashkollët që kishin marrë frenat e pushtetit. Pikërisht nga këtu nis subjekti i këtij romani. Ata janë dy aristokratë që arrijnë t’i mbijetojnë sistemit, falë aftësive të tyre, si të pazëvendësueshëm: Martini në bankën e qytetit dhe Leka, ndër profesorët më të aftë të gjimnazit dhe të institutit dyvjeçar. Autori jep detaje nga takimet e shumta të dy miqve të pandarë

që nga fëmijëria, shkollimi, si ish-studentë të shkëlqyer në Graz të Austrisë (Martini për financë dhe Leka për matematikë). Madje, pikërisht nga këto takime ai ndërton dialogë që të mbeten në mendje.

“Ka mbërritur antikrishti... Dhe është mallkimi i Zotit mbi Shqipërinë tonë sa një pëllëmbë... Kush ka mbaruar jashtë, ose dënohet, ose internohet. Këta i përmbysën të gjitha dhe tani jemi kolektiv. S’ka fe, familje, atdhe... Këta janë masonë, janë vëllazëri ujqërish...”. Këto janë në thelb bisedat që zhvillohen në fshehtësi mes dy profesorëve, që autori i vendos nëpër kafene të ndryshme të Shkodrës, për t’iu ruajtur zbulimit nga ish-Sigurimi. Është koha kur janë dënuar me pushkatime e burgim priftërinjtë e Shkodrës dhe i njëjti fat i priste edhe ata që zbuloheshin ose etiketoheshin si antiparti. Gjithsesi, gjithkush rreth e rrotull tyre do të habitej me mënyrën e të sjellurit prej aristokratësh. Në këtë kontekst, autori evidenton zakonet aristokrat, sipas të cilit “në Shkodër e pinin kafënë ngadalë dhe duke bërë muhabet, zakon ky i aristokracisë shkodrane, e cila për qytetari kishte emër të mirë, e”. Kësisoj do vepronte edhe Martini që kishte trashëguar shumë prona, toka, dyqane (por që ia konfiskuan) dhe sjelljen dhe moralin e një njeriu të madh me origjinë dhe prejardhje fisnike shkodrane.

Autori ka meritën e përcjelljes të lexuesit të mesazhit se ishin pikërisht të shkolluarit jashtë që ndikuan në ruajtjen e atyre pak institucioneve të domosdoshme edhe për atë sistem, falë aftësive të tyre profesionale. Kështu, Martini, që për t’i shpëtuar ndëshkimit kishte divorcuar dhe përcjellë për në Itali bashkëshorten e parë italiane, do të ishte i vetmi specialist që do të “riparonte” gabimet e pallogaritshme të të pashkollëve të punësuar në Bankën kryesore të qytetit. Ndërkohë nuk do të nguronte që në bashkëbisedimet e fshehta me profesor Lekën të shfaqte pasigurinë: “Se kjo shoqëri e kafshëruar komplet s’do të mbijetojë, sepse do të përhapet më shumë imoraliteti, homoseksualizmi, sëmundjet ngjitëse, tradhtia bashkëshortore, degjenerimi i familjes, e cila s’thuret dhe nuk përmban njësinë themelore të shoqërisë, por s’thurje totale...”. Ndërsa Leka i prezantohet lexuesit si profesori perfekt, me aftësi të rralla profesionale, që megjithë ndërhyrjet s’toleron te nota as fëmijët e nomenklaturës komuniste.

KOHA KUR LAVAZHI I TRURIT KISHTE MARRË PËRMASA GJIGANDE

Për gjenocidin e pashembullt komunist në Shqipëri janë shkruar disa romane, novela e tregime, por Flamur Buçpapaj ka meritën se artistikisht, si askush tjetër, jep pasojat e pallogaritshme të atij sistemi që solli mjerim dhe varfëri të tejskajshme. Duke përshkruar qartë e bukur në faqet e romanit realitetin e trishtë të afro gjysmëshekulli të sundimit komunist, ai qëllimisht i kundërvë klasës sunduese mendimin progresist të dy profesorëve aristokratë. Ndaj jo pa qëllim ai vë në gojën e tyre argumentin dhe bindjen se “Nuk mund të mbijetojë një ekonomi kaq e vogël, duke u bazuar në forcat e veta, sepse s’ka treg, s’ka ofertë, s’ka para në qarkullim, se fuqia blerëse është shumë e vogël... janë copa kafshësh me dy sy...”. Dhe po në këtë kontekst, me gjuhë të pasur e mjete shprehëse interesante autori evidenton pasojat e pallogaritshme që sollën eksperimentet bajate me kolektivizimin e bujqësisë, arëzat e tufëzat që varfëruan skajshëm fshatarin shqiptar të atyre viteve. Dhe të gjitha këto bëheshin në emër të krijimit të të ashtuquajturit “Njeriu i ri”.

Dështimin e atij sistemi autori e argumenton edhe me infrastrukturën e rëndomtë, ku jo pa qëllim vë në gojën e njërit prej personazheve konkluzionin se: “Ka thujse njëzet vjet pushtet popullor dhe rrugët e Shkodrës janë krejt gropa. Futu në lagje, të mbyt pislleku, pallate me punë vullnetare ngrihen si shëmti..”.

Për të qenë sa më bindës në artikulin e atij realiteti trishtues, autori sjell në vëmendjen e lexuesit në një nga dialogët mes profesorëve, konkluzionin e tyre se: “Njeriun e ri po e rritin të mangët nga truri dhe, kur të vijë koha të udhëheqin këta të rinjtë e sotëm, kush e di se ç’do të bëjnë? Gjynah për Zotin, për këtë vend, për këta njerëz që po shkojnë me kaq vrull drejt kolektivizimit, bile do të vijë koha që dhe gratë t’i kemi bashkë...!”.

Për të përligjur faktin se ai sistem sillte vetëm varfëri dhe sundim nga i pashkolluari dhe i ligu, autori bën analogji me fqinjët për rreth, si për shembull me Malin e Zi, ku kishte zhvillim intensiv të turizmit dhe me tërë ish-Jugosllavinë ku sistemi i vetadministrimit qe favorit për fshatarët, ndërkohë që pasaporta e qytetarëve jugosllavë ishte aq e vlefshme sa me

të mund të emigroje lirshëm ku të doje, deri edhe në Amerikë. Në kohën që tregtarët shkodranë i njihte gjithë bota, në Shqipëri eksperimentohej fenomeni i lavazhit të trurit, i cili kishte marrë përmasa gjigante.

“DOKTORESHA, PERSONAZHI MË I SPIKATUR I ROMANIT”

Doktoreshë Zana është padyshim personazhi më i spikatur i këtij romani. Ajo është vajza e profesor Martinit, e cila nga autori përshkruhet si një bukuri e rrallë, trupgjatë, syzezë, me tipare si të bëra me dorë... Dhe pikërisht nisur nga këto tipare, profesor Martinit që e ka dobësi, i duket se i ngjet motrës së tij. “Zana është bukuri përrallore... Është një fëmijë i mirë... E ka bërë Zoti engjëll... Vetëm studion. Është tipike raca ime, krenare, e bukur dhe e zgjuar...”, kështu e profilizon autori këtë krijesë të magjishme, gjithnjë në gojën e babait të saj, që vuan brengën se ajo herë pas here çalon në njërën këmbë.

Ndonëse bijë e një aristokrati që survejohej për t’u burgosur apo internuar, Zana përshkruhet si një studente ekselente në mjekësi, ndërkohë ishte shumë e bukur, po bukurisë së saj i ishte shtuar dhe vlera e zgjuarsisë dhe ndershmërisë. Dhe duke vijuar në përvijimin e tipareve të bukurisë së kësaj “zane”, autori vë në gojën e babait të saj dashurinë e pakufishme për të: “Unë e dua Zanën time... jap jetën për të. Zoti e ka qëndisur me dorë. Ajo është krijesë mistike, e zgjuar, e bukur, njeriu më i mirë në tokë. Zoti e krijoi dhe e solli tek ne... Një vajzë simpatike, e gjatë dhe gjithë dhjeta në mësim. Çdokush do të habitej nga gërshetimi i bukurisë me inteligjencën. Një kompozim i rrallë që vështirë të përsëritet më...”. Kjo edhe për faktin se Zanës mësimi në gjuhë të huaj i dukej si në shqip, sepse fliste katër gjuhë të huaja shkëlqyer dhe i shkruante ato fiks... gjuha e saj më e preferuar, pas shqipes ishte gjermanishtja. Trilli i autorit është mjaft tërheqës kur këtë perëndeshë të bukurisë, jashtë vullnetit të babait që e kishte porositur të dashurohej me një djalë larg influencave partiake, pa pritur e përshkruan si të dashuruar marrëzisht me djalin e vetëm ‘kadet’ të ish-kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Shkodrës. Në fantazinë e F. Buçpapajt nuk është thjesht një akt dashurie dhe kurorëzimi në fejesë i tyre, por dhe ndikimi i Zanës tek i dashuri që ai të kuptonte pasojat e atij sistemi, që gjithsesi do të dështonte. Madje, jo vetëm kaq, por pikërisht në këtë linjë F. Buçpapaj

di të përveçojë edhe faktin se edhe në atë sistem (kur kuçedra hante bijtë e vet) kishte kuadro deri funksionarë të lartë, si ish-kryetari i Komitetit Ekzekutiv apo ish-drejtori i Bankës, që ndonëse të indoktrinuar, kishin krijuar bindje në mos eficiencën dhe fundin e dështuar të atij sistemi.

KONCEPTET BASHKËKOHORE PËR DASHURINË

Ndryshe nga dhjetëra autorë që dashurinë e identifikojnë me erotizmin, F.Buçpapaj nuk nguron që në këtë roman të shpalosë konceptet bashkëkohore. Kështu, përballë hezitimit të profesor Martinit për ta fejuar doktoreshë Zanën me djalin e një funksionari të lartë komunist, ai i referohet përvojës jetësore, sipas së cilës s'ka gjë që ndalon një dashuri, qoftë baballarët apo nënat. Gjithsesi, edhe në këtë rast nuk lë jashtë kontekstit shqetësimin prindëror se: "Të rinjtë s'duan t'ia dijnë për pasojat e dashurisë, s'ia dijnë rëndësinë humbjes fare". Dhe po në linjën e koncepteve bashkëkohore për dashurinë autori shkruan se "Dashuria është si sëmundja e kolerës që përhapet në ajër dhe s'ke asnjë mundësi shpëtimi, sepse s'rri dot pa ajër dhe pa oksigjen. Nëse fëmija dashuron, s'ka rrugë tjetër veç t'i thuash "urime". Këto koncepte F.Buçpapaj i përçon te lexuesi, duke i vënë thjesht dhe bukur, herë në gojën e profesor Martinit dhe herë në atë të fejuarit të doktoreshë Zanës, Ditmarit, djalit të ish-kryetarit të komitetit... Le të perifranojmë disa fragmente kur autori shpreh filozofinë e tij për dashurinë: "Askush s'e ndalon dritën e diellit dhe lidhjen e të dashuruarve të bashkohen bashkë. Është më keq se tërmeti dhe vuajtjet më të mëdha në tortura...Dashuria është e vetmja forcë që depërton kudo në hapësirën e lirë... Është dhe në Bibël: Njerëzit që dashurojnë janë pranë Zotit dhe Zoti ua ka hapur derën për në shtëpinë e tij diku lart në qiell, në pafundësi..."

Madje, jo pa qëllim autori e "vetësakrifikon" të fejuarin e Zanës në emër të dashurisë, i cili pasi i kanë pushkatuar babain (ishkryetarin e Komitetit, ku si edhe në dhjetëra raste kuçedra ha bijtë e vet) kryen aktin e guximshëm të minimimit dhe të hedhjes në erë të godinës së ish-Komitetit të Partisë dhe vetëvritet pasi i ka shprehur doktoreshë Zanës dashurinë e përjetshme edhe në botën e përtejme... Ndërsa ajo do të qëndrojë stoike edhe kur e denigrojnë, duke e transferuar si infermiere në një fshat të largët të Shkodrës.

KOHERENCA ME REALITETIN OBJEKTIV

Ndonëse ngjarjet dhe personazhet u përkasin viteve ‘60-‘70 të shekullit të kaluar kur në Shqipëri u instalua sistemi monist, autori F.Buçpapaj ka meritën e artikullimit të tyre në koherencë me realitetin objektiv. Kështu, jo pa qëllim ai vë në gojën e prof. Martinit konkluzionin se “Edhe po iku komunizmi s’ia vlen më, sepse trendi është që të jenë prapë këta. Se atdheu është i këtyre dhe janë mjeshtra manipulimi...v Po erdhi Amerika, këta do të fitojnë prapë. Do të thonë, i tillë ishte regjimi. Ne jemi me Ju. Dhe ne që u dënuam për Amerikën, prapë do jemi në opozitë... fq.188). Po nën këtë optikë e sheh dhe transmeton ai edhe konceptin e luftës për ekzistencë, që sipas tij është gjithmonë lufta më e tmerrshme se çdolloj beteje frontale.... Madje, nga kjo betejë do ta pësonte edhe Kudreti, ish-kryetari i Komitetit Ekzekutiv, i cili, ndonëse që edhe kandidat për Anëtar i Byrosë Politike, ra viktimë e shpifjeve dhe veprimeve supletive të sekretarit të parë që gënjente kudo me shifra fiktive, merrte rryshfete, merrte para për emërimë... Kjo për faktin se lufta për ekzistencë i kalonte dhe kufijtë e gjakut. Ndaj dhe i mëshon familjes që qëndron në themel, si baza e ekzistencës së botës së qytetëruar.

Në këtë roman, F.Buçpapaj prezantohet edhe si mjeshër i rrallë në përshkrimin e peizazheve, si në rastin e lokalit në Shirokë, ku u bë ceremonia e ngushtë e fejesës së Zanës me Ditmarin.

Flamur Buçpapaj (që me këtë roman prezantohet edhe si njohës perfekt i shkencave ekzakte në zbatimin e elementeve përjashtues në ekuacionet termike dhe aerodinamike..... dhe i historisë, si në rastin e historikut të spitalit të Shkodrës që daton në vitin 1891 kur shkodrani Kol Kryqi ose Kryçi la për shpirt bamirësie shtëpinë e tij për spital...dhe se deri më 1928 spitali është administruar nga bashkia e Shkodrës dhe, mbas këtij viti nën administrimin qendror shtetëror....), pas botimeve të romanit “Martesa e dytë”, vëllimit me tregime “Shiritat”, tri dramave për kukulla dhe studimit “E kaluara morfo-arkeologjike e rrethit të Tropojës, qyteza ilire e Rosujës”, si edhe dy vëllzërit e tij Skënderi e Mujo – poetë, studiues e analistë, ndër më të mirët në rang kombëtar, hyn me dinjitet në historikun e fondit të artë të letrave shqipe.

HALIL RAMA

III.
POEZIA

HYSNI BRUÇI, SI MODEL I POETIT KOMBËTAR

Për librin e tij “Krojet e këtyre viseve thonë”, me tetë cikle me poezi



Libri “Krojet e këtyre viseve thonë”, me tetë cikle me poezi, i poetit Hysni Bruçi, është një prurje krejtësisht e veçantë dhe mjaftë cilësore në botimet me poezi të tri dekadave të fundit. Si njohës i thellë i historisë, kulturës dhe traditës dibrane, vlerat madhore të tyre i reflekton në poezinë e tij, të shkruar jo në një ditë, një vit apo një dekadë, por që në rininë e tij të herëshme të viteve ‘60-’70-të të shekullit të kaluar.

Vetë titulli i librit “Krojet e këtyre viseve thonë” është intrigues dhe të josh për ta lexuar. Po ashtu edhe titujt e cikleve: “Si sylynjare”, “Fshati rrëzë malit me pisha”, “Ankohen varret”, “Lisnaja përcjell mesazhe”, “Lulezodat e lirishtave të Runjës”, “Nëpër tërmete”, “Vite lufte” e “Dhe thonë rapsoditë”. Një lëndë aq e pasur dhe e larmishme si dhe vetë poezia e këtij liriku, që pas akumulimit të tij në pesë dekada sjell për lexuesin poezi që u shkrumbëzuan dhe u hirnosën, ndoshta të ndryra në sirtaret e tavolinave të tij të punës si mësues, redaktor letrar në “Ushtima e Maleve” e inspektor i kulturës në ish-Komitetin Ekzekutiv të Dibrës...apo në sepetet e shtëpive të tij në Lukan, Muhurr e Peshkopi, dhe që dalin në dritë me një shkëlqim të rrallë.

Mjaftojnë qoftë dhe pak vargje nga poezia me titull “Bora e gjakut”: “Ra bora e gjakut/ Dhe vatrën e prindërve/ E rralloi,/Berimin e vëllazërisë/ E përcolli/ E mpiksi/ Gjakun e probatinëve/Duarshtërngimin/ E ngriu dhe krisi...” për të konkluduar se si drithëron pena e këtij poeti, teksa percepton dhe fshikullon zakonin shfarosës.

Po ashtu tek cikli “Fshati rrëzë malit me pisha”, dallojmë poezinë lirike, si pjesë e rëndësishme e komunikimit dhe shprehje e botës së brendshme të autorit drejt lexuesit. Më e dukshme kjo tek poezia “Ngjyra, rreze, zëra”: “Në livadhe kanë dalë luledelet/ Ka filluar cijatja në zabele/ Në shtrunga sa s’derdhet kulloshtra/ Gjallojnë vathët prej shqerrave.../....Në dyqan të fshatit/ mbesën e vogël çova/ Fletorkë të re të më blejë/ Për vjersha...”

Në tërësinë e këtij libri me 99 vjersha, Hysni Bruçi shfaqet si njohës perfekt i poezisë dhe veprave letrare në tërësi të Fishtës, Mjedës, Koliqit, Migjenit, Kutelit, Spasses, Kokonës, Dritëroit, Moikom Zeqos, Preç Zogajt, Shafki Karadakut, e tjerë, teksa na jep në këtë libër nuanca të dallueshme kulturore, në përputhje harmonike me zellin e tij studjues e krijues, me frymëzim nga “lulezojet e lirishtave të Runjës” apo dhe nga rapsoditë, që evokojnë dhe përcjellin ndër brza qëndresën e dibranëve në luftrat shekullore për liri e pavarësi kombëtare. E pra, ndonëse shumë poezi i shkroi në vitet e sistemit të kaluar, Hysni Bruçi ka ditur t’i shmangët ndikimit të realizmit socialist, duke krijuar poezi me lëng e klorofilë, plot dritë e perspektivë në horizont. Le të ndalemi për ta konkretizuar këtë tek poezia “ATDHE” e ciklit “Lisnaja përcjell mesazhe”: “Ushqyer këtë fjalë fëmijës/ Me ninullat e qumështin e gjirit;/ Është zemra tek fjala Atdheu/ Fluturimi i dallëndyshes/ E foleja e skifterit.../ Është shamia e zezë e nënës/ E rrukullima e lotit të jetimit,/ Është çfarë ka sofrë/ E të zotit të konakut,/ Është edhe/ Pena e Dritëroit/ E huta e Dedë Gjo Lulit...”

Nga tërësia e lëndës voluminoze, por edhe mjaftë cilësore e këtij libri, mund të konkludojmë pa asnjë mëdyshje se Hysni Bruçi është model i poetit kombëtar, ndaj duhet marrë si shembull që duhet ndjekur nga të rinjtë. Poezia e tij është e mbështetur në tabanin kombëtar dhe qëndron larg të ashtuquajturave skema të realizmit socialist.

Me këtë libër ai vjen si një xhevahir i ri, i rrallë, në gjerdanin e poezisë shqipe, të krijuar nga mijëra poetë shqiptarë ndër vite e shekuj.

PO KUSH ËSHTË HYSNI BRUÇI (PËR ATA QË NUK E NJOHIN NGA AFËR)?

Në vitet '60-'70-të të shekullit të kaluar, në faqet e gazetave e revistave, të përditshme, javore e të përmuajshme periodike që botoheshin në Tiranë, do të tërhiqte vëmendjen firma e mësuesit Hysni Bruçi nga Muhurri i Dibrës. Publicistika e tij po zinte vend të rëndësishëm në gazetën "Zëri i Popullit", "Mësuesi", "Bashkimi" etj. Po ashtu në rubrikat letrare-artistike të gazetave "Drita", "Zëri i Rinisë" e "Puna" si dhe të revistave "Nëntori" e "Ylli" ai do të shfaqej, jo vetëm me reportazhe e skica letrare, por edhe me vjersha e poema.

Mësuesi i lëndëve gjuhë shqipe – histori në shkollën 8-vjeçare "Nexhat Agolli" Muhurr, në vitet 1960-1961, që kishte shërbyer edhe në shkollat e zonave Luzni e Kastriot si dhe me klasë kolektive në Rreth-Kale e Shqath (që kishte mbaruar me rezultate të shkëlqyera Shkollën e Mesme Pedagogjike "Ndrec Ndue Gjoka" në Tiranë e më pas edhe Shkollën e Lartë dy vjeçare pa shkëputje nga puna), do të shpërthente si një talent i rrallë në krijimtarinë poetike të asaj kohe.

Ndërkohë, që nga të parët që u angazhua me Lëvizjen Amatore në fshat. Ai kishte lindur në Lukan, por u rrit e u mirëformua në Muhurr, që ishte vendlindja e nënës së tij. Këtu mori arsimin fillestar dhe po nga Muhurri nisi rrugëtimin e tij të gjatë në fushën e mësuesisë, letërsisë, artit e kulturës. Pasi kishte spikatur për talentin e tij si poet me vjershat e poemat e botuara në shtypin qendror, Hysni Bruçi mori pjesë edhe në përgaditjen e Almanakëve të parë letrarë "Dibra".

Që me fillimin e botimit të gazetës lokale "Ushtima e Maleve" nisi të punojë aty, një vit si korrektor letrar e pastaj për disa vite si redaktor për kulturën e punën me talentet e reja letrare.

Në gjysmën e dytë të viteve '70-të, në Dibër po bëhej një hop përpara për gjallërimin e jetës artistike dhe kulturore dhe gazeta "Ushtima e Maleve", sektorin e kulturës të së cilës e drejtonte Hysni Bruçi pati ndikim të dukshëm në nxitjen e promovimin e talentëve të reja. Madje, që këtu u evidentuan dhe u tërhoqën në institucione njerëz të pasionuar e të

përkushtuar.

Në mars të vitit 1978 fillon punën në sektorin e kulturës të Komitetit Ekzekutiv, ku dha një kontribut të çmuar për organizimin dhe masivizimin e artit e kulturës në rrethin e Dibrës. Ishte koha kur u arrit që Estrada e Peshkopisë të klasifikohet “profesioniste” dhe të krahasohet me të Korçës, Sarandës dhe të Fierit. Ajo arriti të realizonte katër premiera në vit dhe të përfaqësohet denjësisht edhe në eventet kombëtare. Pasurimi i orkestrës së saj me instrumentistë të shkolluar të oboes, flautit, trombës, violinçelit etj, është padyshim edhe meritë e Hysni Bruçit që drejtonte sektorin e kulturës në Komitetin Ekzekutiv të rrethit. Ai inkurajoi dhe mbështeti muzikantë të talentuar që të krijonin e drejtonin grupe të ndryshme artistike. Në Lëvizjen Artistike u përfshinë këngëtarë që bënë emër brenda e jashtë vendit. U rrit profesionalizmi në trupën e aktorëve e të regjive të shfaqjeve; u rrit niveli artistik edhe me skenografinë e shfaqjeve.

Gjatë kohës që Hysni Bruçi drejtonte Sektorin e Kulturës në Komitetin Ekzekutiv të rrethit u krijua edhe Trupa e Teatrit Dramatik Amator që realizonte dy deri në tri premiera në vit. Vatër e argëtimit të fëmijëve u bë Teatri i Kukullave. Orkestra Frymore e qytetit të Peshkopisë arriti të marrë çmimin e dytë në takimin kombëtar të Korçës. Shtëpia e Pionierit po bëhej shkollë për përgatitjen e talenteve të reja. Dega e Librit, me çeljen e 16 librarive në fshat e në qytetet Peshkopi e Bulqizë përmirësoi dukshëm punën me librin. U krijua edhe Dega e Monumenteve të Kulturës. U ngrit edhe Ansambli Artistik “DIBRA” (që fatmirësisht e ruan edhe sot këtë emër), i cili arriti të japë shfaqje të suksesshme edhe jashtë vendit, si në Turqi, Prishtinë, Shkup etj. Hysni Bruçi pati rol parësor edhe në formimin e Shoqatës së Historianëve si dhe të Bërthamës Arkeologjike të rrethit të Dibrës. Puna studimore solli edhe riorganizimin e Muzeut Historik dhe ngritjen për herë të parë të Muzeut Etnografik të rrethit. Sipas një programi të posaçëm pune të Sektorit të Kulturës në Komitetin Ekzekutiv që drejtohej nga Hysni Bruçi, u ngritën Muzeu Tematikë në Dovalan, Sinjë, Okshtun, Bulqizë, Ostren, Lurë, Zerqan, Zogje e Kastriot. Po bëhej praktikë pune që çdo vit të organizoheshin sesione shkencore në zona.

Në tetor 1978, u zhvillua Konferenca e Parë Shkencore e rrethit për çështje të historisë e kulturës të Dibrës. Për herë të parë aty u paraqit projekt-ideja për Rrugën e Arbërit, që po bëhet realitet në vitet e demokracisë, falë

edhe rolit determinant të gazetës me të njëjtin emër “Rruga e Arbërit” dhe Lidhjes së Intelektualëve Dibranë.

Në ato vite, Rrethi Letrar i Dibrës fitoi statusin e Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të rrethit. Dhjetëra krijues dibranë që tanimë kanë botuar edhe librat e parë me poezi e tregime, debutimin e parë e patën në gazetën lokale “Ushtima e Maleve”, në kohën kur sektorin e artit, kulturës e letërsisë e drejtonte redaktori i talentuar Hysni Bruçi.

Për piktorët e skulptorët u dhanë 9 studio. Sektori i Artit Figurativ arriti që çdo vit të çelë ekspozitë. Punët e disa piktorëve dibranë zinin vend në ekspozitat vjetore kombëtare. Masivizimi solli që disa qendra pune e shkollat të ngrenë grupet artistike.

Të 26 shtëpitë e kulturës në zona arritën të ngrenë grupet folklorike me 50-60 pjesëmarrës. Në orkestrat e tyre hynë edhe instrumente të rrallë muzikorë si: gajdja e Klenjës, kavalli i Kastriotit, fyjet e Selishtës, lauria e Murrës, culet e Venishtit e Palamanit, sharkia e Çidhnës, pipzat e Lurës etj. Hysni Bruçi tregon se orkestra e grupit folklorik të Çidhnës kishte rreth 30 instrumentistë.


Po ashtu ai vlerëson krijimin dhe interpretimin e valleve si: vallja e brezave, vallet lirike të Grykës së Vogël e të Kalasë së Dodës, vallja e Xhafer Kabës, vallet dyshe të burrave të Zall Dardhës, Muhurrit e Maqellarës, vallja këmbë mbas këmbë e Katër Grykëve, Vallja “Hore” e Sllovës, vallja humoristike e Pollazhanit, etj. Shpërthyen këngë brilante si: “Na knojnë pushkët nëpër kulla”, “Shtatë liqejt e Lurës”, “300 duvakët”, “Këngë për Mahmut Dacin”, këngët epike për Kosovën (“O prite Azem Galicën”, “Këngë për Jakup Ferrin”) etj. Emra këngëtarësh të tjerë dibranë u bënë të njohur e të dashur për artdashësit brenda dhe jashtë vendit Vlerësimi i mëtejshëm i punës me folklorin, për të cilin H.Bruçi tregoi përkushtim të rrallë, bëri që Dibra të marrë vendin e parë në Festivalin Folklorik kombëtar të vitit 1978.

Hysni Bruçi ka realizuar edhe kumtesa e studime për çështje të historisë e kulturës së kësaj treve. Ato janë referuar në Sesione Shkencore e disa janë botuar në revista e organe shtypi. Të tilla kanë qenë: “Tema e Qëndresës në krijimtarinë e popullit”, botuar në “Dibra e dibranët”, “Vlera pedagogjike në Abetaren e Kolë Gjumarit”, botuar në gazetën “Mësuesi”, “Disa të dhëna historike për lidhjet e Dibrës me Qeverinë e Vlorës të 1912-tës”, mbajtur në

Konferencën Shkencore të Kulturës të rrethit (1978); “Mbi disa shkaqe e koncepte të mënyrës së jetesës” si dhe “Shkaqe e pasoja të thashethemeve”, botuar në “Zëri i Popullit”. Gjithashtu Hysni Bruçi ka realizuar trajtesa me vlerë, si: “Ornamenistika në kostumet e shtatë zonave etnografike të Dibrës”, “Instrumentistë në kohë që bënë emër dhe Orkestra Folklorike e Dibrës”, “Figura mëmëdhetare të Dibrës dhe çështje të simboleve përkujtimore”, “Zall Dardha – një nga djepet e folklorit të Dibrës”, “Rapsodia Dibrane dhe profile rapsodësh” etj. Do të mjaftonte qoftë dhe botimi në një libër i këtyre kumtesave, studimeve e trajtesave, të realizuara, të mbajtura në sesione shkencore e të botuara me firmën e Hysni Bruçit, për të kuptuar kontributin e tij të veçantë për zhvillimin e letërsisë, artit e kulturës në Dibër.

POEZIA E ALBAN BALËS, MAGJIA E FJALËS SË MAGJISHME

- Një poezi kushtuar Sokol Olldashit në vëllimin poetik “Orët e shtëpisë”
- Në gjithë lëndën e larmishme të këtij libri dallohet qartazi pasuria stilistike e vargut, ritmi e elementet e tjerë që i bëjnë vjershat e poemat mjaftë tërheqëse për lexuesin. Kjo edhe për faktin se “Orët e shtëpisë”, sjell një prurje krejtësisht të veçantë dhe mjaft cilësore në botimet me poezi të tri dekadave të fundit.



Gjashtë vëllime me vjersha e poema, tre libra me tregime, dy me novela dhe një roman, shkruar dhe botuar në harkun kohor të tri dekadave, janë një hop, jo vetëm sasior, por edhe cilësor i poetit dhe prozatorit Alban Bala. Dëshmi e këtij hopi janë edhe vetë titujt tepër domethënës të librave të këtij autori: “Semafor” (poezi – 1989); “Lermë të hesht” (poezi – 1993); “Vullkane të përgjumur” (tregime – 1994); “Çmendina” (novela – 1994); “Të verbërit” (tregime – 1994); “Ikje nga shtrati” (novela – 2005); “Ngjyra mbi det” (poezi – 2006); “Qyteti me sy të kuq” (tregime – 2009); “Dashuria e burrit” (poezi – 2013); “I dështuari” (roman– 2017); “Öpücükdua” (poezi – 2020, Turqi) dhe “Orët e shtëpisë” (poezi – 2023).

Në vëllimin “Orët e shtëpisë”, malli dhe dashuria për atdheun, prindërit dhe fëmijët, shprehur me mjeshtëri artistike, me një gjuhë të pasur dhe figuracion të zgjedhur poetik, herë si një trishtim i lehtë, herë si një klithmë e thellë shpirtërore, përshkon si një fill i blertë të 131 vjershat dhe poemat e librit. Në to vërshojnë mendimet dhe ndjenjat e gjalla të njeriut, përpjekjet e mundimshme të njerëzve për të ruajtur të paprekur dashuritë e tyre nga dora rrënimtare e së keqes. Më të dukshme këto në poezinë me titullin sinjifikativ “ATDHEU” : “Atdheu nuk është guri që mbaj në dorë/ Por grushti i mbledhur që shtrëngon gurin/ Është hobe’ që e kapa në ajër teksa ikte/ Për t’u ngulur mbi hijen time./ Tani e mbaj fort si një zog që po ta lëshosh/ Bie/ I pakrahë në gjurmët e errëta të atyre/ Që humbën rrugën, që ikën pa kthim/ Me duart bosh dhe me zemrën e thyer/ Atdheu ka formën e gishtërinjve/ Që sapo kanë zbuluar përmasën e pafuqisë...”.

Mjaftojnë qoftë edhe vetëm këto vargje për të vlerësuar peshën e mendimit filozofik në poezinë e Alban Balës. Evidente pesha e këtij mendimi edhe në poezinë “E PARA MBETET FJALA...”, për të cilën poeti shkruan se: “...sado që të them se të mendosh është virtyt/ Përsëri uë mbetem një njeri i arsyeshëm/ Që heshtjen ka cak si qefinin e bardhë/ Por fjala... fjala ishte e para.../ E para mbetet Fjala...”. Këtë sentencë, poeti Alban Bala e shtjellon artistikisht në gjithë shtratin e tij poetik me gjuhë të pasur e figuracione interesante e të larmishme në 200 faqet e librit “Orët e shtëpisë”. Kësisoj, magjia e fjalës së magjishme në poezinë e Alban Balës, të impresionon, të magjeps, të bën të dashurohesh pas saj. Dhe jo vetëm me vjershat e tij që trajtojnë temën e dashurisë, por dhe me ato që nëpërmjet vargjesh kuptimplote përcjellin dëshpërimin për ngjarje e kohë të trishta, si në poezinë me titull “**KËTU ËSHTË KALBUR EDHE KRYPA...**” : “Në këtë vend tash edhe krypa u kalb/Pemët sot i rrit veç frika e zjarrit./Fushat i mbollëm me hapa udhëtarësh/E rrugët me hijet e atyre që s’janë./Na ka mbetur ky vend e s’po dimë kujt t’ja falim...”.

Në këtë mënyrë, poezia filozofike e Alban Balës të ndihmon të kuptosh se si Ai e percepton gjer në thellësi dhimbjen njerëzore për këtë realitet të trishtë. Këtë perceptim të autorit e ndeshim dhe në vargjet e poezisë “RILEXIM I NJË LEGJENDE”: “Mesnata ra si hëna mbi mal/ Dhe mjegulla uli perdet mbi dritaren e lumit/ Ta kam falë Rozafë gjirin që s’më ngopi Kurrë./ Ta kam falë murin ku më mbylle/ Ta kam falë

botën që s'ë pashë, ta kam falë,/ Të gjitha t'i kam falë/ Kalatë që ngrite/
Përmbi lotin tim prej burri të mitur". A s'janë këto vargje refleksion dhe
në koherencë me realitetin e sotëm, kur shoqëria shqiptare lëngon nën
vargonjtë e kimit e korrupsionit... Këto vargje dëshmojnë perceptime
të poetit Alban Bala në momente të trishta të këtij udhëkryqi. Ai zgjedh
këndvështrime origjinale, në të cilat shoqëria e realiteti i sotëm jepen në
unitet e vazhdimësi. Kjo pohohet artistikisht përmes tablove e detajeve të
zgjedhura me kujdes edhe në poezitë me titull: "RIKTHIM NË PARAJSË";
"PËRTEJ RROKULLISEN VITET"; "NJË FËMIJË KËRKON LËMOSHË";
" PO VJEN STUHIA"; "KUR TA KUPTOJMË" (Kur ta kuptojmë se jeta
nuk zgjat/ Ka ardhur koha të ikim), si dhe në disa poezi të tjera.

Vargje mallëngjimi shkruan Alban Bala edhe për mikun e tij (dhe
timin) Sokol Olldashi: "Ishte vullneti i Zotit/ Ti ike si një jehonë/ Që unë e
dëgjoj ende/ Ike si ylli/ Nga sy dëshirash që tash sa mote zhgënjehen/ Ike
si një e qeshur që braktis buzët e fëmijës/ Për të mos ta trembur/ Ti ike si
e vërteta/ Nga zemrat...", vargje këto që shprehin mall pafund, dhimbje
pafund, pritje pafund të mikut e shokut që vepra e tij e veshi me pavdekësi.

HAIKU.....

Në këtë vëllim dallojmë edhe poezinë në formë HAIKU, si një formë
e veçantë e poezisë së Alban Balës, njëherësh, forma më e shkurtër dhe,
ndoshta, me e bukura e këtij libri. Sepse t'i flasësh lexuesit vetëm me tri
vargje që shprehin një botë të brendshme të magjishme ëshërë vërtetë një
magjepsje e poetit. Dhe nëse Haikun (e pastër) e gjejmë tek ai me titullin
"PIKTURE", ku vetëm me tri vargje autori filozofon për atë çka është hëna
sipas tij: "hëna e plotë/ shkruan himne lulesh/që bien...", elementë të haikut
gjejme edhe në poezinë me titull "REQUIM PËR VETEN" me dy strofa tri
vargjesh, si për shembull: "Ti shkove/ si një curril uji i bardhë/nga maja
e shkëmbit tënd drejt e mbi lule..." dhe më tej: "nuk ike/ veç shkove pa u
pare/si një vettimë që bie lart, shumë lart..."

Poeti shkruan kështu me art poezi që ndërtohet me tri linja ose tre
vargje që i referohen natyrës, nostalgjisë, të shkuarës, së tashmes sociale,
politike, filozofike, por edhe së ardhmes. Të kësaj linje janë edhe vargjet
e poezisë "FOTOGRAFI": "të bukurit, të dashurit, të gjallët,/të vdekurit

dhe motet/ dhe befaz gjithçka rizgohet..”, vargje këto ku triumfon dashuria mbi tendencën e fortë të prishjes së përhershme të kohës. Ky lajtmotiv ravijëzohet edhe në dy strofa tri vargjesh të poezisë me titull: “IKU DHE NJË VIT” : (1) “ iku dhe një vit nën shtrojat e syve/ tash malli ka një rrudhë më shumë/ dhe zemra një këngë më tepër... (2) “thinjat krehin erën me kujtesën e reve/ ngjyrë qumështi/ dhe mosha ime psherëtin për nënën...”. vargje këto që të drithërojnë zemrën. Është pikërisht ky pathos që të grish për të ecur gjithnjë përpara pa droje, pa iu dorëzuar forcës shkatërrimtare të vdekjes. Me shkrimin e kësaj forme poezie, Alban Bala kalon sprovën e aplikimit të një arti të vështirë (të fjalës artistike), duke ja shtrydhur dhe marrë gjithë lëngun e mundshëm çdo fjale.

.....DHE POEMAT

Pa dyshim, peshën më të madhe ideoartistike në këtë libër e mbajnë poemat: “NËNA ËSHTË GJALLË”; “MALLI PËR BABANË...”; “POEMË PËR TIM BIR” dhe “POEMA E NËNËS SË VDEKUR”. Kjo, si për hapësirën e tyre ideore, ashtu edhe për nivelin ideoartistik. Kështu, nëse te “POEMA E NËNËS SË VDEKUR” (KËNGË MUNGESË) poeti e shpreh mallin nëpërmjet vargjeve mallëngjyese: “Sa herë kthej nga rruga më lyp syni me të pà/Hap derën, të thërras, pres se mos përgjigjesh/Me shpresë se ikja jote ish vetëm një shaká/ Një lojë prej të rriturish...” tek “MALLI PËR BABANË...” thellësia e mendimit bëhet edhe më e qartë, sidomos në vargjet: “Ishe burrë prej atyre që nuk kanë nevojë ta thonë Se janë bërë burra/ Për ty kishte një jetë dhe asgjë për të humbur/ Ti ishe burrë/ Gjithë rrugët i kishe mbi lëkurë dhe dashurinë/ Mbi buzë/ Ti ishe burrë...”. Në këto vargje ndjehet trasfuzioni i gjakut. Kjo poemë trajton një subjekt serioz, atë të dashurisë e mallit për babanë. me mendime liriko-filozofike, me koncentrim të ngjeshur të figurës letraro-artistike që shpesh të pushton e të magjeps me frymëzimin e mesazhin e saj. Po ashtu edhe te “POEMË PËR TIM BIR” Alban Bala shpalos profilin poetik të një poeti me ndjeshmëri të lartë, me teknika vjershërimiti midis tradicionales dhe modernes e postmodernes, me një pasuri të begatë mjetesh dhe teknikash poetike, me struktura vargjesh e strofash të zhdërvjellëta, që e kthejnë formën në një procedim të mesazhit estetik. Mjaftojnë për këtë qoftë edhe vetëm vargjet: “Mbill’ zemrën me lulen e buzëve të tua/ Ushëto nëpër qeshje

si jehonë mbi jehona/ Beso duart e tua dhe gatitu për lojën/ E një moshe që nuk e njeh moshën/ Njome ujin me zjarre dhe fiki ëndrrat me britma/ Lidhe lumin si shall dhe fluturo përmbi pyje/ Shuaj yjet me frymë e vëre hënën mbi krye/ Mbill livadhin me sy e përqafoji gjithë hijet/ Si dielli me qeshje.../ Ka moshën tënde dielli/ Veç... dielli nuk ka kujtime...” .

Këtu poeti A.Bala shpalos ndjesitë e brendshme në raport me ndjenjën e shndërruar tashmë në muzën e përjetimeve poetike, pa të cilën nuk gjen qetësinë shpirtërore e me të cilën tundohet deri në pafundësi.

Në këto poema, si edhe në gjithë lëndën e larmishme të këtij libri dallohet qartazi pasuria stilistike e vargut, ritmi e elementet e tjera që i bëjnë ato mjaftë tërheqëse për lexuesin. Kjo edhe për faktin se “Orët e shtëpisë”, sjell një prurje krejtësisht të veçantë dhe mjaft cilësore në botimet me poezi të tri dekadave të fundit.

PËRTEJ KUFINJVE

Kushtuar mikut tim Sokol Olldashi


Kufinj të e botës janë si vijat e dorës.
Tani duart e tua përqafojnë një botë tjetër
Një tjetër horizont të ulët mbi shpatulla
Dhe perëndimi është një ndajnatë e përjetshme.
Ishte vullneti i Zotit. Ti ike si një jehonë
Që unë e dëgjoj ende. Ike si ylli
Nga sy dëshirash që tash sa mote zhgënjehen
Ike si një e qeshur që braktis buzët e fëmijës
Për të mos ta trembur. Ti ike si e vërteta
Nga zemrat.
Por kufinj të e botës janë si vijat e dorës
Ku ta dije ti që fati shkruhet ndryshe
Përtej çdo kufiri ku koha ndalon
Përtej çdo dhimbjeje.
Harrova të ta them përpara se të shkoje:
Njerëzit nuk kanë lindur të fluturojnë!

Alban BALA – 21.11.2013

“S’di ç’ngjyrë kanë ditët atje”, libri i tretë i poetit dhe gazetarit të mirënjohur

JETËZIMI I NDJENJËS NË POEZINË E REXHEP POLISIT

- Si e vlerësojnë poezinë e R.Polisit poetët dhe përkthyesit e mirënjohur Perikli Jorgoni, Vasil Tabaku, Roland Gjoza, Beatrice Balliçi, Irena Gjoni e Aleksandër Bardhi



Dy poetë të mirënjohur, Perikli Jorgoni dhe Vasil Tabaku, në dekadën e fundit të jetës së tyre qenë ndër frekuentuesit më të rregullt të redaksisë të të parës gazetë opozitare shqiptare “Rilindja Demokratike”, ku pata fatin të punoj edhe unë për 13 vjet rresht. Jo vetëm si kontributorë me krijimtarinë e analizat e tyre të mirëfillta letrare në faqet e kësaj gazete, por edhe si mbështetës, inkurajues dhe promovues të talentëve të reja.

E kam të freskët në memorie, vlerësimin që P.Jorgoni i bëri kolegut Rexhep Polisi, ditën që kishte botuar një cikël me poezi në faqen speciale letrare të “RD”-së.

“Poezia juaj Rexhep, është jetësore, e ndjerë, e kthjellët dhe të befason. Përvoja si gazetar të ka mprehur shikimin, të ka bërë të jesh më jetësor e ta përqendrosh vëmendjen në thelbin filozofik të dukurive”, – do të shprehej ndër të tjera përkthyesi dhe poeti i mirënjohur Jorgoni në atë takim mes miqsh të poezisë.

Pak a shumë, të njejtin vlerësim do të shprehte edhe poeti i ndjerë Vasil Tabaku, për të cilin: “Poeti Rexhep Polisi vjen jashtë çdo skeme dhe jashtë çdo maniere poetike. Ai shfaqet si një njohës i mirë i figurës dhe ngjyrimit emocional të fjalës duke i dhënë asaj ngarkesën e duhur semantike me sens dhe masë me një ngjyrim magjie brenda”.

Kam qenë me fat që i njoha nga afër, kur punoja në këtë gazetë si redaktor i kulturës. Dhe ajo që më ka bërë përshtypje ishte sinqeriteti i tyre në vlerësimin e talentëve të reja. Ndryshe nga disa të vetëquajtur “të mëndhenj”, Jorgoni dhe Tabaku ishin miq të vërtetë të poetëve të rinj, çka dallohej jo vetëm në vlerësimin, por edhe në promovimin e tyre.

Pikërisht, këto veçori të spikatura, të evidentuara vite në parë nga këto dy poetë të mirënjohur si qartësia e mendimit, jetësorja, pasqyrimi artistik i ndjenjës nëpërmjet vargut “jashtë çdo skeme dhe jashtë çdo maniere poetike”, janë evidente thuajse në 86 poezitë e pesë cikleve të vëllimit të tretë të Rexhep Polisi “S’di ç’ngjyrë kanë ditët atje”.

“S’DI Ç’NGJYRË KANË DITËT ATJE”

Vargjet e kësaj poezie nga ka marrë titullin edhe vetë libri i tretë i këtij poeti janë vërtetë një shpërthim poetik i guximshëm.

“S’di ç’ngjyrë/ Kanë ditët atje;/ A djeg dielli,/Apo shtegton/ Bashkë me ty/ Në të tjera vise,/ Nëpër largësi?!/ S’di a gulçon deti,/ A ka stuhi/ Brenda teje?!/ Ndërsa ndjej/ Se dallgët/ I tërbojnë/ Ditët e mia, / Ujë bëhem krejt/ Dhe mbytem/ Nga dashuria...”

Një poezi Lasgushiane kjo, ku poeti R.Polisi shfaq ndjenjat e mendimet për të kapur të thellën, të gjrën dhe të largëtën. Krijimi i tij ka një linjë të pandërprerë të enëve të gjakut, që poezia e tij të marrë jetë. Kësisoj, nëpër dallgët mece të kohës, aty ku bashkëjetojmë, poeti qartëson të bukurën, të dhimshmen por edhe të pazgjidhurën.

Pak a shumë, të këtij profili poetik janë edhe 16 poezitë tjera të kapitullit të parë ***“Ftohtë në Tiranë”*** të këtij libri, ku poeti e përçon mesazhin edhe përmes titujve intrigues të tyre, siç janë: *“Fjalët”, “Edhe në dimër vjen pranvera”, “Grua”, “Bota më rrotullohet në duar”, “Ftohtë në Tiranë”, “Me ty në udhëtim”, “Diell i çoroditur”, “Shpërbërje”, “As dielli nuk ngroh”, “Më trego diçka për luftën”, “Pulëbardhat”, “Nënë”, “Kur ti nuk je”, “Kohë e pakohë”.*

“Gjithësia ndizet në flakë”, “Një qershezë” dhe “Mes dy botëve”..

Dhe ashtu si te “Ftohtë në Tiranë”, poeti vargëzon trishtimin: **“Mbuluar me tis trishtimi,/ Dita zvarritet e mpirë./ Ti ndrin si rreze agimi,/ Si pikë vese e dlirë...”**. Këtë ndjenjë e shpreh fare qartë edhe tek poezia “Kohë e pakohë” me vargjet impresionuese: **“Më mbyti kjo kohë e pakohë,/ Ky shi që bie me ngashërim,/ Mendime të lagura vërtiten/ Në qiellin pa ngjyrë,/ Ndërsa ajri mpikset në fytyrë...”**.

POEZI ME VLËRA TË MIRËFILLTA IDEOARTISTKE DHE NATYRSHMËRI TË THELLË POETIKE

I frymëzuar nga thënia proverbiale e presidentit të 16-të amerikan Abraham Lincoln: “Gjithçka që jam apo shpresoj se do të jem, ia kam borxh nënës time engjëllore!”, R.Polisi do t’i qasej si askush tjetër kësaj dashurie të pamatë. Mjaftojnë për këtë qoftë dhe vetëm këto vargje të poezisë “NËNË”: **“Është dimër/ Dhe fjalët kanë ngrirë,/ Nga qielli/ Si breshër më bëhen.../ Në ajrin e qelqtë/ Vizatoj portretin tënd/ Dhe thellë,/ Thellë,/ Së brenshmi/ Ndjej puhizën e ngohtë,/ Buzëqeshjen tënde/ Që më ngroh/ Në këtë natë polare...”**.

Dhe s’ka se si R.Polisi të mos i qaset edhe ndjenjës së dhimbjes njerëzore kur sjell në kujtesë pushkatimin e një gjeniu si Vilson Blloshmi, për të cilin ka shkruar profile in memoriam çdo përvjetor të asaj dite të zezë, jo vetëm për familjet e dy poetëve martirë dhe Bërzeshtën, por për të gjithë Shqipërinë, për fatin tragjik të pushkatimit të dy poetëve Genc Leka dhe Vilson Blloshmi nga regjimi komunist, pas një gjyqi politik farsë me prova të montuara. Kësisoj, teksa shkruan vargjet:

**“Unë s’kam qenë në Sahara,
As Vilsoni nuk pat shkuar;
Veç kur shkroi vargjet për të,
Fundin kurrë s’e kish menduar.**

**Çdo vargu plumba i lëshuan.
Poetin ndanë nga kjo jetë.
Mu në zemër e qëlluan...”
Saharaja, ç’ferr i nxehtë!”**

Poeti Rexhep Polisi padyshim që i qaset edhe kullës emblematike të Blloshmëve në Bërzeshtë të Librazhdit që qëndron hijerëndë dhe kreshnike. Kullë kjo, që ka parë mjaft tragjedi, por i ka rezistuar stuhive dhe furtunave për vite e vite me radhë.

Profilin krijues origjinal të Rexhep Polisit e dallojmë fare qartë edhe në poezitë e tre kapitujve të tjerë: *“Vjeshtën sonte do ta deh”, “Mes malesh pa kuptim” dhe “Më pushton me flokët e gjata”...*

Ashtu siç vlerëson shkrimtari dhe poeti Roland Gjoza, në dhjetra prej poezive të këtyre cikleve dallohet fare qartë vargu intim, i drejtëpërdrejtë, muzikal... si në vargjet: *“Ka ditë që s’jemi parë/ Dhe trishtueshëm/ Mendoj:/ Mos vallë ti s’je/ Si më parë,/ Apo ditët e mia janë/ Tjetërsoj?!/ Sjell ndërmend kohën e shkuar/ Rrahjet e zemrës në arrati.../ Çastet që fluturonin/ Harbuar,/ Mbështjellë/ Në ëndrrat pa kufi.../ Ka ditë që s’jemi parë/ Dhe ku të kërkoj,/ S’e di...”*

Më tej, nostalgjinë për vendlindjen poeti Polisi e përçon përmes meditimeve, duke afirmuar prirjen artistike drejt ndjeshmërisë shpirtërore dhe duke na dhënë imazhe poetike emocionuese si në vargjet e poezisë: *“SHKUMBINI”*.

**“Gjarpëron Shkumbini
Mespërmes shpirtit tim,
Shkumëzon uji i kristaltë
Dhe përmyt mallin jetim...”**

Në tërësinë e këtij vëllimi lexuesi do të gjejë poezi me vlera të mirëfillta ideoartistike dhe natyrshmëri të thellë poetike, ç’ka e “legjitimon” edhe analiza që i kanë bërë librit të tij disa poetëve të njohur me rrezatim mbarëkombëtar.

AUTORË TË NJOHUR VLERËSOJNË POEZINË E REXHEP POLISIT

Poezia e Polisit është jetësore, e ndjerë, e kthjellët dhe të befason. Përvoja si gazetar i ka mprehur shikimin, e ka bërë të jetë më jetësor e ta përqendroj vëmendjen në thelbin filozofik të dukurive.

PERIKLI JORGONI
Përkthyes, poet

Poeti Rexhep Polisi vjen jashtë çdo skeme dhe jashtë çdo maniere poetike. Ai shfaqet si një njohës i mirë i figurës dhe ngjyrimit emocional të fjalës duke i dhënë asaj ngarkesën e duhur semantike me sens dhe masë me një ngjyrim magjie brenda.

VASIL TABAKU

Poet

Rexhep Polisi ka profilin e vet origjinal. Vargu intim, i drejtëpërdrejtë, muzikal, me ngjyra të larushitura plot piskamë, ndjenja e masës, veçanërisht kjo e fundit, bëjnë atë që ne t’i rikthehemi poezisë së tij dhe të themi me bindje; është e bukur, e ndjerë e sinqertë.

ROLAND GJOZA

Shkrimtar, poet, Neë York

Poeti i vërtetë dallohet qartë, sidomos në krijimin e poezisë lirike, intime... Dhe poezitë e Rexhep Polisit krijojnë me të vërtetë gjendje shpirtërore që të emocionojnë.

BEATRIÇE BALLIÇI

Poete

I lexoj me kaq shumë kënaqësi poezitë e Polisit prej vitesh, kjo kënaqësi rrit vlerat si vera! Një poezi plot ndjesi, ku përcillet çdo vibrim shpirti!

IRENA GJONI

Poete

Poezitë e Polisit kanë identitet të qartë. Dhe kjo është vlerë!


ALEKSANDËR BARDHI

Poet

PËR POEZINË E AVNI NDREUT FOLI ELITA KRIJUESE DIBRANE

- Redaktori, Prof.dr. Gafur Muka, shprehet se në vëllimin “Gjurmë në fjalë” që hapet me poezinë “Elegji” kushtuar Haziz Ndreut, duket që vargjet janë shkruar me veneracion për gjithë veprën poliedrike të babait, nga i cili ai trashëgon fantazinë krijuese, ritmin marramendës dhe shpirtin poetik. Ndaj dhe krijimtaria poetike e Avniut është në rrjedhën e të atit, duke krijuar nëpërmjet saj një “odë poetike” brenda shtëpisë së babait

Opinionin i gjerë publik e ka njohur dhe e njeh më shumë si artist, si kërcimtarin e koreografin më të mirë të qindra valleve me motive nga të gjitha trevat e Shqipërisë e të arbëreshëve të Italisë. E njeh si ndër themeluesit e udhëheqësin artistik të të parit edicion të “Odës dibrane” dhe po ashtu si themeluesin dhe drejtuesin e Ansambilit Artistik “Haziz Ndreu”- Nderi i Kombit, ansambël ky që në 10 vitet e fundit ka fituar dhjetra çmime të para e trofe në festivale kombëtare e ndërkombëtare, si në Turqi, Ulqin, Shkup, Strugë, Kërçovë.... Ai është vlerësuar me titujt “Qytetar Nderi” i Peshkopisë, “Nderi i kulturës dibrane”, “Ambasador i paqes”, është dekoruar nga Presidenti i Republikës me titullin e lartë “MJESHTËR I MADH”. Ky është Avni Haziz Ndreu.... Pas gjithë këtyre atributiveve e titujve, Prof.Bujar Kapexhiu – Nderi i Kombit do ta kishte fare të lehtë fjalën e tij në promovimin e librit “Gjurmë në fjalë”: “Avni Ndreu edhe poet!”. Ndaj dhe në emër të Kryesisë së Shoqatës “Bashkësia Dibrane”, si kryetar i saj, po në këtë eveniment do t’i jepte Avni Ndreut “MIRËNJOHJE”, me motivacionin: “Për kontributin e tij të shquar në fushën e artit si koreograf i talentuar në Ansamblin Popullor



‘Hazis Ndreu’, në krijimin dhe zhvillimin e valles popullore, për suksesin e këtij ansambli në akivititetet kombëtare dhe ndërkombëtare, si fitues i shumë çmimeve dhe vlerësimeve për origjinalitetin dhe nivelin e lartë artistik’.

Por të premten e 11 nëntorit 2022, Avni Ndreu u promovua edhe si poet i shumëtalentuar. Për poezinë e tij foli elita krijuese dibrane.

Po. Në promovimin e këtij libri, (ku ka përmbledhur një të dhjetën e 1500 poezive të publikuara gjatë një dekade në faqen e tij në facebook, të komentuara e vlerësuara nga lexues të shumtë), sallën “UNESCO” të Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë e kishte mbushur plot e përplot elita krijuese dibrane..dhe pse jo edhe ajo kombëtare...dhe mes tyre dy deputetët e Dibrës Xhelal Mziu e Lavdrim Krrashi, kryebashkiaku Rahim Spahiu, prefekti Nexhbedin Shehu etj. Përfaqësues të saj e vlerësuan poezinë e Avni H. Ndreut si poezi bashkkohe të llojit e stilit të veçantë.

Njëri prej tyre, studjuesi i mirëfilltë i letërsisë, ndër kritikët letrarë më në zë në rang kombëtar, Xhezair Abazi-autor i librit famoz “Ezopi i Dibrës” siç di të vlerësoi vetëm Ai, foli gjerë e gjatë për dukuritë estetike në poezinë e Avni Ndreut.

NJË “ODË POETIKE” BRENDA SHTËPISË SË BABAIT

Prof. Dr. Gafur Muka, redaktor i librit “Gjurmë në fjalë”, padyshim që do të prezantonte në këtë event analizën më profesionale e kualitative. Sepse në gjykimin e tij, të shkruash poezi duhet ti krijosh ato nëpërmjet proceseve: ndjej, mendoj, mbushem, guxoj dhe ...shkruaj. Duke arsyetuar kështu, ai shpreh bindjen se: “Avniu e ka ndjerë poezinë që në fëmijërinë e tij, madje edhe menduar e recituar atë. Ai e ka dëgjuar fjalën poezi në një formë që pak veta kanë fatin ta dëgjojnë: kur donte të luante si kalama, kur i vinte për të qarë apo për të qeshur po si kalama atij i është thënë: pusho mor voc, lerë babën rehat se po shkruan! Dhe ai që po shkruante ishte Hazis Ndreu. Dhe Hazis Ndreu ka shkruajtur edhe poezi. Dhe Avni Ndreu i ka lexuar herët poezitë e tij. Ai i ka lexuar me zë e pa zë, i ka mësuar përmendësh, ua ka recituar edhe shokëve, kur ata ja kanë kërkuar një gjë të tillë. Dhe kështu, Avniu e gjeti poezinë qysh kur ka qenë kalama. Por ai e ka gjetur poezinë ashtu siç e shkruante Haziz Ndreu. Poeti ynë i sotëm ka dëgjuar t’ja vlerësojnë poezinë e të atit shoqëria e tij, pastaj lexuesit e

shumtë të poezisë së H. Ndreut deri dhe Dritëro Agolli. Në këtë klimë, Avniu ka filluar të krijojë vargje e strofa, të cilat gjithësi nuk ishin si ato të babait. Ndaj, ai edhe kur i shkruante i griste dhe përpiquej t'i harronte”.

Për redaktorin Muka, në vëllimin “Gjurmë në fjalë” që hapet me poezinë “Elegji” kushtuar Haziz Ndreut, duket që vargjet janë shkruar me veneracion për gjithë veprën poliedrike të babait, nga i cili ai trashëgon fantazinë krijuese, ritmin marramendës dhe shpirtin poetik. Ndaj dhe prof.G.Muka vlerëson që krijimtaria poetike e Avniut është në rrjedhën e të atit, duke krijuar nëpërmjet saj një “odë poetike” brenda shtëpisë së babait.

“Duke e lexuar vëllimin poetik ‘Gjurmë në fjalë’ konstaton që tematika e tij është fort e larmishme. Të duket se je futur në një bahçe me mollë dibre, ku jo vetëm pemët por edhe kokrat janë të ndryshme edhe në formë edhe në shije. Aty gjen patriotizmin, profesionin, politikën, dashurinë, idhnimin, pëlqimin, ironinë, llafin nën mutaf etj”, tha ndër të tjera gjatë fjalës së tij Prof.dr.Gafur Muka. Pasi e ka skanuar këtë libër, ai konkludon se “Poezia e Avniut është avniane (bio), është racionale dhe është e sinqertë. Poezia e Avniut nuk ka formatim tematik, nuk ka metrikë të ngurtë apo rimim standard e klasik. Ajo është poezi e ndjenjës spontane, e kualifikimit cilësor të ndjenjës, e konvergencës racionale poetike”. Po, prof.Muka ka të drejtë kur shprehet se “Edhe pse neve dibranëve kjo poezi na përthith si dibranë ajo është poezi përthithëse për të gjithë ata që shqiptojnë fjalën VENDLINDJE”.

POEZI ME NUANCA LIRIKE

Si autor i këtyre radhëve ndjehem i vlerësuar nga organizatorët e këtij event, për faktin që në programin e tij kishin planifikuar që edhe unë të shprehja vlerësimin tim për nuancat lirike në poezinë e Avniut.

Këto nuanca i ndeshim pothuajse në tërësinë e lëndës së këtij vëllimi me titullin sinjifikativ «*Gjurmë në fjalë*» . Ato na vijnë si : «*aromë luleshqerre e aromë lulebore/ shtruar në odat e burrave/ në të sertat kulla malësore...*» që në fillimin e librit, me elegjinë kushtuar Nderit të Kombit Hazis Ndreu – krenari dibrane dhe mbarëkombëtare, për vetë trashëgiminë letrare, kulturore, artistike e studimore, në shtratin e së cilës ecën mirëfilli, i biri

Avniu – Mjeshtër i Madh.

Ky poet tashmë i mirënjohur, pasi prej vitesh ka prezantuar krijimtarinë e tij në rrjetet sociale, e finalizon atë me këtë vëllim, ku në dhjetra poezi shfaq lirizmin nëpërmjet përjetimeve të veta si: gëzimeve, dëshirave, shpresave, vuajtjeve dhe zhgënjimeve.

Kësisoj, nuancat lirike dallohen në poezinë «*Ata sy/Ajo vetull harkuar/ Si gjerdan/ Trup e shpirt zbukuruar* ».. ku risi janë strofa me vargje dy e katër fjalëshe, poezi kjo e llojit dhe stilit të veçantë, mjaftë e pëlqyer dhe preferuar nga lexuesi.

Po në këtë linjë është edhe poezia «*QESH* », ku Avni Ndreu me nota lirike filozofon me të qeshurën, spse sipas tij :

« *E qeshura/ Dhe diellit/ i jep/ shkëlqim../ Jetës/ Hare/ Gaz/ kuptim...* ».

Por më të spikatura janë nuancat lirike në poezitë e identifikuara nga vetë autori, si të tilla, nga të cilat veçojmë ato me titull: «*FUSHA E KORABIT*», «*STINA E DASMAVE*», «*VALËZ E JONIT*», «*LIQENI MAGJI* », «*DILEMË BUKURIE*», «*JU TË DY*», «*CUCË E DIBRËS*», etj.

Ndërkohë mund të konsiderojmë si perla poetike poezitë e Avni Ndreut të mbështetura në motivet popullore, si «*NUSEHËNA*», «*CUCËMIRA*», «*SHEJTANKË*», «*ÇIKË E KOSOVËS*», «*BUZË E SY*», «*KUJT TI FALEM*» etj.

Kësisoj, poezia e Avni Ndreut, e menduar lirisht dhe shkruar profesionalisht, paraqitet si një nga veçantitë në poezinë moderne shqipe.

Poezia e tij është prezantimi më i ndjeshëm i një mëvetësie estetike të rrafshit të epërm, është lodrimi me fjalën në tërësi, si figurë dhe si mendim, është një dremetje e ëmbël nëpër metafora, siç është kompozimi artistik i një jete të plotë njerëzore, të një jete me një përditshmëri mungesash që e trishtojnë dhe e bëjnë të vuajë poetin.

VARGU i Avni Ndreut është bio në çdo vjershë.../ Edhe kur na e ringjall të Madhin Hazis Ndreu.../ Edhe kur jeton me Dibrën nga agim në agim.../ VARGU i tij.../ I ëmbël.../ I butë.../ NJERËZOR...

Vargu i tij është bio.../ Edhe kur vargëzon aq bukur për dr.Benin.../ Edhe kur uron të bijën për ditëlindje.../ Edhe kur të dashurës i thotë: Ç'të kam bërë?!!!

Ja pra, pse është kaq madhështor ky poet i këngës...

VARGU i tij të magjeps.../ Kur shkruan "PËR ATA SY".../ Ashtu siç të

mallëngjen/ tek "Poezitë e Drinit"...

Ai luan me valën../ Dhe puth shtojzavalle../ Kur shkruan për Rozafën.../Dhe Cucat e Dardhës....

VARGU i Avni Ndreut është bio.../ Edhe kur rebelohet...Për Mosmirënjohje".....

VARGU i tij bio../ Na sjell aromën dehëse të blirit.../ Nga bulevardi i ëndrrave dhe shpresës...../ Dhe flladin.../ Nga Fush' e Korabit.../ Herë me zë bilbili.../ Herë me magji kavalli...

Ja, pra: Ky është "poeti bio" AVNI HAZIS NDREU...

POETI QË TË DETYRON TË PUNOSH PËR LIBRIN ME PËRKUSHTIM, PASION DHE DASHURI

Një tjetër emër i mirënjohur në fushën e botimeve, Bujar Karoshi – themelues dhe drejtues i “M&B”, botuese e librave të më shumë se 300 autorëve të njohur, jo vetëm dibranë por nga e gjithë Shqipëria, pasi e falenderoi Aviun për besimin që pati për botimin e librit “Gjurmë në fjalë” e vlerësoi atë si njërin nga bashkëpunëtorët më të mirë në një proces botimi. Kjo sipas tij, për faktin se ky autor të jep besim dhe të vendos në një pozicion që të detyron të punosh për librin me përkushtim, pasion dhe dashuri.

“Ajo që dua të evidentoj te Avniu është këmbëngula e tij, puna e tij e madhe për të qenë dikush, për të qenë një emër në fushën e kulturës dhe traditës popullore. Dhe këtë e ka arritur, pasi me grupin e tij të valleve po përfaqëson Shqipërinë në arenën ndërkombëtare.

Por Avniu, përmes punës, ka zgjidhur edhe një nga dilemat e mëdha që shpesh bëhej në odat dibrane: Se cila është më e vështirë, me qenë baba i mirë apo djalë i mirë.

Avniun, siç e thotë edhe në një nga vjershat e tij, e ka shoqëruar emri i mirë i babait gjatë gjithë jetës–dhe do vazhdojë ta shoqërojë sa të jetë gjallë, por vetë është bërë edhe më i mirë, sepse ka vazhduar traditën e babait, duke mos lënë të humbasë as emri dhe as puna e Hazisit.

Dhe kjo e detyra, pra puna, është një e mirë kombëtare, e cila do të bëjë që të mos harrohet edhe emri i Avni Ndreut”,- e mbylli fjalën e tij Bujar Karoshi.

Pas tij, aktori dhe regjisori i mirënjohur i dhjetra dokumentarëve televizivë në RTVSH, Llesh Nikolla – Mjeshtër i Madh, me interpretimin mjeshtëror të disa poezive të poetit Avni Ndreu, ngriti peshë dhe ngjalli emocione tek më shumë se 200 pjesëmarrësit në këtë promovim.


Në këtë event, si festë e poezisë avniane u mirëprit dhe u duatrokit fuqishëm edhe Liri Rasha gjatë interpretimit të këngës “Amaneti”. E identifikuar si zëbilbili i Dibrës dhe për talentin e saj të rrallë krijues, Liri Rasha, e dekoruar nga Presidenti i Republikës me titujt "Mjeshtër i Madh" dhe “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”, njihet edhe si bashkëpunëtore e ngushtë e Avni Ndreut. Ndaj dhe mirëpritet e duartrokitet në veprimtari të tilla promovuese.

Ndërkohë, në këtë eveniment të ideuar dhe kombinuar edhe me elementë të show-u artistik nga moderatori i shumëtalentuar, ikona e gazetarisë sportive dhe dokumentarit televiziv, Defrim Methasani lanë mbresa me interpretimin e tyre virtuoz edhe këngëtarja Erida Stana dhe flautistja Livia Bushpepa.

Dhe s’kish se si të mbyllej ndryshe festa e poezisë avniane, veçse me performimin e një kolazhi vallesh nga artstët e Ansamblit Artistik që mban emrin e të Madhit Hazis Ndreu – Nderi i Kombit, që drejtohet nga i biri artist dhe poet Avni Ndreu – Mjeshtër i Madh.

LETËRSIA NDRYSHE NË POEZINË E EMMY KROSIT

- Një poete që mbush suksesshëm vakuumin e krijuar në fondin e letrave nga mungesa e poemave cilësore
- Rudolf Marku – poeti i parë Laureat i Letërsisë Shqipe: “Në qoftë se ky “Taedum Viatë” (Koha tepricë e vetes) është libër poetik shkruar nga ti, atëhere të deklaroj si poeten më të madhe shqiptare, të të gjitha kohëve, dhe librin tënd si njërin ndër librat më të mirë poetik! Nëse është libri yt, duhet të mos konsiderohesh kritike dhe studjuese e letërsisë, por një Poeteshë që, herë pas here, shkruan, për hobi, dhe ndonjë studim mbi libra të veçantë”



“Një traktat femëror”...Kjo ide përshkon vetëtimthi gjithë poemat e librit “Taedum Viatë” (Koha tepricë e vetes) të poetes Emmy Krosi, botuar nga “Klubi i poezisë” Tiranë. Është një libër që të ngërthen e s’ të lë pa i shkuar gjer në fund, kur sa nis dhe e lexon...Por që ta kuptosh mendimin e saj të thellë filozofik dhe ligjërimitin e saj estetik, në vargje që përçojnë gjithë arsenalin njerëzor në të gjitha kohët, duhen lexuar e rilexuar poemat e saj, që vërtetë janë “kohë tepricë e vetvetes”...

Që në poemën e parë “Tani është kurrkundi, por ty Solomon”, konstatojmë se kemi të bëjmë me një letërsi ndryshe nga ajo e botuar dhe lëvruar gjer sot, nga poetë të ndryshëm. Sepse referencën nga J. E. Von GOETHE : “Kontradikta midis pamundësisë së qënësishme dhe absolute së saj”, poetja e shtjellon jo vetëm në vargje krejt ndryshe nga të publikuarat deri sot (në libra të botuar dhe në rrjetet sociale) por edhe nga konstrukti po krejt ndryshe. Sepse në njëzet noktune ajo përçon në vargje: Hamurabin e saj; ditën; ujin; natën; zjarrin; motivin e (mos)parasë; mësimet për jetën; tik-tok; unin e saj; tokën; frymën, dashurinë....

Dhe nëse në nokturnin e parë filozofon në vargje gjer edhe për: “sorrat që glasojnë/ Thinjat e Hamurabit”, në nokturnin e dytë (dita) shkruan edhe “për një kupë ujë që e ka lënë për macen/ Që pas xhamit i heton rrudhat e qafës/ qyshkur s’i ka numëruar të gjitha puthjet/ në sheshin e Republikës...”.

Qoftë edhe vetëm në këto vargje, gjithkush do të konstatonte një poete që tenton dhe arrin të shkruaj një letërsi ndryshe.

Sepse kjo poete, njëherazi dhe aset i çmuar i kritikës letrare (të munguar), jo vetëm që mbush suksesshëm vakuumin e krijuar në fondin e letrave nga mungesa e poemave cilësore, por i përmbahet bindshëm kriterëve të analizuarat e shtjelluarat aq bukur në studimin e saj të thelluar “Poezia çeshtje shkrimi dhe leximi”. Sepse ajo e sendërton botën sipas veçantisë së saj..., veçanti kjo që një studjues i vëmëndhëm i poezisë së saj do ta dallonte qoftë dhe në vargjet: “...vetëm diell të (për)ndezuar/ kanë visoret e këtyre anëve/ ku ka forma pa forma/ ka udhë pa udhë/ ka vend pa mbrritje/ ka kohë pa kohë..” (nokturni i tretë, fq.11) si dhe në nokturnin e gjashtë (zjarri...zjarri), ku: “zjarri, – thotë Buda/ të pastron mëkatin,/se im atë, / oxhakun ndez dhe në verë...”.

A nuk është kjo një poezi ndryshe, e shkrueshme, e lexueshme, ku si poetshkruese ajo lë shenjë të vetë individualiste?! Dhe këtë e bën në një mënyrë krejt të veçantë të vështrimit të gjërave e fenomeneve, me një mënyrë krejt ndryshe të shprehive artistike.

Emmy Krosi e shfaq individualitetin e saj krijues në unin e saj “kur dikush i tha: – të puthsha mendjen” dhe ajo (poetja), “ditë të tëra zhbiroi errësirat e mendjes,/ në të gjitha kthinat e Unit të saj/ në të gjitha skutat ku ishte fshehut/ mandili i kujtimeve...”.

Emmy Krosi përçon mjeshtërisht me poezinë e saj dukuritë më delikate të ekzistencializmit kur: "... Fryma...si hije e pabindur,/ në zonat erogjene seksuale,/ përflaket tejndanë perëndishëm/ me një rrëfenjë përmallimi..." (nokturni i katërmbëdhjetë, faqe. 22).

Poezia e Emmy Krosit është ndryshe edhe si reflektim i natyralizmit kur: "dashuria..zien gjakun ndër rremba/..si furi njerëzore..." dhe kur "si ujdhesë në shtratin e pendesës" kur "fjalët, /gërmat dhe ashklat e puthjeve/ gëlltiten në terr/ sa herrë e thërret dashnore...". Por mbi të gjitha ajo i qëndron me besnikëri strukturës organizative, rimës dhe metrikës. Edhe poema "Taedum Viate" (Koha tepricë e vetes) është letërsi ndryshe sepse shkruhet në tetëmbjetë kohë, si edhe në kohën e tashme (esenca e dritës); kohën e tashme të pakryer (të klithmës) etj. Gjejmë në këtë poemë vargje ku poetja vë në simbolikë perceptimet më empirike, kur: "futet e lëkurtë/me lulet e zjarrtë tek Adami.", kur vështron "përballë ballkonit/ një shtyllë me njëmijë tela/ pa dritë të mjaftë/ dhe ashtu si murg grushton yjet..."; kur "bebja ...ka filluar të belbëzojë/ dhe të ecë këmbadoras/..çdo gjë fut në gojë/ por telefonin lodër nuk e do/..do...vetëm një galaxy 12 X"...

Poezia e Emmy Krosit është vërtetë "Një traktat femëror"/ I një dashurie mërgimtare/ Që ecën guximshëm/ Në udhën me trëndafila....". Ajo është vërtetë "Një traktat femëror"/ Që lëkurën e zembrës e shqyen/ E bën rrugë,/ E bën dritë,/ e bën shtresë....".

E TILLË SHTROJË ËSHTË E GJITHË POEZIA JOTE EMMY KROSI...

Po . "Ti je lulesë e dashurisë.../ dhe si e tillë "S'ke se çfarë dëshiron më shumë.../ Ti je lulesë e dashurisë.../Kur muzgjet zbresin/ Në tokat e lagunave të vesuara... / Sytë e tu janë sytë e dritësprej një fruti magjik/ sa zemra jote..."

Ti je vërtetë "Një traktat femëror"/ Se në avullin e frymës tënde/ Ti mbledh të gjitha blerimet.....

Ti je vërtetë "Një traktat femëror"/ Kur shkruan për kohën e (tej) shkruar/ Të përdhosjes së Republikës!!!

Ti je vërtetë "Një traktat femëror"/ Kur shkruan për Amerikën (Si mirënjohje për presidentin Klinton)..

Ti je vërtetë "Një traktat femëror"/ Kur shkruan për kohën e klithmës së Kosovës (Reflekse nga poezia e Ali Podrimjes....).

Mbi të gjitha Ti je vetë poezia/ Që ka brenda tërë universin....

Poezia juaj Emmy Kros, është letërsi ndryshe sepse siç vlerëson Rudolf Marku – poeti i parë Laureat i Letërsisë Shqipe: “Në qoftë se ky (“Taedum Viate” (Koha tepricë e vetes) është libër poetik shkruar nga ti, atëhere të deklaroj si poeten më të madhe shqiptare, të të gjitha kohëve, dhe librin tënd si njërin ndër librat më të mirë poetik! Nëse është libri yt, duhet të mos konsiderohesh kritike dhe studjuese e letërsisë, por një Poeteshë që, herë pas here, shkruan, për hobi, dhe ndonjë studim mbi libra të veçantë”.

BARIE ÇUPI-BOBA, ZË I VEÇANTË NË POEZINË E SOTME SHQIPE



Me katër vëllime me poezi, të botuara dhe promovuara bujshëm në harkun kohor të tre viteve të fundit: "*Vargonjtë e fatit*", "*Ej ti grua*", "*Orët e përhitura*" dhe "*Me zemër të zhveshur*", Barie Çupi-Boba, zë vend të veçantë në fondin e artë të letrave shqipe.

Në promovimin e këtyre katër librave, të shtunën e 5 nëntorit 2022, në sallën "UNESCO" të Muzeut Historik Kombëtar, të moderuar mjeshtërisht nga ikona e gazetarisë sportive dhe dokumentarit televiziv, Defrim Methasani, pohova se kam qenë fatlumë si promovuesi i parë i poezive të Baries në faqet e gazetës "Bulqiza", si themelues dhe Kryeredaktor i saj në vitet 1992-1996 e në vijim 2015-2021.

Siç u vlerësua nga personalitete të letrave, artit e kulturës, ndër të cilët edhe nga poeti, publicisti e analisti i mirënjohur me rrezatim mbarëkombëtar, Dr.Mujë Buçpapaj–Drejtor i gazetës letrare&kulturore "Nacional" (botues i dy vëllimeve të poetes B.Çupi); ikona e kinematografisë shqiptare Margarita Xhepa-Nderi i Kombit, si dhe aktori i madh i hapësirës mbarëshqiptare në botë Xhevat Limani, i njohur si interpretuesi i rolit të Heroit tonë kombëtar Skënderbeut në disa skena të njohura botërore, Barie

Çupi, për vetë origjinalitetin dhe stilin e veçantë të të shkruarit poezi, është ndër poetet më të spikatura, konkurruese dinjitoze në tregun e poezisë së sotme...

QASJE FILOZOFIKE NË POEZINË E BARIE ÇUPIT

Emrie Krosi, një ndër zërat e spikatur të kritikës së sotme letrare, madje aset i çmuar që mbush me kompetencë e profesionalizëm vakuumin e krijuar në këtë fushë, pas një vështrimi të shkurtër, rreth poezisë së Barie Çupit, pohon se në të trajtohet jeta, realiteti dhe filozofia në botëkuptimin e saj nëpërmjet figurave të shumta letrare me stilin e veçantë e unik, në mënyrë të admirueshme për lexuesin, me përjasje moderniste për letërsinë shqipe. Në një linjë me të, mund të konkludojmë se qasjen filozofike e ndeshim pothuajse në qindra poezi të kësaj autoreje. Dhe më evidente kjo qasje tek libri me titullin intrigues “*EJ TI GRUA!*” Me një stil krejt të veçantë poetja, e revoltuar nga ky realitet i trishtë apelon bashkëvujtëset me vargje që sintetizojnë botën e saj shpirtërore: “*Ej ti motër,/ vajzë/, grua/, femë/r, Nënë... /dikur të njihja ndryshe/, tani pas të jam vënë/, të të mbroj/, të të shplodh/, me hijen e bukurisë tënde vargje të stilo/j, me dritën e shpirtit, pa kushte të frymoj/, me mirësinë e gjuhës, kotësinë të braktis/, hapësirës të perëndoj/, pa delire të nxitoj/, nuk kam kohë të pushoj...”.*

Këtë qasje e dallojmë edhe në poezitë me tituj: “*GJITHÇKA LËVIZ...!*”; “*SKENAR I PËRSËRITUR!*”; “*MES DY BOTËVE...!*” (POEMTH); “*RE APOKALIPTIKE!*”, etj. Në këto si dhe në dhjetra poezi të tjera, Barie Çupi–Boba shfaqet dukshëm me përmasat e një poeteje të talentuar.

Këto përmasa dallohen lehtë edhe kur ajo shkruan në vargje “*KODIN E JETËS!*”: “*Do të mundem t’ia shkruaj vetes një kod penal/, ca nene të djallit/, ta dinë ku quhet ndal/. dhe për gjurmët e mia ku i kam lënë/, e për ca fjalë,që ende s’i kam thënë/, për tani e për nesër gjithashtu.../ Errësirave e trembur pa asnjë ndriçim/, duke pritur ndoshta kuturu/, jam gdhirë e kam fjetur sa vite mbi zjarre/, prej të vobektit që s’pati ndryshim/, a prej të ligut që s’njohu pendim/. Mbi gurë kam ecur e më janë vrarë të gjitha lutjet/, të gjitha përgjërimit më janë shkelur/, më janë shqyer të gjitha buzëqeshjet/, male mbi supe m’i kanë ngjeshur/, askund pa u mbështetur/, jam rrëzuar, jam ngritur, kam mësuar/, duke vrapuar shkëmbinjsh e rrokullimash me lot ndër sy.....”.*

MOTIVET SOCIALE NË POEZISINË E B.ÇUPIT

Edhe motivet sociale shtrihen dukshëm në disa poezi të kësaj autoreje, duke përcuar kësisoj në mënyrë perfekte filozofinë e jetës. Mjafton qoftë edhe vetëm poezia me titull: “SE MAMI KA MALL” për të evidentuar këto motive: *“Po ç’erdhi kjo ditë o bijë/, tinëzare koha/, buzën me na ngri/. Deti aromën tënde m’a largoi/, nga prehri një dorë të ngrohtë m’a dëboi/, m’a mori gjumin e qetë/, mërzë që as hëna se mban dot sekret.../.... ulem në sofër e më mardhen sytë/, se mamit i zë kafshata në grykë/. Vjen festë/ e ditë feste fshehtas duke qarë/, kohë e gjatë o bijë/, pa u mbledhë, e pa u parë”....*

Në këto vargje natyra meditative gjen krahë për të zbuluar gjithçka të ndryrë brenda vetes, për të zbuluar më mirë atë dhe për ta vendosur veten në raport me botën dhe të tjerët. Kësisoj, poezia e Barie Çupit paraqet një grishje për lexuesin e saj të specializuar, për t’u nisur bashkë me të në një udhë jo shumë të lehtë.

Poezia e Baries vazhdimisht shquan, percepton, njeh dhe i artikulon realitetet e ndryshme, që janë shumë shtresore dhe të panumërta, si një metafiziciene e cila sheh ato që të tjerët i shohin vetëm pasi që ajo t’i shprehë ato.

Kësisoj, siç jam shprehur pasi ajo kishte hedhur në faqet e saj në facebook një nga poezitë e këtij lloji, “B.Çupi ‘tjerr’ vuajtjet, padrejtësitë, skëterrën në vargje, ndërkohë që beson në hyjnore që ia ofrojnë miqtë e vërtetë, pasi ka provuar plagët që shkaktojnë ligjet zakonore e kanunore. Vargu i saj ngrihet triumfalisht ndaj tyre, frymëzon e do frymëzojë gratë e vajzat shqiptare të mos i nënshtrohen dhunimit...Vargu i Barie Çupit flet sa qindra triumfe në betejat e pafundme ligjore ndaj padrejtësive të tilla.”

Dhe siç shprehet shkrimtarja e mirënjohur Kozeta Zavalani: “dimensioni shpirtëror i Barie Çupit është më tej se universi... metafora, krahasime, similituda, alegoria, ritmi, temporitmi heroik lirik. Nga shtrydhja e tyre del ajo botë që universi do ‘vryste veten’ të mos kishte pranë...”. Sipas Zavalanit, Baria është ajo pikë ndarëse që ëndërron çdo njeri të gjej te një grua.... Është një poete që gdhend dritë pas, në rrugëtimin e saj.

POEZIA E DHIMBJES NJERËZORE NË PESË LIBRA TË DEMIR RUSIT

Katër librat me poezi të Demir Rusit: “Ura e fjalës”; “Mos ik të lutem”; “Anja”; “Mos perëndo o dielli im” dhe libri me tregime e rrëfime “Djali që bleu vdekjen” janë promovuar bujshëm dhe mirëpritur nga lexuesi



Nga libri i parë “Djali që bleu vdekjen”, tek i dyti “Ura e fjalës”, si dhe në dhjetë vëllime me poezi të botuara në harkun kohor të dhjetë viteve të fundit, poeti e publicisti Demir Rusi, identifikohet si poeti i dhimbjes njerëzore.

Nëse në librin e parë me titullin sinjifikativ “Djali që bleu vdekjen”, sipas recensentit Namik Selmani, “Mbetet në gjithë sipërfaqen shkronjore dhimbja, mbetet drama, mbeten viktimat dhe fajtorët e një tragjedie që quhet kurbet i paligjshëm. Mbetet emocioni i rrëfimit...”, në vëllimet me poezi “Ura e fjalës”; “Mos ik të lutem”; “Anja”; “Mos perëndo o dielli im” është trashëgimia e bukur që mund të gjesh në gjuhën shqipe”.

Duke lexuar poezitë e këtyre vëllimeve nuk është e vështirë të konstatosh krijimtarinë productive e cilësore të këtij autori, duke evidentuar kulturën e lartë gjuhësore, në ditaret, përshkrimet e poezitë e tij. Profilin e tij të e

veçantë krijues D.Rusi e shpërfaq sidomos në poezitë që përçojnë plagët e rënda sociale që perjeton shoqëria e sotme.

Kështu nëse kriza globale e shkaktuar pas agresionit rus në Ukrainë reflektohet në vargjet e tij: “Kriza tek ne, për fajin tonë/ Mirë ta ndreqim sa nuk është vonë/Kriza për naftën s’mund të besohet/Nëntoka jonë me naftë mbulohet...”, kur vjen puna tek shkaktari i saj, vargjet e tij kanë nota të theksuara revolte: Si nuk i mbaruam hallet njerzimit/ Mangut kishim dhe këto të Putinit/ Fashist i ndyrë, xhelat i pashpirt/Vret e pret dhe gratë e fëmijët”.

Po ashtu pas vëzhgimit e investigimit të realitetit të trishtë, të krijuar nga veprimtaria e krimit të organizuar, fjala poetike e D.Rusit është alarmuese: “Paksa te SPAK-u njerzit shpresojnë/ Po të vakët duken e spo veprojnë/ Ata që ishin, po ato janë/ Veç po shtynjë kohçn e gja s’po bajnë..” Vargje revolte krijon poeti edhe në poezinë “Mëkatarin, mëkati ndjek”: “ Dëgjuar e kam e s’e mbaj mend/ Madje dhe lexuar në ndonjë vend/ “Shemben malet ngritën halet”/ Ndaj e keqja nuk po ndalet.../ Se nga vijnë këto të këqija/ Topi mbetet tek qeveria/Bëhen zgjedhje ndërron partia/ Hiqen të aftët vjen hajnia!!!”

Poezia e Demir Rusit është poezi që recitohet, madje që interpretohet me ndjenjë, siç e ka inperretuar atë Artistja e Popullit dhe Nderi i Kombit Margarita Xhepa në promovimin e librave të tij. Nga katër vëllimet e tij të promovuara njëherazi mund të përzgjedhësh si të tilla poezitë e titulluara: “Shteti vret”, “ Se ke hall askush s’ta var”, “Paraja dihet se të ngroh xhepin”; “ Helmi”; Pse bën keq o njeri”; “Mos luaj me punën” ; Karrikja ime”; “Skizofrenia” e “Vitet nëpër libra”.

Nëse lexon poezinë e autorit Demir Rusit nuk ke nevojë të vërtitësh rreth qëllimit për të cilin shkruan autori. Poezia e tij e nxjerr prej dhimbjes njerëzore është si mushti.

Por nga libri “Mos Perendo o Dielli im” mund të veçojmë edhe poezinë me titull: “Epitaf për vehten”, kur poeti shprehet në vargje se “nuk do t’ia shkruajnë të tjerët epitafin e pasvdekjes...”


Le të ndalemi së fundi tek libri i tij i parë me tregime e rrëfime “Djali që bleu vdekjen”, një botim produktiv dhe cilësor ku rrëfëhet intelektual i që përjetoi stresa të fuqishëm shkatërrues, por që nuk u tundua nga grishja për veprime aventurore në fushën e kontrabandës mafioze.... Në këtë

libër rrëfëhet intelektual i mirëfilltë që kishte shërbyer me devotshmëri si oficer dhe si publicist ushtarak e si kryeredaktor i gazetës “Minatori”, të cilin koha e gjykoi së mbrapshti, duke e dëbuar nga puna me motive krejt absurde dhe pa asnjë mbështetje, as juridike dhe as logjike. Duke përshkruar si askush tjetër emigranët që i janë lënë rastësisë, të jetojnë ku të mundin e si të mundin, të fituar apo të humbur, të gjallë apo të vdekur, pa një mbrojtje juridike siç e kërkojnë Kartat Ndërkombëtare, D.Rusi shpreh njëherazi dhimbjen për djemtë e mbetur deteve, kufomëprishur, ushqim për peshqit!. Ndjeshmëria e mërgimitarit shprehet qartësisht sidomos në rrëfimin për hollësitë e asaj nate pus të zezë në Grykën e Otrantos. Në librin “Djali që bleu vdekjen”, (si edhe në vëllimin poetik) autori dallohet dhe për gjuhën e pasur në përshkrimin e personazheve dhe sidomos të miqësisë së tij me profesorin e nderuar italian, Xhovani Karbone. Pikërisht kur shpreh admirimin, respektin e mirënjohjen për këtë personalitet të shquar italian, teksa ai e takon me një nga miqtë e tij që kishte shërbyer në Shqipëri gjatë luftës së lavdishme nacionalçlirimtare, evidenton edhe kontributin e partizanëve të batalionit “Antonio Gramshi” dhe veçanërisht heroizmin e Tercilio Kardinalit. Dashuri të pakufishme shpreh autori sidomos për nënat që janë njësoj në gjithë botën, që një emër dhe një zemër kanë. Duke lexuar me vëmendje librin e D.Rusit “Djali që bleu vdekjen”, edhe më pesimisti gjen forca për t’u bërë optimist, pasi përvoja e tij jetësore na mëson se “njeriu duhet të bëhet i fortë dhe t’u bëjë sfidë vështirësive që i dalin përpara; duhet të jetë optimist nëse dëshiron t’i mposhtë pengesat...Edhe kur është keq, njeriu nuk duhet t’i nënshtrohet së keqes....”. Ndërkohë autori është mjaftë bindës në konkluzionin për ekzistencën e të gjitha mundësive që Italia dhe Shqipëria të kthehen në simbole të vërteta miqësie e solidariteti. Kësisoj Demir Rusi prezantohet si vëzhgues i mprehtë i realitetit shqiptar dhe atij italian.

POETI HAMDİ SKEJA, NË ENCIKLOPEDI NË “PERSONALITETE SHQIPTARE TË FRANCËS”

- Tema e dashurisë në vëllimin poetik mbresëlënës “Jetoj brenda një gruaje”
- Është fat të jetosh brenda një gruaje, të jetosh me të, ta duash, ta admirosh, ta hypësh lart mbi yje, ta miksosh me to, ti japësh jetë në vargje, derisa të jesh kaq i vendosur për ta adhuroar. Po, femra adhurohet, e nuk abuzohet, as nuk lëndohet”, shprehet poeti Skeja

Në 520 faqet e enciklopedisë voluminoze të poetit dhe publicistit të mirënjohur Mentor Hoxha, me titullin sinjifikativ “*Personalitete shqiptare të Francës*”, mes 589 emrave, për të cilët siç shkruan shkrimtari Leonard Veizi, “kanë dhënë një kontribut të çmuar herë për Shqipërinë, herë për Francën dhe here herë fama e tyre i ka kaluar kufijtë e dy shteteve për t’u bërë të përbotshëm”, është edhe ai i poetit, gazetarit dhe aktivistit shoqëror Hamdi Skeja. Në faqen 376 të kësaj enciklopedie famoze, të promovuar në Lyon të Francës, si edhe nga media shqiptare, ndër të tjera shkruhet se “katër vëllimet me poezi të poetit Hamdi Skeja: “*Jetoj brenda një gruaje*”, “*Ligjërime ndjenjash*”, “*Flakërima shpirti*” dhe “*Ekstremume*”, janë vlerësuar nga media dhe kritika letrare në Shqipëri, ku veçohen disa artikuj kritikë në shtypin shqiptar, të shkruar nga Halil Rama – Mjeshtër i Madh, Dr.Fejzulla Gjabri, Pëllumb Gorica, Ilmi Dervishi, etj”.



LIBRI I PESTË I AUTORIT SKEJA “JETOJ BRENDA NJË GRUAJE”

Qoftë dhe vetëm nga një kërkim spontan në libraritë kryesore të Tiranës, Durrësit, Lezhës, Elbasanit e Dibrës, bindesh se libri i tij i pestë “*Jetoj brenda një gruaje*” (Botimet M&B, Tiranë, janar 2024) me redaktor

Mentor Hoxhën, në më pak se 6 muaj është më i kërkuari nga lexuesi.

Kjo për faktin se poezitë e tij pëcjellin tek lexuesi mjeshtërinë e fjalës së tij poetike, për ndjenjën e bukur të dashurisë. Kështu, edhe larg në mërgim (poezia me titull “*Tavolina jonë*”, e shkruar në Francë, më 09.08.2022) ai vargëzon për tavolinën bosh në të martën shenjtërore, kur ngado kërkon fytyrën engjëjlore të një vajze: Dhe të mahnit me vargjet: “*Kërkoj fytyrën tënde luledele kudo/ Po nuk gjendet askund;/Kërkimet për ty,/kanë fillim, por jo fund..*”.

Mjaftojnë qoftë edhe vetëm këto katër vargje për të kuptuar se sa thëllë e kërkon poezinë poeti edhe në mërgim, i bindur se këto kërkime s’kanë fund...E kështu ai, si rrallëkush i largohet oqeanopoezisë pa bosht e ide që ka pushtuar rrjetet sociale. Se ai është poeti sqimatar që kërkon më të bukurën edhe në poezi. E kështu, pothuajse në 73 poezitë e këtij vëllimi me 107 faqe ai përligj titullin e librit “*Jetoj brenda një gruaje*”.

Në të është “*gruaja që u ngjan luleve*” e ai (poeti) “*bilbilave që këndon këngët e pashpjeguar// të dashurisë së pashijuar*”. Ai jeton: “*me dashuri, me jetë, brenda asaj gruaje/ mes tingujve të një kënge gjen atë/ ajo e ka mes gishtave, flokëve. Mes lutjeve dhe dashurisë.., është gruaja që jenton brenda ti..., e Ai brenda saj...*”.

A nuk është kjo një poezi dashurie e veçantë, një krijim kompleks po aq sa ndjenja e dashurisë?! Qoftë edhe me këto vargje që hyjnizojnë gruan, H.Skeja përçon mjeshtërisht tek lexuesi filozofinë e ndjenjës së bukur të dashurisë njerëzore. Kësisoj edhe tek “*Qyteti i boshatisur*”, kemi poezinë e që kap në mënyrë të përkryer ndjenjën e padurueshme të mallit për njeriun e zemrës, për të cilin ndër të tjera thur vargjet: “*Ç’pritje e gjatë dhe e dhimbshme!/ Plot vajza qyteti, asnjë nuk ngjante me ty/ Asnjë nuk mund të të ngjaj..,/ Sepse si ti lindin njëherë në jetë vajza me fytyrën plot botë/ që botën time e shemb kur mungon..*”.

Në vargjet e këtyre poezive poeti Skeja shpreh mesazhin e tij universal, me natyrshmëri dhe aftësi marramendëse, duke përdorur një figuracion të veçantë letrar, të nxjerrë nga jeta e përditshme, duke rrëfyer mjeshtërisht se pas çdo përvoje njerëzore ka një derë tek e padukshmja. Qartazi këto veçori të poezisë së tij i shprehin këto vargje të poezisë “**Epitafi i zemrës**”:

*“Vazhdoj të shkruaj epitafit të zemrës për ty,
Për zemrat, për jetët që fati na i burgosi.*

*Ti herë vjen, e herë ikën si dallëndyshet
Unë pres si një peshkatar
Që fati do të të sjell në grepin e pritjes....
O Zot, je femër a perëndi?!”*

Dhe kështu, tema e dashurisë që mbizotëron tërë krijimtarinë e Hamdiut, është dominante edhe në këtë vëllim poetik mbresëlënës. Qartazi kjo dallohet qoftë dhe nga titujt e poezive: “Vajza e luleve”, “Të dua përtej mëkatit tim”, “Gruas që më dashuron”, “Jasemini im”, “Kur të pres ty”, “Largësia jote”, “Malli yt”, “Kënga e vetmisë”, “Dashurisë që i mungon fruti”, “Një letër pa adresë”, “Malli më djeg”, “Ajo flet me hënën”, “Përjetim në ëndërr”, “Shkrumëzohem”, “Asaj që do të ishte e imja”, “Kur mungon një copëz zemre”, “Sytë e saj”, “Femrat që kam njohur”, “Epitafi i zemrës”, “Zambaku i zemrës” etj, etj.

FEMRA ADHUROHET, NUK ABUZOHET DHE AS NUK LËNDOHET

Krijimtaria poetike e Hamdi Skejës është vlerësuar edhe nga Dr. Xhoi Jakaj, Sonila Meço (gazetare dhe moderator e njohur), Anxhela Peza (psikologe), Marjana Kondi (aktore) etj.

Përveç katër librave me poezi, Hamdiu ka realizuar e botuar në shtypin shqiptar intervista me këngëtare dhe gazetare shqiptare, si Sava Lena, Mimoza Paraveli, Marjeta Billo, Maria Aleksis etj.

Dr. Xhoi Jakaj e vlerëson premtues Hamdi Skejën në poezinë shqipe, me nje varg shumë origjinal dhe aktual. Kjo edhe për faktin se “Me librin ‘Jetoj Brenda një gruaje’ pohon si një dëshmitar i vërtetë se dashuria për femrën i jep jetë, ashtu siç e ka kështjellëzuar në vargje poezie”.

Hamdi Skeja ka lindur në Ploshtan, Kalaja e Dodës, Dibër. Për disa kohë banoi familjarisht në Metz të Francës, ku shkroi dhe botoi poezi si dhe artikuj me focus mbrojtjen e çështjes kombëtare shqiptare, e pikërisht për këtë kontribut bëhet pjesë e enciklopedisë “Personalitete shqiptare të Francës”.

Babai i tij, Tahir Skeja ishte valltar i Ansambllit Artistik të Qarkut Dibër dhe mori pjesë në shumë aktivitete në Dibër dhe në viset e tjera shqiptare.

Librin e tij të pestë me titullin domethënës “JETOJ BRENDA NJË

GRUAJE“, që në titull autori e konsideron me mesazh. “Është fat të jetosh brenda një gruaje, të jetosh me të, ta duash, ta admirosh, ta hypësh lart mbi yje, ta miksosh me to, ti japesh jetë në vargje, derisa të jesh kaq i vendosur për ta adhuruar. Po, femra adhurohet, e nuk abuzohet, as nuk lëndohet. E merr dhe e ngre lart mbi keshjtjella, e vesh me lule, me lulet e gjithë botës, e përkufizon me liqenet më magjik, pastaj perkufizimi del jashtë mendimit, deri me perënditë! E bën tinguj, muzikë, e kthen në këngë zogjsh, e bën ajër, dhe në fund e kthen aty ku ka vendin: – PERËNDI”, shprehet autori Skeja.

Ky libër për të është shumë i shtrenjtë, sepse është munduar të bëjë më të mirën, ndonëse nuk është prej atyre që i tundin si kryevepra.

HALIL RAMA

IV.

LETËRSI DOKUMENTARE

VEPËR SHKENCORE ME VLERA TË JASHTËZAKONSHME ETNOKULTURORE

Rreth librit të Prof. Dr. Fatmir Terziut
“*Toponimia e Gollobordës: Diskursi i dygjuhësisë dhe derivati i
originës*”



Pararendja e shkrimit

E lexova me shumë vemendje dhe interes të veçantë librin studimor të veçantë të Prof. Dr. Fatmir Terziut “*Toponimia e Gollobordës: Diskursi i dygjuhësisë dhe derivati i originës*”. Një analizë të mirëfilltë mjaft të detajuar i ka bërë këtij botimi Prof. Dr. Eshref Imeraj, i cili që në krye të pasthënies nxit lexuesin, kur shprehet: “*Lexohet me shumë kënaqësi. Kjo është një vepër me vlera të jashtëzakonshme etnokulturore*”. Por unë do të veçoja vlerat studimore, duke e konsideruar këtë një vepër të rëndësishme shkencore.

TRE DALLESAT TIPOLOGJIKE

Së pari: Që në fillim, autori trajton bindshëm dhe me finesë marrëdhënien mes gurit dhe zjarrit...duke pëshkruar “ *...prodhimin e produktit të lindur prej gurit dhe zjarrit me produktin që në fakt kishte*

*përdorim të dyfishtë, shëndetësor dhe estetik, të katër faktorët janë të pranishëm: toka, riprodhimi primitiv, puna dhe paraja, kombinimet e ndryshme të të cilave përbëjnë historinë e këtij produkti, që u ngjiz si gëlqere, një nga elementët më të rrëndësishëm, pas vetë gurit, baltës, rërës dhe drurit në një proces të ngritjes estetike të një banese. Por që nga momenti i shkëlqes së tyre nga toka, deri në formëzimin e fundit të gurit e produktit të fundit të vënies në shërbim të obligimit njerëzor, si produkt i tij pas zjarrit, gëlqerja, vetvetiu sillen në mënyra gati se gjithmonë kundërshtojnë rrënjësisht lidhjen me zjarrin. Shtëpitë janë të tilla pas së gjithave, por kur zjarri dhe zjarrvënësi nuk kanë arsyen e dhimbjes, natyrisht kundërshtia shkon përtej dhimbjes në të gjitha rrëfenjat, këngët e rrjedhat. Në këtë kornizë të ardhur nga rrëfenjat guri i skalitur në duart e ustait e mbajti zjarrin në shpirt, në zemër e në tërë udhën e tij të ecjes jetike. Sakaq ustai forcoi dashurinë me gurin.”*Për analogji, sipas një legjende: kur **dibranët e Dibrës së Madhe u vendosën në Tiranë**, pas eksodit të 1913-tës, lyen muret e shtëpive dhe të avllive me gëlqere dhe **tiranasit u çuditën dhe kujtuan se po i lyenin me qumësht...** Jo, ajo ishte gëlqerja që Prof. Terziu e sjell me rrëndësinë që ka si element i pazëvendësueshëm në ndërtimtarinë shqiptare ku gollobërdasit dhe dibranët kanë në histori unike si njerëzit që sikur kanë ndërtuar cepë më cep të Shqipërisë duke vënë „vulën“ e qëndresës kombëtare edhe pse gjithmonë nën sulm dhe drejt „detdhedhjes“ nga fqinjët e pangopur.

Së dyti: Gjatë vitit që punoja në ish-këshillin e rrethit Bulqizë për 7 vjet (1991-1997) kam shkelur pothuajse në shumicën e fshatrave të ish-komunave Ostren e Trebisht, ndërsa më parë, në ish-shtëpinë e oficerëve Bulqizë (1997-1991), edhe në disa fshtara të Steblevës, madje deri na Draganin majë maleve. Por veçanërisht, në gazetën “Bulqiza” që themelova dhe nxora rreth 90 nr të saj (1992-1996 në Bulqizë dhe 1015-2020 në Tiranë) kam botuar disa artikuj studimorë të autorëve të njohur nga Golloborda: Hilmi Sadikaj, Velo Cfarku, Agim Bekteshit, Besnik Rama etj, të cilët përveç pozitës gjeografike, pavarësisht dygjuhësisë argumentojnë se shumica e banorëve të kësaj zone janë shqiptarë autoktonas dhe kjo “dygjuhësi“ shpjegohet me tregun dhe etjen për punë të burrave të Gollobërdës historike.

Pa marrë parasysh vëshirësitë e ndërmarrjes së një studimi të tillë në një kohë kur parlamenti i Shqipërisë ka miratuar tashmë ligjin “Për

Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”, në të cilin ka përcaktuar se minoritetet në Shqipëri janë nëntë, përfshirë dhe pakicën bullgare, të cilësuar si të tillë popullsinë e fshatrave të zonës së Gollobordës, Prof. Dr. Fatmir Terziu, nëpërmjet referencave të shumta, ku unë veçoj prof. Kristo Frashëri, prof. Eqerem Çabej, Marin Barleti, Hilmi Sadikaj, arkivat britanike (sidomos mendimtarët e shquar si bizantologu francez Alen Dykelie (Allain Ducellier), dhe historiani anglez Noel Malkolm, etj, është më bindës në këtë kontekst. Kjo sepse argumenton bindshëm se si lëvizjet dhe pushtimet kanë sjellë ndryshime, jo vetëm në konstrukt, por dhe në ADN-në e popujve, krahinave e njëzëve veçmas në Ballkanin që duke qënë „shesh luftime“ shpesh ka përzjerë keqas gjuhëdhe etnitë origjinale. Mjafton të perifranojmë atë që shkruan në fq. 7: *“Se kush janë banorët e një zone të tillë në derivatin e origjinës dhe në diskursin e gjuhës, apo dhe të dygjuhësisë, gjithashtu dhe përsëri për mendimin tim, mund dhe s’mund të përcaktohet nga gjuha që flet dhe shkruan, ndërtimet dhe shenjat e lashta që e rrethojnë aty ku jeton dhe gurët e shkruar nëntokë e mbi tokë. Këta komponentë popullit të kësaj zone, nuk i mungojnë, kur vjen fjala e këngëve të mbetura që edhe në gjuhën e grave dygjuhëfolëse këndohet dhe faktohet se “Rosa rosit vo arbanoshka zemja...” (vesa veson në tokën arbërore...) por i mungon dëshmia e shkruar, i mungon madje mjaft arsyeja e gjuhëve të shumta mbi këta gurë, i mungon, ajo që të tjerët në shekuj e bënë sipas rrethanave të tyre për të nxjerrë në pah “orriginën” dhe mbi të gjitha dhe “dominimin” e dëshirave të hershme të shtrirjes masive territoriale”.*

Së treti: Këto teza autori i shtjellon duke sjellë fakte dhe argumenta në tre pjesët e para të kësaj vepre. Në pjesën e parë “Golloborda nga memorja”, nga artikulli “Emri, rrjedhat dhe gjuhët”, prof. Terziu ka si referencë “Deferi Osman” i vitit 1467, të cilin e solli në vëmendje për herë të parë në këtë drejtim historiani Hilmi Sadikaj (1999), duke theksuar se “kjo krahinë ka qenë e regjistruar me emrin “Dullgobërda ose Dollgobërda”. Pra, emri i kësaj krahine vjen nga bullgarishtja e vjetër dhe do të thotë në shqip “kodër (bordo) e gjatë (dollgo). Ky toponim gjendet i pranishëm pjesërisht në emërtime lokale vendesh, si në Trebisht (kodra përballë lagjes Kasaj të fshatit, që quhet “Borda” nga banorët vendas), në Steblevë (në formën Vetarno Bordo), në Rekë (Velebordo) dhe në Vollnisht (Ternino Nebordo) (fq.22). Gjithashtu autori, në pjesën e parë të kësaj vepre na njeh me traditat

e shkëmbimit dhe mjeshtëritë, me njeshtrit duarartë të Gollobordës, me kostumet tradicionale të grave të kësaj krahine si dhe me ritet në dasmat, gëzimet dhe përcjelljet njerëzore.

STUDIMI ME BAZA SHKENCORE

Pjesa e dytë e librit si zanafilla e studimit na sjell në vëmendjen e lexuesit e sidomos të studjuesve *Vajtimet e Gollobordës*, ndërkohë që më pas në artikullin “Trazim kulturash” nguron ta japë përgjigjen shpejt dhe përciptazi. Kjo sipas tij për faktin se, studimi duhet të kalojë së pari në të gjitha pikat ku ravijëzohen ritet familjare, lindja, dasma, lamtumira, mbyllja e rrethit të jetës njerëzore, të gjitha ato që bëhen momentet më të rëndësishme në tërësinë e një treve, ato që shënojnë tranzicionet e saj kulturore më të rëndësishme.

Interes paraqesin për lexuesin edhe ato çfarë shkruan autori për vllhët dhe “jevgit” e Gollobordës. Mendoj se impresiunuese është pjesa e tretë dhe më e rëndësishme e veprës mbi “Toponimet si Qasje Etimologjike”. Bazuar në toponiminë si kërkim shkencor të emrave të vendeve, origjinës së tyre, kuptimeve, përdorimeve dhe tipifikimeve, prof. Terziu sjell fakte se si mjaft vende të krahinës së Gollobordës kanë marë emërtimet e tyre nga toponimet. Pa u zgatur, për këtë mjafton të lexojmë artikujt e kësaj pjese të veprës me tituj mjaftë intrigues: “Vajtimi i kukuvajkave”; “Guri i lotit”; “Tre lisat”; “Dardha e bekuar”; “Zogu i jargavanit”; “Guri i Xhemos”; “Qershitë e Lamos”; “Raven” u ngjiz nga i Huaji”; “Radec’, toponimi që flet qartë”; “Kodra e Shutecit”; “Krasta’ emri që rrëfen”; “Arra budallaqe”; “Rebori”; “Smilen”; “Kallogjeri”; “Presllop”; “Dragalicë”; “Truku i Bellavodas”; “ etj. Ndërsa për Kështjellën e Trebishtit, ndër më të njohura e kësaj zone autori shkruan se: *“Një nga emrat më të lakuar prej kohësh, që ka ngjizur toponimin më befasues dhe më tipologjik të kësaj treve lidhet me toponimin ‘Gradishtë’, që do thotë qytezë. ‘Gradishtë’ quhet vendi në fshatin Trebisht Çelebi, për të cilin hamendësohet se kohë më herët e kanë cekur në shkrimet e tyre Dhimitër Frangu dhe Marin Barleti”*.

Vështrimin etnokulturor të autorit për zonën e Gollobordës e ndeshim në pjesën e 4-t të këtij libri “Ballkani përtej “njëjësit”. Këtu, veç të tjerash prof. Terziu na njeh me vallen pa ‘njëjës’ “Pajtushka”, me origjinën

e këngës “72 ditë”, ku e gjithë kënga interpretohet kështu: *“Shtatëdhjetë e dy ditë/Ka një plagë në zemrën time/Nuk është plagë nga sëmundja/Tashmë është plagë dhe pikëllimi./Merre pushkën dhe më vrit mua/pastaj më thuaj se s’te dua”*.

Në këtë vepër të rëndësisë shumëdimensionale (studimore, etnokulturore) autori argumenton edhe “Këngët si mesazh unik” si dhe Gollobordën si zonë shumëgjuhëshe.

Ndërkohë, duke u ndalur tek “Rregjistrimi i Tetorit 2020” lehtësisht evidentojmë shqetësimin e autorit për kushtin bullgar në lidhje me marrjen e një date për negociatat nga Tirana që ka të bëjë plotësisht me të drejtat reale të pakicës kombëtare bullgare. Prof. Terziu, jo më kot sjell për lexuesin një artikull të plotë dhe të pandryshuar nga origjinali, thujse jashtë procedurës së referencimit, të shkruar nga Prof. Dr. Spasse Tashev, me qëllim mosndërhyrjen në disa pika që mund të quhen të plotëkuptueshme në një situatë të tillë. Është fjala për problemin e mosgjetjes së „originës bullgare” për mjaft nga ata që aplikojnë për pasaportën e këtij shteti, në kushtet e sotme të komplikuar ekonomike, por që vetëm me këtë mundësi ata mund të lëvizin e të punësohen diku në vendet europiane. Dhe konkluzioni i autorit: *“Përgjigjja është mjaft kuptimplote, nëse nuk do të ishte kjo pasaportë, ata nuk do të kërkonin të ishin ndonjë lloj minoriteti”*. Siç shkrova në fillim, mjaft bindëse e bëjnë veprën e Terziut referencat nga arkivat britanike, të sintetsizuara në pjesën e 5-të “Arkivat Britanike për Gollobordën”.

TJETRI NË KËTË VEPËR TEJET DINJITOZE

Kjo vepër tejet dinjitoze, me interes të veçantë për lexuesin, mbyllet me pjesën e 6-të “Figurat dhe vlerat”. Këtu autori na njeh me personalitetet emërndritur në histori të kësaj zone. Ndërsa evidenton originën shqiptare të Qemal Ataturkut, Terziu shkruan për Kapitenin e Parë Qazim Kasa-Drejtuasi ushtarak i Prishtinës, për “Piktorin e Popullit” Nexhmedin Zajmin, sidhe piktorët tjerë si, Bajram Mata, Tahir Zeneli, Duro Ibrahimij etj. *“... Lexoja kujtimet e Hasan Shahinajt, Dail Halilajt, Ibrahim Allës, Islam Ramës, Fatmir Selimit, Velo Cfarkut, Fidan Markut, Halil Hoxhës etj., dhe ndjehesha kryelartë, komentoja poezitë e dhjetra poetëve të Gollobordës*

dhe bëhesha letrar ndryshe, shikoja skulpturat e Hamza Halilit, Fitim Sulës, Bashkim Sadikut dhe përumbesha në to, shikoja filmat dhe skenaret e Esat Musliut dhe s’kisha të ngopur, pastaj shkrimet e studimet e Hilmi Sadikut, Myqerem Tafaj, Ramazan Hoxhës, Besnik Ramës, Çfetan Maznikut, Kujtim Boriçit, Mehmet Hasanit, Kristaq Trajës..”, shkruan autori (fq.145). Prof Terziu vlerëson gjithashtu veprën e Doktor Arif Hasanit–“Qytetar Nderi i Dibrës”, të këtij kirurgu duarartë që shpëtoi qindra jetë njerëzish.

KONKLUZIONI I KONKLuzionIT

Në pjesën e 7-të të librit janë konkluzionet e autorit. *“Të dhënat e mbledhura në punën në terren gjatë viteve dëshmojnë se njerëzit e kësaj treve shprehin lidhjen e tyre të origjinës në mënyra të ndryshme. Disa e sqarojnë me një fjali që përcaktohet sipas tyre me shprehjen “mije zborime bugarsko”, dhe disa të tjerë me një tjetër që bazohet tek “mije zborime nashincki, nashki”. E para shkon ndoshta më larg në vitet kur sundonte dhe dominonte kultura dhe gjuha bullgare në rajon, duke lënë kështu kuptimin e fjalisë së parë “ne flasim bullgarisht” dhe kuptimin e shprehjes së dytë “ne flasim gjuhën tonë, tonën”. Dhe kështu kur mbetet zgjidhja nga toponimet kjo e fundit flet më së miri në këtë pikë, po aq sa e para. Pra, hipoteza jonë se toponimet ndikuan në këtë bashkësi në mënyrë të ngjashme në përvojën e identitetit të tij të pakicës është vërtetuar e gabuar. Për të forcuar këtë përfundim, komuniteti i Gollobordës që nuk kanë të njëjtën fe si bullgarët dhe maqedonasit duhet të ekzaminohet”, -shkruan prof. Terziu.*

Ndërkohë ai sqaron lexuesin se puna kërkuese e këtij studimi është e një natyre skematike. Ai nuk pretendon se botimi është një përpjekje për të shterruar këtë temë, as nuk mendon „se kontrastet kulturore, sociale dhe historike të theksuara midis efektivitetit tjetër të madh kulturor të traditës Gollobordës janë të gjitha aq sa absolutja e dukurive kulturo-sociale është ekstremisht komplekse, dhe larmia e faktorëve që i përcaktojnë ato shkaktojnë që ato të ndryshojnë shumë gjatë zhvillimit të tyre, nganjëherë ndryshimet i bëjnë ato të duken plotësisht të kundërta. Sidoqoftë, në thelb kontrastet që kam theksuar ekzistojnë. Idetë e përshkruara në këtë punë dhe faktet mbi të cilat ato bazohen mund të mbështeten nga një dokumentim i plotë dhe sistematik në shënimet e mbajtura nga rrëfimet, por duke pasur parasysh

natyrën e punës kam preferuar të shtoj disa elementë plotësues. Ata merren me një temë themelore të tyre, por mbajnë disa aspekte themelore të pikës së parë të Gollobordës dhe do t'u interesojnë lexuesve që kujdesen të hyjnë më thellë në këtë temë". Parë në një këndvështrim të përgjithshëm, Prof. Dr. Fatmir Terziu trajton gjerësisht në këtë vepër madhore fenomenin shoqëror të transkulturimit dhe rëndësinë e tij në Gollobordë.

Të „ripërtpësh“ qetësisht tezat e guximshme që hedh Fatmir Terziu në librin e vet mbi Gollobordën, këtë krahinë me tradita historike në vetë ekzistencën kombëtare shqiptare, duhet që librin to lexosh dhe rilexosh, sepse ka shumë kuptime mes rreshtave. Sikurse thamë më sipër pa marrë të mirëqënë faktin që Terziu i thotë gjitha në këtë vepër studimore në „tezat e një doktrature“ universitare, autori hap për diskutim akademik një çështje të mprehtë shqiptare: kush jemi dhe cila është pjesa jonë më ekzistenciale. Shqipëria duke qënë „kërthizë“ e gadishullit më të trazuar të kontinentit europian, natyrisht ka shumë për të thënë dhe sqaruar duke konfirmuar devizën se autoktonia shqiptare jo vetëm që nuk diskutohet, por studime të mëtejshme do të kristalizojnë të vërtetën e „turbulluar nga koha“. Studimi i Fatmir Terziut nga Londra është një sfidë e hapur ndaj vetë Akademisë Shqiptare, që në monotoninë e vet përgjumëse ende nuk është kthyer ende në „gardën kombëtare“ të mbrojtjes me „zjarr akademik“ dhe të vërtetave gjithëshqiptare që shpesh mbulohen nga mashtrime ulëritëse nga fqinjët tanë.

Autori meriton përgëzime jo vetëm për guximin hulumtues, por edhe për dritën që hedh mbi një krahinë të harruar dhe nënvleftësuar nga regjimet dhe admnistratat qëndore shqiptare. Në fund të fundit Shqipëria është një dhe mbetet një unison ballkanik me vitalitet që po testohet sërish në kohë lirie.

BERISHËT E MUHURRIT, SI RAST UNIKAL NË HISTORINË SKËNDERBEGIANE

Romani i Naim Berishës “Të jetosh në paqe”, me bazë historike të vërtetë, është sa tërheqës dhe intrigues

Barleti, Franku, Sokoloski, Pall, Stort, Stojanovski dhe shumë të tjerë biografë dhe studiues vendas dhe të huaj të Skënderbeut, evidentojnë Berishët e Muhurrit të Dibrës, si një rast unikal në historinë skënderbegiane. Madje Marin Barletite “*Historie Skënderbeut*” – (faqe: 314, 315, ...) shkruan se “*Ndër fisnikët më të mirë të atij vendi (në Dibër) ka qenë familja e lashtë e Berishëve. Dy vëllezërit, gjeneralë të Skënderbeut dhe, njëherësh, kryetrima të rinisë dibrane, Dhimitri dhe Nikolla, ndihmën e të cilëve Skënderbeu e kishte të dendur dhe të shënuar, kur dëgjuan*

për fatkeqësinë e ushtrisë sonë dhe për përfundimin e rrethimit të Beratit, kur morën pastaj vesh për rebelimin dhe pabesinë e Moisiut, nuk u vonuan aspak, por vrapuan fluturimthi për tek roja dhe kryeporta e mbretërisë, të trembur se mos roja atje shpërndahej nga frika apo ngaqë s’kishte kush e frenonte dhe se mos vendi mbetej pa mbrojtës, sidomos kur vinin lajmet se Sebalia ndodhej, ende, në Epir. Dhe kështu Dhimitër dhe Nikollë Berisha me plot arsye, u kujdesuan, së pari, për të kërkuar ushtarë dhe, kështu, e rritën rojën, u dhanë zemër burrave me fjalë dhe me vepra, duke ua shtuar, me çdo mënyrë, dashurinë për Skënderbeun, si dhe duke shfaqur simpatinë e tyre për fatin e tij dhe urrejtjen për pabesinë e Moisiut ...”. Duke shkruar për këtë familje, (filloj: “*Familja e Lashtë të Berishëve*” sepse në gjithë librin voluminoz të tij për Skënderbeun, Barleti, çuditërisht, vetëm këtë familje, në ndryshim nga gjithë të tjerat, e specifikon kështu: “*të lashtë*”) është e



pamundur të mos përmendësh Kastriotët dhe Skënderbeun. Kjo sepse, këto dy familje, u ngjizën në të njëjtën trevë të origjinës, në Masrekat e Dibrës së Poshtme, për të cilën kanë shkruar jo pak historianë vendas dhe të huaj. Edhe nga burimet arkivore, edhe nga ato gojore vërtetohet se këto dy familje qenë jo vetëm bashkëkohës dhe bashkëshatarë, por, njëkohësisht, dhe bashkëluftëtare. Qyshse Kastriotët u shfaqën për herë të parë në skenën politike të kohës, Berishët bëjnë krushqi me ta dhe që nga ajo kohë, familja e lashtë e Berishëve, do të mbetet në historinë skënderbegiane si njëra nga familjet bashkëluftëtare më besnike e kauzës së Kastriotëve.

MASREKAT DHE GARDHI, TREVA NË TË CILAT, EKSKLUZIVISHT, IDENTIFIKOHET MUHURRI

Të shkruash për Berishët, më së pari, do të thotë të shkruash për Masrekat, të Epërmet dhe të Poshtmet, si dhe për Gardhin e Poshtëm (të Dibrës së Poshtme), treva në të cilat, ekskluzivisht, identifikohet Muhurri, ky shtrat i rralle shtrëngatë i origjinës së lashtë të Kastriotëve. Të shkruash për Berishët e kohës së Kastriotëve do të thotë të hedhësh një dritë të re mbi qytezën e lashtë ilirike të Hurdhë-Muhurrit dhe Mazrekave të Epërme vend ku u ngjizen dhe u formuan në shekuj Kastriotët, të cilët i dhanë kombit tonë të shqiponjave pavdekësinë. Të shkruash për Berishët e Skënderbeut do të thotë të farkëtosh dhe një të vërtetë më shumë se Gardhi i Poshtëm, (vendlindja e dy gjeneralëve të Skënderbeut, Dhimitër dhe Nikollë Berisha), ishte ashtu siç pohon Gjon Muzaka, njeri prej dy katundeve që pati në zotërim Pal Kastrioti, gjyshi i Skënderbeut. Dhe, më në fund, të shkruash për Berishët e Skënderbeut do të thotë të shkruash për një rast unikal në historinë skënderbegiane dhe jo vetëm. Do të thotë të shkruash për dy vëllezër, secili më i zoti se tjetri, që të dy gjeneralë të Skënderbeut, luftëtarë të ekselencës, njerëz të elitës sunduese skënderbegiane, nënkomandantë nga më të rreptët e Skënderbeut dhe, njëherësh, nga më të besuarit e tij, personazhe historike të veprës së madhërishme të Skënderbeut shkruar nga Barleti, vepër e përkthyer në shumë gjuhë evropiane dhe që qarkullon prej më shumë se 500 vitesh në gjithë botën. Kur shkruhet dhe flitet për Berishët e kohës skënderbegiane, s'do mend që flitet e shkruhet për Berishët

e Muhurrit të Dibrës së Poshtme. Asnjë historian apo kronikan, asnjë burim arkival apo gojor nuk na bën të njohur ekzistencën e ndonjë fisi a familjeje tjetër “Berisha” në gjithë trevën autentike arbërishte të epokës së Kastriotëve. Në se ka sot familje Berishësh, gjithkund, në hapësirat etnike shqiptare, ato, dihet, kanë divergjuar përgjatë harkut kohor të këtyre pesë shekujve të fundit, pra, fill pas MOTIT TË MADH nga e vetmja pikë: Familja e Lashtë e Berishëve të Masrekave dhe Gardhit të Poshtëm, përndryshe, nga Muhurri i sotëm i Dibrës së Poshtme, pikërisht, aty ku e kanë gjenezën, aty kanë dhe trojet e tyre të vjetra e të pakontestueshme Kastriotët tanë të madhërisëm.

Referuar këtyre kolosëve të historisë sonë kombëtare, por dhe në të dhëna arkivore e gojore, poeti, romancieri, përkthyesi dhe, njëherësh, kantautori muhurrak Naim Berisha, autori i më shumë se 30 librave artistikë, (vetëm në këta 23 vitet e fundit), ka botuar së fundmi romanin e tij të gjashtë, të cilit i ka vënë titullin e bukur dhe kuptimplotë, “TË JETOSH NË PAQE”. Ndryshe nga pesë të parët, ky i fundit i përket zhanrit historik.

Në këtë libër, ai trajton temën e qëndresës së popullit të arbërit në kohën e Skënderbeut. Duke glorifikuar familjen e lashtë të Berishëve të Mazrekave në Gardh të Poshtëm, dmth, në Muhurrin e sotëm të Dibrës së Poshtme dhe të dy gjeneralëve të Skënderbeut, vëllezërve Dhimitër dhe Nikollë Berisha, djem të Gjergj Berishë Mazrekës dhe Majra Kastriotit) ai, në të njëjtën kohë, glorifikon gjithë qëndresën heroike të Arbërisë nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër tiranisë së pashembullt turke.

FRYMA POLEMIZUESE E AUTORIT DHE BESUESHMËRIA NË PËRSHKRIMIN E PERSONAZHEVE

Duke vazhduar me vlerat e romanit, nuk mund të mos nënvizoj frymën polemizuese të autorit me ata që u përpoqën të anashkalojnë qëllimisht Muhurrin dhe Berishët, edhe pas mbledhjes së dëshmimeve të pleqve të urtë muhurrakë Lam Mziu e Fali Rama. Ndërkohë që ka edhe të tjerë që ndonëse botuan libra rreth gjurmëve të kastriotëve në Sinë e Muhurr, megjithë kontributin studimor nuk arritën të orientohen nga figurat e kryetrimave Nikollë e Dhimitër Berisha, siç bëjnë H.Koltraka, S.Mziu e F.Daci. Romani historik i N.Berishës bëhet më i besueshëm kur iu referohet studjuesve të

mirëfilltë të Historisë së Muhurrit, Hilmi Sadikut e Ilvi Shehut, apo edhe Hysni Bruçit e Hysni Milloshit si promovues të vjershë së tij të parë dhe të studimit për Berishët e Muhurrit të botuar në revistën “10 korriku”.

Një figurë interesante është dhe ajo e Liman Berishës, për bëmat e të cilit në betejat kundra turqve e serbëve, deri në kryengritjet e viteve ‘20-21 unë kam shkruar që para 30 vitesh reportazhin “Muhurri në breg të Drinit”, botuar në gazetën “Ushtima e Maleve”, dhe ku ndoshta për herë të parë sjell referenca nga Barleti e Noli për gjeneralët trima të Skënderbeut, Dhimitër e Nikollë Berisha

Tërheqës janë edhe profilet e Xhemalit, Osmanit e hallë Miles, që Gjorgju, mjeshterisht i viziton, qoftë dhe vetem si inkurajues të krijimtarisë së tij. Po në këtë këndveshtrim përfshihen në romanin historik “Të jetosh në paqe” dhe xhaxhallarë e autorit, Ramazani, Haliti e Lika sidhe kushurinjtë, Arbeni, Limani e Bardhyli, si pasardhës të denjë të Dhimitrit e Nikollës. Pikërisht edhe për hedhjen dritë rreth këtyre figurave e personaliteteve të shquara, ky roman i N.Berishës zë vend të veçantë ne analet e historisë sonë kombëtare.

“TË JETOSH NË PAQE” NJË ROMAN I ZHANRIT HISTORIK

Duke u mbështetur në mendimet e konsulentëve dhe të recenzentëve, emrat e të cilëve janë të shkruar në faqen e parë të librit, kemi mbërritur në një akord se ky libër i veçantë i Naimit, më shumë se një libër monografik për familjen a fisin, është një roman i zhanrit historik, sepse i gjithë libri është nën ndikimin e parimit artistik dhe estetik të historisë.

Ky parim, siç dihet, e sheh historinë edhe si art, njëherësh, i përcakton asaj edhe qëllime të tjera, veç tregimit objektiv të ngjarjeve. Romani “Të jetosh në paqe” mendoj se e prek lexuesin dhe, në të njëjtën kohë, e kënaq atë përmes rrëfimit interesant dhe stilit konciz, të trajtave të larmishme të tregimeve impresionuese, të vrullshme e plot ngjyra.

Natyrisht, parimet dhe tiparet e mësipërme letraro-artistike bien disi në kundërshtim me karakterin e rreptë shkencor të historisë, por ato, në roman, kombinohen aq bukur dhe aq bindshëm ashtu siç shkrihet, në një të vetme, forma artistike me përmbajtjen e romanit.

Edhe fakti se në libër janë përdorur mjaft mjete stilistike, si digresionet,

retrospektiva, harmonizimi i kujdesshëm i kësaj të fundit me realitetin e sotëm, ruajtja dhe sigurimi i vazhdimësisë së amaneteve, i kumtit të tejçuar oral nëpër brezat pasardhës të Berishëve të vjetër, në të njëjtat troje (të Muhurrit) deri në ditët tona, kombinimi i të vërtetave historike që përcjell Barleti dhe të tjerë biografë të Skënderbeut me gojëdhënat që janë shumë të njohura në Muhurr edhe sot e kësaj dite për fisin e Berishëve dhe lidhjet e tij shumë të afërta dhe tejet besnike me Skënderbeun, gërshetimi i linjave themelore të ngjarjeve historike me detajet konkrete të luftës dhe të jetës së dy vëllezërve gjenerala, Dhimitër dhe Nikollë Berisha, ingranimi me këto linja, që mbajnë në këmbë librin, i tregimeve të Babës së Madh, i cili jetoi aq gjatë si për të treguar ..., “Rrnoj për me tregue” dhe që, çuditërisht, na kujton plakun Balë të De Radës tek “Këngët e Milosaos”, dhe, më në fund, rrëfimet në vetën e parë të Gjorgut, (që është vetë autori i librit) të cilat shfaqen, mjeshtërisht, në trajtën e kujtimeve, e të tjera, e bëjnë këtë libër që të anojë më shumë si një roman, sesa një libër, thjesht, jetëshkrimor.

Gjithëçfarë thamë më lart, mendojmë se justifikohet edhe me atë që pohon autori, se letërsia, për të, është e pandarë nga historia.

Ky roman historik, shprehim bindjen se i bën nder sa historiografisë skënderbegiane, aq dhe letërsisë artistike që evokon atë epokë të lavdishme.

“Të jetosh në paqe” që i dedikohet familjes së lashtë, të vjetër dhe të re të Berishëve të Muhurrit dhe jo vetëm, është një kontribut i ri si në thesarin e historiografisë skënderbegiane, ashtu dhe për letërsinë që i korrespondon asaj periode legjendare e të papërsëritshme.

Ky roman me bazë historike të vërtetë është sa tërheqës dhe intrigues, aq dhe me interes e domethënës. Si i tillë, ai lexohet me një frymë. Dhe ne besojmë se do lexohet kështu për shumë e shumë kohë, si brenda, edhe jashtë kufijve të atdheut dhe se do zërë vend të merituar në mjaft biblioteka personale të shqiptarëve.

Për shkrimtarin, poetin, përkthyesin, hajkistin, romancierin dhe kantautorin, bashkëfshatarin tonë të dashur muhurrak Naim Berisha, urojmë nga zemra veç të mira në jetë dhe suksese të mëtejshme në krijimtarinë e tij të bukur artistike.

SKËNDERBEU KA LINDUR NË SINË TË DIBRËS

<http://www.panorama.com.al/skenderbeu-ne-serialin-jete.../>
<https://gazetadita.al/skenderbeu-ka-lindur-ne-sine-te.../>

Kjo e vërtetë historike pohohet më zë dhe figurë në serialin turk “Jetë luftëtarësh”, përgatitur nga Instituti i Studimeve Ushtarake të Turqisë – <https://youtu.be/TO6UxLfcXvQ>

Historianët e mirënjohur, prof. Stafanaq Pollo e prof. Kristo Frashëri, pasi vizituan muzeun e Kastriotëve në Sinë të Dibrës lanë këtë shënim në fletoren e përshtypjeve të vizitorëve të këtij muzeu: “Sinë, 12 shtator 1982. Vizituam muzeun e vogël të fshatit Sinë, vendi i origjinës së Kastriotëve dhe Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut. Përshëndesim nismën e banorëve të Sinës dhe atyre që e përkrahën ngritjen e këtij Muzeu. Urojmë që ai (muzeu) të pasurohet sa më shumë e më shpejt dhe të kthehet në një objekt historik të vizitueshëm, për edukimin e brezit të ri”



Fatos Daci është autor i përbërësve i Aka-dem-itë, Kështjës së Shqipërisë, Skënderbeut dhe Artevë me shtet në Nën Jektë, SHBA, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, anëtar i Shoqatës së Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë, i cili është i Komitit të Kulturës Dibrane (Historiam, Shkrimtarit, Poetit, Gazetarit, Artistit) dhe i Kështjës së Shqipërisë, anëtar i Kulturës “Kallë”. Deri më tani ka botuar më 60 libere enciklopedike dhe monografi historike.

Nga viti 1998, udhëkoll të botës gjatë “Dibrës”, si dhe ka drejtuar gazetar “Tregjet Shqiptarë”, “Zori i Lirisë” dhe “Dera e mëngjesit”. Ka shkruar e botuar qëndra libere në antenë si: “qatë dibrane” e jo dibrane. Ka botuar më 13.000 foto libere, ka gjendur 1000 portrete individuale, 35.000 onza e shërbime, të cilat janë ilustruar me 2.811 foto-grafi. Eftësi fletorë dhe monografi të para, si në vitin 1971 e 1974, ka filluar çmimet e para për akteve literare, fletorë dhe vlerime me regjime, si dhe fletorë e çmimi të dëbë për raportues në kërkime të zbuluara në shkollë rivale (1982). Në vitin 1982, filloi çmimet e para për çmimet e raportues në kërkime të zbuluara me regjime “to-pare” të shqiptarëve për antenë, të organizuar nga Bankamitë e Gazetarëve të Shqipërisë. Ndërkohë, në 10 vjetorin e gazetës “Merrani e Malësia”, 1978, dhe për vitin 1981, është ndëruar me Foto-Lidhësit që.

Nga komiteti Artistik, Komiteti i Artit, Bankamitë e Dibrës dhe Komiteti i Dibrës së Madhe, është shpallur “Oxetar Nidër” Bankamitë e Komiteti i ka shkruar titullin “Mënyrë dhe Oxtari”, ndërsa, Akademiti i Shqipërisë-Shqipërisë dhe Artevë, me shtet në SHBA, në janar 2018, e ka ndëruar me certifikatë vlerësime si historian. Eftësi dëborë dhe me titullin e lartë “Magjistri i Madh”.

Ka realizuar 20 dokumentare televizive dhe organizuar e drejtuar dhjetra e dhjetra koncerte publike, historike e patriotike, në Tiranë, Prishtinë, Dibrë e Madhe, Bulgari, Sllovi, Kallë, Zori-Darbë, Shqipëri, Maqedoni, Shtet i Kulturës, “Kallë në dëbë”, “Tregjet Fletorëqitë e Poetikës”, “Kështjës e Dibrës”, në Dibrë, etj. Në TVSH (Televizionin Publik Shqiptar), në Channel One, Ora Nisë, Top Channel, LTV Nisë, TV “Dibrë-Poetikë, TV “Dibrë-Oxetar Madh”, TV “Zori”, dhe Radio “Tiranë”, në dhjetra e dhjetra emisione dhe antenë me të promovuar skriat dibrane, patriotike, kulturore, krijesive e historike të Dibrës dhe të dibraneve, si i tregjet në këto mode. Simbolizimi, prej 50 vitesh, ka dëborë e laboruar artë të ndryshme problemë, historike, politike, raportues etj. në çmimet “Udhëtar e Malësia”, “Dibrë”, “Zori i Popullit”, “Zori i Rrimit”, “Bankamitë”, “10 Korrik”, “Shqiptarë e Rre”, “Lidhësit”, “RD”, “55”, “Shqipëri”, “Shqipëri”, “Tregjet”, “Tregjet Shqiptarë”, “Tregjet”, “Bulgarë”, “Personazhi”, “Nisëtar”, “Zori i Artevë” etj.

Çmimi i Kështjës 1000 Lekë

FATOS DACI



TË GJITHA RRUGËT TË ÇOJNË NË DIBËR

TURQIA VULOS: SKËNDERBEU LINDI NË SINË TË DIBRËS

Për herë të parë autoritetet shkencore turke thyejnë heshtjen, lidhur me historinë e Skënderbeut dhe kryesisht me origjinën e vendlindjen e tij. Nëse deri sot historiografia civile apo ushtarake e Turqisë heshtte

për Skënderbeun dhe historinë e tij, tani foli publikisht. Foli qartë dhe pastër Instituti i Studimeve Ushtarake të Turqisë (Milli Savunma Universitesi-Universiteti i Mbrojtjes Kombëtare) të Turqisë. *Saktësisht në këtë dokumentar në përkthimin nga gjuha turke në gjuhën angleze dhe nga gjuha turke në shqip thuhet: “Gjergj Kastrioti Skënderbeu u lind më 1405, në fshatin Sinë të Dibrës (Kjo shqiptohet qartë në dy fjalitë e para të dokumentarit në fjalë)”.*

Duke e publikuar këtë të vërtetë në librin e tij voluminoz me 497 faqe “Të gjitha rrugët të çojnë në Dibër”, me fakte, argumente shkencore, referenca nga autorë vendas e të huaj, studiuesi Fatos Daci, shprehet entuziast për faktin se: *“Për herë të parë, Turqia vulos: Skënderbeu lindi në Sinë të Dibrës! Dhe kur vulos Turqia, ish superfuqia e kohës, nuk ka më fjalë. Shqip: Skënderbeu ishte dibran. Pra, ishte shqiptar!”*

Po në këtë libër (fq.59) studiuesi Daci sjell referenca nga Akademia e Shkencave të RSH, konkretisht nga Sesioni Shkencor rreth origjinës dhe prejardhjes së Kastriotëve mbajtur në Peshkopi më 2 Nëntor 1985 me rastin e 580-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar, Skënderbeut dhe inaugurimit të Muzeut të Kastriotëve në Sinë të Dibrës. Dhe nëse Prof. Sterfanaq Pollo ka deklaruar në fjalën e tij përmbyllëse të këtij sesioni shkencor se: *“...Tani mund të themi se origjina e Kastriotëve është Çidhna, është Sina”*, Fatos Daci argumenton, se *“Ky dokumentar i tanishëm, i serialit turk “Jetë luftëtarësh”, i dha publikisht të drejtë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit të saj të Historisë për ngritjen në Sinë, në nëntor 1985, të Muzeut të vetëm të Kastriotëve”.*

Autori i librit mjaft voluminoz “Të gjitha rrugët të çojnë në Dibër”, ka të drejtë të ndjehet mirë me këtë konkluzion të pritshëm të shkencës ushtarake turke, për faktin se me argumentet e tij, për gjatë 20 vjetëve, në katër libra që ka shkruar e botuar për Skënderbeun, në qindra artikuj që ka botuar në organe të ndryshme të shtypit ditor dhe atij periodik, në dhjetëra intervista televizive dhe në dhjetëra veprimtari publike që ka zhvilluar në institucionet publike të Tiranës, në Peshkopi a në Dibër të Madhe, ka thënë e shkruar, ka këmbëngulur vazhdimisht me zë të lartë se, për një mijë arsye, Skënderbeu është dibran dhe ka lindur në Dibër, në krahinën e Çidhnës.

Në librin e tij me një bibliografi mjaftë të pasur (87 libra, fjalorë, studime,

botime në gazeta të ndryshme), në 59 tituj, Fatos Daci argumenton, se: Nga ishin Kastriotët dhe Skënderbeu, ditëlindjen e saktë të tij më 6 maj 1405, në Sinë të Dibrës, pamjen fizike të Skënderbeut etj. *Mjaftë interesante e tërheqës janë artikujt: “Pse Skënderbeu braktisi Portën e Lartë dhe u kthye në Shqipëri”; “Skënderbeu nuk mund të tjetërsohet”; “ Skënderbeu është realitet historik” etj.*

SKËNDERBEU NË SERIALIN TURK “JETË LUFTËTARËSH”

“Sipas dokumentarit në fjalë, Gjon Kastrioti ishte princ dhe e shtrinte pushtetin në tokat e Dibrës, Matit, Krujës dhe Mirditës. Gjon Kastrioti, babai i Gjergj Kastriotit u mund dhe pranoi pushtimin osman në vitin 1421, ndërsa në vitin 1423, i dha Sulltanit si garanci (peng), djalin e tij Gjergjin, i cili në Oborrin e Sulltanit u konvertua në mysliman. Pra, Skënderbeu nuk shkoi në Turqi, te Sulltani as në moshën 8 vjeç, siç është interpretuar herë të tjera e as në moshën 10 vjeç, por plot 18 vjeç.

Nga viti 1423, deri në vitin 1431, Skënderbeu qëndroi në Oborrin e Sulltanit, ku mori edukimin me anë të shkollimit, ndërsa në vitet 1431-1437, kreu studimet ushtarake dhe doli oficer. Në kryengritjet shqiptare të 1432 dhe 1436, Skënderbeu nuk mori pjesë. Për 6 vite tregoi aftësitë e tij ushtarake dhe mori besimin e Oborrit. Prandaj, më 1437, u emërua subash dhe filloi të merrte pjesë në luftërat osmane, si spahi, si dhe i ngjiti me shpejtësi shkallët e gradave, duke u bërë më 1443, sanxhakbej (guvernator) i Dibrës”, shkruan F.Daci në librin e tij (faqe 133). Po në këtë faqe të këtij libri autori pohon se dokumentari turk hedh dritë mbi një tjetër fakt të rëndësishëm. “Kemi thënë e kemi shkruar se, bazuar në Marin Barletin, Skënderbeu u kthye nga Nishi vetëm me dibranë, jo ‘me shqiptarë’, siç shpesh problemit i bihet shkurt e kithtazi, me keqdashje, sepse në betejën e Nishit, Skënderbeu mori pjesë me ushtrinë e tij të përbërë me dibranë dhe shkoi nga Dibra në Nish, sepse Sulltani kishte urdhëruar të gjithë guvernatorët që në Nish të shkonin për të luftuar me kryqtarët, me ushtritë që do të mblidhnin nga vendet e tyre. Pra, Skënderbeu do të mblidhte ushtrinë e tij në Dibër, me dibranë, ashtu si mblodhi, se në Dibër ishte guvernator” .

Këto fakte studiuesi F.Daci i argumenton me referenca të autorëve të

shumtë vendas e të huaj të historisë së Skënderbeut. Më konkretisht, autori i referohet edhe *Barletit i cili e përshkruan qartë, se “Skënderbeu u kthye nga Nishi me 300 luftëtarë të një fisi, dhe jo të disa fiseve, dhe me ta ai u kthye drejt e në Dibër, ku të gjithë e njihnin, donin dhe e respektonin”*.

PAK NGA HISTORIA

Pas kthimit nga Nishi, Skënderbeu refuzoi Islamin dhe u betua se do të hakmerrej për familjen e tij dhe shqiptarët. Për t’u hakmarrë ndaj Skënderbeut dhe shqiptarëve, që ishin rebeluar, Sulltani, pas 6 muajsh, dërgoi 30 mijë ushtarë, nën komandën e Ali Pashës. Skënderbeu kishte 15 mijë luftëtarë, nga të cilët 5 mijë luftëtarë i la në fushëbetejë, ndërsa 10 mijë i fshehu në male. Në këtë betejë, turqit patën 20 mijë të vrarë dhe luftëtarët e Skënderbeut 5 mijë të vrarë. Skënderbeu dhe luftëtarët e tij shënuan një fitore të rëndësishme dhe historike. Sipas një dokumentari tjetër dhe dëshmime të historianëve të tjerë fushëbeteja e Torviollit ishte në një fushë të rrethuar me pyje, me një gjerësi prej 4 km. Luftimet filluan më 28 qershor 1444, dhe dinamika e luftimeve u zhvillua më 29 qershor 1444. Vetëm e dhëna interesante, edhe nga autorë të tjerë, se fushë-beteja e Torviollit kishte gjerësi prej 4 km., rrëzon të gjithë aludimet e mëparshme për vendin, ku u zhvillua kjo betejë historike. Të tilla përmasa nuk i plotëson fusha e Përrenjasit (ku, sipas Dilaver Radeshit mund të jetë zhvilluar beteja e Torviollit), aq më pak nuk u plotëson as Fushë-Bulqiza (ku në kohën e komunizmit, te Ura e Qytetit, qe vendosur lapidari i kushtuar betejës së Torviollit), sepse gjerësia tyre nuk arrin mbi 1 km, jo më 4 km.. Të tilla përmasa i plotëson vetëm fusha e Kastriotit (nga shkolla e Kastriotit deri te sifoni mbi Dri dhe nga përroi i Kuke deri te Kodrat e Zdojanit, përballë Muhurrit) dhe vetë Fushë-Alia (Nga sifoni mbi Dri, deri te ura e Topuze).

KONTRIBUTI I FATOS DACIT PËR NDRIÇIMIN E HISTORISË SË SKËNDERBEUT

Mbështetur në studime skrupuloze, në dokumente arkivore e të dhëna gojore, Fatos Daci është i pari dhe i vetmi që ka zhvilluar veprimtari publike për Kastriotët dhe Skënderbeun te Muzeu i Sinës, duke filluar nga

6 maj 2008, kur muzeu ishte kthyer në sallë bagëtish. Pastaj, aty, vit pas viti, ka zhvilluar veprimtari publike në formë spektakli, duke e mbajtur në vëmendje e duke sensibilizuar opinionin për mirëmbajtjen e tij, si dhe për ta vizituar...

Fatos Daci ka shkruar 4 libra (tre të botuar dhe një në proces botimi), si: “Skënderbeu i vërtetë”, “Kastriotët e Çidhnës”, “Çidhna e Kastriotëve” dhe “Të vërtetat për Skënderbeun”

Ai ka realizuar tre dokumentarë, si: “Dibranët festuan ditëlindjen e Skënderbeut”, “Dibra priti me madhështi birin e saj” dhe “Shëngjergji i Skënderbeut”.

Kontributi i këtij autori me mbi 60 libra të botuar konsiston, gjithashtu, në realizimin e tre sesioneve shkencore në Peshkopi për origjinën e Kastriotëve dhe vendlindjen e datëlindjen e Skënderbeut: më 6 maj 2008, më 6 maj 2010 dhe më 25 nëntor 2018.

Në harkun kohor të pesë viteve të fundi ai ka realizuar 5 spektakle në Sinë, më 6 maj, për ditëlindjen e Skënderbeut; Ka realizuar spektakël në Sinë, në kujtim të kthimit të Skënderbeut nga Nishi, më 3-10 nëntor 1443.

Si studiues dhe botues, F.Daci ka mbajtur dy kumtesa shkencore për Skënderbeun jashtë vendit, për origjinën dibrane dhe ditëlindjen e tij, një në SHBA dhe një në Pulia të Italisë, që të dyja gjatë vitit 2018.

Ai ka organizuar ceremoninë e dorëzimit prof.Kristo Frashëri të titullit “Qytetar Nderi” të komunës së Arrasit, te Muzeu Historik Kombëtar, më 25 maj 2008.

Që nga viti 2005, në vijimësi, ka marrë pjesë në debate dhe polemika me autorë të ndryshëm në shtypin e ditës lidhur me origjinën e tij dhe në mbrojtje të figurës së Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Dendësia e veprimtarive mjaftë produktive e cilësore të Fatos Dacit përfshin gjithashtu përrurimin e disa librave kushtuar Skënderbeut në Tiranë, Dibër të Madhe dhe Peshkopi.

RISJELLJA NË VËMENDJEN E OPINIONIT DIBRAN E SHQIPTAR I MUZEUT TË VETËM TË KASTRIOTËVE NË SINE TË DIBRËS!

Z.Fatos Daci, Mjeshtër i Madh, me shumë kontribute për historinë e Dibrës dhe të Kukësit, ishte ai që e risolli në vëmendje të publikut dhe të

vizitorëve Muzeun unik e të Kastriotëve në Sinë. Që nga nëntori i vitit 1985, ku ky muze u inaugurua në mënyrë solemne, deri në vitin 2008, I ishte lënë harresës kolektive. Aty nuk bëhej asnjë vizitë, nuk zhvillohej asnjë veprimtari. Çelësi i Muzeut ishte në dorë të një personi që pretendonte se Muzeu ishte ndërtuar në tokën e tij, i cili e kishte kthyer në stallë bagëtish.

Në maj të vitit 2008, Fatos Daci, në vitin 2008, organizoi ditëlindjen e parë të Skënderbeut te ky muze me një aktivitet publik, që ishte edhe vizita e parë e një komuniteti të madh. Atë ditë, për herë të parë u hap dera e Muzeut. Atë ditë e më pas, e ngriti problemin e gjendjes së mjeruar të tij te strukturat kryesore vendore dhe te komuna, të cilat u vunë në lëvizje. Kjo nismë gjeti përkrahjen e ndihmën e z.Sali Tërshalla Dr.Shkencave dhe kryetar i komunës së Arrasit dhe të z.Xhafer Seiti, atë kohë prefekt i Dibrës.

Që nga kohë z.Daci dhe Unioni i Krijuesve Dibranë, që drejton, ka festuar në vijimësi çdo 6 Maj ditëlindjen e Heroit, shoqëruar dhe me sesione shkencore në Peshkopi. Ftesës për të mbajtur kumtesa i janë përgjigjur Prof. Paskal Milo, Prof. Bernard Zotaj, Prof. Bardhosh Gaçe, Dr. Asllan Zemani, Azis Keta, Haki Pernezha, Enver Kaloshi, Ali Hoxha, Murat Koltraka etj. të cilët gjejmë rastin t'i falënderojmë publikisht, si dhe operatorët Neki Feta dhe Islam Shehu, që i kanë ndjekur të gjitha veprimtaritë, për t'i pasqyruar në televizionet, për të cilët ata punonin.

Më 25 nëntor 2018, në bashkëpunim dhe me “Çidhna e Kastriotët”, organizoi veprimtarinë më të bukur në shkallë vendi, në kuadër të Vitit të Skënderbeut, kur me një veprimtari brilante e shumë të arrirë organizoi “kthimin” e Heroit nga Nishi, më 10 nëntor 1443.

Që nga viti 2008, nisi vullnetarisht të bënte rikonstrukcionin e Muzeut të Kastriotëve në Sinë.

Në një rast, siguroi pllakat, dhuratë nga nderuari Astrit Kuçi, dhe me shpenzimet e tij i dërgoi nga Fushë-Preza, ku i mori, në Sinë. Për fatin e tij, pasi i shkarkoi te hyrja e rrugës së Muzeut me njerëzit që i pagoi vetë, aty u gjend administratori i firmës që kishte fituar tenderin nga bashkia, z.Faruku, dhe ia dorëzoi falas pllakat, ndërkohë që la edhe gjithë materialin figurativ të printuar, fatin e të cilit nuk e di as sot. Me këtë rast la falas për vizitorët edhe 200 copë të librit guidë për Skënderbeun, të titulluar “Kastriotët e Çidhnës së Dibrës, printuar i gjithi me ngjyra.

Sot, falë edhe interesimit të bashkisë së Dibrës, Muzeu është në gjendje

shumë më të mirë, nga ç'ishte kur qe harruar, si deri në vitin 2008.

Çdo veprimtari e zhvilluar te Muzeu i Kastriotëve në Sinë dhe Peshkopi është reklamuar fuqishëm me video, fotografi të shumta dhe kronika në shtypin e ditës, në gazetën “Dibra” dhe në rrjetet sociale.

Megjithatë, duhet bërë dhe më shumë. Materiali figurativ ka dhe gabime shkencore, të cilat Fatos Daci i ka vënë në dukje, por që nuk janë korrigjuar.

KONKLUZIONE

Autori Fatos Daci, me përvojë të gjatë në fushën e botimeve dhe studimeve, në librin e tij më të fundit “*Të gjitha rrugët të çojnë në Dibër – Tuqia vulos: Skënderbeu lindi në Sinë të Dibrës*” ka përdorur të gjitha argumentet për të arritur në konkluzionet e tij. Në librin e zotit Daci gjen plot dokumente arkivore, pa ju heq e ju shtuar asgjë, siç bëjnë rëndom disa që abuzojnë me dokumentin. Raste të tillë sillen me shembuj konkret. Autori bën qartësisht analizën historike, deri dhe analizë gjuhësore, gramatikë historike etj. Në argumentet e tij, ai, mbështetet edhe te toponimet.

Kështu në artikullin “*Toponimia vërteton lidhjet e vetme të origjinës së Kastriotëve me Dibrën*” (fq.46), pasi bën përkufizimin e saktë të vendndodhjes së fshatit Kastriot, përshkruan me hollësi *toponime të këtij fshati*, si “*Kulla e Gjoni*”, “*Ograja e Gjonit*”, “*Kopshti i Gjonit*”, “*Pusi i Gjonit*”, “*Zabeli i Gjonit*”, “*Guri i shamates*”, “*Kodra e pareve*”, “*Guri i kazanave*” etj.

Më tej në faqen 47 të këtij libri, autori F.Daci shkruan se “*Toponime të tilla që lidhen me Kastriotët dhe Skënderbeun gjenden edhe në Muhurr e Selishtë*”, *ku sipas tij, në Muhurr me rëndësi është toponimi “Arat e Mazrekave”, dhe vendndodhja e tij ndodhet pikërisht në ato kordinata që përshkruajnë historianët .*

Referuar këtyre burimeve, autori Daci, shkruan, se “*Njoftimet arkivore, letrare, gojore dhe toponimike që kemi deri tani mbi familjen e Kastriotëve, pajtohen midis tyre dhe plotësojnë njëri-tjetrin, të paktën në vijat kryesore*” (fq.481). Dhe ajo çka është më e rëndësishmja, thyerja e heshtjes nga historiografia turke për të cilën autori F.Daci me të drejtë shkruan: “*Historiografia turke, pas një heshtjeje mbi 5 shekulle, më në fund foli dhe foli publikisht e me zë të lartë për Skënderbeun. Ishte Instituti i Studimeve*

Ushtarake të Turqisë, i cili i kushtoi një dokumentar Gjergj Kastriotiti, tek seriali 'Jetë luftëtarësh'. Ky Institut studimesh, në fjalinë e parë pohon atë që kemi deklaruar në dhjetëra artikuj, katër libra e disa intervista televizive kushtuar Heroit tonë kombëtar, se Skënderbeu ka lindur në Sinë të Dibrës më 1405".(fq.64). Ndaj dhe Prof.dr.Hasan Çipuri shkruan në parathënie se: "Për të sqaruar dhe argumentuar të vërtetën mbi origjinën dhe vendlindjen e Skënderbeut, autori (F.Daci) ka përmendur në libër mbi 28 studiues të huaj dhe mbi 40 historianë shqiptarë nga më të spikaturit, duke filluar që nga Marin Barleti e Gjon Muzaka, te Fan Noli, Naim Frashëri, Marin Serdari, Dhimitër Frengu, e deri tek Aleks Buda, Kristo Frashëri, Sabri Godo, Mustafa Kruja, Injac Zamput, Kasem Biçoku, Luan Malltezi, Shahin Leka, etj. Gjatë hulumtimit të burimeve të nevojshme, autori ka pasqyruar 110 referenca të shënuara sipas çështjeve të renditura në libër".

Dyzetenëntë vjet më parë (janar 1974), çështja e origjinës krahinore të Kastriotëve u bë objekt i një studimi të veçantë të profesor Kristo Frashërit, i cili për herë të parë trajton shkencërisht edhe çështjen e vendit ku lindi Skënderbeu. Në artikullin e tij me titull "Nga ishin Kastriotët? Ku lindi Skënderbeu?", ai shtroi për diskutim dhe ballafaqim të gjitha burimet arkivore dhe letrare, të cilave u shtoi edhe të dhënat toponimike që mblodhi në terren. Nga analiza e këtyre të dhënave, profesor Frashëri del në përfundimin se, me emrin Has, kronika raguziane e Lukarit dhe koleksioni boshnjak i Fermenxhinit, nuk kanë pasur parasysh krahinën e sotme të Kukësit, pasi kjo krahinë, deri në fund të shek. XVI quhej Pashtrik. Ata, sipas Profesor Frashërit, kanë pasur parasysh një nga krahinat e rrethit të Dibrës, qendra e së cilës është Çidhna, e masakruar barbarisht nga Sulltan Mehmeti II më 1466, në gjirin e së cilës ndodhen fshatrat Kastriot, Sinë dhe Gardhi i Poshtëm, që lidhen historikisht me familjen e Skënderbeut.

Tetë vjet më vonë, *historianët e mirënjohur, prof. Stafanaq Pollo e prof. Kristo Frashëri, pasi vizituan muzeun e Kastriotëve në Sinë të Dibrës lanë këtë shënim në fletoren e përshtypjeve të vizitorëve të këtij muzeu: "Sinë, 12 shtator 1982. Vizituam muzeun e vogël të fshatit Sinë, vendi i origjinës së Kastriotëve dhe Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut. Përsëritësishëm nismën e banorëve të Sinës dhe atyre që e përkrahën ngritjen e këtij Muzeu. Urojmë që ai (muzeu) të pasurohet sa më shumë e më shpejt dhe të kthehet në një objekt historik të vizitueshëm, për edukimin e brezit të ri".*

Pikërisht kjo referencë nga historianët e mirënjohur, prof. Stafanaq Pollo e prof. Kristo Frashëri e bën më të besueshëm librin “*Të gjitha rrugët të çojnë në Dibër – Tuqia vulos: Skënderbeu lindi në Sinë të Dibrës*” të autorit Fatos Daci, një botim ky me vlera vërtet shkencore. Kjo edhe për faktin se nëse, sot, ekziston një korpus i madh botimesh mbi origjinën e Kastriotëve dhe vendlindjen e Skënderbeut, historia skënderbegiane do të ishte e mangët pa këtë libër të autorit Fatos Daci, i cili përveç studimeve të shumta serioze e të mirëargumentuara, *sjell më së fundi për publikun faktin e pakontestueshëm: serialin e dokumentarit turk ku që në fillim deklarohet Sina e Dibrës si vendlindja e Heroit tonë kombëtar*. Po, është Fatos Daci, që ka sens në edukimin e gjeneratave dhe studimin e historisë kombëtare, ai që hedh dritë mbi historinë reale skënderbegiane, ndryshe nga shtrembërimet e historiografisë së derisotme. Sot, ai ndjehet krenar dhe është i nderuar për faktin se puna e tij studimore shumëvjeçare ka arritur në destinacionin e duhur, e çertifikuar tashmë edhe nga Instituti i Studimeve Ushtarake të Turqisë që deklaroi Sinën e Dibrës si vendlindje të Skënderbeut.

Si e vlerëson elitën gjirokastrite Prof. dr. Hajri Shehu

NGA ÇABEJ E KADARE, TEK YLLI ASLLANI–KUSH JANË 58 DIJETARËT E GJIROKASTRËS



- Gjuhëtari dhe leksikografi i njohur, një libër me kujtime e vlerësime për kohën kur punoi si mësues i anglishtes në Gjirokastrë
- Profesor Hajri Shehu evidenton veçori specifike edhe në profilin krijues të Kadaresë, për të cilin, ndër të tjera shkruan: “Të jesh gjeni i gjuhës, do të thotë ta zgjedhësh e ta përzgjedhësh shumë fjalën për kontekstin tënd (p.sh: sinonimet), të zgjedhësh e të përzgjedhësh bashkëlidhjet reale, tipike të fjalëve, fjalëformimet mbi bazën popullore të gjuhës dhe sepcifikisht për shqipen, të vjelësh fjalën popullore, duke zbatuar standardin. Ai ka mbi 60 vjet që e bën këtë. Dhe gjeniu respektohet. Respektohet duke i zgjedhur thëniet tona sipas modelit të gjeniut. Dhe duke i pasqyruar në vepra gjuhësore kodifikuese (fjalorë). Në fjalorin e gjuhës shqipe, fjalët arkëmort, dehashpirt, e shumë të tjera janë formime të Ismail Kadaresë”.

Mirënjohja, si shprehja më e bukur e karakterit të njeriut, gjen mishërim të plotë në librin e prof. dr. Hajri Shehut “Për Gjirokastrën dhe nxënësit e Gjirokastrës”. Gjuhëtari dhe leksikografi i njohur, i vlerësuar si “një personalitet i heshtur i gjuhësisë shqiptare”, 35 vjet punonjës shkencor

në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave (1971-1993 dhe 1997-2010), kurrresi nuk mund t'ia linte "harresës" tri vitet kur shërbeu si mësues i gjuhës angleze në Gjirokastrë (1966-1968) në shkollën 12-vjeçare "Koto Hoxhi" dhe në gjimnazin "Asim Zeneli". Kjo edhe për faktin se këtu njohu dhe studioi më nga afër veprat krijuese të elites gjirokastrite. Dhe kështu, pas një pune përkushtimore disavjeçare, prof. Shehu botoi librin me kujtime "*Për Gjirokastrën dhe nxënësit e Gjirokastrës*". Dhe jo rastësisht, por sepse siç shkruan autori në këtë vepër (fq.58), "*Gjirokastra ka pasur e ka shtetarë, ministra dhe zëvendësministra. Veprimtarë. Profesorë. Pedagogë. Pionierë të arsimit kombëtar. Intelektualë të përmasave të mëdha. Emrin ta bën vepra, nuk ta bën rangu. Këta janë ata që emrin ua ka bërë vepra dhe puna...*". Dhe jo rastësisht, prof. Shehu evidenton, jo një e dy, por 58 nga dijetarët e Gjirokastrës (veprimtarë të Rilindjes Kombëtare, Heronj të Popullit, akademikë, historianë, gjeografë, gjuhëtarë, përkthyes, poetë, mjekë, ushtarakë etj), me të cilët ka pasur të bëjë ose që ua njej veprën. Radhitja është sipas rendit alfabetik.

Duke i hyrë në "hak", po veçoj disa prej tyre, që edhe unë i kam njohur ose i kam studiuar.

Eqrem Çabej, Profesor, Akademik, Etimolog e historian i gjuhës, Mësues i Popullit, Nderi i Kombit; **Ismail Kadare**, Shkrimtar i Madh, Akademik; **Musine Kokalari**, Prozatore; **Aleksandër Meksi**, Profesor, Historian i Artit, **Agim Shehu**, Poet, Kritik letrar, Studiuues; **Fatos Tarifa**, profesor, Ambasador; **Katjusha Pogaçi**, Poete, Kulturologe, Veprimtare për emancipimin e gruas...

Por, më së miri, me këta emra të elitës gjirokastrite na njej prof. Hajri Shehu, bashkautor në veprën madhore "Fjalor i Gjuhës së sotme shqipe" (1980), nderuar me Çmimin e Republikës.

Në shkrimin me titull "*Një fjalë e dytë për breza e brezatarë dijetarësh*", ai ka ditur të përveçojë anë të panjohura të këtyre personaliteteve. Kështu, për akademikun Eqrem Çabej "Nderi i Kombit", ndër të tjera ai shkruan: "*I madhi Çabej. I madhi etimolog dhe historian i gjuhës shqipe. Ishte shkencëtar i përmasave europiane. Por një njeri aq i thjeshtë. Kur i përshëndeste në mëngjes vajzat e Institutit – punonjëse tekniko-shkencore a skedariste, hiqte kapelën. Zbriste vetë në bibliotekë dhjetëra herë në ditë për t'u konsultuar me fjalorë, kur ato mund t'ia sillte në zyrë një nga punonjëset tekniko-shkencore të sektorit...*"(fq.63).

VEÇORI SPECIFIKE NË PROFILIN KRIJUES TË KADARESË...ETJ

Profesor Hajri Shehu evidenton veçori specifike edhe në profilin krijues të Kadaresë, për të cilin, ndër të tjera shkruan: *“Të jesh gjeni i gjuhës, do të thotë ta zgjedhësh e ta përzgjedhësh shumë fjalën për kontekstin tënd (p.sh, sinonimet), të zgjedhësh e të përzgjedhësh bashkëlidhjet reale, tipike të fjalëve, fjalëformimet mbi bazën popullore të gjuhës dhe sepcifikisht për shqipen, të vjelësh fjalën popullore, duke zbatuar standardin. Ai ka mbi 60 vjet që e bën këtë. Dhe gjeniu respektohet. Respektohet duke i zgjedhur thëniet tona sipas modelit të gjenit. Dhe duke i pasqyruar në vepra gjuhësore kodifikuese (fjalorë). Në fjalorin e gjuhës shqipe, **fjalët arkëmort, dehashpirt**, e shumë të tjera janë formime të Ismail Kadaresë”*.

Nga një këndvështrim real dhe objektiv e përshkruan profesor Shehu edhe Alizot Emirin, librar. Si një burrë mjaft komunikues e mjaft miqësor, që e bënte mjaft mirë propagandën për librin në librarinë, kur ngjiteshe për te Qafa e Pazarit. Dhe nuk ngurron të shprehë kënaqësinë të thotë që bagazhi i tij më i rëndë, kur është transferuar nga Gjirokastra, ka qenë ai i librave. I librave ku shiste Alizoti...Kësisoj, qoftë dhe me këtë portretizim të Alizot Emirit, profesor Shehu – autor i mbi 100 artikujve shkencorë në disa revista shkencore dhe katër monografive, (në kohën e sotme kur pranohet se është zbehur interesimi për librin) ju vjen në ndihmë librarëve të sotëm për të përsosur metodën e punës së tyre për propagandimin e librit.

Prof. Hajri Shehut, i cili është edhe në librin *Ndërkombëtar të Biografive*, si gjuhëtar, në librin e tij, vlerëson edhe Musine Kokalarin, që përveçse si një veprimtare politike e kulturore dhe shkrimtare shqiptare e shekullit të XX, ka lënë gjurmë edhe me studimin për të folmen e qytetit të Gjirokastrës.

“Musine Kokalari. Prozatore. Ka botuar disa libra. Në veprën e saj mund të njohësh të folmen e qytetit të Gjirokastrës. Prof. Mimoza Kore ka disa artikuj shkencorë për të folmen e qytetit të Gjirokastrës, ndër to, edhe sipas prozës së Musine Kokalarit (Vepra e Musine Kokalarit, mbështetje për studimet etno-linguistike për rajonin Tosk”, “E folura e grave gjirokastrite në veprën e Musine Kokalarit”, etj). (fq.67).

“MENDJA KA FORMËN E SAJ TË VEÇANTË NË ÇDO GJUHË”

Si anëtar i Euraleksit (*Shoqata Europiane e Leksikografëve*), profesor Hajri Shehu ka vlerësim të veçantë për gjuhën. Si gjuhëtar, në shkrimin, “*Pak për mësimin e gjuhës së huaj*”, referuar Rusoit, ndër të tjera, shkruan: “*Mendja ka formën e saj të veçantë në çdo gjuhë. Mendimi i njerëzve formohet nga mënyra si flasin. Mendimet e tyre ngjyrosen nga gjuha e tyre... Nëse flet gjuhën standarde, do të thotë se je bashkaatar me bashkësinë (që e flet atë)*”.

Në këtë optike i sheh autori i këtij libri edhe zhvillimin kulturor në qytetin e Gjirokastrës dhe gjirokastritët si produkt të familjes, të shkollës dhe mjedisit (rrethanave shoqërore). Sepse, kultura është tërësia e arritjeve të një populli dhe të gjithë njerëzimit në fushën e prodhimit dhe në zhvillimin shoqëror e mendor. Kësisoj, duke shkruar për aspekte të veçanta të kulturës shoqërore, kulturës së lartë familjare, kulturës së lartë materiale si dhe kulturës së lartë artistike, prof. Shehu i vlerëson ato të pandara nga qëndrim i veçantë i gjirokastritëve ndaj mjedisit rrethues, karakterit krijues dhe simbolikave si tipar dallues, vetëm i njeriut të të gjitha epokave.

Mesazhet që përcjell autori në këtë drejtim janë aktuale dhe në koherencë me realitetin e trishtë të dhunimit të grave, madje duke i detyruar të kryejnë akte ekstreme tragjike (si rasti i fundit në Shkodër...).

“*Kam parë një kulturë të lartë familjare në Gjirokastrë. Ku? Te sjellja e burrave me gratë dhe vajzat. Mënyra se sillet dikush me femrat, tregon se çfarë është e çfarë dëshiron të jetë..*”, shkruan prof. Shehu. (fq.49). Dhe për këtë i referohet një filozofi të hershëm, që konsiderohet një nga personalitetet më të mëdha të të gjitha kohërave (*kështu e përcakton amerikani Maikëll Hart*) Michael Hart, i cili në librin e tij “*100 Personalitete më me influencë në Botë*”, Tiranë, 1998) thotë: “*Gratë janë binjaket e burrave*”. Ndaj me te drejtë autori Shehu konkludon se fjalë më diturore e më vlerësuese e më emancipuese nuk mund të ketë. Sepse këtë binjakësi të grave me burrat e ka parë në Gjirokastrë. Në gjithçka....

NGJARJE, BËMA, NJERËZ...

Gjuhëtari dhe leksikografi i njohur, në librin e tij me kujtime e vlerësime për kohën që punoi si mësues i anglishtes në Gjirokastrë (1966-1968) ka vlerësim objektiv edhe për kontributin e gjirokastritëve në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Sepse sipas tij, Gjirokastra nuk ishte vetëm e penës dhe e shkollës. Gjirokastra ishte edhe e pushkës. E pushkës çlirimtare.

Nga ky këndvështrim, përveç faktit se dikur nga vitet '80, Gjirokastra-qyteti i muzeve, kishte 22 muze (dhe i tërë rrethi 83), prof. Shehu ndalet tek Muzeu i Armëve në Kala, ku parakalonin si në revistë ngjarje, bëma, njerëz.

“Në Gjirokastrë ka pasur 250 baza të Luftës. Dolën malit për lirinë e atdheut 2000 partizanë. Nga ata, 10 janë Heronj të Popullit. Katër janë ish nxënës të gjimnazit: Ali Demi, Muzafer Asqeriu, Nuri Luçi, Themo Vasi. (Brenda një dite, nga gjimnazi i Gjirokastrës, dolën partizanë 130 nxënës). Në gjimnaz, u shkëlqenin emrat në një pllakë në mur, në katin e dytë. Në muze u shkëlqenin fytyrat. U shkëlqenin sytë. Vetëm nga qyteti pati 55 dëshmorë. Dhe vetëm nga minoriteti pasi 140 dëshmorë. Emrat e Heronjve të Popullit – Bule Naipi, Persefoni Kokëdhima, Fato Berberi dhe Sofie Noti i kanë kaluar kufijtë e historisë shqiptare”, shkruan ndër të tjera prof. Hajri Shehu. (fq.53).

Në librin e tij *“Për Gjirokastrën dhe nxënësit e Gjirokastrës”,* autori shkruan edhe për Ylli Asllanin, fëmija i tretë i familjes së pedagogut të njohur Muzafer Asllani dhe edukatores Nejme Asllani. Për këtë personalitet të njohur gjirokastrit, prof. Hajri Shehu, ndër të tjera shkruan: *“Në aktivitetin e tij publik, si president i Agjencisë së Mbështetjes së Infrastrukturës Vendore (AMIV), ka realizuar mbi 40 projekte në lëmin e demokratizimit të shoqërisë civile, përmirësimit të cilësisë së jetesës, infrastrukturës dhe zhvillimit rajonal, duke qenë partner me një varg programesh të Bankës Botërore, USAID-it, European Aid, Crossborder, IOM, UNHCR, OSBE, Fondacionit “Soros”, Interreg 2-3, Komisioni për Demokraci (U.S. Embassy), REC, Partners of Albania” etj.*


Dhe po në këtë faqe (253) jep disa detaje simbolike për karakterin e Haxhiart Asllanit, që qe shumë i talentuar dhe ndër inxhinierët mekanikë më të aftë në vend.

Dhe kështu, lexuesi mund të mësojë në këtë libër për dhjetëra personalitete të elitës gjirokastrite me kontribute kombëtare e ndërkombëtare. Ashtu siç mund të njihet me vlerësime për *“Bukuritë ndërtimore të Gjirokastrës”*. Lexuesi mund të befashohet me fjalën artistike të autorit në shkrimet: *“Nga Peshkopia në Gjirokastër”*, *“Në shkollën “Koto Hoxhi”*, *“Dheu i Gjirokastrës”*, *“Lagje, shtëpi dhe emra”*, *“Kultura gjirokastrite”*, *“Gjirokastra – qytet i muzeve dhe bibliotekave”*, *“Gjirokatra e dijetarëve”*, *“Katër kompozitorët”*, *“Arkeologë për Gjirokastrën”*, *“Për gjashtë pushtetarë dhe partiakë”*, *“Kolegë e kolege të shkollave ‘Koto Hoxhi’ e ‘Asim Zeneli’*. Për këta të fundit mjafton qoftë dhe perifraximi në hyrje të librit: *“Me kënaqësi të veçantë shpreh mirënjohjen time të përzemërt për kolegët – Dashamir Gega e Mineko Labi dhe për ata ish-nxënës e ato ish – nxënëse – Dhimitër Doko, Harallamb (Lame) Qirko, Katjusha Latifi (Pogaçi), Niko Rogo, Odhise Çerkezi, Pirro Millona, Tatjana Elmazi (Kora), Tatjana Karagoji (Çene), Ylli Asllani, Ylli Xhakollari, që sollën fjalën e tyre në këtë libër”*.

Për vetë vlerat ideoartistike e shkencore që bart, ky libër pa asnjë mëdyshje mund të konsiderohet si një përmendore për elitën gjirokastrite. Qoftë vetëm me këtë lexim, jam i një mendjeje me prof. dr. Eshref Ymerin për vlerësimin e profesor Hajri Shehut si një intelektual-shkencëtar me një botë mjaft të pasur shpirtërore, i thjeshtë si e vërteta, të cilin ke kënaqësi ta dëgjosh kur bisedon shtruar, pa folur kurrë për vetveten.

PAK RADHË PËR PROF. DR. HAJRI SHEHUN

Ka lindur më 10 qershor 1942 në fshatin Vleshë të qarkut të Dibrës. Ka mbaruar shkollën e mesme pedagogjike në qytetin e Peshkopisë. Gjatë vitit 1961 ka qenë student i Institutit të Gjuhëve Lindore në Moskë. Pasi Hrushovi i ndërpreu të gjitha marrëdhëniet me vendin tonë, ai u kthye në atdhe dhe në



vitin 1965 i përfundoi studimet e larta në degën e gjuhës angleze të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Në periudhën mes viteve 1965-1966 dhe 1968-1970, ushtroi detyrën e mësuesit të gjuhës angleze në qytetet e Peshkopisë dhe të Gjirokastrës. Meqenëse gjatë kësaj periudhe kishte shfaqur interesim të veçantë në lëmin e studimeve gjuhësore, drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, prof. Androkli Kostallari, u interesua në strukturat përkatëse shtetërore për ta tërhequr në Institutin në fjalë. Kjo u bë e mundur në vitin 1971, kur ai filloi punën në Sektorin e leksikologjisë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave. Në këtë Institut ai punoi vite të tëra (1971-1993, 1997-2010), derisa doli në pension.

Prof. dr. Hajri Shehu ka veprimtari të pasur shkencore, si filolog, si përkthyes e si hartues tekstesh mësimore për gjuhën angleze. Ai është bashkautor dhe autor i 22 fjalorëve të gjuhës shqipe dhe të fjalorëve anglisht-shqip, shumica të botuar dhe ca në dorëshkrim, por që po përgatiten për në shtyp. Është autor i disa monografive dhe i më shumë se 100 artikujve shkencorë, kushtuar problemeve të gjuhës së sotme letrare shqipe, të leksikologjisë, të leksikografisë dhe të fjalëformimit. Është anëtar i Euraleksit (Shoqata Europiane e Leksikografëve). Është në librin Ndërkombëtar të Biografive, Kembrixh.

HAZIS NDRU, IKONË E ARTIT DHE KULTURËS KOMBËTARE

**Për librin “Burri i odes dibrane” të autorit
Bujar Kapexhiu – Nderi i Kombit**

*Hazis Ndreu arriti shumë shpejt ta ngrejë në nivele kombëtare e
ndërkombëtare emrin e artit dhe mençurisë së Dibrës*

- **DRITËRO AGOLLI:** “Hazis Ndreu, miku im, mjeshtër i humorit dibran. Sot e kësaj dite si ai nuk gjen më. I papërsëritshëm, i papërtuar, modest dhe shpirtmirë”
- **MOIKOM ZEZO:** “Hazisi është unik. I veçantë, i rrallë në çdo krijimtari të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë shkrimtarëve me mënyrën e veçantë të të rrëfyerit, duke qenë një nga pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjërimit, jo vetëm kombëtar, por ndoshta edhe europian”
- **AGRON TUFA:** “Hazis Ndreu ishte ‘magu’, i cili me prekjen e tij magjike e ngre peshë zemrën e çdo dibrani, pasi arti i tij i flet atij për gjërat më të vyera të pajës më të vyer shpirtërore... Thjesht, Hazis Ndreu arriti shumë shpejt ta ngrejë në nivele kombëtare e ndërkombëtare emrin e artit dhe mençurisë së Dibrës. Ne kemi pasur fatin që jemi përfaqësuar si kulturë përmes një artisti si ai”

HISTORIA E NJË SPEKTAKLI

Në 2008, u realizua një spektakël madhështor në përkujtim të “Artistit të Merituar” Hazis Ndreu – “Mjeshtër i Madh”. Skenarist, regjisor dhe prezantues, prof. Bujar Kapexhiu – “Mjeshtër i Madh”. Një spektakël për një artist dhe njeri të madh, ku interpretuan artistë dhe njerëz të mëdhenj të botës së artit, kulturës e shkencës. Në formë gjysmëharku, në skenën e sallës së madhe të ishSHQUP-it, me sfond portretin e madh të Hazisit, qenë ulur të gjithë pjesëmarrësit e spektaklit.

Artistët, aktorët, këngëtarët, valltarë të radhitur në krah të njëri-tjetrit. Përballë, spektatorët, ashtu siç ulen në formë harku, në shiltetë e Odës Dibrane. Skena me artistët dhe salla me spektatorët, tamam një Odë Dibrane gjigante, e mbushur plot e përplot.... Një kompozim perfekt i një spektakli perfekt, produkt i “Artistit të Merituar” Bujar Kapexhiu, që jo vetëm në aktrim e karikaturë, por edhe si skenarist e moderator, mbetet një Mjeshtër i Madh. Për të arritur deri te ky spektakël-show iu deshën muaj të tërë parapërgatitje...

Dhjetëra takime me studiuesit e Institutit të Folklorit, prof.dr. Ramazan Bogdani, Agron Xhagollin, Skënder Sallakun, Skënder Calën, Inajet Shehun etj. Të gjitha takimet të monitoruara besnikërisht nga Avniu, djali i madh artist i Hazisit, sipas të cilit: “Baba interesohej për të gjithë, të njohur e të panjohur, që ishin në hall apo që kishin ndonjë problem me zyrtarët. Interesohej për ata që hynin në burg, që i pushonin nga puna, për ata që s’kishin Triskë Fronti, për të futur dikë në shkollë, për vizitë te ndonjë mjek i zoti.... Ishte me një fjalë, derë e hapur për popullin, njoft e panjof... e dinin që Hazisi të mbaron punë se është i njohur dhe e duan të gjithë... deri në Tiranë... te qeveria”.

Pjesë e skenarit të spektaklit, studiuesi i mirënjohur Moikom Zeqo, i cili rrëfen se i ka bërë përshtypje të veçantë studimi i Hazis Ndreut për Skënderbeun, nëpërmjet toponimeve, legjendave dhe përgjithësisht studimit të terrenit... Me hulumtimin e të gjitha toponimeve që lidhen me Skënderbeun. Sipas tij, “Studimi i Hazis Ndreut në këtë pikë është diçka e re, është diçka serioze...”. Më pas, një tjetër artist i njohur dibran, Dervish Biba, ka zgjedhur të recitojë rapsodinë e Hazis Ndreut, “Dibrës sime”.

Para recitimit, ai shprehet se ka qenë fare i ri kur ka dëgjuar dhe është mrekulluar me këngët, rapsoditë e kërcimet e tij. Hazisi, si kërcimtar, në shumë festivale kombëtare e ndërkombëtare, qe fitues i shumë çmimeve, sidomos në vallen dyshe dibrane me kërcimtarin e mirënjohur Besim Zekthi. Vlerat e tij si koreograf e valltar i evidentoi më së miri prof. dr.Ramazan Bogdani. Studiuesi Agron Xhagolli, veç të tjerash, flet për Odën Dibrane si institucion dhe për burrin e saj, Hazis Ndreu.

“Një universitet që ua kalon shumë universiteteve me emër, për nga forca e riprodhimit të ngjarjeve, interpretimit, për nga mençuria dhe ironia e hollë, aspak fyese për mikun, por shumë favorizuese edhe për

t'u formuar në të...". Këtë e pohon artistikisht edhe "Artisti i Popullit" Reshat Arbana, me fjalë, por edhe me interpretimin e poezisë së Hazisit, të titulluar "Pajtimi". Më pas, "Artisti i Popullit", Skënder Sallaku, pohon meritën e padiskutueshme të Hazis Ndreut, i cili duke eksploruar në rrënojat e lashtësisë, si një historian i mirëfilltë, e futi Historinë e Dibrës në shina të sigurta për të ecur me dinjitet në fushën e madhe të Historisë sonë Kombëtare.

"Kemi qenë shumë miq të afërt me Hazis Ndreun. Një artist i rrallë, por mbi të gjitha një shok e mik i rrallë. I qeshur, fisnik, i mençur, muhabetçi, korrekt, punëtor, i papërtuar, talent. I shoqnisë, por jo i rakisë!". Pikërisht këtu "ndalon" Skënderi për të interpretuar më pas dy barsoleta, një tiranase dhe një dibrane (nga krijimtaria e Hazisit). Kështu vijoi spektakli, me interpretime të krijimtarisë së Hazis Ndreut nga Veli Rada, Luftar Paja, Behar Mera, Skënder Cala, Llesh Nikolla si dhe nga këngëtarët Arif Vladi, Lirie Rasha, Qerim Sula, Vera Laçi, Saje Poleshi...

Kështu u përkujtua Hazis Ndreu në 80-vjetorin e ditëlindjes së tij, me një spektakël madhështor të ideuar, inskenuar e realizuar nga prof.dr.Bujar Kapexhiu, emri i të cilit, (edhe si kryetar i Shoqatës Bashkësia Dibrane) spikat më së miri, sidomos në tubime intelektualësh dibranë, përvjetorë ngjarjesh e individësh të shquar apo dhe në promovime librash të autorëve dibranë, ku ky korife i mendimit dhe veprimit krijues po i lartëson kaq shumë, Dibrën dhe dibranët.

BURRI I ODËS DIBRANE

Dhjetë vjet më vonë, pikërisht në 90-vjetorin e ditëlindjes së tij, lexuesi ka në dorë profilin e "Burrit të Odës Dibrane" në një libër shumëvlerësh, të stilit dhe llojit të veçantë. Autor, Bujar Kapexhiu – Mjeshtër i Madh, Artist i Merituar, regjisor, skenarist dhe aktor i mirënjohur shqiptar. "Historia e një spektakli", pas qindra karikaturave të botuara në shtypin e përditshëm që janë përmbledhur në tre libra "Ngërç", "Për një karrige" dhe "Kthesë", është libri i B.Kapexhiut, ku "Burri i Odës Dibrane",



përveçse si profil i skalitur mjeshtërisht, të bën për vete edhe me karikaturat tejet miqësore për Hazis Ndreun e miqtë e tij të shumtë. “Historia e një spektakli” është një spektakël origjinal, në formën e një udhëtimi në vite me krijimtarinë e të madhit Hazis Ndreu, ku gjithçka është e dokumentuar në librat e tij me këngë e rapsodi, tregime alegorike e studime të mirëfillta historike. Gjithçka është e ilustruar me tregimet fantastike të këtij krijuesi e mendimtari të shquar. Gjithçka është e komentuar nga personazhe reale, biografia e të cilëve është historia e vërtetë e vendit tonë. Në tërësinë e tij, libri sjell Odën Dibrane, që në gjuhën popullore përfaqëson dhomën e pritjes së mikut. E përkufizuar në mënyrë sinjifikative nga Bujar Kapexhiu, “Ajo është simbol i vatrës bujare, besa e burrit, qëndresa e trimit, mençuria e fjalës, kënaqësia e muhabetit, sheshi i përplasjes së opinionëve, urtësia e më të moshuarve, këshilla e prindit, përkrahja e mikut, shpërthimi i këngës, sheshi i kërcimit, jehona e të qeshurit, kuadrati i lodrave, dashuria e respekti midis njerëzve, zanafilla e ngjarjeve, fundi i armiqësive, tempull për pleqtë, shkollë për të rinjtë, çerdhe e patriotizmit, burim i humorit. Oda është grumbullim njerëzish, miq, të afërm, farefis, komshinj, për arsye gëzimi, sepse hidhërimi, mikpritjeje të të ftuarve apo udhëtarëve nga larg. Këtu lindi dhe u rrit Hazis Ndreu...”

Autori vjen në këtë përfundim, pasi ka evidentuar vlerësimet e dhjetëra personaliteteve të letrave, artit, kulturës e shkencës për figurën dhe personalitetin e Hazis Ndreut, të cilat i ka përfshirë si kapitull më vete në librin “Burri i Odës Dibrane”. Mjaftojnë qoftë dhe vetëm disa perifrazime nga Dritëro Agolli, Kol Jakova, Moikom Zeqo, Agron Tufa, Tonin Çobani, Xhezair Abazi, Lutfi Turkeshi, Vasil Tole, Përparim Tomçini, Afërdita Onuzi, etj, për të konkluduar për një libër të bukur e për më tepër, shumë origjinal. Gjer më sot nuk është botuar një libër i tillë, me humor, studime, dialogë, anekdota e të gjitha këto të ilustruara me karikatura. Një libër që nxjerr në pah madhësinë e këtij artisti të rrallë, origjinal, duke e përqendruar këndvështrimin në zhanrin e humorit.

DISERTACION ME VLERA SHKENCORE

Dhe kur gjatë gjithë leximit të këtij libri, je munduar të evidentosh esencien në profilizimin e Mjeshtrit të Madh, Hazis Ndreu, për të shkruar qoftë edhe pak radhë për të, në ndihmë të vjen vetë autori, me

kapitullin përmyllës, “Kanë thënë për Hazis Ndreun”, në faqet 386-393. Dhe nëse për Dritëro Agollin, “Si Hazis Ndreu, mjeshtër i humorit dibran, sot e kësaj dite, si ai nuk gjen më, i papërsëritshëm, i papërtuar, modest dhe shpirtmirë”, për Moikom Zeqon “Hazisi është unik. I veçantë, i rrallë në çdo krijimtari të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë shkrimtarëve me mënyrën e veçantë të të rrëfyerit, duke qenë një nga pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjërimit, jo vetëm kombëtar, por ndoshta edhe europian”. Shkrimtari i mirënjohur Agron Tufa vlerëson se: “Hazis Ndreu ishte ‘magu’, i cili me prekjen e tij magjike e ngre peshë zemrën e çdo dibrani, pasi arti i tij i flet atij për gjërat më të vyera të pajës më të vyer shpirtërore...” Thjesht, Hazis Ndreu arriti shumë shpejt ta ngrejë në nivele kombëtare e ndërkombëtare emrin e artit dhe mençurisë së Dibrës. Ne kemi pasur fatin që jemi përfaqësuar si kulturë përmes një artisti si ai”. Me botimet e tij, “Dibra në udhën e historisë”, “Kastriotët dhe Skënderbeu në trojet arbërore”, “Ushtima e Malevë”, “Dibra dhe etnokultura e saj”, “Alegori dibrane” etj., Hazis Ndreu ka hyrë me dinjitet në fondin e artë të letërsisë shqipe. Le ta kujtojmë, nderojmë e respektojmë si të tillë Hazis Ndreun, si simbolin e Odës Dibrane, gatigati si një institucion lëvizës ndërshekullor i traditës, të cilin, shumëformësia e qasjes, ribërja letrare e evenimenteve historike, aftësia vrojtuese, kultura e begatë e shkathtësia përpunuese e lëndës së trevës së vendlindjes, me gjithë gamën përjetuese, e bëjnë të kapërcejë nga Dibra në vizionin e botës shqiptare në përgjithësi. Në këtë këndvështrim, libri i Bujar Kapexhiut, “Burri i Odës Dibrane”, është një ikonë dibrane plot vlera, është disertacion me vlera shkencore.

<http://www.panorama.com.al/hazis-ndreu-ikone-e-artit-dhekultures-kombetare/>–Gazeta “Panorama”, Jul 17, 2018

PROF.DR.ESHREF YMERI, SHTIGJEVE TË FJALËS ARTISTIKE

Mirënjohja si shprehja më e bukur e karakterit të njeriut gjen mishërim të plotë në librin e prof. dr.Eshref Ymerit, *Shtigjeve të fjalës artistike*. Që në hyrje të librit, me titullin “Dy fjalë”, ky personalitet i shquar i letrave dhe i kulturës kombëtare, falenderon të gjitha ato pena të talentuara shqiptare që ia kanë dhuruar librat e tyre me aq bujari. Dhe profesori ua shpërblen po me aq bujari, me mbresat e renditura me modesti në faqet e këtij libri.

Në librin e profesor Eshref Ymerit *Shtigjeve të fjalës artistike* gjejmë modelin më të mirë se si duhet shkruar recensionin i një veprë letrare.

Prandaj edhe prof.dr.Fatmir Terziu e konsideron veprën studimore të prof.dr.Eshref Ymerit “*Shtigjeve të fjalës artistike*”, një analizë tekstuale brenda zbërthimit kontekstual. “*Kjo vepër,-thotë ai,- është një ndalesë e gjatë e autorit, ku në thelbin e ndërmarrjes së tij u jep përgjigje të thellë e kuptimplote mjaftë enigmave ku rreken burimet e frymëzimeve të autorëve të ndryshëm, në atë pikë ku shkrimet e para janë të lidhura me faktet dhe me prototipat dhe në pikën ku krijimtaria e vëzhguar thellë e në detaje, merr një zhvillim më të madh*”.

“PËR TË QENË KRITIK I SHKËLQYER, DUHEN AFTËSI PËR TË QENË NJË SHKRIMTAR I MIRË”

Jo pa qëllim prof.Ymeri citon shkrimtarin dhe personalitetin shtetëror frances Fransua Vilmenit (*Abel-François Villemain – 1790-1890*), kritik dhe historian i letërsisë: “*Për të qenë kritik i shkëlqyer, duhen aftësi për të qenë një shkrimtar i mirë. Vetëm talenti është në gjendje t’i zgjerojë hapësirat*



e *dijes*". Në këtë qasje, prof.Ymeri rendit mbresa që ka përjetuar nga leximi i veprave artistike që ia kanë dhuruar mikësja apo miq të tij, pena të talentuara në botën e letrave shqipe. Dhe kështu, prof.Ymeri vlerëson strukturën e librit "*Vikama e tingullit*" të Vera Ibrahimit, kushtuar Artistit të Popullit, Feim Ibrahimit, shkruar në trajtë ditari, por me përthyerje kronologjike e me fluturime lirike e që të pushton qenien sapo ke lexuar rreshtat e parë.

Ndonëse shpreh me tepri modestinë e tij në analizën e veprave letrare të më shumë se 70 autorëve (që sërish, me modesti i quan "SHKRIME"), ato në vetvete janë recensa të mirëfillta, ku jepen detaje për tematikën, figuracionin, përmbajtjen e mesazhet që përcjellin.

Prof.Ymeri i evidenton fare qartë këto elementë, kur ndalet te "Shtegtimet lirike në poezinë e Elida Buçpapajt." Në analizën e vëllimit poetik me titull "*Ujshëm*", prof.Eshref Ymeri evidenton, ndër të tjera lirizmin që përbën njërin nga karakteristikat e të menduarit artistikisht të poetes, publicistes dhe përkthyeses së talentuar Elida Buçpapaj, që mbështetet në përjetimet vetjake gjatë perceptimit të ngjarjeve në morinë e realiteteve shqiptare, çka gjen pasqyrim në gjendjen e saj shpirtërore.

Po ashtu, në analizën e romanit "*Çatia e gjarpërinjve*" (Misteret e çatisë së gjarpërinjve"–fq.339), prof.Dr.Eshref Ymeri (të cilin me të drejtë prof. dr.Fatmir Terziu e konsideron "*Filozofi modern mes dy kohëve*"), shkruan: "...Poet-shkrimtari Eqerem Canaj e ka lidhur vërtetësinë e realitetit që përcjell në krijimtarinë e vet me shtresëzimet e një stili të papërsëritshëm që e shpërfaq me një shpirt krijues të jashtëzakonshëm".

Thjeshtësinë deri në madhështinë e tij, prof.Ymeri e tregon edhe në analizën e poezisë së Qazim D.Shehut, të cilin e konsideron një zë origjinal që ndjek shtigjet e veta të krijimtarisë, duke iu shmangur me elegancë përditshmërisë. Për prof.Ymerin, "*Ligjërimi poetik i Qazim D.Shehut të bën përshtypje për forcën shprehëse, të cilën ia japin mjetet artistike, figurat që ai di t'i organizojë me art*".

Në koherencë me realitetin objektiv prof.Ymeri analizon lirizmin emocionues të shkrimtares Mira Meksi, prozën tregimtare të Sotir Athanasit e Vilheme Vrana Haxhirajt, fushëbetejën e fjalës artistike të Uran Butkës, "potpurinë" letrare të Flori Bruqit, fabulën në penën e Nimfa Hakanit, si dhe poezinë e poetëve Daniel Gazulli, Artur Shemaj e Arqile Gjata.

FRYMA POLEMIZUESE....

Duke rrugëtuar nëpër këto shtigje, prof Ymeri, nuk ngurron të bëjë një “pushim të shkurtër” edhe te poezia elegjiake e Dritëroit me titull “*Më fal Enver*”, kur shkruan se “..dikatura e egër e kriminelit Enver Hoxha e kishte bërë punën e vet: Njerëzit i kishte zhveshur tërësisht nga dinjiteti personal”. Por vetëm një faqe më pas të kësaj vepre shumëpërmasore, me gjykim racional gjejmë një tjetër përfundim të prof.Ymerit për poezinë e Dritëroit me titull “*Sikur s’jetoj në vendin tim*”. Pasi pohon se e ka lexuar këtë poezi në faqen internetike VOALtë datës 19 shtator 2016, me moderatorë dy publicistë me emër të kombit shqiptar – Elida Buçpapaj dhe Skënder Buçpapaj, prof Ymeri shkruan: “*Poezia është mjaft prekëse dhe dëshmon për një zhgënjim tepër të madh të Dritëroit në këtë moshë të nderuar*”. Do të mjaftonin për të arritur në këtë përfundim qoftë edhe vargjet e të Madhit Dritëro: “*Ky vend më duket do helmohet krejt/ Nga helmi rrjedhur vrimash në themelet, /Pastaj do tundet toka në tërmet/ Dhe djalli i Madh do qeshë e do zgërdheshet*”.

I drejtëpërtejte, objektiv dhe konciz është prof.Eshref Ymeri kur shkruan se “*Nuk mbrohet Kadarea me të pavërteta*”. Pasi ka lexuar artikullin e botuar nga Poli Hoxha me titull “*Kadarea, Enveri dhe ata që s’kanë ‘jetuar’ atëherë*” (Gazeta “Ballkan”, 02 korrik 2004), prof.Ymeri ndër të tjera shkruan: “*Sigurisht, nga kujtimet e Kadaresë për Enver Hoxhën nuk del askund se ai ka qenë beniamin i diktaturës. Por halli është se ‘beniaminizmin’ e vet ndaj diktaturës Kadarea e ka vulosur me krijimtarinë e vet poetike, e cila është e shkruar e zezë mbi të bardhë dhe sot është pronë e mbarë lexuesve shqiptarë*”.

PËRSËRI PËR MIRËNJOHJEN

Mirënjohja, ky virtyt që e fisnikëron njeriun përshkon pothuajse tërë librin “*Shtigjeve të fjalës artistike*” me 543 faqe të prof.dr.Eshref Ymerit. Ashtu si modestinë, edhe mirënjohjen, prof. Ymeri e shfaq me tepri, jo vetëm në përditshmërinë e tij, në takimet me miq e shokë, por edhe në analizën e veprave të autorëve të ndryshëm (pa i diferencuar ato) .

Ndoshta, nisur edhe nga kjo anë e profilit të tij, miku im, publicisti dhe prozatori i njohur Shefqet Meko, shkruan: “*Prof.dr.Eshref Ymeri është nga ata burra, që i peshon fjala dhe i ndrit karakteri. Ai, me gjithë aftësitë e*

shquara si përkthyes dhe intelektual, nuk u bë kurrë vegël e politikës jargavitëse të kohës që jetojmë, por duket se ka nënshkruar vetëm një 'kontratë' me të vërtetën dhe Shqipërinë”.

Po. Prof.Eshref Ymeri ka qenë dhe është i drejtpërdrejtë ndaj kalemxhinjve, që tentuan dhe tentojnë të shtrembërojnë historinë e kombit tonë. Ai i tillë është edhe në shprehjen e mirënjohjes për ata dhjetëra krijues të talentuar që veprat e tyre i bazojnë tek e vërteta. Prandaj jam i një mendjeje me Skënder Sadri Kapitin, i cili, i nxitur nga shkrimi i prof.dr.Eshref Ymerit, me titull “*Mirënjohja është pasuri shumë e çmuar shpirtërore*” (faqja e internetit “Fjala e lirë”, 11 janar 2021) shkruan: “Te profesor Eshref Ymeri, mbi gjithçka konstatojmë shpirtgjerësinë, modestinë dhe respektin e mirënjohjen që e karakterizon”. Këto veti të karakterit të tij i gjejmë pothuajse në të gjitha vlerësimet e librave, të përmbledhura në veprën “Shtigjeve të fjalës artistike”.

Po ashtu edhe Vilheme Vranari-Haxhiraj – akademike, Mjeshtre e Madhe, në librin e saj “*Elitat e mohuara...Krenari kombëtare*” (*Shtëpia Botuese “Nacional”-Tiranë 2019, fq 404-411*), ndër të tjera shkruan: “Eshref Ymeri është një personalitet dhe individualitet i veçantë i kulturës sonë kombëtare, një erudit që ka dhënë vlera të pallogaritshme në fushën e gjuhësisë, të përkthimit dhe të publicistikës”.

Dhe së fundmi, dua të përshfaq edhe mirënjohjen që prof.dr.Eshref Ymeri shpreh për shoqen e shtrenjtë të jetës së tij, Havanë. Jo vetëm për mirërritjen e miredukimin e dy fëmijëve të tyre, Plarentit dhe Kesianës, të cilët tashmë kanë hyrë me dinjitet në indin e jetës amerikane, por edhe për ndihmën e çmuar në redaktimin dhe korrektimin e artikujve publicistikë dhe të librave të botuar.

PËR POETIN E KËNGËS, NAIM PLAKU

Katër dekada pas ndarjes nga jeta të autorit të poemës së famshme “Bagëti e Bujqësi”, lindi një tjetër poet i talentuar, me të njejtin emër. Jo në Frashër të Përmetit, por në Sllatinë të Dibrës.


“Data shënonte 14 nëntor 1940. I jati, Shemsiu ishte në punë e vonë, kur u kthye, e mori vesh se ishte shtuar me një djalë.... Emri Naim ishte emër i librave. Nxënësit e shkollave, ato që kishin pak klasë, e njihnin këtë emër. Ishte Naim Frashëri i Rilindjes sonë Kombëtare. Nxënësit e mësonion nëpër shkolla e të rriturit e kishin lexuar. Edhe në shkollën e Slllovës kishin mësuar e recituar poezitë e tij.

Shemsiu pothuaj i kishte lexuar të gjitha poezitë e tij të botuara. Djalit që lindi këtë natë nëntori, ia lanë emrin naim. ‘E gëzoftë! – u dëguan urimet nëpër kullën që ishte mësuar të priste e të përcillte miq të shumtë, të ftuar e rrugëtarë të ndryshëm...”.

E nisëm me këtë perifraksim të autorit të librit “Dritëhijet e një poeti”, të shkrimtarit të njohur Shaqir Skarra, për të bërë një analogji të dy Naimëve, poetë, që ngjasojnë shumë në jetët dhe veprat e tyre.

Nëse rilindasi i shquar rridhte nga dega e Dakollarëve ose e Dulellarëve e Familjes së shquar Frashëri, edhe Naim Plaku, ishte pinjoll i një fisi emërndritur në Sllatinë, nipi i “gjenralit me shajak” Elez Isufi. Nëse Naim Frashëri u shqua për lirikën e tij patriotike me temë aktuale (vjershat “Gjuha shqipe”, “Korçës” 1887, etj.), u këndoi me pasion të rrallë mallit dhe bukurive të atdheut (“Bagëti e bujqësia”) dhe bëri thirrje të fuqishme për çlirimin e tij (krijime të ndryshme, “Dëshira e vërtetë e shqiptarëve”), në shekullin që lamë pas, vepra e Naim Plakut, është një testament fjale.

Dhe siç shprehet autori në monografinë “Dritëhijet e një poeti”, Naim Plaku, që e konsideronte poezinë si një “zanë mali, por kryeneçe”, me



mjeshtri të rrallë e ledhatoji, e përkëdheli dhe pastaj u dashura pas saj. U dashurua me poezinë që në fëmijërinë e tij, kur qau për “dhinë pikaloshë që ia hëngri ujku” dhe për “mushkën, që ia hodhi ngarkesën të gjithën në tokë, ngaqë nuk e kishte ngarkuar mirë”. Janë këto detaje nga fëmijëria e një nxënësi që shkëlqente në të gjitha lëndët, në gjuhë e lexim, në aritmetikë e gjeometri, në histori e gjeografi, në kimi e biologji...Ngaqë mbante sy e vesh te shpjegimi, si rrallë nxënës, por edhe ngaqë tek kulloste bagëtinë apo dhe kur shkonte për dru në mal, me vehte kishte edhe trajstën me libra. I tillë do të ishte ai edhe në fidanishten e mësuesisë, siç njihej Shkolla e mesme Pedagogjike e Peshkopisë, për përfundimin e së cilës, babait të tij, Shemsi Plakut, iu desh të shesë pothuaj të gjithë bagëtitë. Por edhe në Universitet, tek do të përballlej e triumfonte me pedagogun e sintaksës që “dhjetën” e konsideronte pronë të veten. Ishte pikërisht N.Plaku, ndër studentët e paktë që me zotësinë e talentin e tij të rrallë e theu këtë tabu të pedagogut zemërgurtë, ashtu siç sfidoi në vitet e dekadat e jetës së tij të gjithë nihilistët e mediokrit që i shërbyen me zell sistemit të diktaturës.

Këto e të tjera detaje jetësore për këtë poet të këngës, e bëjnë më të dashur për lexuesin këtë vepër dinjitoze të publicistit, studjuesit dhe analistit tashmë të njohur, Shaqir Skarra. Me mjeshtri të rrallë ai ka ditur të “shfrytëzojë” arkivën e pasur që la si trashëgimi, poeti i këngës, Naim Plaku. Nuk është rastësi që nga kritika letrare, emri i Naim Plakut si poet kënge, radhitet përkrah Gjokë Becit e Lefter Çipës. Këtë, përveçse autorit të monografisë “Dritëhijet e një poeti”, e pohojnë edhe emra të spikatur të letrave shqipe, që e kanë studjuar hollësisht veprën e Naim Plakut. Kjo edhe për faktin se tekstet e Naim Plakut janë lënda e parë e standardit më të lartë për këngëtarët e mirënjohur Arif Vladi, Shkurte Fejza, Haxhi Maqellara, Skënder Cala, Liri Rasha, Qerim Sula, Ilir Shaqiri, Selami Kolonja, Caje Poleshi, Sherif Dervishi, Vera Laçi, Dritan Jashari etj. Mjafton të kujtojmë se si janë ngritur peshë zemrat e mijëra artdashësve, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në skenat më presitigjioze të botës, kur kanë përjetuar zërin e tyre melodioz në interpretimin e teksteve të këngëve të N.Plakut: “O prite Azem Galicën”, “Një gërshet u la me gjak”, “Na knojnë pushkët nëpër kulla”, “O i madhi Skënderbe”, “Përcolla ylberin”, “Mine mori Mine”, “Tinguj krenarie”, “Fluturo shqipe ka kalaja”, etj.

“Naimi u bë gjuhëtar, punoi shumë për të, mblodhi fjalë të rralla jo

vetëm të krahinës, por edhe jashtë saj... Naimi truppakët, çapitej nga Fushë Alia në Shumbat, nga Cereni në Sllovë e nga Sllova në Gollobordë... Ai çlironi shpirtin, duke tjerë zgjuarsinë me fjalët e botës së dijes që mbledhi jo vetëm nga gjuha e mësuar e shkollës, por edhe në odat e kullat dibrane dhe nga valët e fjalës së Drinit e oshëtima e Korabit, duke i shikuar këto nga shpirti i lirisë... Pas mësimit, gjatë udhëtimeve do të nxirrte bllokun e do të shkruante toponime e mikrotoponime. Për to pyeste qoftë dhe një çoban që ishte me bagëti... Gjeti ninullat e bukura të djepit e shprehjet frazeologjike, të përdorura aq bukur në këto anë. Përpara se ta hidhte në bllok, këngë qoftë apo shprehje gjuhësore, kërkonte burimin. Kështu ai ra në gjurmë të ciklit të këngëve të Korabit, mbledhi këngën e Ymer Agë Ulqinit, “Motra me nantë vllazën”, “Balada e Rexhës” e dhjetra të tjera... I mori këto këngë nga goja e popullit, ua hoqi pluhurin dhe i bëri pronë të të gjithëve për të mbetur visare të folklorit shqiptar”. Mjaftojnë qoftë edhe këto perifrazime të shkëputa nga faqe të ndryshme të veprës së Sh. Skarrës “Dritëhijet e një poeti”, për të konkluduar në punën e mirëfilltë studimore e shkencore që ai ka bërë për të na e sjellë në mënyrë sa më origjinale madhështinë e profilit krijues e njerëzor të Naim Plakut.

Poeti që përjetoi skajshmërisht përndjekje, ishte vërtetë një poet i përmasave të spikatura. Në monografinë e botuar nga Shtëpia Botuese e mirënjohur tashmë M&B, evidentohen qartazi variacionet poetike në formë mozaiku brenda konstruktit poetik të poezive të tij që shkrihen në kodet nëntekstuale, të shartësive të kumteve dhe përcjelljeve të folkut. Kjo edhe për faktin se në poezinë e tij, Naim Plaku i ngre një kult botës dibrane, nderit, dinjitetit, virtytit, arketipit social, etik dhe filozofik të dibranit që motivohet nga zgjuarsia, matura, etj. Këto, më së miri i gjejmë në veprat poetike të N. Plakut “Fllad e frullizë”, “Kreshtat e Korabit” dhe “Trëndafila mbi mermer”. Por vitet e fundit botimet e tij po lexohen e po pëlqehen nga publiku, sidomos “Krojet e zanave” e “Folklor nga viset e Dibrës”.

Qoftë edhe me një vështrim sporadik të veprës “Dritëhijet e një poeti”, lexuesi do të mrekullohej me “rrëfimet nga ditari”, të cilat autori Sh. Skarra ka patur fatin t’i ketë në dorë dhe prej tyre të përveçojë nektarin e veprës shumëdimensionale të Naim Plakut. Dhe jo vetëm kaq, por shkrimtari e studjuesi Skarra, sjell risi në “Raportet e Naimit me veprën”, duke i parë ato në një kontekst të gjerë, në fushën e gjuhësisë e letërsisë, por edhe duke

na e paraqitur Naim Plakun si një figurë të shquar të folkloristikës tonë, si skenarist dhe libretist.

Dhe në vlerësimin e veprës së N.Plakut, autori i monografisë “Dritëhijet e një poeti”, nuk ndalet vetëm tek mendimi i tij analitik, mjaftë i vlefshëm, por sjell referenca të çmuara nga bashkëkohës të mirënjohur. Kështu, Prof. Dr.Shaban Sinani, përveç shumë punëve të bukura në krijimtari, veçon atë çfarë Naim Plaku i ka kushtuar traditës gojore të popullit të Dibrës, traditës etnozakonore dibrane, studimeve me karakter historiografik dhe etnologjik, krijimtarinë letrare në përgjithësi, sidomos poezinë e tij. Ndërsa Ali Ahmeti, sjell në kujtesë këngët e mrekullueshme që këndonin Arif Vladi, Liri Rasha, Qerim Sula dhe të tjerë këngëtarë, që atij dhe shokëve të tij, kur luftonin për të drejtat e popullit shqiptar, u jepnin zemër dhe i hidhte në flakën e betejave. Por, lideri i mirënjohur historik i shqiptarëve të Maqedonisë pohon se në atë kohë nuk e dinte që tekstet e tyre aq të fuqishme i kishte bërë Naim Plaku.

Dhe nëse për Shkurte Fejzën, poezia e N.Plakut ka shpirt dhe i jep motiv kompozitorit, që të kompozojë, por edhe këngëtarin e frymëzon për të kënduar me shpirt, për Dr.Fejzulla Gjabri, që është edhe redaktori i librit, “Në vëllimet e Naimit ka frymëzim vendlindor, dibran dhe gjithëshqiptar. Aty është lashtësia, aty burojnë mesazhet, aty ngrenë krye hulumtimet....”.

FAKTE DHE NGJARJE HISTORIKE TË SHKRUARA ME DASHURI NJERËZORE NGA SAKIP CAMI

Për librin “NGJARJE DHE FIGURA TË SHQUARA HISTORIKE TË KOMUNITETIT TË BASHKISË SË BULQIZËS” (1839 – 1939)

Në harkun kohor të dy dekadave, poeti, publicisti dhe studjuesi i mirënjohur Sakip Cami, ka bërë një hop cilësor dhe produktiv, duke i dhuruar lexuesit më shumë se 15 libra të botuar, vëllime me poezi, monografi letrare, profile e studime.

Libri i tij “NGJARJE DHE FIGURA TË SHQUARA HISTORIKE TË KOMUNITETIT TË BASHKISË SË BULQIZËS” (1839 – 1939), përbën një kontribut real, të konkretizuar në një vepër shkencore të një niveli shumë të lartë.

Ndonëse përmbledh studime historike të një shekulli luftrash e përpjekjesh madhore të shqiptarëve për liri e pavarësi kombëtare, ngjarjet dhe protagonistët vijnë me realizëm objektiv. Autori, pas një studimi skurpuloz dhe ballafaqimi të mirëfilltë shkencor të fakteve, sjell risi në historinë e Heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, duke hedhur dritë edhe mbi personalitetet dhe ngjarjet legjendare skënderbegiane. Parë nga ky këndvështrim ia vlen të evidentohen përpjekjet e autorit për të përveçuar legjendat dhe paragjykimet. Dhe këtë e bën mbështetur në fakte mbi qëndresën e paepur të kryetrimave të një treve lavdiplote siç është Bulqiza, Zërqani, Gryka e Vogël e Gryka e Madhe, por edhe Golloborda. Kemi kështu një libër të një lloji të veçantë me lëndë e material shumë interesant dhe tepër argumentativ mbi vendluftimet e ushtrisë së Skëndebeut, si Vajkali, Valikardha, Gjorica etj, por edhe toponime që flasin shumë për rezistencën e popullsisë së kësaj zone ndaj



pushtuesve osmanë turq.

Kështu, autori hedh dritë për “Luftimet e Skënderbeut në zonën e Bulqizës dhe të Gollobordës”, duke përshkruar me një gjuhë të pasur dhe argumentuese, gjurmët e sheshbetejave si: Gurët e Skënderbut, Betejën e Valikardhës, SOFRA E SKËNDERBEUT, VENDKOMANDA E LUFTËS, fortesën e Modriçit, Kalanë e Maçadit, ku është zhvilluar edhe beteja e Maçadit në qershor të vitit 1465 kundër forcave turke të komanduara nga Ballaban Pasha, etj.

Si mjeshtrë i përshkrimit dhe profilit, S.Cami sjell me freskinë dhe origjinalitetin e duhur personazhe të njohur e të panjohur të një kohe të largët, si: ZAHARIA GROPA, NGA GRYKA E MADHE, PRINCI OHRIT DHE KONTI VLLADAN GJURICA, PRINCI I ÇERMENIKËS, –DY BASHKËLUFTËTARËT MË BESNIKË TË SKËNDERBEUT. Ndërsa në aspektin gjeografik dhe zakonor, gjejmë në këtë libër një diapazon më të gjerë, si tek: “ÇIDHËN E GRYKË E VOGËL, VËLLA ME SHKODËR”, “HEROIZMI MASIV DIBRAN NE LUFTEN KUNDER TURQVE TE KOMANDUAR NGA HAJREDIN PASHA, KORRIK 1844” (sipas variantit të vjetër të këngës kushtuar luftës kundër Hajredin Pashës) apo dhe te: “Mustafa SHEH ZERQANI, LIDERI KRYESOR I LUFTËTARËVE DIBRANË NË LUFTËN KUNDËR HAJREDIN PASHËS”.

Duke ecur në të njejtën linjë, autori sjell fakte dhe ngjarje historike, të shkruara me dashuri njerëzore, edhe në profilet e Lam Dacit, madhështia e të cilit del qoftë dhe nëpërmjet vargjeve: “Lum kjo kulla ç’ish ka mrena/ Ka Lam Dacin me shtatë zemra...”...apo te figurat e patriotëve të shquar Sheh Fejzë Bulqiza, Dalip Karaj, Mehmet Duriçi–embleme e mençurisë dhe trimërisë dibrane, Salë Markja etj.

Nëpër tymin e zjarrin e luftimeve dhe përmes fakteve të personazheve–heronj të këtij libri, gjejmë gjithashtu bëmat dhe heroizmin e “Hoxhë Hasan Moglicës, këtij kleriku dhe luftëtari të shquar për lirinë dhe gjuhën shqipe, si dhe të Elez Koçit nga Ostreni....

Dashuria është ai motiv që ka rrokullisur njëra pas tjetrës këto figura interesante në faqe të tëra të këtij libri, duke i dhënë atij një dimension të veçantë.

Shumë emra, shumë vende dhe histori, shumë dashuri dhe mirënjohje sjell autori Cami brenda faqeve të këtij libri, duke personifikuar njerëz të



mençur, trima, patriotë, luftëtarë e intelektualë të Dibrës martire. Ato vijnë e ulen pranë nesh përmes faqeve të këtij libri, të rrethuar me trimëri nga jehona e kohërave, të thjeshtë deri në madhështi.

Ndërsa te “KLUBI ATDHETAR «BASHKIMI» I DIBRËS SË MADHE DHE ROLI I TIJ PER PERHAPJEN E ARSIMIT SHQIP DHE PER PAVARESINE E VENDIT”, autori flet për patriotë me vlera të mëdha kombëtare për përhapjen e mësimimit shqip ashtu si dhe për luftëtarë të shquar kundër pushtuesve turq, serbë dhe bullgarë.

Duke konsideruar monografitë e shkurtra letrare të përfshira në librin “NGJARJE DHE FIGURA TË SHQUARA HISTORIKE TË KOMUNITETIT TË BASHKISË SË BULQIZËS“ (1839 – 1939), mund të konkludojmë se S.Cami sjell për lexuesin dhe veçanërisht për studjuesit e historisë një përmbledhje të shkurtër të historisë së kombit shqiptar nga njëra prej trevave më me emër. Për vetë lëndën e pasur dhe larminë e figurave e personazheve, mund ta konsiderojmë këtë libër edhe si një prej enciklopedive prestigjioze në shërbim të studjuesve. Kjo për faktin se Sakip Cami sjell një seri faktesh historike, korrespondencash diplomatike dhe mendimet e tij rreth ngjarjeve e personazheve të kësaj treve. Dhe këto ai i sjell nëpërmjet shumë fakteve dhe dokumentave historike të kohrave dhe burimeve të ndryshme. Dhe nëse në libra të tjera të S.Camit gjejmë poezi brilante që ai ua kushton këtyre ngjarjeve e figurave historike, edhe në këto monografi, portrete e refleksione ai dëshmon se poezinë e ka në shpirt dhe e bart kudo me vete. Ai bart në krijimtarinë e tij diçka origjinale. Ashtu si Gjorica, vendlindja e tij në prehër të Maleve, përmes së cilës kalon Drini, edhe ai si krijues lëvron dy fusha të krijimtarisë artistike: poezinë, me të cilën ka krijuar tashmë profilin e tij të spikatur si dhe studimet historike, një dyzim i natyrshëm ky për një shkrimtar por edhe një bashkëjetesë jo e lehtë. Gjithsesi, edhe me këtë botim dinjitoz, ai është dhe mbetet poet pavarësisht se balanca e botimeve anon nga studimet, prej të cilave, edhe si ish-ushtarak i talentuar njihet tashmë si një zë i njohur i fushës.

Studimi i gjuhëtarit të njohur/ U vlerësua nga Kadare, por u injorua nga Akademia e Shkencave

PETRO ZHEJI: “SHQIPJA ËSHTË MËMA E TË GJITHA GJUHËVE”



- Insistimit të gjuhëtarit të shquar Zheji për të argumentuar lashtësinë e shqipes, akademiku Buda i është përgjigjur me këshillimin: “Kujdes djalë, se të ikën koka”!
- Profesor Petro Zheji, pas vendosjes së demokracisë emigroi për shumë vite në Amerikë, SHBA, ku, në sajë të zotërimit të mbi dhjetë gjuhëve të huaja, i thelloi e i zgjeroi edhe më shumë studimet e tij në fushën e Gjuhës Shqipe. Gjatë kohës në SHBA kemi pasë letërkembime të vazhdueshme me të

Shtatëmbëdhjet vjet më parë (13 shtator 2007) gjuhëtari i shquar Petro Zheji, në promovimin e veprës së tij akademike “**SHQIPJA DHE SANSKRITISHTJA**”, në Pukë, deklaroi se “shqipja është mëma e të gjitha gjuhëve”.

Këtë të vërtetë e pohon edhe gjuhëtari i njohur Albert V.Nikolla, i cili në një intervistë për gazetën “Nacional” (13 janar 2024) ndër të tjera

shkruan se “...kur sigurimi i shtetit, dërgoi emisarë tek Çabej për ta pyetur se çfarë mendonte për Petro Zhejin, ai iu përgjigj se: “Të dy, unë dhe Zheji kemi të njëjtin qëllim: të ndriçojmë vjetërsinë e gjuhës shqipe, por rrugët që kemi zgjedhur si metodologji janë të ndryshme”. Gjithsesi kuptohet që Çabej që shprehur pozitivisht për studimin e thelluar të P.Zhejit.

Në vlerësim të kontributit madhor të të përjavshmes prestigjioze letrare e kulturore “NACIONAL” dhe të Drejtorit të saj Dr.Mujo Buçpapaj, për evidentimin e shqipes si një ndër tri gjuhët më të vjetra indo-europiane që fliten ende, po sjellim në vëmendjen e lexuesit bisedën tonë të para 17 viteve me prof. Petro Zheji. Ndërsa na kishte dhuruar një kopje të daktilografuar të studimit të tij të mahnitshëm “**Shqipja dhe Sanskritishtja**”, (të cilin e lexuam me interes të veçantë”), për herë të parë po mësonim prej tij se gjuha jonë shqipe është e lashtë sa vetë njerëzimi dhe e vetmja me koeficientin më të lartë që motivon vetveten dhe po kështu edhe gjuhët e tjera, çka përbën veçorinë dhe epërsinë e saj në raport me gjuhët e tjera simotra. Por askush nuk i hapte rrugë botimi Studimit të Tij.

Pas kësaj insistuam që profesor Zheji t’i kërkonte takim kryetarit të Akademisë së Shkencave, Prof. Aleks Budës dhe t’ia parashtrojë studimin me tezat e tij, në lidhje me gjuhën shqipe?”. Dhe ai na pohoi se këtë ia kishte sugjeruar edhe shkrimtari ynë i madh **ISMAIL KADARE**, i cili jo vetëm e kishte lexuar e vlerësuar por edhe ishte entuzmuar nga punimi i tij.

“Në Akademinë e Shkencave kanë dijeni për Studimet e mia, por nuk denjojnë të shprehen, t’i pranojnë as t’i rrëzojnë idetë e mia dhe as Aleks Buda nuk pranon të më presë bile”, - na tha disi i revoltuar.

Profesor Petro i jepte mësim të gjuhës frënge privatisht vajzës së Aleksit, e cila më vonë e ndërmjetësoi tek i ati dhe ai një ditë e priti në takim.

Sipas Petros ai e priti ftohtë, por e dëgjoi. Nuk ia pranoi konkluzionet e Studimit të Tij dhe as pranoi ta studionin atë si Akademi..

-Midis tyre,- siç na tregoi Petro,- ishte zhvilluar një debat bukur i fortë sa i kishte thënë se – “Gjuha Shqipe është një gjuhë shumë e vjetër, e pa zhvilluar dhe e shkruar shumë vonë ndryshe nga gjuhët e tjera të shkruara shumë herët”.

Atëherë, Profesor Petro i kthehet dhe i thotë: “Po pikërisht këtu, tek

vjetërsia e saj, shoku Aleks, qëndron rëndësia e gjuhës sonë, sepse ka mundur të ruajë origjinalitetin e saj pa u shue me kohë si shumë gjuhë të tjera të vjetra”. Por insistimit të gjuhëtarit të shquar Zheji, akademiku Buda i është përgjigjur me këshillimin: “*Kujdes djalë, se të ikën koka!*” (Se këtë fat pati edhe Milam Shuftai për veprën “*Serbët e shqiptarët*”).

-E tmerrshme! - Ishte Ai, i Madhi Zheji që na i pohoi me gojën e tij këto, se po ti dëgjonim nga dikush tjetër nuk do mund ti besonim dot... Dhe ja, pas afro dy dekadash këtë e pohon edhe gjuhëtari e shkrimtari i njohur Albert V.Nikolla në një intervistë për “NACIONAL”.

ZOTËRUESI I DHJETË GJUHËVE TË HUAJA, STUDIME TË THELLUARA NË FUSHËN E GJUHËS SHQIPE

Profesor Petro Zheji, pas vendosjes së demokracisë emigroi për shumë vite në Amerikë, SHBA, ku, në sajë të zotërimit të mbi dhjetë gjuhëve të huaja, i thelloi e i zgjeroi edhe më shumë studimet e tij në fushën e Gjuhës Shqipe. Gjatë kohës në SHBA kemi pasë letërkembime të vazhdueshme me të.

Si u kthye, u vendos në një shtëpi me qera, se të vetën ia kishte zënë një person, të cilit ia kishte lënë në përkujdesje, por ai e kishte privatizuar për vete. Qe konstitucionalisti i mirënjohur Halil Kopani që e ndihmoi me anë të gjykatës që ta merrte përsëri shtëpinë e vet.

Asokohe ai mundi ta botojë me shpenzimet e veta librin “**Shqipja dhe Sanskritishtja**”, në dy vëllime. Sapo doli në qarkullim përnjëherësh disa i blenë librat e tij, por nuk po gjëndeje më në shitje. Si e mësoi këtë fakt Petroja një ditë futet në librari për të parë se si po shkonte shitja e librit dhe, nëse ishin mbaruar të çonte të tjera.

Në librari vëren se librat mungonin të afishuara në asnjë raft. Këto i kishte heqë nga vitrina librashitësja dhe i kish futë nën banak, duke u thënë klientëve, kur e kërkonin se “është mbarue”. Kuptohet se ajo nuk kishte as arsye, as kishte interes ta bënte këtë gjë të poshtër me kokën e saj, por me siguri dikush tjetër, ndonjë antishqiptar e kishte kërcnuar dhe porositur që të vepronte kështu.

Dhe për më keq, nuk kemi parë deri më sot që nga autoritet shkencore a zyrtare të larta ta përmendin a përkujtojnë të ndjerin PETRO, këtë vigan

që gjithë jetën e tij ia kushtoi gjuhës sonë të bukur Shqipe. Dhe akoma për më keq, paska qenë një “akademik” kosovar, që para disa vitesh ka shkruar për veprën e Petros, duke e quajtur “vepër idiote!”. E kush pra, ky akademyth i fermentuar në shkolla antishqiptare serbo - sllave.... ?!

Para shtatë vitesh, prof. Petro Zheji (1929-2015) botoi pjesën e dytë e veprës “Shqipja dhe sanskritishtja”, e cila u mirëprit nga personalitete të botës akademike, ndërsa çuditërisht u shoqërua me heshtje nga Akademia jonë e Shkencave. Gjithsesi ja vlen të nënvizojmë përfundimin në të cilin Zheji arrin me këtë të studim se: “Sistemi leksikor i gjuhës shqipe është më i gjerë nga ai i gjuhës sanskritishte, e pra ai e përfshin atë në sistemin e gjuhës sanskritishte që është një nënbashkësi e bashkësisë së sistemit të gjuhës shqipe. Përfundim ky që e shtyn Zhejin të deklarojë se është konform frymës së Rilindasve tanë mbi gjuhën shqipe, sepse saktëson vizionin e tyre profetik mbi një lashtësi zanafillore të gjuhës dhe popullit tonë.

Dy pjesët e kësaj vepre janë kuruar dhe shoqëruar me parathënie të të afërmëve të Zhejit, Gjergj Zhejit dhe Lluka Qafokut. I pari e mbron këtë vepër kështu: “Analizat filozofike-logjike-etimologjike në këtë studim janë plotësisht të justifikuara nga pikëpamja e Dijes së kohës sonë, ndonëse jo nga ajo e gjuhësisë klasike, ku kanë ngecur ende të gozhduar mjaft gjuhëtarë”. Ndërsa i dyti e sheh si zbulimin e një teknologjie sui generis, për t’i bërë operative në fushën e etimologjisë, zbulimet gjeniale të teorisë së shenjës dhe të kuptimit të linguistikës moderne. Zbulim ky sipas Qafokut që nuk del jashtë kuadrit të përpjekjeve që kanë nisur prej fillimit të shekullit XX e që i shohin problemet e origjinës së fjalës, edhe nga pikëpamja logjike dhe psikologjike.

Vepra e tij, siç e quan përmbledhësi dhe redaktori i librit të fundit të Petro Zhejit, Albjon Bogdani, është një diamant që shihet në të gjitha dimensionet e tij, dhe me studimet e kryera prej profesorit, ta shohësh diamantin në përsosmërinë e tij.

Vepra e Petro Zhejit për kritikën është një monument mendimi shkencor dhe akademik, mes dialogimeve të historisë dhe filologjisë, filozofisë dhe matematikës, simbolikës dhe kozmogonisë, religjionit dhe interpretimeve transhedentale.

PETRO ZHEJI: “GJUHA SHQIPE ËSHTË GJUHA E ZOTIT”

Gjatë një bisede me dishepujt e tij Rudina Robertsen dhe Afërdita Zaja, këta të fundit kanë vlerësuar se “Petro Zheji është i vetmi që ka vërtetësuar shkencërisht rolin mesianik të Shqipes si edhe lashtësinë e padiskutueshme të saj duke e vendosur gjuhën Shqipe në një rang të vërtetë Superior karshi gjuhëve të tjera të botës”.

Dhe nëse për poetin, prozatorin dhe analistin e mirënjohur Preç Zogaj, “Petro Zheji është një magjepsje”, Astrit Cani vlerëson se “Shkenca është arti i Petro Zhejit”. Kjo sipas tij për faktin se “vepra përkthimore e Zhejit, mbetet një etalon i matunisë, duke qenë Zheji artisti i matun dhe njeriu me formim të mirëfilltë shkencor, që e ka rrokë artin si mbishkencë, por ruen të paprekun higjienën mendore të intelektualit të mbryjtun me logjikë.”

Ndërsa Përparim Kabo, referuar Petro Zhejit që shkruan se “Gjuha shqipe është gjuha e zotit”, vlerëson se punimet e tij dallojnë për një metodologji krejt ndryshe prej asaj klasike që merret me analizën e formës së fjalës dhe strukturën e saj gramatikore.

“Në punimet e tij, studiuesi Petro Zheji merret me gjenezën historike dhe me evoluimin historik të gjuhës si mendim dhe si fjalë, pra ai e nis studimin të përmbajtja e fjalës dhe kështu në këtë rrugëtim ai zbulon veçoritë e shqipes dhe kontributin e saj në raport me gjuhët e tjera. Duke ndërtuar algoritmin e gjuhës shqipe, Petro Zheji evidenton disa nga tiparet unike të shqipes si një gjuhë primordiale dhe rëndësinë e saj në lëmenjtë e gjuhësisë botërore”, vlerëson Përparim Kabo.

Studiuesi, hulumtuesi, përkthyesi, ndër njohësit më të mirë të shqipes Petro Zheji, pas largimit e tij nga jeta më 14 mars 2015 ka lënë shumë kryevepra por është “Shqipja dhe sanskritishtja” kryevepra e tij dhe pasuria më e madhe që i ka lënë brezave të rinj.

“Misioni i tij kishte zënë rrënjë që në barkun e nënës, – si thotë vetë Petro”,- shkruan Përparim Kabo për mjeshtrinë. “Do të argumentonte se, cila është gjuha shqipe? Sa e vjetër? Ku i ka rrënjët? Sa paradoksale është ajo në shprehjet e saja idiomatike? Dhe për pasojë, sa moderne dhe e pashtershme është shqipja? Ca e shihnin me habi, ca me mëshirë, ca

e quanin misionhumbur dhe ca pseudo e quanin “të marrë”, që merrej me një punë të kotë, sepse sipas tyre, këto gjëra për shqipen i kishin thënë të tjerë dhe se çështja e shqipes ishte e zgjidhur. Ajo ishte një gjuhë indoeuropiane, dihej se në cilin grup identifikohesh dhe se sa e vjetër ishte, dhe sa e si ngjasonte dhe ku dallonte nga gjuhët e tjera”.

Këze Kozeta Zyllo, një tjetër studjuese e veprës së gjuhëtarit të mirënjohur shprehet se 36 gërmat e Gjuhës Shqipe vijnë si vetëtima drite nga sytë e prof. Petro Zhejit. Pikërisht nga kjo optikë shkrimtarja e njohur shqiptaro-amerikane Zyllo vlerëson se Prof. Petro Zheji qëndron mal kryelartë sepse është një gjeni i letrave shqipe, është një erudit i jashtëzakonshëm. Dhe tingëllima e Gjuhës Shqipe në librin e tij “Shqipja dhe Sanskritishtja” vjen si jehonë e largët qysh kur ka lindur njerëzimi. Megjithatë shpirti i tij endet në librat që na ka lënë është në fytyrën e tij të pruar, që dhe pse i ikur, ai rrezaton dritë, me zërin e tij që i tingëllon aq bukur, shqip.

Nëse akademikë dashakeqas të vendeve fqinje (serbë, maqedonas, grekë etj) janë munduar ta varrosin përfundimisht gjuhën Shqipe sepse kanë kuptuar që gjuha Shqipe është gjuha e parë Evropiane dhe që ajo qëndron në themel të krijimit të gjuhëve të tyre, profesor petro Zheji ka provuar shkencërisht se Gjuha Shqipe është një pasuri kombëtare dhe një thesar apo vlerë botërore dhe një gjuhë, e cila po lulëzon çdo ditë dhe më shumë. Për faktin se trumbetat e gjuhës Shqipe po bien sot dhe po dëgjohen kudo në çdo vend të botës, studjuesi **Stiljan Dedja me të drejtë vlerëson se kjo meritë** i takon veçanërisht atij që zbuloi mekanizmin e funksionimit të Gjuhës tonë të vjetër dhe të bukur, gjigandit Petro Zheji.

Për një njohës të gjuhëve si profesor Zheji, shqipja është e aftë ta kapërcejë kufirin nga një gjuhë në tjetrën...Rrugëtimin e nis nga sanskritishtja, të cilës duke e krahasuar me shqipen e ka sjellë në dy vëllime në punët e tij më të hershme.

VEPRAT MË KRYESORE TË PETRO ZHEJIT

Përkthimet, ndër qindra shqipërime veçojmë:

1. Ringjallja – Leon Tolstoi
2. Vilet e zemërimit – John Steinbeck

3. Zoti President – Migel Asturias
4. Don Kishoti – vol i Dytë, Migel Servantes
5. Galileo Galilei – BertoldBreht

Studimet Gjuhësore:

1. Shqipja dhe Sanskritishtja – dy vëllime
2. Libri i aforizmave
3. Roli mesianik i gjuhës shqipe

*** Shkruar me bashkëautor studjuesin e mirënjohur Xhemal Meçi –
Mjeshtër i Madh*

“TOPONIMIA E ÇIDHNËS”, NJË BOTIM ME VLERA TË RRALLA SHKENCORE

Vepra e Haki Përnezha e Rruzhdhi Bitrit ka një mënyrë të konceptuari e shtjelluari mjaft të rrallë, brilante

Botimet “M&B”, pas suksesit të padiskutueshëm në Panairin e Librit 2016, prezantuan më 25 Nëntor 2016, në sallën e Akademisë së Shkencave në Tiranë librin “Toponimia e Çidhnës” (me 110 ilustrime fotografike dhe me një fjalës të leksikut të rrallë), të bashkëautorëve Haki Përnezha e Rruzhdhi Bitri.


Për vlerat e rralla shkencore të këtij botimi folën: poeti dhe prozatori i mirënjohur Agron Tufa, Prof. Gjovalin Shkurtaj, Prof.Dr. Shaban Sinani, si dhe studjuesit Ali Hoxha, Besim Cengu e Mustafa Tola.

Përveç studimit të thelluar e skurpuloz, për besueshmërinë e këtij botimi flasin qoftë dhe 328 referencat e përdorura nga bashkautorët, ku spikasin ato të Prof.E.Çabej, Mjeshtrit të Madh, Hazis Ndreu, studiuesit Iljaz Kaca, apo dhe të Giuseppe Valentini (E Drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare).

Në përpjekjet për të sjellë aromën e vendlindjes së tyre, H.Përnezha dhe Rr.Bitri hyjnë në analet e historisë së letrave me një botim të rrallë. Pa hyrë në një analizë të thellë të këtij botimi tejet dinjitoz, në këto pak radhë unë dua të shpreh vlerësimin për kontributin e tyre në kërkimet shkencore.

Një sipërmarrje të tillë të vështirë mund ta quajmë pa mëdyshje të suksesshme dhe merita për këtë u takon dy bashkautorëve, por edhe redaktorit potencial, akademik Shaban Sinanit, si dhe botuesit M&B (Miranda e Bujar Karoshi).

Larmia e studimeve të paraqitura në këtë libër janë dhe një nga arsytet



e suksesit të botimit, i cili është i një cilësie shumë të mirë, i denjë për të nderuar dy studiues të shquar, botuesin dhe redaktorin. Në këto studime, pa mëdyshje shquhen ato mbi fshtarat Sinë e Epër e Sinë e Poshtme, Çidhën e Poshtme, Grykë Nokë, Mustafe, Zall dhe Kodër Leshe, Fushë Alie, Laçes, Çelias, Blliçe, Rrenx, Kastriot, Brest i Epër e Brest i Poshtëm.

Natyrisht, lexuesi shqiptar, bazuar në këto studime merr një informacion relativisht të pasur për këtë trevë të njohur që nga lashtësia. Vepra e H.Përnezhës e Rr.Bitrit ndërkaq ka një mënyrë të konceptuari e shtjelluari mjaft të rrallë, brilante. Meritë e padiskutueshme e këtyre autorëve, krahas njohurive që zotërojnë për vendlindjen e tyre, është padyshim shfletimi dhe studimi në origjinal i një bibliografie mjaft të pasur.

Më së miri e vlerëson librin e tyre redaktori Sh.Sinani, i cili evidenton 100 fotot ilustruese dhe një burim të fjalës së rrallë e në zhdukje, që së bashku me frazeologjinë që lidhet me to, është një provë burimore dhe shkencore e rëndësisë kulturore e historike të emërtimeve vendore.

“I shkruar pas një vëzhgimi kërkimor prej shumë vitesh, prej dy njerëzish që janë edhe vetë subjekt i kërkimit; me një vëmendje diturore të kthyer në qëllim prej dekadash më parë, “Toponimia e Çidhnës”, – thekson akademiku Sinani – është një regestum i emërtimeve të përveçme të kësaj krahine etnografike, një hipoteke e kësaj pasurie shpirtërore, e cila për fat tashmë ka zot, dhe ky zot është folësi shqiptar i atyre anëve, bartës brez pas brezi i saj, një bartës sa krijues aq dhe ruajtës, sa pragmatik, aq dhe sintagmatik, sa figurativ aq dhe përdorues”.

Sipas Prof.Sh.Sinanit “Në librin e këtyre dy autorëve janë ndërthurur meritat e mbledhësit, tejskruarit dhe të studiuesit. Aty janë bashkë edhe filologu, edhe dialektologu, edhe antropologu e historiani. Libri i tyre është një arritje etnogjuhësore, në të cilën fjala dhe bartësi i saj nuk ndahen”. Madje sipas akademikut të mirënjohur “Toponimia e Çidhnës” dëshmon mbi të gjitha se populli i këtyre anëve nuk ka jetuar si popull malesh, si barinj shtegtarë, sikurse shkruhet edhe sot në disa botime enciklopedike, por ka ditur të jetojë dhe madje ka jetuar mirë.”

“NA KA ÇUE SHKODRA NI FJALË”, MBROJTJA E QYTETIT NGA SERBO - MALAZEZËT.

Libri i Xhemal Meçi sjell referenca të shumta nga autorë vendas e të huaj



Libri i sapobotuar i studiuesit Xhemal Meçi “Na ka çue Shkodra ni fjalë”, është një botim interesant me përmbledhje artikujsh, kryesisht për Luftën për mbrojtjen e Shkodrës së rrethuar prej ushtrive pushtuese serbomalazeze (Nëntor 1912 – maj 1913), si një prej luftërave më heroike dhe po aq të lavdishme të kombit shqiptar.

Autori i këtij libri (“Mjeshtër i Madh” dhe “Qytetar Nderi” i Pukës) ka meritën se për herë të parë sjell referenca të shumta nga autorë vendas e të huaj për qëndresën e shqiptarëve për mbrojtjen e Shkodrës që përbën epopenë më heroike e më madhështore në historinë e luftërave të shqiptarëve. Kështu, nëse në shënimet e Mareshalli turk Mustafa Fevzi Çakmak, pjesëtar i shtatmadhorisë së armatës turke për mbrojtjen e qytetit të Shkodrës, ndër të tjera shkruhet që “Mbrojtja e Shkodrës të merret si shembull krenarie kombëtare!”, Xh.Meçi sjell edhe referencën e Gino Berri, korrespondent italian i luftës, i cili shkruan se “Luftën e bënin ata (shqiptarët), që sapo kishin shpallur Pavarësinë e Atdheut, agimin e ri të vendit të tyre.

HISTORIA

Në artikullin "110 – vjetori i Luftës së Shkodrës kundër ushtrive pushtuese serbo-malazeze gjatë rrethimit barbar 7 mujor, nëntor 1912-prill-maj 2013, Xhemal Meçi sjell fakte dhe ngjarje që flasin për qëndresën heroike të shqiptarëve kundër pushtuesve barbarë. Ndër të tjera ai shkruan: "Forca vullnetare të ardhura që nga Kavaja, Tirana, Kruja, Dibra, Lura e Mati numëroheshin deri në 4000 luftëtarë, të komanduara nga Esat Pasha. Ushtria malazeze bombaronte pa reshtur. Edhe sulmet e ushtrisë tokësore ishin të furishme drejt pozicioneve të mbrojtjes së Shkodrës. Në mënyrë të herëpashërëshme, çdo ditë, sulmonte edhe ushtria serbe nga fronti i lindjes dhe i jugut, por pa sukses. Humbjet e tyre ishin të shumta.

Mbas luftime Mali i Zi i Krajl Nikollës deklaronte se për mposhtjen e Shkodrës ka pasë më se 8000 luftëtarë të rënë. Prandaj Urrejtitjen për këto humbje e shfrynin duke bombarduar qytetin, sidomos lagjet myslimane. Megjithatë Shkodra nuk jepej. Por pak nga pak armiku kryesor i saj u bë uria, jo vetëm për qytetarët, por edhe për luftëtarët. Mbas 5 muajsh rrethimi e luftime, u mbaruan të gjitha rezervat ushqimore, aq sa nga fillimi i marsit 1913 u mbyllën të gjitha furrat e bukës, nga që ishte sosur mielli. Kështu uria u bë masive me pasoja sëmundjesh e vdekjesh. Nga fillimi i prillit mesatarja e të vdekurve arriti në 25 vetë në ditë. Një ditë prej ditësh u gjet e vdekur një nënë me tre vocërrakët e saj rrotull qafës. Edhe ata të vdekur urie; Një burrë kah se nuk i shihte dot dy djemtë e tij vocërrakë duke u përpëlitur nga uria e vdekjes, se kishin 10 ditë pa ngrënë, hoqi koburen dhe i vrau (kurse vet u zhduk!!!). Edhe në ushtri gjendja që po aq e rëndë, se u arrit që të ndaheshin vetëm 400 gram peksimet në ditë, po edhe ato me krimba.

Në vazhdim ranë në 200 e 100 gram. Kështu, luftëtarët shtriheshin në pozicione gjysmë të vdekur!! Ndërsa Fuqitë e Mëdha, të mbledhura në Londër u kujtuan së fundi, nën presionin e Austro-Hungarisë vetëm më 22 mars 1913, se duhej të ndërhynin ushtarakisht, si paralajmërim për Cetinën kokëfortë, se ia njihnin Shkodrën me rrethinë Shqipërisë, duke u kërkuar që të hiqnin rrethimin e Shkodrës. Më 12 prill 1913 u tërhoq ushtria Serbe, kurse ajo malazeze jo. Atëherë Fuqitë e Mëdha urdhëruan për një presion force... Kështu që në fillim të prillit një skuadrije detare ndërkombëtare, nën komandën e nënadmiralit anglez Sesël Bërnei bllokoi Tivarin deri në

grykën e Drinit. Por ushtria malazeze, rifilloi sulmet, sapo skuadrilja detare u largua. Gjendja e të rrethuarve u bë si edhe më parë e padurueshme. Më 14 maj 1913, hynë forcat e skuadriljes detare ndërkombëtare, kurse administrimin e qytetit e mori një komision ndërkombëtar i kryesuar nga anglezi Sesil Bërnej, i cili nuk lejoi festimin e Bajramit, as ngritjen e Flamurit kombëtar shqiptar në Shkodrën e shkretuar. Për më tepër, nuk përfilli as Qeverinë e Vlorës, e cila ishte e vetmja qeveri legjitime e Shtetit Shqiptar (me Shkodër) (!!!)” (fq. 12-14).

Po në këtë artikull Xh.Meçi sjell referencën e Dr. Dutton, profesor në Universitetin të Kolumbisë, sipas të cilit “Raporti i Komisionit Ndërkombëtar ishte një dokument tragjik, ndërsa dy luftërat ballkanike – si kapituj vdekjeje dhe tmerri, se viktimat më fatkeqe e më tragjike në masakrën e Ballkanit ishin Shqiptarët” .

Duke pasur si pikë referimi Prof. dr. Bajram. Xhafën që është edhe redaktor i librit, autori i këtij libri, që në hyrje na njeh edhe me frontet e mbrojtjes së Shkodrës. “Hasan Riza Pasha, Komandanti i Përgjithshëm i forcave mbrojtëse të Shkodrës me rrethinë, që pa fillue Lufta e Parë Ballkanike mori masa mbrojtëse, me punimet për fortifikime të menjëhershme, duke përcaktuar dy vija mbrojtëse: Vija e parë mbrojtëse, nga kështjella dhe kodrat në lindje të kalasë. Vija e dytë mbrojtëse ishte më e jashtme, e përbërë nga fortifikimet e Taraboshit, kodrat e Bërdicës, Beltojës, Vukatanës e Bardhajve. Në pozicione u vendosën 25 mijë forca luftarake me gryka zjarri artilerie të futura thellë në tokë mbi lartësitë e kodrinave. Kështu Shkodra mbrohej nga katër pikëmbështetje, që përbënin katër frontet kryesore: 1. Në veri, – Fronti i Shtojit, pjesa mes Liqenit dhe lumit të Kirit; 2. Në lindje, pjesa mes Kirit e Drinit, – Fronti i Bardhanjorit; 3. Në jug, pjesa në mes të Bunës e Drinit – Fronti Bërdicës; 4. Në perëndim, zona prej Bunës e Liqenit deri te mali Taraboshit, – Fronti i Taraboshit”.

KOMANDANTI

Për herë të parë në këtë libër (botim i “FIORENTIA”, Shkodër 2024) gjejmë edhe në një portret Hasan Riza Pashës (1871-1913) – Vali dhe komandant i garnizonit ushtarak të Shkodrës. Ai kishte lindur në Bagdat nga një nënë me origjinë shqiptare. Studimet ushtarake i kreu në Stamboll

dhe i plotësoi në Akademinë e Luftës në Berlin (1899 – 1903). Shërbeu në detyra të larta ushtarake në Janinë dhe në Manastir. Në janar 1911 caktohet komandant i korpusit Ushtarak (Garnizonit) Shkodër. Mars 1912 u emërua edhe Vali i Vilajetit Shkodër. Organizoi e drejtoi me vendosmëri e guxim gjatë rrethimit të plotë nga ushtritë pushtuese serbo – malazeze mbrojtjen e qytetit të Shkodrës me një efektiv prej 22.000 trupash, ndër to 7000 oficerë e ushtarë vullnetarë shkodranë, kundrejt afro 55 000 trupash rrethuese serbo – malazeze, duke u shprehur: “Nuk do ta dorëzoj Shkodrën edhe sikur t’i vinte urdhër nga Stambolli”. U vra si doli, nga shtëpia e Esad Pashës, më 30 janar 1913. U varros në Shkodër. Më 1993 është dekoruar “Për veprimtari patriotike të Klasit Parë. (Përparim Rexhepi, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 2009, f. 2253 – ’54).

MBROJTJA

Në një tjetër artikull po aq interesant, historiani Meçi përshkruan qëndresën e malësorëve të zonës Pukë – Mirditë në mbrojtje të Shkodrës së rrethuar nga ushtritë pushtuese serbo – malazeze para 111 viteve. Risi në këtë artikull është përjetësimi i heroizmit të shqiptarëve nëpërmjet këngëve popullore. Janë këngë që përjetësojnë qëndresën e 400 vullnetarëve të udhëhequr prej Mustafë agë Kryziut dhe Mehmet Dervishit, të cilët brenda fillimit të nëntorit 1912 u vendosën në pozicionet e Bërdicës, ku gjatë luftimeve me malazetë ranë dëshmorë të atdheut tre kabashës trima: Dem Ismail Ibrahim, Kurt Nezir Cina dhe Rexhë Adem Baci. “Me të ardhë porosia e Bajram Beg Currit, Zenel Mustafë Aga i Iballes me Mustafë agë Kryeziun dhe Salih agë Malziun (Vaspas) vendosën me kërkue ‘një burrë për shpi me i shkue Shkodrës në ndihmë’ para se të rrethohej nga ushtritë serbo – malazeze për t’u ndihmuar forcave shkodrane me pushkë për sy”, shkruan Xh.Meçi. Ndërsa referuar të dhënave gojore, ai e njeh lexuesin me faktin se “Në çdo katund u vendos të merreshin masat për t’u vetëmbrojtur dhe të bëheshin përpjekje që me çeta të vogla ta sulmojnë ushtrinë pushtuese serbe, sapo të futej në Shtatë Bajraktë. (në krahinën) e Pukës, që nga Vaspasi e deri në Flet, Qafë-Mali, Fushë-Arrëz, Pukë e Kabash. Katundet e Rrugëmadhes: Flet-Xath, Kulumri, Sakat-Trun. 80 shtëpi Thaç, lidhen besë me ia fillue pushkën që nga Fleti e mos me ia

da deri sa të tërhiqet krejt. Po kështu si Vaspasi edhe Pistë-Gdheshtë. Në Lejthizë vendosën të sulmonin prapavinë e kësaj ushtrie, duke i shkaktuar sa më shumë humbje! Sepse kështu do të dobësoheshin edhe sulmet serbe të divizionit “DRINA” mbi mbrojtësit e Shkodrës. Por ky divizion goditjen e parë e mori në Vaspas nga çeta e Ismajl Arifit”.

Në pjesën e parë të këtij libri, mbrojtja e Shkodrës kundër ushtrisë pushtuese serbo – malazeze jepet edhe nëpërmjet këngëve të rapsodit Prendush Gega, Artist i Merituar. Kështu autori sjell të freskëta për lexuesin vargjet: ”Kur erdh serbi me Karadak,/ Shkodra vogel u ba marak:/ “Nuk e lshoi vendin pa gjak!, /nuk e lshon vendin pa u shkri!”... Dhe po aty, (fq.26) vargjet kuptimplota: ”Top e pushkë digjet Shkodra!/ Top e pushkë Shkodra shkret!/ Për Shkipni po don me dek!” ...Autori këtu sjell edhe referencën nga Miss Durham: ”Malazetët të tërbuar nga që nuk po arrinin ta merrnin Shkodrën me forcën e armëve dhe nga dështimi i bisedimeve për dorëzim... deklarorin se do ta asgjësojnë gjithë popullsinë muslimane të Shkodrës!

Ky libër ka vlera të veçanta se pikërisht në këtë 111 vjetor të asaj lufte heroike legjendare na njeh me qëndresën e shqiptarëve kundër pushtuesve barbarë serbomalazez.

SHQIPTARËT

Pjesë interesante e librit është edhe historia e Norës së e Mirditës (Marshterpa e Spaçit), për të cilën autori Xh. Meçi shkruan se “Ndërsa Nora legjendare e Kelmendit ishte e shek. XVII, NORA e Mirditës ishte rreth 150 vjetë më përpara, por e mbetur në heshtjen e harresës”. Po ashtu në këtë libër mësojmë për qëndresën e Pukës dhe Malësisë së Gjakovës që shpëtojnë nga arrestimi i forcave osmane Hafiz Haxhi Ymer Prizrenin, kryetar i Komitetit Drejtues të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1881).

Autori i këtij libri, Xhemal Meçi është i kudogjendur në përvjetorë të ngjarjeve e personaliteteve historike. Dhe jo vetëm fizikisht, por me shkrime mbresëlënëse. Të tillë janë në këtë libër artikujt: “Përurohet pllaka përkujtimore kushtuar atdhetarit Haxhi Rrustë Kabashi” (fq.41), ku më tej (fq.47) boton edhe fjalën e mbajtur nga gjeneral Rrahman Parllaku – Nderi i Kombit në këtë përkujtimore (me titullin sinjifikativ: Shqiptarët,

një komb unik, si kurrë ndonjëherë në historinë tonë kombëtare”.

Po në këtë linjë është edhe analiza e librit të poetit, prozatorit e kantautorit të njohur Naim Berisha “Të jetosh në paqe”, ku sipas këndvështrimit të tij, hedh dritë mbi të vërtetën e origjinës të gjeneralëve të Skënderbeut Dhimitër e Nikollë Berisha.

Studiuesi i mirënjohur Xhemal Meçi (autor i librave të mëparshëm: ”Puka që në lashtësi”; “Kanuni i Lekë Dukagjinit, variant i Pukës, Itali 1996”; “Ndue Jak Pjetri ‘Mësues i Popullit’”; “Migjeni në Pukë”; “Kanuni i Lekë Dukagjinit, variant i Mirditës, Tiranë 2001; “Kabashi”- monografi; “Poeti i Malësisë” dhe “Komani, trashëgimi iliroarbërore”) në këtë liber (“Na ka çue Shkodra ni fjalë”) shkruan edhe për Zenel Xhemajl Kabashin, këtë burrë fisnik të Kabashit të Prizrenit, që sipas autorit ishte vetë historia dhe ndërgejeja kombëtare kosovare.

Në funksion të edukimit atdhetar të të rinjve tanë, Xh.Meçi bën pjesë të këtij libri edhe shkrimet me titujt: ”Recitohen ‘vaje’ nga ‘Lahuta e Malcis’ e Fishtës në provim shteti (Instituti i Lartë Pedagogjik , Tiranë, Qershor 1968); “Piktori Abdurrahim Buza puthi në Pukë për herë të parë flamurin kombëtar shqiptar” (1922); “Legjenda dhe burime për shqiponjën e zezë dykrenare” (Prof. dr. Bardhosh Gaqe) etj.

KONKLUSIONE

Në këtë libër gjejmë pasqyrim veprimtari akademiko – shkencore, të zhvilluara në Shkodër, Pukë e Tiranë, me objekt studimin e historisë së rezistencës së shqiptarëve në Luftën për mbrojtjen e Shkodrës së rrethuar prej ushtrive pushtuese serbo-malazeze (Nëntor 1912 – maj 1913), si një prej luftërave më heroike dhe po aq të lavdishme të kombit shqiptar, si dhe për traditat, kulturën e lashtësinë e gjuhës shqipe.

Nëpërmjet hulumtimesh e studimesh skrupuloze, autori i këtij libri sjell për lexuesin shkrimet interesante: “Puka – një qytet i bukur turistik malor” (ballë madhështisë së Alpeve Shqiptare), në 110-vjetorin e hapjes së shkollës Shqipe të Kabashit (1914-2024); “Abacia e Shën Palit të Pukës, Grykë Kabash në 1440 – vjetorin e saj” (për të cilën i referohet prof. Injac Zamputi, historian dhe përkthyesi i relacioneve të shek. XVI-XVII, që e radhit krahas abacive ma të njohuna në Shqipni). Po ashtu Xh.Meçi

shkruan për personalitetin e shquar islam dhe të kulturës kombëtare Hafiz Haxhi Hysen Ismail Muçaj – një erudit në traditën e dijes dhe të kulturës sonë gjuhësore mbarëkombëtare shqiptare. Ndërsa në 50 – vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (Tiranë, 20-25 nëntor 1972), trajton referencën e Ndre Mjedës “Kjoft mallkue kush qet ngatrrime ndër kto vllazen shoq me shoq, kush i dan me fjalë e shkrime, çka natyra vet përpoq!”..., për të vijuar me tej me shtjellimin e referatit të Profesor E. Çabej në Kabash të Pukës për sesionin e parë shkencor për toponimet, Kabash Qendër, 21 maj 1977, si dhe me profilin e Prof. David Luka i cili ndërroi jetë duke lënë pas kujtimin e një studiuesi të përmasave akademike, vazhdues i denjë i akademikut E. Çabej për gjuhësinë shqiptare, autor i botimit të 20 vëllimeve “Studime Gjuhësore”.

Në librin “Na ka çue Shkodra ni fjalë”, autori Xhemal Meçi shkruan edhe për veprimtarinë kërkimore – shkencore të Jeronim De Radës në fushën e studimeve filologjike dhe në lëmin e gjurmimeve onomastike e në atë të toponimisë historike (referuar kumtesës së Prof. dr. Jup Kastrati, botuar në kuadrin e 100 vjetorit të lindjes së tij (1924- 2024)..., shkruan për kontributin e Prof. dr. Eqrem Zenelaj, “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut” në fushën e studimeve dhe botimeve për pasqyrimin e historisë së popullit shqiptar dhe prejardhjes sonë iliro-pellazge,...

Në këndvështrimin tim analitik të kësaj vepre, interes për lexuesin paraqesin edhe artikujt: “Iballa sipas albanologut të shquar Han” (JOHANN GEORG: von HANN, albanolog i shquar, 1811-1869) në botimin “Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit”, 1863; “Migjeni në Pukë”, si dhe studimi i gjuhëtarit të njohur Petro Zheji: “Shqipja është mëma e të gjitha gjuhëve”, studim ky që u vlerësua nga Kadare, por u injorua nga Akademia e Shkencave.

Në tërësinë e tij libri “Na ka çue Shkodra ni fjalë” bart vlera të rëndësishme studimore për faktin se në të gjejmë prurjet më të reja në fushën e studimeve për historinë kombëtare shqiptare. Në faqet e tij ka studime dhe artikuj që përbëjnë arritjet më të reja të historiografisë shqiptare për ngjarjet dhe figurat historike./*Gazeta Panorama*

Kultura Ilire e Tumave të Matit në zbulimet e arkeologut të mirënjohur matjan

THESARE ARKEOLOGJIKE DHE ETNOKULTURORE NË TRE LIBRA TË DILAVER KURTIT



Krahina e Matit është e njohur jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë Shqipërisë, si një krahinë arkeologjike e rëndësishme me vlera të veçanta, sidomos për gjurmimin e studimin e kulturës ilire.

Ai që iu dha dimensionin e duhur shkencor këtyre gjurmimeve është historiani, arkeologu dhe etnologu i mirënjohur matjan, Dilaver Kurti. Me zellin e papërshkruar dhe njohuritë shkencore, në harkun kohor të tri dekadave (1952-1984), fillimisht si autodidakt dhe pas disa kërkimeve e zbulimeve me vlera të rralla, edhe si bashkëpunëtor shkencor i instituteve përkatëse të Akademisë së Shkencave, Dilaver Kurti bëri gjurmime në dhjetëra tuma të luginës së Matit, një pjesë e të cilave ishin mjaft të dëmtuara nga punimet bujqësore. Rezultatet e këtyre gjurmimeve ai i ka bërë të njohura dhe i ka botuar në revistat shkencore të kohës.

Rëndësia e këtij produkti kërkimor shkencor para së gjithash konsiston në faktin se nga tumat ilire të gjermuara të kësaj krahine u fituan të dhëna të reja lidhur me kufijtë kronologjikë të ngritjes e të përdorimit të tumave në krahinën e Matit dhe u grumbullua një lëndë arkeologjike e pasur e me vlerë që ndihmon për të krijuar një kuadër më të plotë mbi kulturën ilire të Matit, si dhe për lidhjet e saj me kulturat bashkëkohëse të krahinave të

tjera brenda e jashtë vendit.

Në shënimet e tij në dorëshkrim, të botuara tashmë në librin “Trashëgime iliro-arbërore”, studiuesit e kësaj fushe mund të gjejnë përshkrime të hollësishme për Tumën e Karicës, qytetin ilir të Xibrit, gjurmë të hershme vendbanimi në Burrel e Baz, etj.

Në studimet e thelluara të këtij historiani, arkeologju e etnologu gjejmë të dhëna të reja mbi kulturën ilire të tumave të Matit. Ato bazohen mbi gërmimet e kryera në dhjetra tuma ilire në luginën e mesme të lumit Mat, të cilat dhanë një material të pasur dhe me vlerë të madhe shkencore për studimin e kulturës materiale të banorëve të lashtë të kësaj treve.

Në vitin 1971, ky arkeolog i përqëndroi gërmimet në një tumë në afërsi të qytetit të Burrelit. Përdorimin më të madh tuma e Burrelit e pati në shek. VI-V p.e.s. Në këtë kohë ajo u pajis me unazë të ndërtuar nga një ose dy rradhë gurësh të vendosur në tabanin e tokës dhe me mbulesë gurësh, e cila pjesërisht ishte e dëmtuar, me sa duket, gjatë varrimeve të vona që janë bërë në të. Në këtë tumë u zbuluan gjithsej 79 varre, (54 me inventar dhe 25 pa inventar) që sipas arkelologut Kurti i përkasin gjysmës së dytë të periudhës së parë të hekurit, shek. VIII-V p.e.sonë.

Në këtë mënyrë, në punimet e këtij arkeologu gjejmë profilet e tumave, tipet e varreve, ritet e varrimit, ndërkohë që ai bën edhe analizën shkencore të gjetjeve. Kjo analizë, ndër të tjera iu përket objekteve të gjetura gjatë gërmimeve që ka kryer si: qeramikës, enëve metalike, veglave të punës dhe armëve, stolive, si dhe datimit të tumave dhe varreve.

Si askush tjetër, ky dishepull i dijes dhe ikonë e kulturës sonë kombëtare, sjell jo vetëm zbulimet e tij mbi tumat e Burrelit, varrezat e Burgajetit, për kodërvarrezën ilire të Komsisë e një mbishkrim latin në Mat, por edhe argumente e konkluzione, bazuar në metodat shkencore të kërkimeve e zbulimeve arkeologjike mbi Stelushin – Qytet i Skënderbeut në Mat, si dhe për zejen e prodhimit të barotit po në këtë krahinë.

Zbulimet arkeologjike të Dilaver Kurtit, me vlera të mirëfillta kërkimore shkencore kanë marrë ekspertizën dhe vlerësimin e dhjetra personaliteve akademike të fushës së arkeologjisë, si të: Prof. dr. Muzafer Korkutit, prof. dr. Afërdita Onuzit, Prof. as. dr. Zhaneta Andreas, prof. dr. Bep Jubanit, prof. dr. Mark Tirtës, prof. Selim Islamit, prof. Frano Prendit etj.

Prof. dr. Muzafer Korkuti, arkeolog (ish – kryetar i Akademisë së

Shkencave të RSH) vlerëson se “Nderi dhe kontributi që ka dhënë Dilaver Kurti në fushën e zbulimeve të kulturës ilire të gërmimeve në tumat e Burrelit, të Komsisë, të Suçit, etj., ka një vlerë kombëtare, sepse nëpërmjet dhjetëra tumave e qindra varreve u grumbullua një inventar shumë i pasur, i cili zgjeroi shumë njohjen tonë për kulturën e Matit”.

TESTAMENT I THESAREVE ARKEOLOGJIKE DHE ETNOKLUTURORE TË MATIT

Mat, përveçse një nga trevat lavdiplotë të luftërave kundër pushtuesve turq, serbë e bullgarë është i njohur edhe për thesaret e kulturës sonë popullore. Disa studiues të Matit dhe institucioneve qendrore shkencore, madje dhe ekspedita kërkimore shkencore komplekse kanë studjuar e hulumtuar rreth këtyre vlerave të pallogaritshme që përbëjnë pasurinë shpirtërore të popullit tonë, por ai që i la si trashëgimi është padyshim historiani, arkelologu dhe etnologu matjan Dilaver Kurti.

Zbulimet dhe shënimet argumentuese të tij janë testament i thesareve arkeologjike dhe etnokulturore që bart rrethi i Matit. Punimet e tij hedhin dritë mbi gjetjet arkeologjike në Mat, ndërsa sjell të dhëna të reja mbi kulturën ilire të tumave të Matit. Po ashtu në përmbajtjen lëndore të veprës së tij madhore “Trashëgime iliro-arbërore” gjejmë gjurmë të kulturës së herëshme shqiptare në Mat, si dhe kulturën e vonë antike të Matit si hallkë ndërlidhëse të kulturës iliroshqiptare.

Pjesë e përmbajtjes së pasur lëndore të kësaj vepre janë gjithashtu: “Shqiponja në motivin e gunës shqiptare”, “Veshja gurabardhase”; “Kulla e Matit”; toponimet e poemës “Kënga e sprapsme e Balës”, “Andrea Stopan i Arbërit”, “Shën Trinia e Matit” dhe studimi i thelluar për prejardhjen e Kastriotëve.

BASHKËPUNËTOR I FAMSHËM I TRE INSTITUTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE

Dilaver Kurti është afirmuar si historian qysh në fillim të viteve ’70, duke u bërë njëkohësisht bashkëpunëtor i famshëm i tre institucioneve kërkimore-shkencore, që kishte arritur jo vetëm të takohej me personalitete

të shkencave historike shqiptare, si me Aleks Budën e Eqerem Çabejin por edhe të vlerësohej prej tyre për produktin kërkimor shkencor të zbulimit dhe evidentimit të thesareve etnokulturore të Matit.

Më të hollësishëm e gjejmë këtë produkt në librin e tij të dytë “Shënime etnografike nëpër Mat”, ku përshkruhen gjer në detaje, jo vetëm gjërmimet arkeologjike, por edhe të dhënat gojore nga bashkëkohës në 62 fshatra të Matit, që nga Macukulli, Laçi, Bruçi, Uraka, Dukagjini, Bushkashi, Shkopeti, Batra, Martaneshi, Muzhaka, Gurra e Madhe e Gurra e Vogël, etj.

Dhe siç vlerëson Rakib Lasku, një emër i njohur i letrave dhe kulturës në Mat dhe në rang kombëtar: “Kushdo që ka rrënjët në Mat, qysh nga grykët e thikta të Shkopetit dhe deri në Martanesh, nga Qafë Murra në Qafë Shtamë, prej Qafës së Buallit në Qafën e Murrizës, do të gjejë në këtë libër vetveten ose të paktën një pjesë të vetvetes dhe sigurisht për atë, që është krenar për origjinën e vet, kjo nuk është pak”.

Për rëndësinë e kësaj vepre flet qoftë dhe vetëm studimi i Dilaver Kurtit “Rrugë karvanesh në Mat në shek. XIX-XX” (referuar shumë personave), ku ndërsa përshkruan me hollësi fillimin, përshkimin dhe mbarimin e tyre, arrin në konkluzionin se “Këto rrugë kryqëzonin krahinën e Matit, duke kaluar nëpër katër pazaret e saj: Në Derjan për zonën e Prellit, në Lis për Tematen, në Komsa deri më 1928 e më vonë në Burrel për Rranxën dhe në Stragj (Klos-Pazari ke Ura) për zonën e Krematës”.

Në vlerësim të këtij produkti voluminoz dhe cilësor në fushën e zbulimeve arkeologjike dhe studimeve etnokulturore, Prof.dr. Aferdita Onuzi, shprehet se: “Dilaver Kurti insistonte për të njohur deri në detaje çdo fenomen, jo vetëm në gjërmimet në terren, por edhe në njohjen e literaturës. Ishte i interesuar për çdo gjë që botohej”. Parë nga ky vështrim, etnologia e mirënjohur Onuzi e konsideron ndarjen nga jeta të Dilaverit (para 25 vitesh, më 27 nëntor 1998) një humbje e madhe për shkencën shqiptare, por kjo humbje, sipas saj, minimizohet në kuptimin se Dilaveri nuk ka ikur pa lënë gjurmë, pasi kemi shumë punë të tij të botuara, ndërkohë që ka lënë dhe shumë materiale e punime shkencore në familjen e tij.

PËRGJIGJE E DENJË PËR NJË PUNË “TË MUNGUAR”

Po prof. dr. Agron Xhangolli ka të drejtë që e vlerëson të tillë kontributin e Dilaver Kurtit. Se vërtetë ishte punë e munguar ajo që bëri studjuesi i zellshëm, arkeologu e etnografi shembullor Dilaver Kurti, që si bir i lindur në truallin e tokës së Matit, në gjirin e popullit të kësaj krahine, i brumosur me ndjenjat dhe kulturën e tij, vuri në shërbim të tij një punë sa voluminoze aq dhe të një rëndësie të pallogaritshme në fushën e studimeve kërkimore shkencore të dimensioneve mbarëkombëtare.

Këtë e gjejmë të sintetizuar qoftë dhe në shënimin e tij të para 40 viteve (Burrel, 15 shtator 1983) ku ndër të tjera shkruan se: “Tradita folklorike ka shtrirje të gjerë në hapësirë dhe në kohë. Ajo ngërthen ngjarje të vetë trevës së Matit, trevave përrreth tij dhe të mbarë trojeve shqiptare. Duke e parë në këtë vështrim, brenda truallit shqiptar topografia e tij rrezaton deri në Janinë, Delvinë, Vlorë, Berat, Elbasan, Durrës, Kavajë, Peqin, Manastir, Gostivar, Ohër, Shkup, Prizren, Prishtinë, Nish, Pejë, Gjakovë, Ulqin, Shkodër, Lezhë, Mirditë, Lumë etj. Por kjo topografi i shpërthen kufijtë e vendit e del jashtë deri në Rusi (Moskov), Austri (Nemca), Turqi, Greqi (Junani), Serbi, Mal të Zi (Karadaku), Egjipt (Misir), me të cilët lidhen ngjarjet apo tematikat folklorike”.

Ky parashtrim shëmbëllen botëkuptimin e gjerë të Dilaver Kurtit në studimet e gjurmimet e tij folklorike, jo vetëm nga Mati, por në gjithë trevat shqipfolëse, brenda e jashtë kufijve tanë tokësorë. Dhe këtë e bën mjaft mirë në librin “Folklor nga Mati” me një lëndë mjaftë të pasur, në gjashtë kapituj (me 315 faqe) ku përfshihen: Balada; Këngë kreshnikësh; Këngë historike; Lirika familjare; Lirika shoqërore (gjithsej 268 tituj këngësh) dhe proza popullore (me 12 tituj përrallash e 3 anektoda) që reflektojnë bardin popullor si krijues, interpretues dhe instrumentist. Këtë e pasqyron më së miri prof. dr. Agron Xhangolli, sipas të cilit: “Puna e realizuar për regjistrimin e krijimeve të ndryshme folklorike nga Dilaver Kurti ka qenë e shtrirë në kohë...”

Në krahina të ndryshme etnografike të Matit, në fshatra jo të pakta, ka shënuar tekste të këngëve të ndryshme, si tekste baladash, ndonjë tekst nga këngët e kreshnikëve, tekste këngësh historike, këngë lirike të llojeve të ndryshme, si ninulla, këngë dasme, synetie, vajtime, dashurie, nizami etj”. Po ashtu prof. Xhangolli evidenton edhe krijime të mirëfillta të Dilaver

Kurtit nga proza popullore, të tilla si përralla, anektoda, proverba dhe gjëegjëza.

DILAVER KURTI – KRIJUESI DHE DREJTORI KOMPETENT I MUZEUT TË BURRELIT

Vepra shumëdimensionale e Dilaver Kurtit vlerësohet edhe nga Esat Ruka, i nderuar e vlerësuar me titullin “Mjeshtër i Madh” nga Presidenti i Republikës, laureat i festivaleve folklorike, “Qytetar Nderi” i Matit dhe ambasador i paqes. Në librin e tij “Dukuri, fenomene kulturore, profile krijuese”, Ruka e vlerëson Dilaver Kurtin si arkeologun dhe etnologun e mirënjohur matjan. Kjo sipas tij, për faktin se Dilaver Kurti, pinjoll i fisit Kola të Burrelit që nga ato personalitete që rrëmoi me pasion e përkushtim në sektorin e historisë, specifikisht në arkeologji e etnografi. Pasi evidenton linçimin e Dilaverit (si të dhjetëra personaliteteve matjane) nga sistemi i diktaturës, sepse i ati i tij kishte qenë oficer i Mbretërisë Shqiptare, Esat Ruka ndër të tjera shkruan se: “Gjithsesi, puna e tij titanike bëri që ai ta rrëmbejë mbështetjen, duke ngritur njërin nga muzetë historikë më të mirë në shkallë vendi”.

Dilaver Kurti u lind të Burrel më 19 tetor të vitit 1934 dhe ndërroi jetë më 27 nëntor 1998. Që në rini, jetën e tij e vuri në shërbim të zellshëm të gjurmimit, mbledhjes dhe studimit të trashëgimisë historike dhe etnokulturore në trevën e Matit, fillimisht si autodidakt e më pas i diplomuar në Universitetin Shtetëror të Tiranës, dega Histori-Gjeografi.

Pas punës vetjake për grumbullimin e materialeve të shumta arkeologjike, etnografike etj, në vitin 1969 u bë nistatori i krijimit të Muzeut të parë në Mat. Ishte drejtues i Muzeut Historik të Matit deri në fillim të viteve '90, si dhe i ekspeditave të gërmimeve arkeologjike të kryera nëpër Mat në vitet '70-'80 të shekullit të kaluar.

Gjatë viteve '60 (shek.XX) e në vazhdim ishte bashkëpunëtor i jashtëm i instituteve kërkimore – shkencore pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ndërsa produktin e punës gjurmuese dhe studimore e botoi në revistat e tyre periodike shkencore “Studime historike”, “Iliria”, “Etnografia shqiptare”, “Monumentet” etj., si dhe në shtypin kombëtar e lokal të kohës.

Ndaj dhe Esat Ruka e vlerëson veprën e Dilaver Kurtit si apel për

intelektualët, që të kthejnë sytë edhe nga sektori i kulturës si pjesë e rëndësishme e identitetit tonë. Apeli i tij është se në kohëra do të kemi nevojë për të tjerë “Dilaver Kurtë”. Madje, z. Ruka shprehet se “Ky vlerësim dhe respekt për të paharruarin Dilaver Kurti, matjanin zemërbardhë, e si një dhëndër i lashtësisë, është përjetësuar me një këngë të bukur. Kënga ka marrë në hapësirat e saj poetike polenin e mjaltuar të vargjeve të poetit Gjokë Beci dhe muzikë e interpretim të kantautorit Esat Ruka që në vitin 1999”.

Në gjurmët dhe sipas shembullit e përvojës së tij, ecën edhe i biri, Artan D. Kurti, autori i librit “Matja në gur e në dru”, i cili me largimin nga jeta të të atit (studjuesit Dilaver Kurti) u mor me sistemimin dhe botimin e materialeve të tij, kryesisht të papublikuara.

Po ashtu dhe e bija Mimoza, mësuese e talentuar e letërsisë, që prej vitesh banon e punon në SHBA (me disa diploma e çertifikata të fituara edhe në Amerikë), i është përkushtuar studimit të historisë, duke eksploruar në terren venburimet ku babai i saj zbuloi thesare të arkeologjisë dhe etnokulturës matjane.

VEPRA KRIJUESE E DR.HAJRI MANDRIT NË TRI DIMENSIONE

- Poeti, dramaturgu dhe studjuesi i shembëlltyrës në folklor dhe letërsi, në proces të mbrojtjes së Titullit Profesor i asociuar.
- Dr.Hajri Mandri është pedagog në “ALBANIAN UNIVERSITY”, Tiranë, ku kryesisht jep lëndët: pedagogji dhe shkrim akademik.
- Në botimet e fundit ka kontribute të çmuara në pedagogjinë speciale, ku më evident ky kontribut shfaqet te libri i tij shkencor “Tiflopedagogjia”.



Para tre dekadash, në konkursin kombëtar të teatrove të Njësisë të Ushtrisë, si metodist i punës kulturore në ish – Shtëpinë e Ushtarakëve të Divizionit të Bulqizës, për t’iu përshtatur tematikës, zgjodha për të konkurruar me dramën “Bregdrinasit”. Autori, Hajri Mandri, ishte i njohur për kohën, pasi kishte botuar edhe drama të tjera. Madje, drama e tij “E fejuara”, e inskenuar nga trupa amatore e Pallatit Kulturës Bulqizë, pati një numër rekord shikuesish.

Për interpretimin e arrirë artistik dhe veçanërisht për faktin se drama “Bregdrinasit” kishte si subjekt historinë e “gjeneralit me shajak”, Elez Isuf

Ndreu, trupa e Shtëpisë së Kulturës të Divizionit të Bulqizës zuri vendin e parë në rang kombëtar.

E solla në vëmendje të lexuesit këtë fakt për të evidentuar një talent të “fshehur” të Dr.Hajri Mandrit, atë të dramaturgut. E dëshmon këtë talent qoftë edhe vetëm drama “Bregdrinasit”, me paraqitjen imponante dhe burrërore të Elez Isufit, që rrezatonte ngjashmëri me heronjtë antikë. Ngritja në art e aktivitetit të tij atdhetar, është një vlerë e shtuar për dramaturgun Mandri. Nëpërmjet dialogimit të personazheve, heroit kryesor Elez Isufi dhe bashkëkohësve të tij, Sufë Xhelili, Osman Paci etj, vjen jehona e asaj kohe të largët kur kryengritësit dibranë mbrojtën me stoicizëm trojet e tyre kundër pushtuesit serb.

Fjala artistike në dramën e Hajri Mandrit e sjell “gjeneralin e veshur me shajak” në të njëjtin nivel të atdhetarisë së gdhendur me gërma të arta në historinë tonë kombëtare. Mandri ka meritën e ngritjes në art të këtij biri besnik të atdheut, luftëtar i shquar për çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare. Kësisoj, dramaturgu H.Mandri, që para tri dekadash, e shihte këtë përzgjedhje si një mundësi e mirë që drama e tij të mund të ndikonte në edukimin atdhetar të shoqërisë shqiptare, ndërkohë që krijoi dhe botoi në Revistën “Teatër” edhe dramën “Mjeku i ri”, “Në rrjedhën e jetës” dhe “Joana”.

MODEL I RI VJERSHËRIMI DHE....

Hajri Mandri, fillimet e veta letrare i ka në poezi. Që kur ishte gjimnazist në Peshkopi dhe më vonë pas mbarimit të studimeve të larta, si mësues i letërsisë në shkollat e Bulqizës (dhe si Drejtor i Pallatit të Kulturës të qytetit minator), ai do të ishte fitues i disa konkurseve letrare të Degës së Lidhjes të Shkrimtarëve dhe Artististëve të Dibrës. Por gjithsesi, poezia e tij do të bëhej e njohur për lexuesin pas viteve '90 kur ai do të mund të botonte vëllimet poetike “Prag mijëvjeçari” e “Zjarret e ditëveveres”. Në të dyja vëllimet dallohet poezia liriko-filozofike. Këto veçori të poezisë së tij i ndeshim qoftë dhe vetëm tek vjershërimi i porosisë së babait: “M’u zgjuan ca fjalë të kyçura në zemër/ M’i tha babai që nuk është më sot/ M’i tha e iku pa m’i ngopur sytë/ Duke më lënë një det me mall të ngrohtë....”

Në këto dy vëllime H.Mandri krijon një model të ri vjershërimi në problematikë dhe në mjeshtërinë letrare, gërsheton natyrshëm vlerat

tradicionale të poezisë me mënyra të reja të shprehjes poetike.

Në përgjithësi në poezinë e tij mbizotëron natyra lirike, si te “Kroi i Verës” : “Mos ma prishni Kroin e Verës/ Kroi i Verës pikon mjaltë/ Tek ai krua, ajo hije/ Mrizon ëndërra prej fëmije/ Vijnë kujtimet më mbajnë gjallë,/ Kroi – leitmotiv i rrallë/ Mos ma prishni Kroin e Verës/ Musht e mjaltë në buzë e kam.....”.

Lirika është mbizotëruese edhe në disa poezi të tjera të Mandrit, por më evidente ajo është tek ajo me titullin “Lirikë”: “I rashë hënës me një grusht/ Hëna shkau dhe ra n’humnerë/ Atë natë ishte gusht/ Binte shi dhe frynte erë.../ Desha, që veç unë e ti/ Ta sundojmë tërë errësirën/ Qënia jote qe magji,/ Luminishonte natyrën”.

Ndërkohë konstatojmë se lirika në poezinë e këtij poeti shfaqet si vazhduese e vlerave më të mira të poezisë lirike shqipe, si psh tek poezia e titulluar “Ti më pret...”: “Mos më ndal sonte në rrugë/ Eshtë e shtunë, ajo më pret/ Vijëzon në ballë një rrudhë/ Dhe nga sytë, loti i shket.../Nuk ka forcë që më ndal sonte/ Ti ditëlindjen ke në fshat/ Po t’mos vijë ai merak nëne,/ Të shqetëson, s’të lë rehat!”.

Dhe duke e vështruar në tërësi krijimtarinë poetike të H.Mandrit mund të konkludojmë se ajo është bartëse e tipareve moderne që shfaqen në sistemin letrar shqiptar, ndërkohë që thjeshtësia e komunikimit, mesazhet universale dhe shprehja e hapur e ndjeshmërisë janë shtyllat e forta ku mbështetet poezia e tij.

.....SHEMBËLLTYRA NË FOLKLOR DHE NË LETËRSI

Në krijimtarinë e tij, Hajri Mandri është mbështetur thuajse tërësisht në traditën folklorike shqiptare. Librin “Shembëlltyra në folklor dhe letërsi” e ka shkruar fillimisht si tezë për shkallën “Master”, me titull pune “Shembëlltyra në tregimet alegorike dibrane”. Por kësaj teze iu përkushtua për vite të tëra deri sa arriti të marrë titullin Doktor i Shkencave në Studime Letrare.

Siç është shprehur udhëheqësi i kësaj teme, Prof. Dr.Shaban Sinani: “Studimi i Hajri Mandrit, për qëllimin që u hartua, mund të mjaftohej edhe vetëm me një paraqitje panoramike-anatomike të formave të ligjërimit me shembëlltyra në tregimet alegorike dibrane, në të folurit me rrotulla të Kosovës, në kallëzimet popullore të viseve të tjera veriore të Shqipërisë, që

përbëjnë dukuri folklorike me përhapje tejet të gjerë deri në ditët e sotme”. Por, duke e rilexuar tashmë si një monografi që u drejtohet studiuesve, lexuesve me interesa në fushë të letërsisë, folklorit, etnografisë, ligjërimeve gjuhësore, jo thjesht për ta paraqitur me dinjitet para një komisioni specialistësh, vlerat e këtij libri mund të çmohen në një kontekst më të gjerë.

Analiza gjuhësore e Studimit “Shembëlltyra në folklor dhe letërsi” hedh dritë jo vetën në pasqyrimin dhe dokumentimin e vlerave folklorike të Dibrës dhe krejt Verilindjes, por edhe për çështjet që lidhen me fushat e onomastikës, krijimtarinë popullore folklorike, dialektologjike etj.

Ky studim paraqet frymëzim shpirtëror jo vetëm për studiuesit e sotëm të Folklorit shqiptar, por edhe për gjuhën shqipe dhe popullin shqiptar në përgjithësi, sepse aty pasqyrohet historia, mendësia popullore, doket, ritet, besimet etj.

Përveç synimit për të qenë një ndihmesë në studimin e tipologjisë dhe karakteristikave të veçanta të mjeteve kohezive në gjuhën shqipe, punimi është motivuar dhe mbështetur edhe nga një qëllim tejpgjuhësor, për të vënë në qendër veprën e mbledhësve të folklorit, si përfaqësues të prirjes realiste kombëtare në letërsinë shqiptare, që bosht të krijimtarisë së vet pati vlerat dhe vyrtytet njerëzore të njëmendëta dhe të përhershme, që shqiptarin e djeshëm dhe të sotëm, pa se i lidh vazhdimësia e traditës, e urtësisë, e virtytit moral por edhe tragjiciteti, ky shoqërues i përhershëm i ekzistencës së tij, i cili ka përcaktuar edhe kalitjen e shpirtit të tij të qëndrësës.

Qoftë edhe më këtë botim shkencor mund të arrijmë në përfundimin se Dr.Hajri Mandri është tashmë nga ata personalitete me kontribut të rëndësishëm që u ofron studentëve njohuri parësore për një dukuri të pastudiuar, vetë bartësve të fundmë të ligjërimit me shembëlltyra një mënyrë të interpretuari të stilit të tyre të të folurit, specialistëve të letërsisë e të folklorit një varg problemesh të nevojshme për të gjykuar drejt për gjuhën, folklorin, letërsinë dhe marrëdhëniet midis tyre dhe mbi teoritë e evolucionit të zhanreve dhe të figuracionit; studiuesve të një niveli më të lartë formimi tema të hapura që presin njerëz të zellshëm dhe të formuar për t’u shpënë më tej.


<http://rrugaearberit.com/2017/09/05/tri-dimensionet-e-vepres-krijuese-te-hajri-mandrit/>

PEDAGOGJIKJA E PESHKOPIË, TEMPULL I DIJES

Studjuesi Xhavit Lashi, monografi interesante për historinë e arsimit në Dibër

Më 27 shtator 1948, në qytetin verilindor të Peshkopisë u hap e para shkollë pedagogjike, e cila për vetë “produktin” e saj (qindra personalitete, deri ministra, gjuhëtarë e profesorë, poetë e shkrimtarë, artistë, diplomatë e gazetarë), me të drejtë njihet si “Universiteti i Dibrës”. Një bilanc mbresëlënës për faktin se ajo nxori rreth 2200 kuadro, djem e vajza, që çuan dritën e diturisë dhe kulturën në gjithë krahinat e fshatrat e zonës verilindore të Shqipërisë.

Pikërisht në vigjilje të 70-vjetorit të krijimit, njëri nga ish-nxënësit e shkëlqyër të saj, historiani Xhavit Lashi botoi monografinë “Shkolla Pedagogjike e Peshkopisë”. Kjo është dhurata më e mirë që studjuesi kukësiyan u bëri në këtë ditë feste jubilarë ishmësuesve e nxënësve të kësaj shkolle. Autori sjell fakte interesante që plotësojnë historikun e zhvillimit të arsimit: Nga shkolla e parë shqipe në qytetin e Dibrës më 1888; Internati i Dibrës më 1923 dhe i Kastriotit më 1925, Unikja më 1945, Pedagogjikja më 27 shtator 1948 e deri tek filiali i Universitetit të Durrësit në qytetin e Peshkopisë.



PAK HISTORI

Mësojmë nga kjo monografi hapjen e të parës shkollë shqipe në qytetin e Dibrës më 1888 nga patrioti Said Najdeni, vetëm një vit pas hapjes së shkollës së parë shqipe në Korçë. Më tej, mbështetur në burime arkivore në libër gjejmë ngritjen e dy Internateve në Dibër e Kosovë, sipas Shkresës së Ministrisë së Arsimit nr.366, datë 8 shkurt 1923.

Internati “Dibra” u vendeos së pari në shtëpinë e Shehat Shehut në Qafë të Pazarit, të marrë me qera dhe në vitin 1925, ky Interant kaloi në Kastriot të Dibrës. Meritë për këtë kanë drejtorët e nderuar: Haki Sharofi, Ferid Jegeni, Sali Morina, Ahmet Imami, Ferid Imami, Ramadan Sejдини e Rifat Spahiu, si dhe mësuesit: Qemal Drita, Zejnel Zajmi, Ramazan Sefedini, Hafuz Fetah Ajdini, Abdulla Çanga, Muharrem Musa, Refik Shpuza, Fehti Dizdari, Faik Pajuni, Beqir Spahiu, Hydajet Ceka, Shyqyri Daiu, etj.

Jo pa qëllim, autori sjell një listë me emra personalitetesh të përmasave kombëtare që kontribuan në drejtim e në mësimdhënie, për të vijuar me nxënësit që kanë mësuar në Internatin “Dibra”, ndër të cilët dëshmorët e atdheut Nazmi Rushiti, Demir Gashi e Tufik Çanga, si dhe personalitetet e mëvonshme të arsimit në Dibër: Selim Alliu, Adem Shehu, Xhavit Hysa, Fehmi Plaku, Haki Alush Kumanova, Munir Shehu etj.

Është pikërisht kjo plejadë që do kontribuonte më vonë, pas çlirimit në hapjen e shkollës Unike të Peshkopisë më 1945 dhe tre vjet më vonë edhe të Pedagogjikes, më 28 shtator 1948. Shkolla Pedagogjike e nisi rrugën e saj më 21 nxënës: 13 nga rrethi i Dibrës, 5 nga rrethi i Kukësit dhe 2 nga rrethi I Elbasanit. Në vitet në vazhdim u rrit numri i nxënësve, duke u pranuar në të me bursë si konviktorë ata që vinin nga rrethet e Verilindjes. Asnjë mësues nuk ishte vendas. Mësuesit u emëruan nga Ministria e Arsimit. Studjuesi Xhavit Lashi, në librin e tij, ndër të tjera nënvizon se “Prej Shkollës Pedagogjike Peshkopi, kanë dalë kuadro që kanë bërë emër të mirë në shkallë rrethesh e në shkallë vendi. Nga bankat e shkollës janë përgatitur jo vetëm mësues e pedagogë të aftë, por dhe kuadro të tjerë që kanë punuar me përkushtim e kompetencë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, shkencës e politikës. Prej tyre ka shkencëtarë, profesorë, diplomatë, juristë, artistë, sportistë, gazetarë, drejtues të organeve të pushtetit, të partisë dhe të ekonomisë”.

PEDAGOGJIKJA E PESHKOPISË NXORI PERSONALITETE NË RANG KOMBËTAR

Në këtë mori emrash autori ndër të tjerë evidenton ish pedagogjikasit e Peshkopisë (deputetë, diplomatë, profesorë e doktorë shkencash, gjuhëtarë, fizikantë, biologë, shkrimtarë, ushtarakë, artistë, sportistë etj)

si: Xhelil Gjoni, Tefta Cami, Lumturie Rexha, Femi Abdiu, Safet Zhulali, Shefqet Hoxha, Sulejman Tomçini, Abdi Baleta, Maxhun Peka, Kamber Faruku, Nuri Abdiu, Shaban Sinani, Muharrem Dezhgiu, Xhafer Martini, Lutfi Hanku, Naim Plaku, Sali Onuzi, Musa Riçku, Liri Rasha....Këta, si dhe dhjetra emra të tjerë të spikatur që u përgatitën nga ky tempull i dijes vijnë të profilizuar në opinionet, kujtimet essetë e disa bashkëpunëtorëve të autorit Lashi, i cili ka spikatur në përzgjedhjen, redaktimin dhe përfshirjen e tyre në këtë monografi dinjitoze, duke plotësuar kështu historikun e Shkollës Pedagogjike të Peshkopisë si vatër e ndritur e dijes per gjithë zonën verilindore të vendit. Libri ka shumë personazhe, që gjithsesi redaktori i tij, prof. dr.Hajri Shehu nuk i konsideron si personazhe të një libri letrar-artistikë, por më shumë se kaq, pasi sjellin kujtime dhe vlerësime për shkollën e për mësuesit. Kjo edhe për faktin se ato janë tubuar sipas një tematike të caktuar. “Kujtimet vijnë nga autorë të ndryshëm e prandaj krijojnë një mozaik, një thyezim. Dhe është një thyezim shumëngjyrësh. Kësisoj, shumë i këndshëm”, nënvizon prof.dr.Hajri Shehu. Autori i kësaj monografie Xhavit Lashi që mban diplomën “shkëlqyer” nga Pedagogjika e Peshkopisë, më 1975 përfundoi studimet e larta për histori-gjeografi dhe filozofi dhe më pas për dekada të tëra punoi si mësues e në detyra e funksione të rëndësishme në rrethin e Kukësit. Ka botuar dhjetra artikuj studimorë e problemorë si dhe librin “Qarku i Kukësit në rrjedhën historike – ndarja administrative dhe qeverisja vendore”. Në librin e ri “Shkolla Pedagogjike e Peshkopisë”, që u botua pikërisht në vigjilje të 70 vjetorit të krijimit të saj, Xh.Lashi sjell në kujtesën e armatës së mësuesve e nxënësve të saj rrethanat historike në të cilat u ngrit kjo shkollë e konsideruar si “Universiteti i Dibrës”, si dhe një varg ngjarjesh e personalitetesh që kanë lënë gjurmë në historinë e arsimit tonë kombëtar. Kjo monografi është produkt i hulumtimeve, evidentimit dhe pasqyrimt të ngjarjeve që lidhen me rritjen ndër vite të këtij tempulli arsimor. Studimet e autorit si dhe rrëfimet e bashkëpunëtorëve të tij flasin për një histori përpjekjesh për të përgatitur kuadrot që do përhapnin dritën e diturisë në zonën verilindore të vendit me një popull të vogël në numër, por të madh në botën e tij shpirtërore, në vullnetin e tij për të qenë i arsimuar e i kulturuar. Botimi i kësaj monografie paraqet rëndësi të veçantë sidomos për më shumë së 2200 kuadrot që u përgatitën nëpër dyert e këtij tempulli të diturisë, por

edhe për vetë qytetarët e Dibrës, Kukësit, Matit, Tropojës e Krujës, pasi në këtë historik të Pedagogjikes së Peshkopisë ata gjejnë edhe një pjesë të historisë së tyre.

Ky libër që duhet konsideruar si kontribut i çmuar i autorit Xhavit Lashi në letërsinë dokumentare, në pesë kapitujt e tij sjell një lëndë të pasur me të dhëna për Dibrën e Peshkopinë, Shkollën Pedagogjike dhe rrethanat e hapjes së saj, drejtorët e stafin pedagogjik ndër vite, kujtime nga shkolla, ku një vend të veçantë zënë ish-pedagogjikasit kukësi në Peshkopi si dhe takimet me rastin e përvjetorëve të shkollës. Monografia për historikunë saj përbën një ngjarje të madhe për historinë e arsimit dhe të kulturës shqiptare.

<https://telegraf.al/kulture/70-vjetori-i-tempull-i-dijespedagogjikja-e-peshkopise/>

PUBLICISTIKA IMPRESIONUESE E IRFAN DASHIT

Shënime për një vepër në koherencë me realitetin e sotëm shqiptar



Ky libër, në tërësinë e tij është produkt i një shpirti të ushqyer me dashurinë e madhe për jetën. Në faqet e tij gjen jetën, njerëzit, atdheun, finesën kulturore, krenarinë dhe dashurinë mëmëdhetare, përmes temash që trokasin në mendjen dhe zemrën e autorit I.Dashi.

Irfan Dashi, një emër shumë i njohur për publikun, jo vetëm në kryeqytetin shqiptar por thuajse në gjithë vendin, si sindikalist, politikan lokal dhe drejtues i suksesshëm i disa ndërmarrjeve e institucioneve, ish-kryetar i Njësisë Bashkiake Nr.6 (Kombinat) Tiranë, për dy mandate (2000-2007), drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit të Bashkisë Tiranë dhe Rezervave të Shtetit, pas botimit të librit të tij të parë **“Kam punuar me Edi Ramën”** (2022), kësaj here vjen si befasi për lexuesin me librin e dytë: **“Kohë e artë për pëhlivanët”**.

Qoftë edhe nga titulli intrigues i librit, që në fillim hamendësojmë për një vepër në koherencë me realitetin e sotëm shqiptar.

A nuk janë vërtetë në koherencë me aktualitetin e sotëm tema si: *“Sot, të jesh i poshtër është e modës”*; *“Mundësia historike dhe absurditeti shqiptar”*; *“Pragmatizmi i pushtetarëve”*; *“Pushteti i Badigardëve”*; *“Konsumi i marrëzisë politike i politikanëve shqiptarë”*; *“Po ikin Vip-ët e krimit”*,*etj (kapitulli I)*, që autori i trajton më sëmiri nëpërmjet një publicistike

impresionuese?!

Ndërtimi strukturor i veprës në katër kapituj: **(I)**-Për politikën dhe fenomenet politike të kohës; **(II)**-Portrete personazhesh të spikatur, intervista, reportazhe e vëzhgime; **(III)**-Politika sindikale, marrëdhëniet e punës, opinione për legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës etj....; **(IV)** -Jo vetëm shënime udhëtimi... si dhe lënda mjaft e pasur dhe e larmishme e librit me *publicistikë, ese, portrete njerëzore e intervista*, e bëjnë atë tërheqës.

Ndonëse në fokus janë analiza, ese dhe refleksione, të frymëzuara kryesisht nga ngjarje të viteve 1993-1999, ku autori është investigues, tema të tilla janë të prekshme edhe sot e kësaj dite, pas më shumë se tri dekadash tranzicioni shqiptar të tejzgatur.

Autori Irfan Dashi është konkret përballë kësaj përgjegjësie historike, kur trajtimin e këtyre temave e bën duke shtjelluar perifraxime të të mëdhenjve të politikës e letrave si: **Malaparte në librin e tij “Kaput 1943”**: “Të jesh i poshtër është moda e fundit në Itali. Të gjithë janë bërë të poshtër: mbreti, papa, Musolini, princat, kardinalët e gjeneralët”; **Xhorxh Oruëll**: “Të gjitha kafshët janë të barabarta por, disa kafshë janë më të barabarta se të tjerat”; **Nolin e famshëm**: “Kur mbreti vjedh një vezë, ministrat përlejnjë tërë pulat e fshatit”; të urtin gjer më madhështi **Arbër Xhaferi** kur thotë se: “Politikanët shqiptarë po konsumojnë marrëzinë e tyre politike”, apo edhe thirrjen e **Ana Oxës**: “Politika shqiptare të shohë më larg se kolltuqet, të lë mënjanë grindjet e interesat e ngushta, e të rivalitetit për përfitime” që është apeli, që del nga thellësia e shpirtit të një gruaje, e cila ka ndër deje gjak shqiptari dhe kërkon që, energjia ndërkombëtare e harxhuar dhe gjaku i derdhur nga populli kosovar të shfrytëzohet për ndërtimin e paqes e demokracisë, sepse.... siç thotë Ana, ne i tregojmë botës që na ndihmoi, por edhe vetes se e meritojmë fjalën e madhe e të rrezikshme që quhet **Liri...**

Si redaktor i librit, që në leximin e tij të parë pikasa e përftova një plazmim estetik të ngjeshur në përfytyrime, imazhe të reja dhe origjinale, mesazhe të qarta dhe sinjifikative, tekst e nëntekst, gjeta të plazmuar përditshmërinë dhe, njëherësh, pashë të gëlonte historia, e tanishmja si dhe e nesërmja e përfytyruar sipas vizionit të këtij autori.

Më të dukshme këto në kapitullin e II-të: “Portrete personazhesh

të spikatur, intervista, reportazhe e vëzhgime”, ku autori i kësaj vepre profilizon mjaft mirë artististikisht personalitete si: **Mjekët e Poliklinikës së Specialiteteve nr.2 në Tiranë**, pasi për të tillë njerëz ka nevojë kjo kohë, ka nevojë ky vend, kanë nevojë shpirtrat e lënduar të shqiptarëve. “Të njohësh këta njerëz është kënaqësi, të rrish me ta është nder dhe privilegj dhe të vizitohesh nga ata është fat”. Apo dhe **Muhamet Rrumbullaku**, për të cilin autori shkruan se: “Fytyra e krimit dridhet tashmë nga profesionalizmi dhe përkushtimi i kolonelit”. Ndërkohë, në këtë kapitull, mbresëlënëse janë intervistat e autorit me: **Bejkush Birçe**, një nga korifejtë e bankinës së futbollit shqiptar; me ish-futbollistin e njohur të “Partizanit”, **Gjergji Thaka**, si dhe “**Biseda me miq sindikalistë nga Italia**”, sipas të cilëve “Puna sindikale duhet të jetë dinamike”.

Parë nga ky këndvështrim, në këto portrete, biseda e intervista, sështë e vështirë të kuptosh se si Irfan Dashi di të depërtojë në botën e brendshme të personazheve në mënyrë realiste e objektive, atë çka ata mishërojnë dhe përçojnë te publiku i gjerë.

Për Irfan Dashin, Lëvizja Sindikaliste, problematikat dhe pëpjekjet e instancave shtetërore e të individëve të veçantë për ta shuar atë, ka qenë shqetësim permanent. Ndaj dhe në harkun kohor të një dekade (1991-2000) ka shkruar e botuar dhjetra artikuj problemorë, vëzhgime e analiza të mirëfillta në gazetën “Pasqyra”, (të përmbledhura këto në kapitullin e tretë të këtij libri: “*Politika sindikale, marrëdhëniet e punës, opinione për legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës etj...*”).

Ky libër, në tërësinë e tij është produkt i një shpirti të ushqyer me dashurinë e madhe për jetën. Në faqet e tij gjen jetën, njerëzit, atdheun, finesën kulturore, krenarinë dhe dashurinë mëmëdhetare, përmes temash që trokasin në mendjen dhe zemrën e autorit I.Dashi.

Më videntë këto në kapitullin e fundit: “**Jo vetëm shënime udhëtimi..**”. Gjejmë në këtë kapitull përshkrime brilante të vizitave zyrtare të autorit (si kryetar delegacionesh dhe në përbërje të tyre) në Danimarkë, Greqi, Austri, Gjermani, Francë, Maqedoni, jo vetëm të bukurive magjepëse të kryeqyteteve e resurseve turistike të këtyre vendeve, por edhe të karakterit e të imazhit negativ që krijuan disa persona, përbërës të këtyre delegacioneve gjatë këtyre vizitave. Në këto përshkrime autori përshfaq profilin e tij të intelektualit të virtytshëm që s’bën kompromis me të keqen,

krenarinë për vendin tonë Shqipërinë, ndërkohë që evidenton fenomenet negative të shfaqura në metrotë e njësitë e shitjes të këtyre kryeqyteteve nga ata që demonstruan vesin e keq të vjedhjes, diferencat në kulturën e të ngrënit etj. Në këtë kapitull, gjejmë modelin shkrimor publicistik–letrar të reportazhit që kërkon një specifikë tjetër të të shkruarit. Madje, ndonëse me profesion inxhinier mekanik, autori i këtij libri prezantohet si njohës i gjuhës dhe letërsisë, dhe këtë e reflekton më së miri, qoftë dhe në zbatimin me përpikmëri të rregullave drejtshkrimore, ashtu dhe në perifrazime të disa personaliteteve të njohura të letrave.

Shumë do doja, përpara se libri të shtypej, të hidhja edhe unë “pakëz kripë”, duke bërë ndonjë vërejtje a sugjerim për autorin, por s’mundem. Ju kthehem faqeve të tij herë në krye e herë në fund duke qëndruar nëpër to dhe nuk gjej dot “asgjë të lajthitur” për nga vlerat publicistike, të letrares dhe historikes të pasqyruara në këtë libër. Me të vërtetë libri është konceptuar si një koncert i madh muzikor, (i arritjeve dhe problematikave të sindikalistëve shqiptarë ndër vite, i mëkateve të politikanëve dhe pasojave të inkriminimit të politikës si rrjedhojë e lidhjes së saj me krimin, etj, etj) ku gjen nga të gjitha instrumentet, që nga bateritë e tam-tameve të të korruptuarve e deri te përvoja e përparuar botërore e Lëvizjes Sindikale.

Kjo edhe për faktin se nuk ka zgjedhur poezinë Irfan Dashi në një Oqeanopoezi, ku të gjithë vargëzojnë ditën e natën, para telenovelave e para tribunave, e pak, shumë pak poezi të mbetet në kujtesë, në mish, nën lëkurë; pale t’i vësh nën jastëk apo t’ua tregosh fëmijëve, miqve, nxënësve, në një kohë të caktuar, edhe pse bëhen sa e sa konkurse, shtrohen dreka për të, hidhen sa e sa lekë, euro, dollarë në tavolinat e botuesve të shtëpive botuese kudo e kurdo. Ai vjen me një libër racional, emocional, dokumentar, arkivor që të bën ta marrësh diku një laps nga ato që shumë herë i kemi harruar përballë dehjes që na kanë bërë tastierat e kompjuterave dhe të celularëve dhe të shkruash diçka, mbase edhe shumë. Të shkruash për t’u bërë më tej një urë modeste e dobishme dhe e bukur mes kësaj vepre dhe publikut që e ndjek me shumë respekt, padurim dhe kureshtje mendimin dhe ligjërimin e tij estetiko-profesional.


Kësisoj Irfan Dashi vjen në tregun e librit shqiptar me botimin e tij të dytë, me një përmbledhje publicistike, sa modeste aq edhe mbresëlënëse. Thjesht dhe bukur, me gjuhë të pasur dhe me një ndjesi njerëzore, autori

rrëfen, përshkruan, tregon fakte, ngjarje, jetë dhe kontribute njerëzore, karaktere dhe viktima, të vërteta rrëngjethëse të qeverive e institucioneve të tri dekadave të fundit..

Libri i tij **“Kohë e artë për pehliuanët”** është një “mozaik publicistik”, shkruar thjesht, pa bujë dhe bërtitje, me gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme qartë dhe rrjedhshëm, ndaj dhe duhet të jetë në bibliotekën e çdo lexuesi të rregullt shqiptar.

<https://gazetadestinationsi.al/publicistika-impresionuese.../>

PROF.SHPËTIM CAMI “KOHERENT ME ATO ÇKA THOTË E BËN”



Pasi ke lexuar librin “KOHERENCË” të autorit Shpëtim Cami – botim i “M&B”, nuk ka se si të mos i bashkohesh vlerësimit të Prof. asoc. Dr. Zamira Çavos, pasi me të vërtetë në të gjen shpirtin dhe veprën e një njeriu koherent me ato çka thotë e bën.

I kompozuar në formën e një triptiku (me tre kapituj: Vlera dhe personalitete; Opinione dhe analiza; Politika dhe qeverisja si përgjegjësi) libri “Koherencë” përçon tek lexuesi mesazhet e një intelektualit me vitalitet e shpirt krijues. Autori e bën këtë në 38 shkrimet që i përgjigjen titullit të librit, si profile, reportazhe, analiza e refleksione. Ai ka meritën që t’i paraqesë personazhet dhe ngjarjet në mënyrë sugjестive, me thjeshtësi dhe në mënyrë të perceptueshme në komentet dhe në arsyetimet e veta. Në tërësinë e lëndës ndjehet dora e një publicisti të përgatitur, që shkruan me ndjenjë e me stil, cilësi këto që e bëjnë interesant këtë libër për lexuesin. Në këtë pikëpamje libri ka vlera të njëmendta dhe është i rëndësishëm fakti që botohet bash në kohën e duhur.

Duke evidentuar dhe përçarur tek lexuesi vlera të veçanta, me qartësi mendimi dhe me stil të mprehtë, autori shkruan për personalitete të cilat,

edhe pse nuk jetojnë, do të ishin në unison me të, në shqetësimin e tij për të ardhmen e kombit, për Shqipërinë. Shembulli më sinjifikativ për këtë është profili i Prof. Nuri Abdiut, si emblemë e fisnikërisë, urtësisë dhe mençurisë dibrane. Madje, autori ia dedidon pikërisht këtij dishepulli të dijes edhe zgjedhjen e tij në dilemat midis fushës akademike dhe asaj politiko-administrative. Ndonëse me përvojë jo të pakët në këtë të fundit (si ish-Përgjegjës i Sektorit të Statistikës dhe Informacionit në Drejtorinë Arsimore Kurbin; ish-Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Transportit Rrugor, anëtar i Këshillit të Bashkisë Tirnë, Kryetar i Njësisë Bashkiake Nr.1, Tiranë, etj), referuar prof. Abdiut, autori shkruan se Ai, pa u menduar gjatë ka rekomanduar që të angazhohet në fushën akademike. Rezultati i kësaj përzgjedhjeje është përvoja 12-vjeçare e Shpëtim Camit në sistemin e arsimit të lartë, si pedagog dhe drejtues në Universitetin Illyria, Tiranë dhe Universitetin Ndërkombëtar Strugë, Maqedoni e Veriut. Aktualisht ushtron detyrën e përgjegjës të Departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit pranë Universitetit “Barleti” në Tiranë.

U ndala jo pa qëllim, pak në CV-në e këtij autori, për të evidentuar implementimin e kësaj përvoje gati 38-vjeçare në fushën e arsimit, politikës, administratës, shoqërisë civile, biznesit dhe në fushën e botimeve, si edhe në këtë liber.

Kështu, në kapitullin e parë “Vlera dhe personalitete”, autori shkruan me frymëzim, por edhe me plotë emocione dhe krenari të ligjshme për “Gjoricën, fshatin midis ujrave”, si recensë të librit të bashkëautorëve Qemal osmani e Shaqir Skarra.

Me mjeshtri të rrallë artistike autori sjelledhe jehonën e këngës dibrane në Kurbin, nëpërmjet zërit brilant të artistes së mirënjohur Liri Rasha, dekoruar nga Presidenti i Republikës me titujt “Mjeshër i Madh” dhe “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”. Për këtë ai i referohet kohës kur kjo artiste më 1994, me bashkëshortin e saj Pashk Jushi erdhën të jetonin pranë të afërmëve të tij në qytetin e Laçit. “Pavarësisht se në Laç mungonte tradita e këngës si në Dibër, Liria kontribuonte, jo vetëm me zërin, por edhe me përvojën e saj artistike. Ajo ishte pjesë e koncerteve me orkestrën e Pallatit të Kulturës Laç dhe Krujë, të cilat u shfaqën jo vetëm në rrethin e Krujës e të Kurbinit, por edhe në Danimarkë e Belgjikë”, -shkruan autori Cami. Më tej ai i bën të ditur lexuesit se në Laç

u rrit edhe e bija e Liri Rashës, Ingridi, trashëgimtarja e zërit kumbues të nënës së saj dhe që prej vitesh ka bërë emër si një zë i veçantë dhe interpretuese dinjtoze e këngës qytetare dibrane e asaj shqiptare në tërësi. Në morinë e vlerësimeve autori i librit shkruan për shkollën e fshatit Viçisht ku u skalitën dashuria për letërsinë dhe shkencat e natyrës. Po ashtu në reportazhet “Një udhëtim buzë Korabit” e “Një ditë e veçantë me vlera të shumëfishta” (Nga fjala në “Ditën e librit”, zhvilluar nga Lidhja e Intelektualëve Dibrane në Shkollën “Hasan Leka, Shumbat) autori përcjell mesazhin se ka edhe vlera të mira ky vend, kjo krahinë, që duhen njohur, që duhen ndjekur e promovuar.

Ndërsa kur është fjala për Bulqizën “pasuria me tre emra”, Sh.Cami, përveçse përshkrimi brilant të pozitës gjeografike, fokusohet edhe në vendbanime të herëshme me gjetjet arkeologjike në Krajkë të Zerqanit apo në Shupenzë, si edhe në fushën e Gjoricës, luginën e Fushë Bulqizës dhe të Vajkalit, që kanë hyrë në histori që nga koha e Skënderbeut. Pjesë e këtij libri racional, emocional, dokumentar, arkivor është edhe artikulli “Sfida që duhen përballuar”(Mbi kontributin dhe suksesin e Shoqatës Gryka e Vogël Dibër), si dhe intervista dhënë gazetës “Rruga e Arbërit” (“Faktor të bën nevoja e përbashkët”) kur Z.Cami ishte nënkryetar i Njësisë bashkiake Nr.1, Tiranë.

Ndërsa në kapitullin e dytë “Opinione dhe analiza” autorishpalos një shpirt të madh, gati parajsor, pothuajse në të gjitha shkrimet, si në analizën e librit me vlera globale të gjeneral Gëzim Ostrenit “Dëshmia e Gjeneralit”, ashtu edhe në këndvështrimin mediatik mbi luftën e UÇK-së në Maqedoninë e Veriut, për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut si faktor shtetformues, etj.

Testin e saktë të profesionalizmit të tij, Sh.Cami e kalon suksesshëm edhe në pjesën e portretizimit. Këtë ai e jep, jo vetëm në profilet e personazheve të spikatur (sinë profillin e prof.Nuri Abdiut), por edhe kur shkruan për të njohur e të panjohur shumë për publikun, si për “Vlerat qytetare të Leko Makos” ashtu edhe tek “Heroi i shtangës”, kushtuar peshëngritësit Aleksandër Kondo.

Në kapitullin e tretë “Politika dhe qeverisja si përgjegjësi” Sh. Cami është i drejtpërdrejtë me lexuesin e tij dhe konformizmi për të është i papranueshëm. Reflektim i këtij qëndrimi janë shkrimet “Tirana, një model

përtej të majtës e të djathtës”, “Të ndjesh përgjegjësinë e përfaqësimit”, “Fokusi i punës së ndërlydhësve me komunitetin” etj.


Sh.Cami vjen kështu në tregun e librit shqiptar me një përmbledhje publicistike, sa modeste aq edhe mbresëlënëse. Thjesht dhe bukur, me gjuhë të pasur dhe me një ndjesi njerëzore, ai rrëfen, përshkruan, tregon fakte, ngjarje, jetë heronjsh dhe kontribute njerëzore. Me një gjuhë letrare dhe rrëfim të admirueshëm ato të emocionojnë për detajet e stilin që ai ka zgjedhur dhe që e bën origjinal.

Referuar fakteve që na sjell autori dhe libri i tij me reportazhe, portrete, analiza etj, vetë kultura në këtë libër shumë të detajuar dhe mjaft përfshirës është reflektim nga qasja, tradita, avancimi në njohjen e gjerë të veprave të marra në konsideratë, po ashtu dhe të personaliteve që autori i ridimensionon me thjeshtësinë e bukurinë e fjalës shqipe.

Profilin krijues të këtij autori e evidentojnë më së miri Prof.asoc. dr.Zamira Çavo dhe prof.asoc.dr.Bajram Yzeiraj, vlerësimet e të cilëve janë vënë që në hyrje të librit. Kështu nëse sipas Znj.Çavo: “në këtë libër gjen komunikim njerëzor si dhe vlerësime për individë që kanë kontribuar në shoqëri heshtazi, pa pritur lëvdatat publike, por me besimin që një vepër e mirë nuk harrohet dot kollaj”, për Z.Yzeiraj: “botimi sjell një pjesë të jetës e veprimtarisë së autorit në kohë të ndryshme dhe njëherësh pasqyron vlerat e mjedisit familjar, shoqëror e shtetëror ku ai ka zhvilluar veprimtarinë e tij; si dhe problematikën e kohës në fushën politike të qeverisjes, të shoqëruar me përkushtimin e tij si intelektual, për ndryshim e zhvillim”.

LURA DHE PERSONALITET E LURËS NË NJË VEPËR ENCIKLOPEDIKE

Pesë vjet më parë (2018) e gjer në frymën e fundit më 20 dhjetor 2020, i ndjeri Dine Kaca, i njohur në gjithë Dibrën e më gjerë për vlerat e tij njerëzore dhe intelektuale që mishëronte e përçonte kudo, do më kontaktonte që nga Italia dhe për çdo verë që kthehej për pushime në Tiranë, për të më njohur me angazhimin e tij për të shkruar dhe botuar një monografi për Mark Ndrec Vladin e Lurës. E kishte obligim si mik i kësaj familje emërndritur për t'i dhuruar Lurës dhe lurjanëve një vepër enciklopedike, që ndonëse në epiqendër do të kishte Mark Ndrec Vladin, në tërësinë e saj do të ishin Lura dhe personalitetet e kësaj treve me histori të lavdishme.



Aktualisht, unë dhe Lenin Vladi e familja e tij e madhe, ndjehemi disi të lehtësuar që këtë angazhim të Dine Kacës e ka përmbushur më së miri akademik Preng Vorfi, me përgatitjen dhe botimin e veprës “Heroi i heshtur i kohës, Mark Ndrec Vladi i Lurës” që u promovua në Akademinë e Shkencave, të shtunën më 27 Maj 2023.

Kjo monografi është e një rëndësie të veçantë edhe për faktin se ka ekspertizën e Prof. dr. akademik Shaban Sinanit – Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave të RSH, i cili në parathënie, ndër të tjera shkruan se: “Libri i Preng Vorfit, kushtuar figurës së Mark Ndrec Vladit, është shkruar me një dashuri të shkëlqimtë për personalitetin të cilit i është dedikuar; për historinë e vendlindjes së tij, Lurës, një mrekulli natyrore e njerëzore, një rezervat virtytesh e visaresh; për trashëgiminë historike e kulturore që ka ndërlidhur Mirditë e Dibër, Mat e Lumë, me Lurën si krahinë “më vete e me të tjerë”. Figura e Mark Ndrecë Vladit, me historinë

e origjinës, të lidhjeve familjare, të vështirësive të rritjes e të formimit, të pjesëmarrjes në luftën çlirimtare si antifashist, të përgjegjësive që mori në një prej kohërave më të vështira–në vitet e mëkëmbjes së pushtetit që doli nga lufta dhe të mbrojtjes së tij prej ndërhyrjeve nga jashtë e nga brenda, ka qenë më se e mjaftueshme për një monografi”.

Parë nga ky këndvështrim, autori Preng Vorfi e ka përmbushur më së miri misionin e tij, duke na sjellë nëpërmjet referencash, faktesh e dokumentash arkivore tejet bindëse, jo vetëm profilin e personazhit të veprës së tij, por në tërësi Lurën dhe personalitetet e saj që zënë vend nderi në panteonin e vlerave. Kështu ai evidenton historinë e Lurës në dokumentat e kohës, gjurmët e lashta të jetës në Lurë, toponimet, gjetjen e 15 monedhave bizantine në Kepin e Xhitetit, në fshatin Arrëmallë, që tregon për zhvillim ekonomik të trevës; Historinë interesante të Lurës, sidomos gjatë periudhës së Skënderbeut, kur lurasit u përfshinë gjerësisht në luftë kundër pushtuesit otoman; Lurën si krahinën e fundit të islamizuar në Shqipëri; qëndresën e paepur të lurjanëve ndaj pushtuesve turq, serbë e austrohungarezë dhe kontributin gjatë LANÇ.

PATRIOTË, LUFTËTARË E PERSONALITETE TË LURËS

Referuar të drejtës zakonore, autori sjell në vëmendjen e lexuesit Pesë Kararet e Lurës që nuk janë gjë tjetër veçse Pesë Ligje dhe disa akte nënligjore, që zbatoheshin nga 12 Pleq, 12 Çekiçë e 6 Dhetarë dhe që ishin: KARARET E BESËS, BARAZIA, RRAGJET, BIMËT E GJËJA E GJALLË, si dhe TROJET.

Preng Vorfi paraqet në këtë vepër me artin e tij të fjalës patriotë, luftëtarë e personalitete të Lurës si: Kol Bib Doçi; Dom Nikoll Kaçorri–nënkryetar i qeverisë së Vlorës, Ded Mardeda (Vladi); Gjetan Loka; Ibrahim Gjoçi; Hasan Ajazi; Hasan Kaci, Xhemile Gjogjegja e Gjok Doçi, Hero i Popullit; Ndreçë Mark Vladin, mjekun e humanistin që fitoi zemrat e lurjanëve; Lenin Mark Vladin, ushtarakun që shërbeu me dinjitet për shtetin shqiptar; Ded Mark Vladin, oficerin që la mbresa në artilerinë bregdetare nga Saranda, Kepi i Rodonit, Lezhë e Shkodër, e dhjetra e dhejtra të tjerë që kanë bërë emër, jo vetëm në Lurë e Dibër, por në gjithë Shqipërinë.

PERSONALITETE TË HUAJA E TË VENDIT TONË PËR LURËN

Madhështinë e kësaj treve autori e paraqet edhe nëpërmjet personaliteteve të huaja e të vendit tonë për Lurën, si: Edit Durham, Franc Nopçe, Loro Mihaçeviç, Margaret Hacluck, koloneli britanik Maklin, Dom NIKOLL KAÇORRI, Dritëro Agolli, Ismail Kadare e të tjerë, të cilët na kanë lënë shumë burime e dokumente për Lurën..

Kështu, nëse misionarja angleze Edith Durham, shkruan në librin e saj “Brenga e Ballkanit” se: “...Lura mbetet model shumë i mirë i tolerancës fetare” dhe se sipas saj”: “Lura, është Bajraku kryesor i grupit të tmerrshëm të Dibrës (Tigrave të Dibrës), siç e quajnë edhe bashkatdhetarët e tyre myslimanë”, patriarku i letrave shqipe Dritëro Agolli, duke vizituar Lurën, shkruan: “Kur arrita në Lurë, para meje shtrihej një botë tjetër, një botë e gjelbër në të errët, të gjelbra ishin livadhet dhe të gjelbra e të errëta ishin pyjet. Shkëmbinj të e bardhë dhe të kuqërremtë dukeshin si një mur i madh, për të mbrojtur këtë thesar. Dhe ky mur, në të vërtetë, fshihte thesare”.

Ndërsa shkrimtari ynë i madh ISMAIL KADARE, në shkrimin e tij “Një mbrëmje në Lurë”, në vitin 1967, shkruan: “Rruga kalon midis kodrave të buta, të gjelbra. Majë kodrave ngrihen kullat e gurta malësore; dritare të vogla, të ngushta, frëngji, sharapollë për të luftuar. Përderisa nuk mund të hynte bashkë me rrezet e diellit dhe plumbi, atëherë... ..Mbi ato frëngji ka shtirë ai që ndodhej përjashta, nga ato frëngji është mbrojtur ai që ndodhej brenda. Dhe, të dy, ndodheshin mbi të njëjtën tokë, mbi tokën amtare. Tani frëngjitë heshtin. Krismat gjakmarrëse po zhyten dalëngadalë në harresë. Ato nuk janë fshehur në katet e ulëta të ndërgjegjes, që të shpërthejnë një ditë përsëri, ato po shkulen njëherë e përgjithmonë nga psikika e malësorit tonë. Asnjë forcë nuk mund ta shkulë nga ndërgjegjja e malësorit gjakmarrjen. As ligji, as arti, as përpjekjet e intelektualëve të ndershëm. U desh një tërmet i tillë, si Lufta Nacionalçlirimtare, për të shkundur këtë etikë të tmerrshme”.

MARKA NDREC VLADI, “QYTETAR NDERI” I LURËS

Autorit nuk i kanë shpëtuar pararendësit e personazhit kryesor të vepërës së tij, duke evidentuar: historinë me lavdi të Ndrecë Nikollë Vladit; Mara Ndue Vladin (Nëna e Marka Ndrec Vladit), e cila duke qenë bijë e një familjeje e fisi të dëgjuar në Lurë, e martuar me Ndrec Nikoll Vladin, një burrë trim e i zgjuar i fisit Vladi, një fisi nga më të vjetrit në Lurë, mbeti një zonjë fisnike, që përballoi të gjitha vështirësitë e asaj kohe... dhe për të mbrritur në fillim të gjysmës së dytë të shekullit XX, kur në Lurë shndrit një meteor, që do të rrezatojë ndër vite si Hero i Heshtur i ditëve tona. Ai është MARKA NDREC VLADI, i cili në Lurë bëri punë të mëdha për vendlindjen e për fshatin dhe për këtë, armiku e vrau në kulmin e rinisë. Ndaj nuk është rastësi që në vlerësim të kontributit të tij, Këshilli i Komunës Lurë, me VENDIM Nr. 94, datë 18.5.2015, i ka dhënë titullin “QYTETAR NDERI”, ZOTIT MARKA NDRECA (Vladi), pas vdekjes, me motivacionin: “Si trashëgimtar i denjë i një fisi me vlera patriotike e atdhetare, që u aktivizua me trimëri në LANÇ, për çlirimin e vendit tonë nga pushtimi nazifashist, ishte ndër organizatorët e parë të ngritjes së pushtetit të pas luftës në Lurë, pjesëmarrës direkt në rindërtimin e vendit të shkatërruar, përkrahu në ato ditë të vështira disa luras, që, nga regjimi politik i kohës, konsideroheshin me qëndrim të keq politik armiq, dhe mundësoi shpëtimin e disa jetëve të njerëzve në Lurë e jashtë saj, derisa dha edhe jetën e vet në moshën e rinisë, në krye të detyrës që i ishte caktuar”.

Siç nënvizova edhe në fillim, më vjen mirë që autori Preng Vorfi, për të na dhënë sa më të plotë figurën e Mark Ndrec Vladit, i është referuar edhe shënimeve të Dine Kacës, që shërbeu si kuadër i lartë, drejtues politik në Sllovë, Lurë, Maqellarë, kryetar lokaliteti në Zall Dardhë e Përgjegjës Grupi i instruktorëve në Komitetin e Partisë Dibër.

RRUGËTIMI I GJATË I MARKA NDREC VLADIT NË DETYRA TË RËNDËSISHME

Dine Kaca, si kuadër e drejtues-politik, me emër e përvojë në Dibër, kishte dëshirë të madhe të shkruante një libër me shumë vlera për Dibrën, ku në qendër të kishte si objekt veprimtarinë dhe historinë e Marka Ndrec Vladit dhe të bashkëshortes së tij Dila. Autori Preng Vorfi, materialet e Dine Kacës i ka trajtuar siç i ka në shënimet e tij, duke ruajtur autenticitetin e tyre nga origjinali. Dhe ja çfarë shkruhet ndër të tjera në shënimet e Dine Kacës: “Rrugëtimi i gjatë i Marka Ndrec Vladit në detyra të rëndësishme dhe kontributet që dha gjatë Luftës Nacionalçlirimtare deri në çlirimin e plotë të vendit dhe në vitet e para të periudhës së pasluftës, në kryerjen e reformave dhe të aksioneve për të zgjidhur emergjencat për Lurën, pjesëmarrja e tij aktive për ndërtimin e Shqipërisë së Re dhe periudha si oficer i Sigurimit të Shtetit, janë një dëshmi e gjallë e njeriut që e lidhi gjithë jetën e tij për t’i shërbyer deri në çastet e fundit të jetës Atdheut e shoqërisë shqiptare. Në karakterin e Marka Ndrecës lindën dhe u formuan, lulëzuan dhe u demonstruan virtyte e cilësi të rralla: dashuria e përkushtimi që Marku kishte për Atdheun, për t’i shërbyer atij edhe me sakrificë supreme. Te Marka Ndreca ishin çimentuar guximi dhe trimëria, mprehtësia dhe nuhatja, gjakftohtësia dhe shpejtësia e manovrimeve për zgjidhjen e situatave në kohë lufte e paqeje. Ai pati krijuar marrëdhënie të mira me të gjitha grupmoshat, që nga fëmijët e shkollave e deri te të moshuarit. Zotëronte informacione të hollësishme e të gjithanshme, realiste dhe, mbi këtë bazë, ai vepronte me kurajë, duke marrë vendime të drejta, të cilat i zbatonte në kohë në vendin e duhur. Karakteri e patriotizmi i Marka Ndrec Vladit kishte një bazament me themele të qëndrueshme. Ai as nuk shitej tek të tjerët dhe as nuk blihej, qëndronte njeriu më me besë, që e bën të fortë e më të besueshëm te njerëzit, i cili fitoi zemrat e tyre. Gjatë luftës bëri më shumë se partizani partizanëve. Në fillim të vitit 1942, në bashkëpunim dhe me ndihmën e Gjok Doçit, Marka Ndreca në shtëpinë e tij krijoi grupin apo njësitin e parë të të rinjve antifashistë për Lurën. Kulla e Marka Ndrecës u bë shtëpia e parë ilegale në Lurë, kur Gjok Doçi vinte

nga Shkodra e bënte propagandë kundër regjimit fashist. Marku dha një kontribut të madh në rrugën e Brigadave III– IV S në të gjitha veprimet e tyre për çlirimin e Lurës e të Mirditës, si ndërlihdhës e informator, kreu shumë takime me krerë e kuadro të luftës në zonën Fan-Mirditë. Pas çlirimit, Markut iu besuan detyra me rëndësi, si: kryetar i Frontit për Lurën, anëtar i lokalitetit, drejtues i Partisë për Lurën dhe detyra të tjera në Komandën e vendit, në Lurë e Selishtë. Në kohën kur mori de juro e de fakto detyrën e oficerit të Sigurimit të Shtetit, Marka Ndreca do të jetë njeri më i besuar për të ndihmuar shumë lurjanë që kishin hyrë në rrugën qorre. Ai arriti t'i bindë dhe ata të largohen nga rruga e gabuar ku ishin futur. Marka Ndreca, duke qenë një kuadër i aftë, diti të punojë me të gjitha shtresat e popullit, me individë të gënjyer, që nuk kishin kryer krime dhe i ktheu në rrugën e mbarë, por u bëri thirrje edhe krerëve që ishin bashkuar me armiqtë dhe vepronin bashkë me bandat kundër pushtetit popullor. Rasti më tipik për Marka Ndreca është puna e madhe e tij në Selishtë, në luftë kundër bandave, me radiolojën “LIQENI I VAJKANIT”, ku u kapën dhe u shpartalluan 10 banda deri në fund, me likuidimin e bandës famëkeqe të Hamit Matjanit. Marka Ndreca, me aftësitë e tij, ndihmoi një burrë fisnik në Selitë të Mirditës, Preng Gjok Dedën, që e largoi nga bandat, të cilit iu fal jeta dhe u kthye në familje me tre djemtë. Në misionin e ri dhe të fundit që Marka Ndreca iu dha në fundvitin 1953, duke hyrë viti 1954, nga Dega e Brendshme e Dibrës me Degën e PB të Mirditës, ai përfundoi tragjikisht në mbrëmjen e 1 janarit 1954, duke rënë në krye të detyrës, vetëm 500 m larg shtëpisë së tij. Kjo ishte një vrasje e pastër politike e tipit UDB, që ka lidhje për shkak të detyrës, për faktorë e motive politike dhe të aktivitetit të tij të gjithanshëm. Ceremonia mortore ishte madhështore. Mori pjesë gjithë Lura, burra të ardhur nga Reçi, Dardha e Selishta, erdhën të shumë të edhe nga Mirdita. Në ceremoninë e përmortshme qënrim burrëror mbajti edhe nëna e tij Dila Marka Ndreca. Ajo ishte një grua e veçantë, me kontribute të jashtëzakonshme gjatë Luftës, përkrah Marka Ndreca. Këtë e tregoi me pritjen e përcjelljen e partizanëve, në aksionet lokale e kombëtare për zhvillimin e Lurës. Ajo u zgjodh kryetare e organizatës së gruas në Lurë dhe e drejtoi me përkushtim e aftësi deri në fund. Ishte shembull në aksione për luftën kundër analfabetizmit, pjesëmarrjes së vajzave e të grave në luftë kundër zakoneve prapanike dhe afirmimin e së resë, modeli i gruas në

familje e shoqëri. Kjo familje do të mbetet gjithmonë një trashëgimi e vyer për Lurën dhe lurjanët.”

LURA, ME BUKURI PËRRALLORE, LIQENE, QË KRAHASOHEN ME ZVICRËN E VENDET NORDIKE

Profili i Mark Ndrec Vladit, si dhe i nënës së tij Dila Marka Ndreca, plotësohen më së miri në këtë monografi edhe nga opinion/vlerësimet e shkruara për të nga: Tefta Cami, ish-Ministre e Arsimit dhe Kulturës; prof. dr. Petrit Bara; Ahmet Kaçorri; Ilir Balili; Nezir Buci; Haziz Ndrejoni; Ramazan Vladi; Ded Llesh Doçi; Fadil Asllani; Han Sul Kaci; Lazam Istref Kaci; Ismail Staf Hoti; Qazim Prrejsi; Fatos Daci; Xhaferr Han Mena; Osman Vladi; Zef Vladi; Demir Osman Vladi; Aqif Ademi; Ali Ibrahim Mena; Halit Karasani; Pjetër Lleshi; Elta Lenin Vladi, Mevlud Buci dhe Nikoll Vladi. Këto opinion/vlerësime kanë si emërues të përbashkët atë që shkruan autori Preng Vorfi si dedikim: “Të shkruash për Lurën është sa e vështirë, por edhe kënaqësi, se ke të bësh me një trevë me histori të lavdishme në të gjitha periudhat e historisë, nga Mesjeta, Koha e Artë e Skënderbeut, luftërat, nga dyndjet sllave e deri në Luftën e Parë e të Dytë Botërore, Lufta e lavdishme Nacionalçlirimtare e deri me çlirimin e plotë të vendit. Ke të bësh me një zonë fizikogjeografike të rrallë, me bukuri përrallore, liqene, që krahasohen me Zvicrën e vendet nordike. Lurjanët janë një popull kreshnik. Në të gjithë rrjedhat e historisë kanë qëndruar kryelartë, si krahina e Kanunit, e unitetit të besimeve fetare dhe e Karareve. Lura është vendi që ka shkruar faqe të lavdishme të historisë dhe ka nxjerrë heronj, si: Gjok Doçi, burra shteti, si Dom Nikoll Kaçorri, nënkryetar i parë i Qeverisë së Vlorës, 1912, e dëshmorë në luftën për ruajtjen e trojeve shqiptare e deri te Marka Ndrec Vladi, që u flijua në krye të detyrës”

MIRËNJOHJE ÇAMËRIE PËR DIBRËN E DIBRANËT

Libri i Namik Selmanit, një model i bukur gjuhësor, i shkrimit të gjuhës amtare

Pena e artë e poetit, studiuesit, eseistit e publicistit të mirënjohur Namik Selmani “shtegton” kësaj radhe në Dibrën e “Nëntë Maleve” kreshnike, duke sjellë prej andej vlera të rralla natyrore e njerëzore, ende të panjohura për lexuesin në një libër mjaft të veçantë. Një libër për mirënjohjen, në hyrje të cilit autori shpreh “Një falënderim Çamërie e mbarëkombëtare për atë që krahina e Dibrës i ka dhënë kombit”.

I ndërtuar mbi një treshe magjike, ky libër sjell për lexuesin recensionë, portrete njerëzore, poezi dhe ese poetike, të frymëzuara nga Dibra dhe dibranët.

“Kur hyra në shkollën dibrane, isha nxënës dhe dola prapë nxënës”, shprehet autori Selmani, i cili më tej vlerëson pa asnjë mëdyshje se DIBRANIZMI është një portë rrezatuese të cilën, të gjithë në Shqipëri e në diasporë, duhet ta bëjnë atë pjesë të kulturës së tyre. “E dibranizmi na jep mjaft zemër e shpirt, themi se ai jeton e do të jetojë tashmë edhe në urtinë e tij. Mbase nuk është e rastësishme që nga kjo krahinë kanë dalë mjaft ushtarakë e intelektualë të fushave të ndryshme të jetës...”

Nuk është e rastësishme që dhe boksierët më të mirë të kombit e me kurora bote (Ismail, Gjetan e Ferit Keta), të kenë lindur në këto troje. Është emocion të dëgjosh këngët, elegjitë dibrane si perla të muzikës së kombit tonë, të interpretuara mjeshtërisht nga Arif Vladi, Hazis Ndreu, Liri Rasha, Qerim Sula, Vera Laçi, Sherif Dervishi e Dritan Jashari...

Nuk është e rastësishme që lojërät e fëmijërisë i burrëronin më shpejt se mosha fëmijët e saj siç ishte “kalaja dibrançe”. Mbase edhe manushaqet,



ashtu si dardhat, kumbullat, mollët kanë atje një aromë që nuk e shijon në ndonjë vend tjetër.... Nëse diku keni dëgjuar e keni përsëritur shprehjen “Mat shtatë herë e prit një herë!” për Dibrën bashkë me këtë urtësi popullore, duhet të keni kaluar Shkollën e Dashurisë për Shkronjën. Madje dhe mirë. Duhet të keni kaluar e të jeni përballur me një ujëvarë mentarie. Nëse nuk je i stërkaluar i tëri me atë ujëvarë, duhet me e pasë njomur me të penën tuaj, sytë tuaj!”, –shprehet ndër të tjera autori i këtij libri.

DHURATË PËR DIBRËN E DIBRANËT NGA BOSTONI

Në këto 30 vitet e fundit, po edhe më herët janë shkruar me qindra e qindra libra për Dibrën. Kjo temë dhe liria e fjalës ka nxitur mjaft shkrimtarë, historianë, poetë. Ky libër, i botuar nga shtëpia botuese prestigjioze “M&B”, i shkruar për Dibrën, është krejt i veçantë. Është shkruar nga një njeri i mirë i Çamërisë që quhet Namik Selmani. Më shumë se fjala e tij është një mirënjohje që një krahinë plot tradita e plot dhimbje si Çamëria, duket se ia bën Dibrës, por edhe vetë këtij shkrimtari. Ai jeton prej disa vitesh në Boston e, siç e thotë dhe ai vetë, e ka shumë të dashur këtë libër për të cilin ka punuar gati 20 vite. Është një dhuratë që ai ia bën Dibrës në një përvjetor të veçantë siç është 70-vjetori i lindjes, ndërkohë që vetë Dibra, miqtë e tij dibranë dhe unë personalisht e uroj nga zemra për shëndet e për vepra sa më të arrira. Edhe për faktin se ky libër i tij vjen si një “dhuratë” nga Bostoni për Dibrën e dibranët. Para një të vërtete të prekur, unë do të thosha se libra të tillë janë të rrallë e për këtë, mirënjohja e lexuesve dibranë e më gjerë është e madhe. Kam pasur disa raste të bashkëpunimit konkret me Namikun, si në librat për Rrahman Parllakun, për Skënder Calën, etj. Madje nuk duhet të çuditeni se në gazetatat dibrane si “Rruga e Arbërit” e “Bulqiza” ai boton herë pas here poezi dhe ese që pëlqehen nga lexuesit. Në katër kapitujt e këtij libri ka recensionë (parathënie librash), portrete, ese poetike dhe poezi të autorit Namik Selmani. Kështu në kapitullin e parë gjejmë recensionë për librin tim “Në panteonin e vlerave”; Refleksione mbi librin e dr. Islam Canit “Rrënjët historike të Kastriotëve të Çidhnës”; Mendime për librin e Abdurahim Ashikut “Rrëfimet e Komshiut”; Mendime për librin me poezi “Ura e Fjalës” të poetit Demir Rusi....

VLERAT INTELEKTUALE, MORALE E MATERIALE

H.Rama shkruan për Shuaip Methasanin, intelektualin dibran që rrezaton mirësi dhe vlera, duke vlerësuar dy librat e tij–testament për brezat ku përshkruhen më së miri vendlindja, historia e lavdishme, personazhe e personalitete që kanë bërë historinë e traditat më të mira. Po në kapitullin “Portrete”, autori shkruan për Muharrem Gjokën, si mishërues dhe përçues të fjalës së mençur dibrane. Shkruan për këtë dibran të shquar që u “diplomua” në kantieret e ndërtimit e asfaltimit të rrugëve në gjithë vendin, ku implementoi suksesshëm dijet e marra në “Universitetin e Dibrës”, leksionet e të cilit i përvetësoi nëpër odat e kuvendet dibrane...., shkruan për vitet e jetën e Doktorës së Shkencave Mjekësore Suzana Zhuka–Nuellari që si okuliste e talentuar e sheh jetën me sytë e dashurisë për profesionin e njerëzit... ..,shkruan për intelektualin dhe biznesmenin e suksesshëm Latif Miha, i cili ka përvojën, moshën, fuqinë intelektuale, morale e materiale që t’i përkushtohet sipërmarrjes....

Në këtë libër autori “rrugëton” në gjurmët e jetës dhe veprës së Shemsi Prençit–muhurakut që ka qenë dhe mbetet në garën e madhe dhe të ndershme me forcën dhe motivin për t’i shërbyer kombit...Më tej ai shpreh fjalë zemre për gazetarin Defrim Methasani , që si ikonë e gazetarisë sportive dhe e dokumentarit televiziv jeton dhe punon brenda mençurisë dhe humanizmit dibran. Nën titullin “Lum kush njih vëllezërit Rusi”, autori shkruan për Demir e Baftjtari Rusin, duke ua “peshuar” fjalën ndershmërisht! I gdhendur mjeshtërisht është në këtë libër edhe portreti i Prof. Dr. Bujar Kapexhiut, Mjeshtër i Mjeshtrove–“Nderi i Kombit”. “Mirënjohje për mirënjohjen” është titulli i profilit të artistit Skender Cala, ikonë e artit dhe kulturës kombëtare.

Në këtë kapitull, autori shkruan edhe për urtakun e përjetshëm Azis Keta, për të cilin shprehet se ka të paktën rreth 30 vite që e njih nga afër....

Kështu, nëse Bujar Kapexhiu–“Nderi i Kombit” është pasqyra më e bukur e shpirtërave njerëzorë, të asaj që e duam si fabul, si gjendje shpirtërore, të punëdashjes e artdashjes, “Nderi i Kombit” Hazis Ndreu vjen si një shpirt lirie i derdhur në një këngë -simfoni. Referuar vargjeve

të kësaj kënge (kënga e “Hajredin Pashës”), autori pohon se që prej gati 300 a 400 vitesh ka ardhur në ditët tona ajo urti dibrane që e solli koha, që e vulosi koha atëherë dhe sot: “Nëse do të humbë Stambolli, Dibra do ta ndërtojë atë e nëse humbet Dibra, Stambolli nuk mund ta ndërtojë më atë”... Dhe e dini se cili është gjoksi që mban këtë vrundullimë të egër? Janë vetë malet. Jo male të zakonshëm, se kudo në botë ka male, ka lumenj, ka gryka, ka kroje dhe dete, po këtu malet kanë shpirt qëndrese që dinë të bëjnë edhe BESË. E pas besës vjen BELAJA. Nuk e dimë se sa e njeh fjalorin e ushtrive këngëtarit popullor, apo ai rapsod që ka bërë vargjet e saj. Po fjala BELA është më e mira që e tregon humbjen, disfatën, sfidën e fituar. Përballë BESËS është vdekja. Këtu nuk ka diplomaci sallah të fshehta, nuk ka traktate, nuk ka marrëveshje të firmosura me një lloj ceremoniali të rrallë. Këtu flet vetëm pushka. Jeta dhe vdekja për liri nuk rrinë në asnjë vend të Ballkanit më afër se në këtë grykë të Radikës....

NJË MODEL I BUKUR GJUHËSOR I SHKRIMIT TË GJUHËS AMTARE

Në kapitullin e tretë “Ese të zgjedhura”, si redaktor i librit do të veçoja esetë poetike me tituj:

- “Amaneti i këngës” (Në kujtim të këngëtarit dibran Qerim Sula-“Mjeshtër i Madh” dhe “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut);
- “Simfonia” për Çamërinë” (Në gjurmët e këngës së Arif Vladit-“Mjeshtër i Madh” dhe “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut);
- “Një shpirt lirie i derdhur në një këngë” –simfoni duke ndjekur këngën “Kënga e Hajredin Pashës”;
- “Moj Fusha e Korabit, o e mjera unë-oooo” (Në vend të një mirënjohjeje publike për këngëtarët e shquara dibrane Liri Rasha dhe Vera Laçi - Meditim për këngën “Oj Fusha e Korabit”);
- “Ylberi nuk shuhet, edhe pse shekujt ecin me revan të pandalur” (Për këngën “Kur e përçolla ylberin”).

Libri “Jehona e urtësisë dibrane” mbyllet me kapitullin me një tufë poezi të frymëzuara nga Dibra. Me një gjuhë letrare dhe rrëfim të admirueshëm ato të emocionojnë për detajet e stilin që ai ka zgjedhur dhe që e bën origjinal. Ky libër është një vlerë për historinë e Dibrës që mund

të ushqente mjaft muze të saj, atë të luftës, të arsimit, të teatrit, të ushtrisë, të shkencës, etj. Është një model i bukur gjuhësor, para të cilit mësuesit e gjuhës amtare do të shihnin modelin e mirë të shkrimit të gjuhës amtare. Dhe këto nuk janë pak që edhe vetë libri, ashtu si personazhet e tij, të vihet në “vitrinën” e kulturë së shkruar shqiptare të viteve të fundit.

<http://rrugaearberit.com/2021/02/04/jehona-e-urtesisedibrane-nelibrin-e-ri-te-poetit-namik-selmani/>

CIP Katalogimi në botim BK Tirana

Rama, Halil

40 vepra letrare të 40 autorëve, në “skaner”: profile krijuesish dhe
kritika letrare / Halil Rama ; rec. Eshref Ymeri ; red. Hajri Mandri. -



Tiranë : Univers, 2024.

232 f. : me fotogr. ; 16 x 23 cm.

ISBN 9789928355935

1. Letersia shqipe
2. Autorë shqiptarë
3. Kritika, interpretimi

821.18 .09



ARTI I ANALIZAVE KRITIKE TË HALIL RAMËS, MJESHTËR I MADH

Mjeshtri i penës, Halil Rama, njihet si një analist veprash të gjinive të ndryshme. Kjo vepër është një kaleidoskop idesh, përsiatjesh, faktesh. Janë 40 vepra të gjinive të ndryshme, të 40 autorëve, duke filluar nga vepra biografike e një autoreje amerikane, kushtuar jetës politike dhe artistike të ish-presidentit amerikan Ronald Reagan (Ronald Reagan -1911-2004), dhe duke vazhduar me krijimtarinë e autorëve tanë, të pasqyruar në prozë artistike, në poezi, në letërsi dokumentare, në diplomaci dhe në monografi.

Duke pasur parasysh këndvështrimet mjeshtërore të Halil Ramës, i cili ka një përvojë mjaft të pasur në fushën e kritikës letrare, lexuesi gjen në këtë libër artin e fjalës të këtij kritiku të talentuar ...

Prof. dr. Eshref Ymeri

Çmimi 1200 lekë

